

**DHIMITER XHUVANI**

8.11.2

24 97

■ Kur ndërrohen kohërat

■ Mbas dy vjetësh

■ Në prag të jetës

■ Në jetë

**drama**

8JH-2

2697

Dhimitër  
Xhuvani

## DRAMA

- Kur ndërrohen kohërat
- Mbas dy vjetësh
- Në prag të jetës
- Në jetë



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

## VETAT:

KOSTANDINI	— i ati i Zafirës, plak shtatëdhjetëvjeçar
SOSIA	— e shoqja, plakë dhe ajo
ZAFIRA	— e bija, bareshë, ka mbaruar tetëvjeçaren
ISAKU	— elektrikist, 30 vjeç
XHEMALI	“ 22 “
SKËNDERI	“ 21 “
ANDONI	— prift që tani ushtron profesionin e kallajxhiut
MIRI	— shkes
MARIA	— anëtare e këshillit
SPIROJA	— sekretar i Partisë
I ATI I DHËNDRIT	— i ri nga fshati që mëson zanatin e elektrikistit
DJALI	
DAFINA	— shoqe e Zafirës
NDREKA	— fshatar, rreth të 60-tave
MARKU	— “ “ “ 50-tave

*Figurantë. fshatarë, të rinj, të reja, gjeometër, teknikë.*

**(Ngjarjet zhvillohen në fund të viteve 60, në një fshat malor.)**

## AKTI I

### SKENA I

*(Një dhomë e zakonshme fshati, e madhe dhe me oxhak. Njëra derë të lidh me dhomën e zjarrit, kurse tjetra të çon në dhomën e miqve. Përballë janë dy dritare të vogla me hekura në formë kryqi. Dhoma e grave është më e ngritur 5-6 shkallë. Shkallët zbresin gjer në oborr ku është një portë e madhe.)*

KOSTANDINI — Do të ishte mirë të na linin rehat. Kjo shtëpi s'është për dritë elektrike. Mua do të më pëlqente ta shoh kështu siç është deri ditën që do të mbyll sytë.

MIRI — Nuk është puna aty, Kostandin, se si të pëlqen ty ose mua. Ne i kemi ditët të numëruara dhe s'na vjen mirë që dikush të na shtyjë me bërryl, të na prishë gjumin, që të lëvizim një çikë, të ecim përpara, siç thonë, de! Mirë për krijimin e kooperativës, hajt po e bëjmë kabull se s'kemi si i shpëtojmë dhe ne, malësia, po...

KOSTANDINI — S'po të marr vesh!

MIRI — *(Përpiqet të buzëqeshë.)* Po ja, do të vijnë e do na shpojnë muret, çatitë, do hapin brima, do fusin tela me korent. Fap *(lëviz gishtin e madh)* dritë, fap, errësirë.

KOSTANDINI — Si në qytet.

MIRI — Si në qytet, po a janë shtëpitë tona si në qytet? Ja, të vajti fëmija dhe e zuri me dorë. Të iku.

KOSTANDINI — Korent.

- MIRI — Korent, po sa ka prapa ai malukat se! Janë ca shufra të spërdredhura që po t'i futësh në ujë vlon sikur të kesh futur shejtanin brenda.
- KOSTANDINI — Jo, ore! Këtë s'e kisha dëgjuar, ujë me korent...
- MIRI — S'e ke dëgjuar se ti nuk je i dalë, as shkollë s'ke, po më pyet mua. Jo se kam shkollë, jo, por kur isha në kamp...
- KOSTANDINI — Ku?
- MIRI — Në burg, de!
- KOSTANDINI — A, po!
- MIRI — *(Bën kryq.)* Zot na ruaj nga korenti! Shpikje më të keqe se atë të mos dish. E preke me dorë, top në vend. As ciu, as miu. Dëgjoje fjalën time, Kostandin!
- KOSTANDINI — Mund të jetë ashtu si thua ti, po prapë s'më besohet, se gjithë qytetarët s'janë budallenj që e kanë futur në shtëpi korentin.
- MIRI — Të tjera shtëpi janë ato, të tjera shtëpi janë tonat. *(Kërcet dera e dhomës së zjarrit. S'andejmi hyn Zafira me një tabaka dhe dy kafe. Fshatari merr kafën pa e vështruar vajzën, po ashtu dhe i ati. Zafira drejton trupin dhe bën dy tri hapa mbrapa. Kokën e mban të ulur dhe vështron që nën vetulla.)*
- KOSTANDINI — *(Vështron të bijën vrazhdë dhe i bën shenjë që të largohet. Zafira hyn në dhomën e zjarrit. Derën e lë hapur dhe përgjon.)* Nuk kam frikë, jo, shtëpia ime është gur, themelet gur, muret gur, çatia gur, po...
- MIRI — Edhe ti gur je, o Kostandin *(Me dredhi)*
- KOSTANDINI — Si thatë?
- MIRI — I fortë je.
- KOSTANDINI — Mbase.
- MIRI — Po, po, mirë e the, mbase! Eh, tani burri s'ka ku e tregon burrërinë; vdiqën ato kohëra, o Kostë!
- KOSTANDINI — *(E ka parë se e bija përgjon.)* Tyt! Lanet!

MIRI — Ç'thatë?

KOSTANDINI — *(Duke çukitur me mashë.)* I thirra asaj të ngrejë fälxhanet. *(Hyn Zafira me sytë përdhë. Merr filxhanet dhe largohet.)*

MIRI — Vdiqën ato kohëra. Tashti s'je më zot as i tokave të tua, as i bagëtisë, as i shtëpisë sate, de, as i fëmijëve të tu.

KOSTANDINI — Unë jam dhe do të jem.

MIRI — Ashtu qoftë, po duhet të mbahesh. Ja, ke vajzën. Ajo e para mund të të turpërojë. Ti e ke të fejuar që në djep, apo jo?

KOSTANDINI — Po!

MIRI — *(Tund kokën.)* Keq i ke punët. Nxirre sa më parë se nga ç'po marrim vesh, me këtë luftën e re kundër zakoneve...

KOSTANDINI — Ajo është pjella ime dhe unë i ati i saj.

MIRI — Ashtu është, po nderi e do që ta mbyllësh. Njerëzit e dhëndrit këtë porosi më dhanë dhe...

KOSTANDINI — E mbylla, e mbylla. Mjaft ndenji jashtë. Shkollën e mbaroi, tetë vjet shkollë. U thuaj të rrinë të qetë.

MIRI — Tetë vjet shkollë nuk janë pak për një burrë, kurse për një grua janë shumë.

KOSTANDINI — Mund të jetë ashtu si thua ti, po për çikën time jo. Mësuesi më mbeti në derë. Dhe të këshillit më mbetën në derë që ta çoja të ndiqte shkollën më lart, në qytet. Mësuesi thoshte se Zafira është... nxënëse shumë e mirë, po ata, të dhëndrit nuk donin, dhe unë isha me gjysmë mendje. Po, nejtë. Tani, ç'duan?

MIRI — Duan ta marrin.

KOSTANDINI — Si the?!

MIRI — Një ditë e më parë, brenda muajit, brenda javës. Ja që më mbeti mua kjo krushqi.

KOSTANDINI — Nuk e kuptoj përse nguten ata dhe ti, o Miri?

MIRI — Sepse s'ka më siguri prindi, o Kostandin! Është fushatë e madhe kjo, o Kostë!

KOSTANDINI — S'po ta marr vesh gjuhën, o Mir Shaluku.

MIRI — Fushata është si puna e ortekut. T'i bësh bisht se të rrëmben. Më mirë të shkojë goca në fat të vet. Tashti edhe veshët nuk çuditen nga ato që dëgjojnë. Ka plasur cipa fare. S'e ka për gjë çika të lëjë të fejuarin e të lëjë shtëpinë. Bën çfarë t'i shkojë për mend. Mjaft që të jetë kundër t'et, kundër zakonit. Nuk e kuptoj se ç'është ky dreq që u ka hyrë në tru. Jepe, Kostandin; një orë e më parë.

KOSTANDINI — Unë e kam të urtë! Pa shih! *(E thërrret duke goditur mashën pas vatrës.)*

ZAFIRA — *(Hyn ngadalë, kokulur, me sytë përdhë. Afrohet tre katër hapa dhe ngadalë ngre kokën.)*

KOSTANDINI — Ma ndiz! *(Ajo merr mashën dhe i ndez llullën.)* Shko! *(Zafira bën dy tri hapa prapa, pa u kthyer, pastaj kthehet anash dhe del ngadalë.)* — E, e pe?

MIRI — E pashë.

KOSTANDINI — Hë, si të duket?

MIRI — E bindur, si dele.

KOSTANDINI — Është dhe me shkollë. Ka më tepër shkollë seç kemi ne të dy bashkë. *(Qesh.)*

MIRI — *(Qesh.)* E po, mirë thonë që dituria është urti.

## SKENA II

*(Hyn plaka)*

SOSIA — Mirë se erdhët!

KOSTANDINI — Pse u vonove, moj grua?

SOSIA — Në fshat erdhën disa punëtorë për dritat. I priti e gjithë brigada. Përtej shtëpisë, pranë obo-rrit tonë, do të ngrënë një kullë të vogël e të

gjatë, një kullë me një konak të vetëm. Nga kjo kullë do të marrë dritë fshati ynë dhe fshati fqinj. E zgjodhën vendin pranë shtëpisë sonë që të bjeri në mes të dy fshatrave. Si puna e shkollës së vjetër.

MIRI — E, të thashë? Ja, paskan mbërritur. Pa, pa, sa të shpejtë që janë! Sa erdh haberi, erdhën dhe ata.

KOSTANDINI — E pastaj? (*Sheh me inat plakën.*)

SOSIA — Hiç. (*Murmurit nëpër dhëmbë.*) Pastaj... njëri prej punëtorëve do të rrijë te ne.

KOSTANDINI — Si?!

SOSIA — Njëri, vetëm njëri. Të tjerët do të shkojnë nëpër dyert e tjera.

KOSTANDINI — Kush vendosi kështu?

SOSIA — Maria.

KOSTANDINI — Kush, moj?

SOSIA — Maria, o burrë, Maria e këshillit!

KOSTANDINI — E pse s'ma tha mua Maria po të tha ty? Kush është zot këtu?

SOSIA — Mos u rrëmbe! Mua më gjeti, mua më tha. Po të të kishte gjetur ty, ty do të të thoshte.

MIRI — E po, tashti kështu u kthyen punët, o Kostë. Gratë s'janë më veç për punë shtëpie. Ato kanë shumë gjëra në dorë, bile dhe këshillin.

KOSTANDINI — Jo, besa, në shtëpinë time s'kanë kurr-gjë. Pas vdekjes sime, le t'i bjeri zjarri. Sa jam gjallë, jam unë. Për këtë nder burri u vranë gjithë burrat e kësaj shtëpie.

MIRI — E di, e di fort mirë se ç'shtëpi pushke ka qenë dhe është kjo kullë e veçuar midis dy katundeve.

SOSIA — (*Duke psherëtirë.*) O zot! Si jua mban zemra të zini në gojë atë kohë të kobshme, që nxiu këtë shtëpi.

KOSTANDINI — Mjaft, grua!

SOSIA — Ja, ai po vjen.

KOSTANDINI — (*Bëhet nevrik, lëviz i shqetësuar drejt dritares dhe sheh punëtorët që po vijnë.*)

ZAFIRA — (*Ka dëgjuar gjithë bisedën te pragu i derës.*)



*Flet me shpoti.)* Tatë! Po zakoni thotë që miku të pritët mirë!

KOSTANDINI — Tyt, lanet, ti do të më mësosh mua?!  
Dhe çfarë! Ç'thotë zakoni?

SOSIA — Ku do ta vendosim?

KOSTANDINI — Në konakun e miqve, ku gjetkë.

MIRI — *(Me ironi)* Mirëmbetsh, o burrë! Ky do të jetë i pari mashkull që do të rrijë gjatë në këtë shtëpi. Qoftë e hajrit ardhja e tij! *(Largohet.)*

### SKENA III

*(Hyjnë Maria dhe tre pënëtorë. Të gjithë i kanë duart e zëna me plaçka, kush me trasta, kush me rrytë, kush me valixhe ose pallto të madhe. Kanë bërë shumë rrugë dhe janë të lodhur dhe me baltë, janë dhe të gëzuar e të qeshur. Dikush i ka bërë të qeshin që jashtë. Hyjnë gjithë zhurmë e gëzim. Përhëndeten me Sosën, pastaj me Kostandinin që rri e pret në dhomë.)*

MARIA — Ta zumë konakun, o Kostandin! *(I jep dorën.)*

KOSTANDINI — Mirë sa ju pruri e mira!

XHEMALI — *(I zgjat dorën.)* Tungjatjeta, i zoti i shtëpisë!

KOSTANDINI — *(I jep dorën.)* Tungjatjeta e mirë se erdhët?

SKËNDERI — A je burrë i fortë, o Kostandin?

KOSTANDINI — Vallahi si plak nuk jam keq, gjynah të qahem... Po emrin nga ma ditke?

SKËNDERI — Ka nja dy orë që ta mësova emrin. Në rrugë pyeta një fshatar se sa mban fshati juaj, ai na tha se pas kullës së Kostandinit do dhe një gjysmë ore. Bile na e tregoi me dorë shtëpinë tuaj majë malit. Si bëmë dhe një copë

udhë kulla na humbi sysh. Shyqyr që gjetëm shoqen e këshillit.

KOSTANDINI — Edhe po të mos e kishit gjetur këtë (tregon Marien) shtëpinë time do ta gjenit. Rruga vetë do t'ju sillte në oborrin tim dhe nata do t'ju detyronte të trokisnit.

SKËNDERI — Qoftë me nder kjo shtëpi!

KOSTANDINI — Ejvallah! Po ti, o mik? (I drejtohet Isakut dhe i zgjat dorën.)

ISAKU — (I jep dorën.) Për besë, u lodhëm. Kur pamë shtëpinë tënde na u çelën sytë.

KOSTANDINI — Mirë se ju pruri e mira, o burrë, urdhëroni e zini vend!

MARIA — Jo, jo faleminderit! Nuk do të zenë vend. Vetëm njëri do të rrijë këtu, të tjerët do t'i çoj në fshat. Këta s'janë miq vetëm për një natë.

KOSTANDINI — Ashtu qoftë, po uluni njëherë.

XHEMALI — Jo, faleminderit, po të ulemi s'ngrihem më. — (Shikon nga Maria. Kostandini e vë re.)

KOSTANDINI — Jua paska prishur mendjen kjo flokëprera. Po derisa shkelët në konakun tim do të bëni si them unë e jo si thotë ajo. I pari në këtë shtëpi jam unë. Dhe aq bukë sa për tre burra kam.

MARIA — Ju thashë që të hynte vetëm njëri? Ky, po të futi në shtëpi, s'të nxjerr pa lagur. Ulemi atëherë! (Të gjithë ulen. Sosia del.) Rrimë ca sa të çlodhemi, pastaj nisemi! S'kemi ç'i bëjmë Kostandinin.

KOSTANDINI — Epo, mirë se erdhët! (U jep dorën me radhë sipas zakonit. Maria e kupton se plaku do t'i pyesë të gjithë, ia merr fjalën nga goja.)

MARIA — Të gjithë janë elektrikistë. (Kostandini, që ishte bërë gati të fliste, përcillet dhe matet përsëri t'i pyesë. Po Maria përsëri ia pret fjalën.) Dhe që të gjithë janë nga qyteti, punojnë në NISH-elektrikun.

KOSTANDINI — Po ti prit një herë, oj e këshillit,

këta kanë gojë e flasin vetë. (*Të gjithë qeshin.*)  
Vallahi, kështu s'më ka bërë vaki ndonjëherë.  
Ty të kemi zgjedhur në këshillë për punë të fshatit e jo për të prishur muhabetin e burrave.

XHEMALI — Ajo ngutet se do që ne të rehatohemi sa më parë, pasi nesër do të fillojmë nga puna.

KOSTANDINI — Puna e mbarë ju qoftë, po jo kaq me ngut.

SKËNDERI — Për katër vjet duhet të ndriçojë gjithë Shqipëria.

KOSTANDINI — Mirë boll, po të njihemi njëherë, kush jeni, si ju quajné.

ISAKU — Këtu ke të drejtë, o Kostandin. Këtë shokun e quajné Skënder, është i Tasim Çukës, këtë e quajné Xhemal, është i Ali Zahos, mua më quajné Isak, jam i biri i Demir Kallajxhiut. Që të tre jemi nga Elbasani.

KOSTANDINI — (*I kënaqur.*) Ashtu! Tashti nisëm muhabet burrash. (*Hyn Sosia me tabaka në dorë. I qeras me raki dhe u jep të gjithëve, veç Maries.*) Hajt pra, gëzuar e mirë se erdhët! (*Punëtorët shohin të habitur nga Sosia që nuk i dha raki Maries.*) Hajt pra, gëzuar! (*Matet ta çokasë gotën pas Isakut që ka pranë dhe kupton pse ngurrrojnë ata.*) Mbushja një gotë dhe Maries! (*Plaka del dhe vjen me një gotë tjetër rakie.*)

ISAKU — Gëzuar e mirë se të gjetëm!

XHEMALI — Gëzuar!

SKËNDERI — Gëzuar!

MARIA — Gëzuar! Kur të ndizen dritat do ta tundim.

KOSTANDINI — Si thatë?

MARIA — Do ta tundim sa të çuditet bota.

KOSTANDINI — Gëzuar!

(*Të gjithë e pinë me fund, Maria sa e vë në buzë, shikon në derën përballë Zafirën, me tabaka në dorë. Zafira hyn. Punëtorët dhe Maria ngrihen në këmbë. Zafira hutohet. Sosia ia merr tabakanë nga dora.*)

MARIA — *(Punëtorëve.)* Kjo është Zafira. Është vajza e vetme e Kostandinit. Kostandini ka pasë dhe pesë djem, po i janë vrrarë nga hasmëria. Kjo është çupa e pleqërisë.

KOSTANDINI — Po uluni, bre burra! Pse u ngritët në këmbë?

ISAKU — *(Që e ka më afër Zafirën, i zgjat dorën.)* Si jeni? *(I ati ngrihet në këmbë. Zafira e tërheq dorën. Vështron Isakun në sy, pastaj Kostandinin dhe ikën.)*

MARIA — Ç'është? *(Zafira stepet dhe kthen vetëm kokën. Kostandini vështron ashpër të bijën, e cila largohet.)* Ç'është, Kostandin?

KOSTANDINI — Asgjë, Marie, asgjë. Është pak pa qejf.

MARIA — Ti prapë sillesh ashpër me tët bijë. Dikur ia preve hovin për në shkollë...

KOSTANDINI — Boll shkollë ka, më tepër se unë e se e ëma.

MARIA — Shkollë ka, por s'ka as edhe një të drejtë në këtë shtëpi, bile as t'u japë dorën miqve.

KOSTANDINI — As ti s'u ke dhënë dorën miqve.

MARIA — *(Duke qeshur)* S'ua kam dhënë, po ajo kohë vdiq. Sot unë po të sjell miq në shtëpi.

KOSTANDINI — Miqtë mirë se i pruri e mira dhe ti mirë se erdhe po pate ardhur për të mirë, po nëse ke ardhur të më turpërosh përpara miqve, më mirë do të jetë që të...

MARIA — Mos u rrëmbe, Kostandin! Si miqtë dhe mua na ka sjellë e mira E mira e të mirave. Kemi ardhur për të futur dritën e diellit që të shohësh gjithçka, të mirën e të ligën.

KOSTANDINI — Ti the të ligën?

MARIA — Po, edhe të ligën. E mira duket vetë edhe sikur prapa Bokanikut të jetë, po e keqja, e liga, Kostandin, ajo mezi duket aq më tepër nën dritën e këtij bishtuku.

KOSTANDINI — Ti, Marie, gjithnjë flet me kunja.

- MARIA — (*Me të qeshur*) Jo, bre Kostandin, ty të ngjan ashtu! S'po flas fare me kunja.
- KOSTANDINI — Oj plakë, na i mbush edhe nga një gotë, mos harro dhe Marien.
- MARIA — Faleminderit, Kostandin, rakinë e ke të fortë si dhe fjalët, po ne do të shkojmë! Nëse ke merak për rakinë, këta shokët mbas oborrit do t'i kesh. Kur të lodhen çoju nga një faqore. Tani zgjidh njërin prej tyre, cilin do të mbash?
- KOSTANDINI — Vetëm njërin?
- MARIA — Vetëm njërin.
- KOSTANDINI — Heu, pse s'bën të rrijnë të tre?
- MARIA — Jo.
- KOSTANDINI — (*I drejtohet Xhemalit.*) Ç'njerëz ke në shtëpi, o bir?
- XHEMALI — Nënë, babanë dhe një motër.
- KOSTANDINI — Qenke djalë i vetëm!
- XHEMALI — Po.
- KOSTANDINI — (*Skënderit.*) Po ti, mor bir?
- SKËNDERI — Vetëm nënën. Babai më është vrrarë në luftë, kur ishte partizan.
- KOSTANDINI — Të rrosh vetë e të të rrojë nëna!
- SKËNDERI — Faleminderit, bashkë me ty!
- KOSTANDINI — Po ti?
- ISAKU — Besa boll kam, nënë, baba, motër, vëlla, grua dhe një djalë të vogël, nja tre muajsh.
- KOSTANDINI — Heu, tashti të ka lindur djali dhe ti e le dhe erdhe këtu në malësi!...
- ISAKU — Detyra. Zanati është i tillë, pastaj puna e elektrifikimit të fshatrave është sot një aksion i madh, gjithsekush duhet të japë gjithçka...
- MARIA — Akoma s'e zgjodhe?
- KOSTANDINI — (*Tregon Isakun.*) Ja, po mbaj këtë.
- MARIA — (*Qesh dhe matet të flasë.*)
- KOSTANDINI — Pse qesh, moj flokëprerë?
- MARIA — Më qeshet se zgjodhe të martuarin. (*Dalin duke i dhënë dorën. Shtëpia bie në qetësi.*)
- SOSIA — (*Ka qëndruar te pragu i derës së miqve me*

të dy duart e zëna me plaçkat e mikut dhe vështron Marien që largohet e fundit.) Këtu do ta kenj dhomën. (Mundohet ta hapë me këmbë.)

ISAKU — (E ndihmon të hapë portën dhe bashkë me Sosën hyjnë brenda.)

NJË ZË — (Plaku që ka mbetur vetëm dëgjon të lehurën e një geni dhe një zë.) O i zoti i shtëpisë! O Kostandin!

SOSIA — Ç'është ky zë, o burrë?!

KOSTANDINI — E pra, se kush thërret.

NJË ZË — O i zoti i shtëpisë! (Të dy dalin në dritare.)

SOSIA — Ç'më shohin sytë?! O zot!

KOSTANDINI — Çfarë sheh, moj dreq?!

SOSIA — Ai duhet të jetë, ai, prifti ynë.

KOSTANDINI — Ç'prift, moj, mos të lanë sytë? Priftërinjtë dhe hoxhallarët ka kohë që janë zhveshur.

SOSIA — Vë dorën në zjarr po s'qe prifti ynë! Ja, dhe geni pushoi, e njohu....

KOSTANDINI — Besa po më çudit. Ç'do më ky në këto anë?! (Plaka bën kryq dhe zbret të hapë derën.)

#### SKENA IV

(Hyn prifti i veshur si qytetar, mjekrën e ka të shkurtuar aq shumë, sa duket sikur është i parruar qysh prej një jave. Në shpinë mban një thes me bakëre e vegla për kallajisje.)

KOSTANDINI — (I del përpara dhe e përqafton kur ai është duke ngjitur shkallët.) Ç'është kështu?

ANDONI — Këto janë punët e njerëzve që s'e besojnë më të plotfuqishmin.

SOSIA — (Bën kryq dhe mundohet të ngrrejë thesin

që e ka lënë pranë derës së madhe.) Ç'i ke këto, uratë?

ANDONI — Bakëre, kallaj e plumb.

SOSIA — E ç'të duhen ty këto, o uratë?

ANDONI — Për t'i ndërruar ngjyrën bakrit, për të mbuluar me kallaj helmin që të mos u priset stomaku njerëzve.

SOSIA — *(Flet me vete.)* O zot, mbaja mend të uratës. Ai folka përçart. *(Mundohet të ngrejë thesin. E ngre dhe ngjit shkallët.)*

KOSTANDINI — Urdhëro e mirë se të pruri zoti!

ANDONI — *(Buzëqesh me ironi.)* Zotin s'duhet ta zëmë më në gojë. Ai që e njeh duhet ta mbajë të fshehtë. Ai është një e tjetër s'ka, por ja, erdhi një ditë që edhe ai s'duhet të jetë më.

SOSIA — *(Ka ngjitur lart thesin; me të dëgjuar fjalën e fundit të priftit e lëshon atë. Bakëret bëjnë zhurmë.)*

KOSTANDINI — Ç'është kjo zhurmë? Po ky thes?

ANDONI — *(Ngre dorën si për të bekuar.)* Fëmijët duhet të hanë, duhet të rrojnë. Dikur, kur mësoja teologjinë, bëja dhe një punë të dytë për një pare xhepi. Ungjilli thotë: «Mësoje zanatin dhe lëre, kur të të kapi uria zëre». Që sot e tutje do të jem kallajxhi. Miq kam dhe ata do të më lejojnë që t'u kallajis enët.

KOSTANDINI — Jo, kurrë. Ti the se ke miq?

ANDONI — Po.

KOSTANDINI — Atëherë...

ANDONI — Jo, do të punoj edhe unë siç punojnë dhe miqtë e mi. Sot gjithkush duhet të punojë e të rrojë me djersën e tij.

KOSTANDINI — Po zoti?

ANDONI — Zoti është në qiell dhe në zemrat e atyre që e besojnë. Zoti s'ka nevojë për bukë dhe kripë, kurse robi ka. Dikur ushqehesha duke i shërbyer atij, kurse tashti do të ushqhem duke u shërbyer njerëzve.

KOSTANDINI — Pse, mos vallë kur ishe prift nuk u shërbeje njerëzve?

ANDONI — *(Pshërëtin.)* Po, u shërbeja në lindje, mar-tesa e vdekje. U gjendesha pranë në ditët e krem-te e të zeza dhe i qetësoja me fjalët e perëndisë, në emër të perëndisë, po ato kohëra shkuan e vanë e s'kthehen më, siç nuk kthehet prapa uji i lumit. Dhe njerëzit që shkojnë s'kthehen më, kurse ata që kanë mbetur, kanë ndërruar fytyrë e gjuhë e nuk duan ta njohin për zot zotin e gjithësisë që i solli në këtë jetë.

KOSTANDINI — Kohë tjetër, uratë!

ANDONI — Kohë tjetër. Sa kollaj është ta thuash dhe sa zor ta besosh kur ti vetë je dëshmitar i dy kohëve.

KOSTANDINI — Ulu, uratë, qetësohu! *(Plakës.)* Na bëj dy kafe. *(Të dy ulen pranë vatrës, karshi njëri-tjetrit. Kostandini i jep dorën për së dyti, sipas zakonit.)* E po, mirë se erdhe!

ANDONI — *(I hutuar i zgjat dorën, po me vonesë.)* Mirë se të gjeta! *(Heshtje.)*

KOSTANDINI — Jeta është e rëndë dhe e vështirë, lum ai që i bën ballë.

ANDONI — Jeta jote ka qenë e rëndë dhe e vështirë dhe ti i ke bërë ballë si burrat. Ti dhe kulla jote kanë parë shumë. Ato që s'ke parë ti i ka parë kjo shtëpi dhe ti i ke dëgjuar nga të tjerët, ja këtu, pranë kësaj vatre të veçuar. Pe dhe dë-gjove gjëra të çuditshme, më shumë se ç'duhet të dëgjojë njeriu i shkretë. Dhe u forcove që të dëgjosh e të shohësh fundin.

KOSTANDINI — Njeriu jeton e lufton dhe beson se do të rrojë njëqind vjet. Përderisa e mbajnë këmbët dhe duart i punojnë, ai s'mendon ku-rrë për fundin. Kjo kullë u nxi dhe u mbyll pesë herë, dhe kur të tjerët prisnin që ajo të rrënohej, çuditëshin kur lulëzonte.

ANDONI — Ashtu është, sepse ishte zot që të ndih-

48761



monte, kurse tani u binda që ti s'paske besuar tek Ai, por te vetja jote.

KOSTANDINI — Uratë, unë kam besuar dhe besoj tek ai.

ANDONI — Më vjen mirë që e dëgjoj por s'është ashtu. Tani s'jam më prift ndaj do të flas hapur. Dëgjomë dhe mos m'u zemëro. Emrin e zotit e ke zënë në gojë, po jo gjithmonë. E ke thënë me zë kur ka qenë nevoja dhe këtë e ke bërë, sepse doje një fjalë për kurajo. E ke zënë emrin e tij në gojë edhe kur je nisur të kryesh një punë të pa dëshiruar dhe kur ke shkelur këmbëzën e pushkës për të vrarë një të krishter.

KOSTANDINI — E kam zënë.

ANDONI — E ke zënë edhe i ke besuar më shumë pushkës se sa zotit. (*Me gishtin tregues tregon qiellin.*)

KOSTANDINI — Nuk të kuptoj, uratë.

ANDONI — (*Vë buzën në gaz.*) Ti kupton vetëm punët e kësaj shtëpie. Ato i kupton shumë mirë dhe i kollandris shumë mirë, po prit se erdhi dita që edhe ato s'do t'i kuptosh më.

KOSTANDINI — Përsëri nuk të mora vesh, uratë.

ANDONI — Shumë gjëra nuk i kuptohen kësaj bote. Dikur njeriu jetonte që të hante në qetësi një copë bukë. Po qetësi s'ka më, o Kostandin!

KOSTADINI — S'ka.

ANDONI — Shyqyr që e kuptoke këtë gjë.

KOSTANDINI — E ndiej, më shumë e ndiej, se e kuptoj. Vras mendjen, po karar s'i jap.

ANDONI — S'ka qetësi e s'do të ketë, sepse s'ka më zot, sepse njerëzit s'besojnë më në atë që i krijojnë po besojnë në vetvete, vetëm në veten e tyre, ndaj janë ngritur në këmbë e po thyejnë ç'gjejnë përpara; kisha, xhamira, ikona... shkëmbinj. U ka hipur në kokë se janë gjithçka dhe duan të mbjellin grurë në gurë. Ta bëjnë kaun të pjellë viça.

KOSTANDINI — Ç'po flet, uratë? S'po flet drejt.

ANDONI — (*Po me atë ton të lartë.*) Po ky është vetëm fillimi dhe, si fillim, është shumë i «mbarë»,

sepse ka hyrë te çdo shtëpi, bile dhe në shtëpinë tënde të veçuar. (*Hyn Sosia me kafetë. Në tabaka janë tre filxhanë. Prifti shikon me vëmendje. Sosia e kupton.*)

SOSIA — Matanë kemi një mysafir ai po rregullon plaçkat, dhe do të rrijë te ne, derisa të ndriçojë fshatin. (*Hapet dera dhe hyn elektrikisti. Afrohet dhe i zgjat dorën Andonit, i cili ia jep ftohtë.*)

KOSTANDINI — (*Elektricitit.*) Është papa Andoni, mik i vjetër i shtëpisë.

ISAKU — Qoftë me nder!

ANDONI — Si ta kuptoj këtë?

ISAKU — Mos ma merr për të keq. Nderi ka vetëm një kuptim, të punosh punë të pastër e të jetosh me djersën tënde.

ANDONI — Enët do t'i kallajis pastër e bukur dhe do të marr vetëm hakun që më takon.

(*Plaka zbrapset dhe shkel mbi thesin me bakëre, të cilat bëjnë zhurmë. Elektricitist shikon thesin.*)

ISAKU — Zanat i vështirë ky për ju, uratë. Derë më derë e fshat më fshat. Keni për t'u lodhur. Nuk është më mirë të hyni që tani në kooperativën e artizanatit.

ANDONI — Në artizanat jam, o bir i perëndisë.

ISAKU — Unë nuk jam bir i perëndisë, jam bir i Demir Lekës nga Elbasani.

ANDONI — (*I habitur.*) Ashtu? Ti qenke i biri i Demir Kallajxhiut?

ISAKU — Po.

KOSTANDINI — Shyqyr zotit që dolët miq. Sic e patët nisur bisedën pata frikë. (*Heshtje. Thërret.*) Zafira! (*Hapet dera dhe hyn Zafira për të marrë filxhanët. Hyn ngadalë sepse druhet nga elektrikisti. Nis t'i marrë dorën priftit, ta puthë. Stepet nga vështrimi i elektrikistit dhe tërhiqet.*)

KOSTANDINI — Po ky të ka pagëzuar, moj, është urata. (*Zafira habitet.*)

ANDONI — Tani jam kallajxhi.

*(Zafira shikon vjedhurazi elektricistin, i cili kollitet.)*

ISAKU — Si kallajxhi a ta kanë puthur ndonjëherë dorën, uratë?

ANDONI — Jo.

ISAKU — As mua.

ANDONI — *(Si me vete.)* Pagëzimi i saj paska qenë pagëzimi i fundit në këtë shtëpi.

*(Hyn Sasia me sofrën dhe një tepsi me bukë. E shtron. Prifti matet të bëjë kryq po e lë përgjysmë. Në heshtje të tre burrat fillojnë të hanë, kurse të dy gratë rrinë në këmbë, gati për t'u shërbyer. Zafira ndez dy bishtukë dhe i vë një në oxhak dhe një në mur.)*

## AKTI II

### SKENA I

*(Po ajo skenë. Janë bërë instalimet elektrike. Zafira vetëm. Nga dera anësore hyn elektrikisti gati për t'u nisur në punë. Kanë kaluar disa ditë.)*

ISAKU — Po ti?

ZAFIRA — Hiç.

ISAKU — Si, hiç?

ZAFIRA — *(Mbledh supet.)*...

ISAKU — Ku janë të tjerët?

ZAFIRA — Babai është në punë. Erdhën e morën.

ISAKU — Kush e mori?

ZAFIRA — Katundi. Rruga për në mal kalon këtej. Erdhën dhe e thirrën. Vajtën të presin shtylla për dritat.

ISAKU — *(Vë buzën në gaz.)* Shtylla për dritat?

ZAFIRA — Po, për dritat. S'i kisha parë ndonjëherë burrat e fshatit aq të gëzuar.

ISAKU — Po ti, s'je e gëzuar?

ZAFIRA — *(Ul kokën.)* Unë...

ISAKU — Zafira, ty se ç'të mundon. Kam disa ditë që e kam vënë re. Se si rri, se si flet. Ose më mirë të them s'flet fare. Si është puna? Maria diçka më foli për ty ditën e parë kur erdha, ajo më tha... *(Zafira matet të ikë.)* Zafira!

ZAFIRA — Ç'është?

ISAKU — Më thua, ç'ke?

ZAFIRA — Asgjë.

ISAKU — Mos më gënje! Mos gënje as veten tënde.  
Thuaj ç'ke, ç'të mundon, pse rri kështu?

ZAFIRA — Si?

ISAKU — Po ja, si të them, rri si e trembur, sikur  
pret të të ndodhë diçka e keqe.

ZAFIRA — (*Pohon me kokë.*) Po.

ISAKU — Si? Dhe hesht!

ZAFIRA — Akoma s'ka ndodhur, po shpejt do të ndo-  
dhë, gjersa më thanë që të rri në shtëpi, të mos  
dal...

ISAKU — Nuk të kuptoj, Zafirë!

ZAFIRA — Asgjë, asgjë! Hë për hë më thanë të rri në  
shtëpi, siç duket këtë gjë do ta kenë kërkuar  
edhe ata.

ISAKU — Kush? Cilët janë ata?

ZAFIRA — Njerëzit e të fejuarit do ta kenë kërkuar  
që të mbyllem.

ISAKU — Ti qenke e mbyllur?!

ZAFIRA — (*Ul kokën.*) Po.

ISAKU — (*Tepër i habitur sa s'di ç'të flasë. Zafira e  
kupton hutimin e tij.*) Ta hajë dreqi, ta hajë!  
Çfarë zakonesh! Po ti, moj goce, as gazetat  
s'paske lexuar?

ZAFIRA — Gazetën? Jo! Veç kam dëgjuar se shumë  
vajza e gra...

ISAKU — Atëherë pse s'bën dhe ti atë që po bëjnë  
shoqet e tua anëmbanë Shqipërisë, ë?

ZAFIRA — Më vjen keq për nënën dhe babanë. Unë  
vetëm ata të dy kam. Si t'i vras në shpirt. Jo,  
jo nuk mund të bëj asgjë... S'di ç'të bëj!

ISAKU — Si s'di! As me jetën tënde, as me ëndrrat  
e tua s'di se çfarë të bësh?

ZAFIRA — (*Nënqesh.*) Eh!...

ISAKU — Pse nënqesh?

ZAFIRA — Sepse flet tamam si mësuesi i historisë. Ai  
numëronte shumë gra trimëresha që kishin vep-  
ruar të lira si dhe burrat, bile që edhe kishin  
luftuar.

ISAKU — Atëherë bëj dhe ti si ato dhe ke për të parë se si Zafira e vogël do të bëhet një heroinë që u ngrit kundër zakoneve dhe bëri ashtu siç i tha zemra e vet. *(Heshtje. Pas pak Isaku bëhet gati për punë.)* Unë tani po dal, se u vonova, për në punë. Do bisedojmë prapë. Na, merre këtë, që të mos mërzitesh. *(I jep tranzistorin.)*

ZAFIRA — Unë s'di ta përdor.

ISAKU — Shumë kollaj, ja. U hap, lëviz këtë këtu. *(Gjatë kësaj kohe dëgjoen stacione radioshe dhe zëra të ndryshëm. Punëtori largohet. Zafira mbetet vetëm me radion e vogël në duar që e mban me shumë kujdes. Muzika mbush shtëpinë, ajo lëviz stacionet. Dëgjoen zëra, zhurmë, fishkëllimë, fjalime. Bëhet e hutuar. Duke e lëvizur, del stacioni i Tiranës. Shtang kur dëgjon pas gjithë atyre fjalëve në gjuhë të huaja, gjuhën e saj. Radioja flet diçka nga gazetat për emancipimin e gruas, për vrullin revolucionar që ka shpërthyer kudo. Fjalimi mbaron shpejt. Zafira kërkon përsëri të gjejë atë fjalim, por më kot. Dëgjoet muzikë, fjalë të huaja, pastaj rastësisht gjen përsëri stacionin e Tiranës, që jep një emision muziko-letterar. E qetë rri e dëgjon.)*

## SKENA II

*(Troket dera e jashtme që është e mbyllur në paftën e sipërme. Dera gjëmon nga të trokiturat. Më në fund e ndien dhe Zafira, e cila trembet; radion s'di ku ta lejë. E hutuar, ngaqë s'di ta mbyllë, e fut në dhomën e saj dhe zbret shkallët për të hapur derën. E hap. Hyn Dafina, një shoqe e shkollës që ka qenë në hekurudhë dhe që është e veshur jo më si fshatare.)*

DAFINA — *(Duke dëgjuar muzikën që vjen nga dhoma.)*

O, ç'mrekulli!

ZAFIRA — Çfarë thatë?

DAFINA — Akoma s'kam ardhur në vete. Më duket sikur e shoh. Ja, po të mbyll sytë shoh gjithçka, gjithçka, Zafira!... Dy fshatrat tona, dy fshatrat më të largëta të krahinës sonë, me shtëpinë tënde prush me drita, gjatë gjithë faqes së shpatit. E shoh dhe më duket sikur jemi ngritur edhe ne në qiell. Dhe shtëpitë tona të ndriçuara, do të duken nga fusha si yje të zjarrtë, si yje të kuq! *(Zafira dëgjon dhe matet ngadalë të hyjë në dhomën e saj për të mbyllur radion.)* Ku shkon Zafira?

ZAFIRA — Matanë, të mbyll radion.

DAFINA — Jo, jo! Lëre të buçasë. Ajo më ktheu këtu. Kur po kaloja këndeje, me të dëgjuar thashë: muzikë! Dhe përnjëherë mendja m'u mbush me dritat elektrike që do të llamburisnin së shpejti. Dhe erdha e trokita si e çmendur.

ZAFIRA — Kurse unë u tremba.

DAFINA — U trembe? E pse? *(Shikon rreth e qark, i venë sytë te instalimet elektrike.)* I paskeni bërë gati! Sa mirë! Kjo dritë do të përzejë hijet e frikës nga kjo shtëpi. E di, Zafira, shtëpia juaj do të duket si një vapor.

ZAFIRA — Po, ashtu do të duket, po unë...

DAFINA — *(E zë për dore dhe e tund.)* Ç'ke që tula-tesh. Unë çuditëm me ty, ti akoma je ajo nxënësjë e frikësuar, me sy të frikshëm. Ah, të kishë ardhur edhe ti në hekurudhë, do të ishe kthyer tjetër Zafirë!

ZAFIRA — E pse të bëhem tjetër Zafirë? Mos vallë, e tillë si jam, s'paskam të drejtë të jem e lumtur?

DAFINA — Po mirë, pra, rri e mbyllur mes katër murëve dhe shko te burri që të kanë fejuar që në djep. *(Ironike.)* Me siguri që e do, apo jo?

ZAFIRA — Nuk e urrej. Unë nuk e njoh fare, nuk e kam parë kurrë. Ai nuk është as soj me ne. Ne

kemi qenë të varfër. Herë herë më duket sikur jam në ëndërr dhe pres, pres të vijë ai. Dhe ai vjen i hipur në kalë të bardhë dhe zbret, troket në derë e ngjit shkallët, hyn në dhomë, po unë as e shoh, as e prek.

DAFINA — Ç'shikon dhe ti! Na i pështirose.

ZAFIRA — O, sa frikë që kam! Tmerrohem kur e kujtoj. Më dridhet këmisha e trupit. E di, Dafinë, unë kurrë s'e kam menduar si burrë. Ai veç më del në ëndërr dhe më tremb. Po ti nga e di që unë do të shkoj tek ai?

DAFINA — I gjithë fshati e di dhe po bën çmos që kjo gjë të mos ndodh dhe s'ka për të ndodhur. Vdiq ajo kohë kur kjo shtëpi ishte e veçuar dhe vuante nga plagët e zakonit. (*Zafira qesh.*) Pse qesh?

ZAFIRA — Kot.

DAFINA — Më thuaj ç'ke, hë të keqen motra? Ka gjëra që njeriu s'mund t'ia thotë as nënës, as vëllait, po vetëm një shoqeje. Fol, Zafirë!

ZAFIRA — E ç'të të them, moj Dafinë, sikur s'e di ti se si jam rritur unë, me lak në fyt. Unë as femijërinë time nuk e mbaj mend. (*Imiton të ëmën.*) «Ti s'je fëmi që të luash me shoqet, ti je e fejuar, ti je grua». Këto fjalë janë thënë aq herë, sa gurë ka kjo kullë.

DAFINA — Hiqe, pra, këtë lak dhe ke për të marrë frymë lirisht.

ZAFIRA — Hiqe! Një fjalë goje. Si ta heq?! Me atë lak s'jam lidhur vetëm unë, por edhe tata, edhe nëna.

DAFINA — Zafirë, mos mendo kaq shumë! Çlirohu njëherë ti, pastaj...

ZAFIRA — Nuk mundem. E kam vështirë.

DAFINA — Nuk mundesh? Me dhëmbë, moj, këpute. Jeto, të paktën një ditë e lirë, pa lak në fyt, dhe do të shohësh se sa i freskët është ajri. Ty të është trashur qafa dhe je mësuar të të tërheqin e të të fusin në stallë si bagëti.



ZAFIRA — Më keq. Unë i njoh bagëtitë. Njoh dhitë e urta dhe të prapa. Atyre, kur s'u pëlqen gjethi, nuk e hanë.

DAFINA — E sheh, pra!

ZAFIRA — E shoh, moj motër, po... (Dëgjohet një zë nga jashtë. Si e trembur.) Po thërrasin tatën.  
(Të dyja largohen.)

### SKENA III

SPIROJA — (Nga jashtë.) O Kostandin!

(Hyn në dhomë Kostandini.)

KOSTANDINI — Hajde, bujrum!

SPIROJA — (Hyn. Përshëndetet.) Na nxirr një zjarr ta ndezim njëherë.

KOSTANDINI — Po hajdeni brenda, more burra!

TEKNIKU — S'po vijmë kësaj radhe, se sa herë që vijmë në vatrën tënde, na e djeg gërmazin me atë rakinë e vjetër.

GJEOMETRI — Kemi frikë se mos po na e nxjerr dhe sot e mos dehemi.

KOSTANDINI — Po hajdeni, pra...

SPIROJA — Tallen këta, more Kostandin. Nuk i shikon se janë veshur me rroba pune.

KOSTANDINI — (Thërret.) Zafira, na sill një zjarr!

SPIROJA — Do hapim rrugën. Ja këtej, midis oborrit tënd.

KOSTANDINI — Si?!

SPIROJA — Ja, mu këtu!

TEKNIKU — Kjo derë ka për të dalë në rrugë.

SPIROJA — Pse mendohesh, o Kostandin? Rruga do të na sjellë shumë të mira.

KOSTANDINI — Të mira, të mira, po mua do të më nxjerrë lakuriq, pa oborr, pa mur. Jo, ore sekretar, jo! Tokat i bashkuam, po jo dhe shtëpitë.

SPIROJA — Shtëpinë s'ta luan kush, o Kostandin, as

oborrit. Do shembet vetëm muri. Dikur duhej ky mur se kish hasmëri, por sot s'duhet gjë. Jëmi të gjithë vëllezër, të gjithë punojmë e luftojmë që të ndrisë më shumë ky vend, kjo kullë. Që të hyjë dielli deri në konak.

KOSTANDINI — Dielli ka punën e tij, unë kam hallet e mia.

ZAFIRA — *(Del me një urë zjarri të ndezur.)* Urdhëroni zjarrin, ndizeni!

SPIROJA — *(Ndez cigaren.)* Faleminderit, o bijë! Më thanë se s'ke dalë në punë fare. Si kështu, moj Zafirë? *(Zafira ul kokën.)*

KOSTANDINI — Si shumë po i bie më qafë kullës sime, o sekretar!

SPIROJA — Për të mirë e kam, o Kostandin.

KOSTANDINI — Të mirën e di vetë i zoti i shtëpisë.

SPIROJA — E di dhe s'e di. Vajzën mos e mbaj mbyllur!

KOSTANDINI — Prandaj po m'i shemb muret?

SPIROJA — Muret i shemb rruga, që mezi po e pret krahina, fshati dhe ti vetë. I ranë këta shokët kryq e tërthor e më shkurt se këtu s'pret gjë-kundi.

TEKNIKU — Po ti na ke gostitur disa herë kur bënim matjet e rrugës, o xha Kostandin! E tani na del kundër?

KOSTANDINI — S'jam kundër rrugës, o bir! As kundër kooperativës nuk isha. I pari i bashkova tokat po jo kështu. Të më shembet muri i oborrit.

ZAFIRA — O tatë!

KOSTANDINI — Tyt, moj! Akoma këtu ti! *(Zafira hyn brenda.)*

SPIROJA — A, more Kostandin, more Kostandin! *(Kostandini ndjek të bijën. Të tjerët dalin nga skena.)* Njeri i çuditshëm! Tërë jetën ka rrojtur i ngujuar. Bëj fëmijë e bëj luftë me hasmërinë. Tani e ka të vështirë të jetojë i qetë.

*(Hapet dera, hyn Kostandini i nevrikosur, pas tij Zafira)*

KOSTANDINI — Bukën, shpejt bukën! *(Dy gratë nxi-tojnë. Njëra sjell sofrën, tjetra tepsinë. I shtrojnë për të ngrënë. Kostandini merr një copë bukë dhe e ha me nervozizëm.)* Të dalë dera ime në udhë të madhe! Të mos ketë shtëpia ime oborr dhe derë të parë? Rrugë, dritë, rrugë, dritë! Janë ngritur të gjithë dhe vetëm te rruga e dritës e kanë mendjen. S'ke me kë të bisedosh. Ika dhe s'do të kthehem, po s'mbarova punë. O unë, o ata! *(Del.)*

ZAFIRA — Prit, baba! *(Ai ikën pa kthyer kokën fare.)*

SOSIA — S'hëngrëm njëherë të qetë. Ulu, bijë të hamël! *(Ulen dhe hanë në heshtje. Zafira ha me përtesë.)*

ZAFIRA — S'më ahahet.

SOSIA — *(Nuk e dëgjon të bijën.)* Pesëdhjetë vjet më parë kam ardhur nuse në këtë shtëpi. Pragun e asaj dere e leva me mjaltë. S'kisha parë ndonjëherë mjaltë me sy. Kjo shtëpi kishte tre burra, dy prej tyre u vranë pa u martuar. Pastaj me radhë u vranë, sa bëheshin për dyfek, dhe pesë djemtë e mi. Dhe yt atë vriste, merrte gjakun e të vëllezërve, të bijve, bënte fëmijë të tjerë dhe qëllonte me pushkë nga dritarja për t'i dhënë haber hasmërisë se në shtëpinë e veçuar lindi një djalë që do përdor pushkën. Ata rriteshin dhe vdisnin po nga pushka. Kur u vra djali i fundit shtëpia jonë u mbyll. U mbyll dhe yt atë. Ai nuk dilte më jashtë kësaj porte. Arat dhe bagëtia më mbetën mua derisa nisi lufta me gjermanin. Çudi se si i lanë burrat gjaqet. Pas luftës, u nda toka. O zot, lutesha, shtoja jetën kësaj qeverie që qe e zonja të presë gjakun dhe të ndajë

tokat! Që atëherë yt atë doli në punë, u bë njeri tjetër. Atëherë linde ti, po yt atë nuk u gëzua. Ai donte që unë të pillja vetëm meshkuj. Kur ti mbushe dy vjetët, yt atë ishte mik në një derë të huaj. U fut atje se e zuri shiu, pastaj bora mbylli Shtegun e Dhive dhe ai ndenji atje tri ditë e tri net. Atje u bë dhe fejesa jote me një fëmijë që qau atë natë. Dhe ai që qau që djalë...

ZAFIRA — Ç'tmerr!...

SOSIA — (*Sikur s'e ka dëgjuar.*) Pas tri ditësh në shtëpi bëmë një darkë të vogël për fejesën tëndë, po njeri nuk ftuam. Akoma shtëpia jonë ishte e veçuar dhe njerëzve s'u bënte zemra të shkelnin qoftë për të mirë, qoftë për të keq. Atë natë qava për të parën herë në jetën time. Qava dhe e ndjeva veten të lehtësuar!

ZAFIRA — Po pse qave atëherë?

SOSIA — Kisha shumë helm në shpirt, e zbraza dhe m'u duk se mora frymë lirisht. Që atë ditë thashë se shtëpia jonë s'është më e veçuar, se shtëpia jonë u bë me një nuse të vogël.

ZAFIRA — E shkreta ti, nëna ime e fortë, sa ke vuajtur në këtë shtëpi! Pas gjithë atyre vdekjeve, ti duhej ta mbaje dhe me bukë këtë kullë.

SOSIA — Njeriu i bën të gjitha, veç mos ta zejë e liga.

ZAFIRA — Po, nënë, po ti s'pe një ditë të bardhë.

SOSIA — Ditë të bardhë të kisha ty, moj bijë!

ZAFIRA — (*Lë bukën dhe puth nënën.*) Po tata pse më rri ashtu?

SOSIA — Po ai është burrë, të pastë nëna!

ZAFIRA — Po unë kam shumë qejf që ai të më thotë një fjalë të mirë.

SOSIA — (*Qesh hidhur.*) Jo, oj bijë! Kot që e pret.

ZAFIRA — (*E habitur*) Heu!

SOSIA — As mua s'më ka thënë një fjalë të ëmbël...

ZAFIRA — Dhe i fejuari im s'paska për të më thënë një fjalë të bukur?

SOSIA — Nuk e di, tashti është kohë tjetër, mbase dhe do të të thotë.

ZAFIRA — *(Ul kokën dhe ngrihet nga sofrja.)* Paska hak zemra ime që s'e qas pranë.

SOSIA — Si?

ZAFIRA — S'e dua atë, nënë...

SOSIA — Mos!

ZAFIRA — Jo, s'e dua...

SOSIA — Turp, turp!

ZAFIRA — E si ta dua atë, oj nënë, kur s'ma do zemra.

SOSIA — Lëviz, moj, prej vendit se po më luan mendsh!  
*(Hyn Kostandini.)*

KOSTANDINI — Asgjë s'munda të bëj. Askush s'të ndihmon dhe s'të dëgjon. Po të lëvizin planin, rruga del matanë shkëmbit, po të dalë matanë shkëmbit zgjat shumë. Të gjithë duan që rruga të vijë që nesër, po qe e mundur. Çudi për t'u çuditur, sikur s'kanë jetuar me shekuj pa rrugë dhe pa dritë. Po ju ç'keni? Ç'është? *(Ato nuk i përgjigjen; rrinë në këmbë pranë sofrës.)* Ndizni dritat! *(Zafira merr bishtukun tjetër dhe pasi e ndez e vë në mur. Kokën e mban nga dera e cila hapet. Hyn elektrikisti, Isaku.)*

## SKENA V

ISAKU — Mirëmbërmani, si u ngryset?

KOSTANDINI — Keq.

ISAKU — Pse, ç'ka ndodhur?

KOSTANDINI — Një dreq e merr vesh se ç'ka ndodhur në këtë shtëpi. Bërtit sa të duash, çirru, po përgjigje s'merr nga askush, as nga njerëzit e shtëpisë, as nga njerëzit e katundit. Vajta dhe u qava kudo: në këshill, në kryesi, po kurrkush s'ma vuri veshin. Qeshin me fjalët e mia.

ISAKU — Për të qeshur është, o Kostandin. Të mos duash rrugën, të mos duash dritën është njësoj si të mos duash, ja këtë! (*Tregon me dorë Zafirën*).

KOSTANDINI — Dhe dritën e dua, dhe rrugën e dua, po nuk dua që shtëpia ime të dalë lakuriq, pa derë të jashtme, si pulë pa pendë.

ISAKU — Shtëpia ime, oborri im, lopa ime. E imja, e imja, e imja.

KOSTANDINI — Heu! Për besë po më çudit!

ZAFIRA — Tata nuk të kupton, kot e ke që i flet...

KOSTANDINI — (*Shikon i habitur nga e bija. Zafira ul kokën.*)

ISAKU — (*Gjithashtu i habitur.*) Pse të mos e kuptoj? A nuk janë fshatarë shokët e tij që po bëjnë çudira? A nuk janë fshatarë ata që po falin oborrret dhe bagëtitë? Fshatarë janë, si dhe yt atë, si dhe ti, Zafirë.

KOSTANDINI — Fshatarët! Fshatarët! Unë s'dua veç një copë bukë thatë dhe të jem zot në oborrin tim, në shtëpinë time.

ISAKU — Gabohesh, o Kostandin! Ti ke vuajtur shumë, ke derdhur gjak vëllai dhe gjak evlati për këtë shtëpi, për këtë oborr. Ti ke qenë i mbyllur në mes të katër mureve. Në shpirtin tënd të drobitur gjetën strehë fjalët e priftërinjve. Ato e pushtuan zemrën dhe mendjen tënde, futën në të errësirën dhe pasigurinë e të bënë ty një njeri të vogël, të egër, që të ëndërrosh vetëm një thërrime lumturi: pak bukë e qetësi. Bukën e fitove me Reformën Agrare dhe qetësinë e sigurove se gjaku u pre. Ti mendove se u bërë zot e s'doje gjë tjetër. Po koha ecën. Dhe njerëzve nuk u pëlqen të rrinë në një vend, në një oborr të mbyllur. Duan rrugë, duan dritë, duan një lumturi më të madhe, një lumturi për të gjithë.

KOSTANDINI — Mund të jetë ashtu si thua ti, po unë i kam ditët të numëruara e brenda këtyre katër mureve s'dua të ndodhë asgjë.

ISAKU — Do, s'do ti, midis këtyre mureve ndryshimet do të bëhen, sepse këto ndryshime po ndodhin në të gjithë Shqipërinë dhe s'ka forcë zakoni as reaksioni që t'i ndalë. Disa i kuptojnë shpejt, disa i kuptojnë ngadalë, kurse disa...

NJË ZË NGA JASHTË — O i zoti i shtëpisë, o Kostandin! *(Të gjithë mbajnë vesh.)*

SOSIA — Si zëri i priftit.

ISAKU — Kurse disa vijnë vërdallë dhe përpiqen që të mos i kuptojnë këto ndryshime. Vijnë dhe derdhin helmin e tyre. Ata po, ata nuk duan as rrugë, as dritë. Ata kështu i kanë dashur këto male: të egra dhe të errëta, pa bukë dhe pa dritë. Dhe njerëzit i kanë dashur pa sy, sepse vetëm kështu ata mund t'i mbanin nën zgjedhë.

KOSTANDINI — Për kë e ke fjalën?

ISAKU — Për atë që ti, në vend që ta quash mallkim, e quan uratë. *(Largohet për në dhomën e tij. Kostandini e shikon i habitur.)*

## AKTI I III

### SKENA I

*(Zafira përsëri vetëm, pranë dritares së vogël me hekura, rri dhe vështron jashtë se si po zbardh dita dhe dëgjon se si gjëmojnë minat. Pas pak dëgjohe zëra që thërrasin: «Hop-hop, ho-hop.» Janë zërat e punëtorëve dhe fshatarëve që punojnë. Dëgjohe përsëri mina. Hyn elektrikisti. Zafira kthen kokën, është i dëshpëruar.)*

ISAKU — Mirëmëngjes!

ZAFIRA — Mirëmëngjes!

ISAKU — Ç'është, Zafirë?

ZAFIRA — Të gjithë pyesin: ç'është. Dhe im atë, dhe ti...

ISAKU — Kurse ti hesht, kurrkujt nuk i përgjigjes.

ZAFIRA — *(Nënqesh hidhur.)* S'kam ç'të flas! Gjithë ditën rri e vështroj si agon dita, si zgjohe fshati. Dëgjoj se si pëlcasin minat, se si punëtorë e fshatarë po ngrehin kullën e tensionit dhe më vjen të pëlcas. Ja edhe telat po shtrohen, kurse unë rri e pres.

ISAKU — Çfarë pret moj, se më plase? As mua s'më beson?

ZAFIRA — Prifti s'ka ardhur për të mirë, ai erdhi nga fshati i të fejuarit. Ç'të bëj? Thuaj, ç'të bëj? Po sikur ata të më nisin nuse tek ai që s'e



njoh, që s'e kam parë kurrë dhe që zemra s'ma do.

ISAKU — Atëherë bëj ç'të thotë zemra, Zafirë. Ti nuk je vajzë e vogël.

ZAFIRA — Ah, sa lehtë e keni ju burrat të flisni për ne. Eja ti në vendin tim. (*Bën sikur heq një gjerdan nga fyti.*) Dhe na këtë lak që të shtrëngon në fytyrë, që të ndrydh qafën.

ISAKU — Ke të drejtë. Mbi ty rëndon gjithçka, por megjithatë duhet të veprosh, duhet të ngrihesh dhe të luftosh. Po heshte, po psherëtime, do të humbësh. Ti s'je më ajo Zafira e ditëve të para. Të kujtohet? Kur erdha në këtë shtëpi, mezi më dhe dorën, kurse tashti ti ke filluar të qahesh, të nervozohesh. Hë, pra!

ZAFIRA — Me nënën e mjerë, me babanë që kanë vuajtur tërë jetës si t'ia bëj?

ISAKU — Po ata duan që ti të nisesh nuse, duan që ti t'i nënshtrohesh fshatit, zakoneve. Duan që ti të jesh mot e jetë grua e një njeriu që ti s'e njeh, që s'e do. Ata s'mund të ngrihen e të kundërshtojnë doket e zakonet që u kanë rënduar në shpirt. Ata ashtu janë mësuar. Ata i kanë sytë e zënë. Duhet ti e para t'ua hapësh sytë.

ZAFIRA — Është e kotë, derisa ata nuk ndiejnë dhimbjen time, s'kanë se si të më kuptojnë.

ISAKU — Atëherë ik. Kur ti të ikësh, ata, duan s'duan, do ta ndiejnë vuajtjen tënde dhe do ta kuptojnë, mbase edhe do të të falin.

ZAFIRA — Jo, s'mund të iki! Jo!

ISAKU — Atëherë shko nuse atje ku të kanë fejuar që në djep.

ZAFIRA — Kurrë! E gjallë jo!

ISAKU — (*Qesh i kënaqur.*) Tani më pëlqeve. Ja, kë shtu duhet të jesh: e vendosur, trime!

ZAFIRA — (*Vë buzën në gaz.*) Ashtu!?

ISAKU — Kur qesh ti, duket sikur qesh e gjithë shtëpia. Ika.

ZAFIRA — Eja shpejt. Kam frikë nga prifti.

ISAKU — Po, po, do të vijë se do të vë llampat. Nga prifti mos u tremb. Ai sot tremb vetëm ndonjë fanatik.

ZAFIRA — Ai s'vjen kot vërdallë. Më tremb mjekra e tij që ka filluar të rritet.

IŠAKU — (*Qesh.*) Do t'ia rruajmë prapë. (*Del.*)

## SKENA II

*(Prifti lëviz ngadalë derën e cila bën zhurmë, Zafira trembet.)*

ANDONI — Mos u tremb, o bijë, jam unë prifti që të kam pagëzuar dhe që do të të vë kurorë.

ZAFIRA — Pse di të vëjë kallajxhiu kurorë?

ANDONI — Atje ku s'më njohin për prift, hyj si kallajxhi.

ZAFIRA — Dhe bën punën e priftit?

ANDONI — Diçka duhet të bëjë njeriu, aq më shumë ai që di se ç'duhet të bëjë. Si bakërxi bëj punën që më ka caktuar shteti, si prift bëj punët e perëndisë.

ZAFIRA — Im atë të mban dhe të di për njeri të ndershëm.

ANDONI — Të gjithë të ndershëm jemi, pavarësisht se kemi nga dy fytyra, dy zanate apo dy emra. Yt atë, ti e di që ka dy emra, apo jo? Njërin Kostandin e tjetrin Hysen. Të parin e ka emër të vogël, të dytin të madh. Të parin e ka të regjistruar në defterin e kishës, të dytin në qitapin e shtetit.

ZAFIRA — Emrin e dytë e mori që të mos i nënshtrohej turkut. Pastaj, atëherë, ishte kohë tjetër.

ANDONI — Edhe tashti është kohë tjetër.

ZAFIRA — Ti qenke një gjarpër!

ANDONI — (*Qesh me të madhe.*) Dhe ti qenke një nepërkë që të qenka zgjidhur gjuha. (*Vazhdon të qeshë. Hyn Kostandini.*)

KOSTANDINI — Qenke zgjuar me të mirat, uratë! (*Drejtohet nga e bija.*) Ku janë burrat?... (*Zafira del.*)

ANDONI — Bareshës i është zgjidhur gjuha dhe mendja i është kthjelluar. Mos u sill ashpër me të. Ajo të do. Dëgjova se ç'bisedoi me punëtorin. Punët janë keq. Dhëndri ka hak që ngutet. Ata e duan shpejt. S'është koha për të pritur. Në shtëpinë e Markut ka ardhur shkesi dhe i ati i dhëndrit. Ata duan të bisedojnë me ty dhe t'i japin fund punës. Duan nusen.

KOSTANDINI — Kaq shpejt?

ANDONI — Është shumë vonë. I kanë rënë në erë kë-saj pune. Këto ditë do të ndizen dritat dhe s'është çudi të bëhet mbledhja e katundit për të prishur fejesat e bëra që në djep.

KOSTANDINI — Dale, dale.

ANDONI — Ah, Kostandin! Ti gjithnjë kërkon të jesh i matur dhe i drejtë. Vdiq ajo kohë. Tashti bëhesh me turp kur të duash dhe kjo shtëpi s'mban më. Ti je plak dhe një turp të tillë s'e duron dot.

KOSTANDINI — Fole shumë, uratë, dhe s'të mora vesh. Unë vajzën e kam të fejuar dhe e kam gati. Kur të duan le të vijnë ta marrin. Kjo shtëpi ka parë vetëm vaje, le të shohë edhe një gëzim. Dua që dy sytë e mi, para se të mbyllen, të shohin një ditë të bardhë, të bukur dhe të gëzuar midis këtyre katër mureve.

ANDONI — Amin! Ashtu u bëftë! (*Ngre dorën për të bërë kryq po sprapset.*)

(Muret e oborrit të shtëpisë janë shembur. Është hapur rruga e cila është gjysmë e shtruar me gurë. Shtëpia e Kostandinit ka dalë në shesh. Prapa, në të majtë, duket kabina e tensionit. Mbi rrugë kalojnë telat e tensionit. Dy fije që do të ushqejnë shtëpinë janë të lidhura vetëm me shtyllën kryesore dhe bien në gjysmën e oborrit të Kostandinit. Porta e jashtme është e mbështetur pas murit të rrëzuar. Fshatarët vullnetarë janë duke punuar, sistemojnë murin e shembur të Kostandinit zgjerojnë rrugën. Disa të tjerë bëjnë kalldrëm, disa kanale. Elektricistët punojnë, njëri ka hipur në shtyllë dhe bën lidhjen, dy fshatarë tërheqin telin. Xhemali vendos izolatorët në murin e shtëpisë së Kostandinit për të bërë lidhjen. Të gjithë punojnë, punëtorë dhe fshatarë, burra, të rinj dhe gra. Është buzëmbremje. Mënjanë është dhe Kostandini me të shoqen dhe Zafirën.)

MARKU — Për besë, u lodha, s'kam punuar ndonjëherë si sot. Sikur të më jepnin leje të shkoj në shtëpi, ë!

SPIROJA — Jo, or Mark, po s'mbaruam deri në fund, s'ke ku shkon. Kam frikë se po i lamë gurët këshu grumbull. Kostandini e ngre murin prapë. (Të qeshura.)

NJË GRUA — Lëre, mos e nga Kostandinin. I ka ardhur shpirti majë hundës, s'e sheh si rri?

XHEMALI — I doli shtëpia lakuriq si ato pulat që s'kanë pupla. (Qeshin. Afrohet Kostandini. Të gjithë heshtin.)

KOSTANDINI — Qeshni, qeshni. Derisa erdhi koha që me dorën time të prish murin tim, oborrin tim.

NDREKA — (I shkuar nga mosha) Dridhe një herë,

o Kostandin! Leri këta të bëjnë punën e tyre. Dinë më mirë se ne. Gjersa e sollën rrugën nga qyteti deri këtu, derisa sollën dritën dhe begatinë, dinë se ç'bëjnë.

XHEMALI — O xha Kostandin!

KOSTANDINI — Hë, more spurdhiak, ç'do?

XHEMALI — A di ç'desha të të them? A s'na jep leje ta prishim fare shtëpinë tënde sonte për gjithë natën e natës dhe të ngremë një të re në mes të katundit?

KOSTANDINI — Tyt, lanet, shko e shemb shtëpinë tënde atje në qytet! (*Matet t'i bjerë, po ai kërcen dhe pastaj hipën në shtyllën elektrike.*) Vallahi, o Ndreka, u bëra gazi i botës.

NDREKA — Pleqëria si fëmijëria, o Kostandin.

KOSTANDINI — As me ty s'u llafoska. (*Matet të largohet.*)

XHEMALI — (*I thërret që nga maja e shtyllës.*) Ruaju, o Kostandin, se po prek telat që kanë shejtanin brenda. (*Kostandini hutohet dhe shkel mbi telat të cilat i ngatërrohen nëpër këmbë. Trembet dhe i largon me bishtin e lopatës. Të gjithë qeshin.*)

DAFINA — Ka frikë nga telat si djalli nga temjani.

KOSTANDINI — Djalli je ti dhe shokët e tu që i kurdisët të gjitha këto.

DAFINA — Bëjnë shaka, Kostandin. Kanë punuar gjithë ditën, janë lodhur. Shyqyr që dole ti nga shtëpia për të na bërë me gaz.

KOSTANDINI — Unë jam për të qarë hallin e ju kërkoni të qeshni.

NDREKA — Vallahi, jam gati ta ndërroj shtëpinë time me tënden. Ti centralin e ke te dera. Dritën e merr taze i pari dhe makina të vjen nga kasa. baja mu këtu te shtëpia. Mjafton të dalësh në dritare e t'i bërtasësh shoferit. Prit, ore, a më çon tek doktori se po më dhemb stomaku. (*Të gjithë qeshin, bie çanga.*)

SPIROJA — Kabina mbaroi, o burra! (*Të gjithë bërtasin të gëzuar.*) Rruga deri këtu erdh! Tashti dhe pak punë mbeti. Do t'i vëmë forca, kemi shtyllat dhe lidhjet me shtëpitë. S'besoj se do të kursehem.

ISAKU — Ata që janë caktuar të na ndihmojnë të rrinë dhe ca. Sot do të lidhim shtëpinë e Kostandinit, nesër e pasnesër kemi lagjen matanë dhe hajt shëndet!

MARKU — Natën e mirë bëfshi dhe u vaftë puna mbarë! (*Ikën si vjedhurazi.*)

ISAKU — Natën e mirë!  
(*Të gjithë mbledhin veglat dhe largohen. Mbeten elektrikistët, dy fshatarë të rinj, sekretari i Partisë, Dafina, Kostandini, plaka dhe Zafira.*)

SPIROJA — O burrani se na zuri nata. Hajt ta mbarojmë shtëpinë e Kostës.

(*Fillojnë tërheqjen e telit. Punojnë për të bërë lidhjen, ndihmojnë njëri-tjetrin. Kostandini mënjana pastron gjysmën e oborrit që i ka mbetur.*)

ISAKU — (*Sekretarit të Partisë.*) Po te oborri e ka mendjen.

SPIROJA — Është fillimi, dita e parë. Do të mësohet. O Kostandin! Ndize një të hekurosur! (*Afrohet dhe i jep një cigare*)

KOSTANDINI — Ejvallah! Urdhëroni brenda të pimë një kafe.

SPIROJA — Jo, do të iki, ja, sa ta lidhin telin. Hë, o burra!

SKËNDERI — Edhe pak, shoku sekretar. (*Lidh përfundimisht telin.*) Mbaruam. Po të duash nisemi.

ISAKU — Po, po, nisuni ju! Lidhjen e brendshme e bëj unë.

SPIROJA — Bëfshi natën e mirë!

KOSTANDINI — Natën e mirë bëfshi!

*(Largohen të gjithë. Elektricisti hyn brenda me Zafirën pasi kanë mbledhur telin. Kostandini rri jashtë.)*

SOSIA — Hajde, se u err!

KOSTANDINI — Do të rri dhe ca.

SOSIA — Hajde, s'ke ç'bën jashtë!

KOSTANDINI — Do të rri, të shoh.

SOSIA — S'ke çfarë të shohësh, po hajde!

KOSTANDINI — Ja, këto gërmadha dua të shoh!

SOSIA — Mos fol ashtu, është gjynah, hajde brenda!

KOSTANDINI — Ik, tashti do të vi. *(Mbetet vetëm. Rri dhe vështron. Brenda në shtëpi ndizen bishtukët. Dritaret lëshojnë pak dritë. Shikon muret e rrëzuar.)* U shembët, o mure! Të gjitha përpjekjet e mia shkuan kot. U përpoqa që të mbeteshit, por u bëra qesharak. *(Afrohet pranë murit të rrëzuar dhe e prek me dorë. Mban vesh. Dëgjon hapa e shkarpa që thyhen nga dikush që ecën. Kthen kokën dhe dallon një -hije që afrohet.)* Kush të jetë vallë?

*(Hyn prifti i lodhur dhe gjithë baltë, me një torbë në krah. Vjen nga larg dhe sa sheh shtëpinë e Kostandinit që ka dalë në shesh shtanget.)*

ANDONI — Ç'po më shohin sytë! Paskan hequr murin, paskan vënë telat gjer në strehë të shtëpisë?

KOSTANDINI — Gjithçka u bë ashtu si u tha.

ANDONI — Më trembe, o Kostandin, s'të vura re fare Ç'po bën?

KOSTANDINI — Po shoh.

ANDONI — Tashti! Natën?

KOSTANDINI — Ditën s'mundem se më qeshin.

ANDONI — Bëje zemrën gur dhe duro! Hallet e njeriut s'kanë fund në këtë botë... Ai që vuan do të qetësohet... Kishën e kanë bërë klub për të kërcyer rinia. S'ka më as edhe një vend të bekuar, gjithçka u shemb. Dhe këto mure u shembën. Tashti njeriu s'mund të thotë për asgjë se kjo është imja. Ja dhe oborri yt, i vetmi që të kish

mbetur u bë rrugë. E filluan shumë bukur, i hoqën njeriut atë që ishte e tij. S'ka më «imja», o Kostë.

KOSTANDINI — S'ka!

ANDONI — Vetëm shpirti na ka mbetur, shpirti dhe shpresa.

KOSTANDINI — Çfarë shprese, o prift!

ANDONI — Shpresa tek i madhi zot. (*Bën kryq.*)

KOSTANDINI — (*Vë buzën në gaz.*) Zoti yt qenka shumë i duruar, uratë.

ANDONI — Ai është i të gjithëve.

KOSTANDINI — Besa jo, i të gjithëve s'është më. Shumë pak i kanë mbetur.

ANDONI — (*Vë buzën në gaz dhe bën përsëri kryq.*)  
Dhe ai vetë e ka thënë që do të vijë dita kur s'do të më besojnë më. E tha dhe fjala i doli.

KOSTANDINI — (*Me ironi*) Paska qenë i zgjuar!

ANDONI — (*Bën kryq. Me qortim.*) Dhe ti, Kostandin!

KOSTANDINI — Hajde të hyjmë brenda! Po më shkojnë të dridhura për trup. Nata ka filluar të ftohet shumë.

ANDONI — Sikur të mos isha i lodhur do të isha kthyer te Marku. Atje është dhe i atij i dhëndrit.  
Do të vijë nesër këtu për të biseduar dhe për...

KOSTANDINI — Nesër?

ANDONI — Po, nesër. Do të qe më mirë të kishin ardhur sonte. Ditët kanë filluar të mos i ngjajnë njëra tjetrës. Dje isha me oborr, sot pa oborr. Sot je me vajzë, nesër mund të jesh dhe pa të. Nesër do të vijmë të gjithë.

KOSTANDINI — Çudi! Si po më venë punët!...



SKENA IV

(Hyjnë me radhë: shkesi, Marku, i ati i dhëndrit. Përhëndeten me të zotin e shtëpisë dhe priftin, pastaj ulen.)

KOSTANDINI — Mirë se erdhët, o burra! Urata më tha pse jeni munduar deri këtu.

MIRI — Unë u bëra shkak i kësaj fejese sot e tetëmbëdhjetë vjet të shkuara.

ANDONI — (Psherëtin.) Tetëmbëdhjetë vjet të shkuara! Eh, ishte kohë tjetër...

MIRI — Po, ishte kohë tjetër. Sot si gdhin nuk ngryset. Ç'nuk po na dëgjojnë veshët. Që të mos mbetemi me turp, themi që ta mbarojmë këtë punë.

KOSTANDINI — (I shqetësuar) Kjo punë ka tetëmbëdhjetë vjet që është mbaruar.

I ATI I DHËNDRIT — E duam shpejt edhe në qoftë se nuk e ke hazër...

KOSTANDINI — Hazër është. Po ti mos u ngut, or krushk! Nusen e ke si molla në dhomën e zjarrit.

MIRI — Meqë qenke hazër, do vijmë ta marrim nesër.

KOSTANDINI — Si, nesër? Jo, kështu nuk e jap.

MIRI — Po ti e ke dhënë, o Kostandin.

I ATI I DHËNDRIT — Do të vijmë para dite, pa zhurmë, pa dasmë e pa harxhe.

KOSTANDINI — (I hutuar shikon me radhë të gjithë deri te prifti.) Ç'është kjo punë? Përse kjo ngutje?

MARKU — Nesër kur të lëshohen dritat, do të mbli-dhet fshati dhe Zafirën do ta caktojnë të shkojë në një kurs për elektriciste. Ndërsa ty do të të japin dajak që e ke mbyllur brenda, pastaj do të prishen të gjitha fejesat e bëra sipas zakonit.

KOSTANDINI — Si?!

ANDONI — Vajza jote nuk e do burrin që i keni dhënë.

KOSTANDINI — Qysh?

ANDONI — Nuk e do. E dëgjova me këta veshë siç po të dëgjoj edhe ty.

KOSTANDINI — Heu! (*Ngrihet të thërrasë vajzën, prifti e mban.*)

ANDONI — Ajo s'duhet të dijë gjë. Ajo duhet t'i hipi kalit e të shkojë atje ku e ke dhënë ti. Atje ku e do nderi i kësaj shtëpie.

KOSTANDINI — Si, nesër?

ANDONI — Nëse kjo punë s'bëhet nesër, ty të pret turpi.

KOSTANDINI — O zot!

ANDONI — Lëre zotin dhe shejtanin. Këto janë punët e robit e jo të zotit.

KOSTANDINI — Dua të flas me time bijë!

ANDONI — Është tepër vonë. Ajo s'është Zafira që ti mendon.

KOSTANDINI — Ajo është ime bijë.

ANDONI — Është jot bijë, por vetëm përpara zotit.

Para katundit ajo është Zafira Komeni. Mos harro se tashti është kohë tjetër. Jepu fjalën këtyre burrave dhe mos pyet më, se do të turpërohesh.

I ATI I DHËNDRIT — As unë, o Kostandin, s'e pata të lehtë të vij në konakun tënd dhe ta kërkoj nusen në këtë mënyrë, ta marr si hajdut nusen e tim biri.

KOSTANDINI — (*Zë kokën me duar.*) Jo! Nuk është punë që bëhet. E kam të vetme. Vetëm atë gëzim kam dhe s'mund ta jap pa i gëzuar këto mure, këtë shtëpi. S'mund ta jap (pa dasmë, pa thirrur gjithë katundin. Kam bërë hazër çdo gjë, pata blerë dhe bishtukë të rinj që ta ndriçoja kullën e nxirë nga gjakësi. Shpirti më është plakur dhe më është thyer. Dua një gëzim. Nga kjo derë kam përcjellë shtatë kufoma, të shtatë s'u martuan, se ua shkurtoi jetën plumbi. Dy ishën vëllezërit e mi, pesë qenë djemtë e mi. Zafira më mbeti dhe atë s'mund ta nxjerr si hajdute. Ajo është çupë dhe së këtejmi do të dalë nuse.

I ATI I DHËNDRIT — *(Ngre kokën.)* Më lëndove, o Kostandin! Zemra ma ndien dhe të jap hak, por po qe se kjo punë s'bëhet nesër, turpi do të jetë më i madh.

ANDONI — Nesër ajo mund të iki dhe ti do të mbetesh jo vetëm pa dasmë, por edhe pa çupë.

MIRI — Kurse kështu ti s'do të shohësh dasmën që ke ëndërruar, po do të shpëtosh çupën, do të shpëtosh nderin e kësaj shtëpie.

KOSTANDINI — Mjaft, mjaft më! Nderi i kësaj shtëpie, turpi i kësaj shtëpie, zakoni i kësaj shtëpie. S'dua t'ju dëgjoj më. Pa shpirt dhe pa zemër nuk mbrohen zakonet, o burra!

MARKU — S'është më ajo kohë, Kostandin.

KOSTANDINI — Atëherë le t'i bjerë zjarri, le të shembet... *(Pëlcastin minat, të gjithë shohin të trembur.)*

ANDONI — Minat! Janë minat. Po me mina nuk shembet gjithçka. Mund të shemben pishat dhe shkëmbinjtë, por jo zakonet, ligjet e këtyre maleve. Ato janë aq të lashta, sa ç'janë edhe vetë malet, ato janë më të lashtë se ne. Na i lanë të parët dhe ne s'do t'i lëmë t'i marrë era se plasi një minë, megjithëse s'është puna as për një minë, as për një nuse.

MIRI — Të lumtë goja, uratë! E the bukur, s'është puna për një minë, as për një nuse.

ANDONI — Nuk është as punë inati, o Kostandin Komeni. Është më e thellë puna. Minat nuk pëlcastin që të shembet mali, ato pëlcastin që të shembemi ne. Ja, Miri u shemb i pari. Pastaj të shembën ty, *(i drejtohet babait të dhëndrit)*, sepse gjysma e kësaj krahine ishte tëndja. Re ti dhe u bëre një me të zotin e këtij konaku, fshatar ti, fshatar ky, njësoj në çdo gjë, në toka e bagëti, bile ky sot është më mirë se ti.

KOSTANDINI — Po atëherë çfarë mbeti më për t'u shembur?

ANDONI — Njeriu.

KOSTANDINI — (*Sheh i çuditur priftin.*) Si? Njeriu!...

ANDONI — U shembën pronat, toka, dhentë, dhitë, arat, livadhet, pishat, po njeriu mbeti. Tashti duan të na shembin, të na shembin besimin tonë, fjalën, nderin, zakonet, gjithçka kemi në shpirt: dhe ëndrrat, dhe shpresat, dhe dhimbjet. Ti, Kostandin, i dhe fjalën këtij, ky të dha fjalën dhe besën e të parëve, sipas nomeve të këtyre maleve, ja sepse pëlcastin minat dhe ja se çfarë duan që të shembin: fjalën tonë dhe, nëpërmjet saj, ne. (*Zëra dhe britma nga jashtë. Hoo-hoop, hoo-hoop! Shkarkohen trarët me zhurmë të madhe, të gjithë mbajnë vesh.*) Janë elektricistët dhe vullnetarët, kanë sjellë trarët e fundit. Nesër do të lëshojnë dritë.

KOSTANDINI — Nesër?

ANDONI — Nesër gjithçka merr fund. Vendos pra, Kostandin!

I ATI I DHËNDRIT — Nëse s'ma jep nesër, të dy do të mbetemë me turp. Dhe ti edhe unë.

KOSTANDINI — (*Tepër i tronditur.*) Zoti le të na ndjejë, s'kam se ç'të bëj. (*Të gjithë, me përjashtim të Kostandinit, ngrihen më këmbë dhe largohen; prifti i përcjell dhe kthehet. Kostandini ngre kokën.*) Turp, oh sa turp! Ky është rrëmbim! Jo, zakonet nuk mbrohen me turp! Ata do të vijnë dhe do ta marrin time bijë nesër, kurse mua më ngjan se do të vijnë dhe do ta vjedhin. Pse kështu, uratë?

ANDONI — (*I kënaqur.*) Sepse edhe ne rrojmë dhe jemi aq njerëz të ndershëm sa të mos turpërohemi. Edhe ne marrim frymë. Ç'na mbetet tjetër në qoftë se s'jemi të zotë të fëmijëve tanë? T'i fejojmë dhe t'i martojmë si duam ne!

KOSTANDINI — Ashtu është, por...

ANDONI — Atëherë, gëzohu!

KOSTANDINI — S'mundem, jam pikë e vrer.

ANDONI — Gëzohu, ata futën në këtë shtëpi dritën  
(*tregon me dorë llampat*) por s'mundën të futin  
dot idetë e reja. Nesër, kur ata të festojnë fi-  
toven e tyre, do të hidhërohen se në këtë shtëpi  
pësuan disfatë.

KOSTANDINI — Nuk të kuptoj. Kohët e fundit, që  
kur je zhveshur, sikur s'je më ai që ke qenë prej  
vitesh.

ANDONI — (*Duke buzëqeshur*) Do të më kuptosh. Dhën-  
të zoti që Zafira të jetë e urtë nesër.

KOSTANDINI — Dhe po të mos jetë, do të bëhet. Ah,  
të kisha pas lindur djalë, do të qe ndryshe!

#### SKENA V

(*Hyn një djalë nga fshati, i veshur me çizme.  
Në bel mban rripin me litar që i shërben për t'u  
ngjitur në shtyllë.*)

DJALI — Tungjatjetani, o burra! Pse qenkeni kaq të  
ngrysur?

KOSTANDINI — S'kemi gjë. Po ti ç'do që hyn me kaq  
rrëmbim, apo se s'ka më mur oborri?

DJALI — Unë? Më dërgoi Isaku që të marr një vegël.  
Ai s'mund të vijë se ka shumë punë. Nesër do të  
lëshojmë dritë. Ai më tha që të marr pak pin-  
cat dhe rrotullën e izolantit. Pasi të mbarojë pun-  
nën do të vijë për të vënë llampën në ballkon.

ANDONI — Shiko, shiko, çuni i Palit ditka gjithë ato  
fjalë, ditka dhe të vejë drita!

DJALI — Ku do t'i gjejë qyteti gjithë ata elektrikistë  
po s'mësuam ne vetë, nga njëri-tjetri? Më mësoi  
Isaku. Të tjerë do të shkojnë në kurs. Sot e ka  
radhën fshati ynë, nesër tjetri, për tre vjet gjithë

fshatrat e Shqipërisë do të ndriçohen, kurse fshati ynë nesër.

ANDONI — Atëherë vuri dritat që the dhe ndriçoje sa më shumë këtë shtëpi.

DJALI — E ka hak që të ndriçohet sa më shumë. Kjo shtëpi ka qenë viktimë e zakoneve të këqija, nga ato dhe u nxi. Pas kësaj do të ndriçojë gjithë kjo faqe mali. Që nga kjo shtëpi do të përhapet drita në dy fshatra. Pranë ka shkollën dhe kabinën e tensionit. Nesër, kur të vijë rruga, do të ketë dyqanet, mbase edhe qendrën e lokalitetit. Vend më i përshtatshëm zor se mund të gjendet.

ANDONI — (*Qesh me ironi.*) Kur?

DJALI — Pa dalë dimri, ja erdhë drita. Dhe rruga po vjen. (*Dëgjohen shpërthime minash.*) E dëgjoni? Po çahen shkëmbinjtë. (*Hyn në dhomën e Isakut, merr veglat dhe ikën i shoqëruar me zhurmën e minave që shpërthejnë.*)

ANDONI — Ardhja e tij nuk më pëlqen. Vështronte nga të katër anët siç duket për Zafirën. Duhet t'i kenë rënë në erë. Dhe tha se Isaku do të vijë posa të mbarojë punë. Ia kam frikën atij elektrikisti.

KOSTANDINI — Ai na është bërë si djali i shtëpisë. Na ka rregulluar çatitë, na ka ndrequr murin, na ka bërë edhe tryezë.

ANDONI — Dhe sat bije i ka prishur mendjen.

KOSTANDINI — Si? Po ai është i martuar?

ANDONI — Jo, jo me atë kuptim! Ia ka prishur mendjen dhe e ka bërë që të flasë si nepërkë. Ki kujdes kur të flasësh me të. Unë po hyj në dhomë. Do të shtrihem ca.

SOSIA — (*Hyn nga jashtë.*) Ç'është? Pse më vështron ashtu? Po prifti ku është?

KOSTANDINI — Më mirë thuaj ku është ajo!

SOSIA — Nuk e di.

KOSTANDINI — Thirre, dua t'i them një fjalë!

SOSIA — (*Thërret.*) Zafira! Zafira! (*Hyn në dhomën*

e zjarrit dhe del.) S'është Zafira. (Kostandinit që nervozohet.) Po ti ç'ke? (Del në dritare dhe sheh përjashta.) Zafira s'qenka gjëkund, do të ketë dalë.

KOSTANDINI — Si the? Do të ketë dalë? Gjallë a vdekur e dua këtu. Dhe dyerve veru bravat! Gjer nesër s'dua që ajo të kapërcejë pragun e shtëpisë.

SOSIA — Mos ka shkuar atje tek punojnë, në kullën e dritave?

KOSTANDINI — (Ngrihet.) Po e gjeta atje do t'ia shkul flokët! (Del. Pas tij dhe plaka. Prifti, i cili ka përgjuar, del dhe vështron rreth e qark.)

ANDONI — Nesër do të ndizen dritat, kurse këtu s'do të ketë gëzim. Njëra do të shkojë e mërzitur te burri që s'e do, tjetri do të jetë i mërzitur se s'bëri dot dasmë, kurse, ata do të çmenden se si dështuan me turp në një ditë përrurimi. (Hapet dera dhe hyn elektrikisti.) E paske marrë rrëmbyer. Në shtëpi s'ka njeri. Mos ke harruar ndonjë vegël?

ISAKU — Jo. Veglën që pata harruar ma sollën dhe punën për të cilën ajo m'u desh e kreuva. Në përgjithësi të gjithë punët u kryen, nesër s'do të ketë më errësirë edhe kur të vijë nata.

ANDONI — Gëzohem!

ISAKU — E di. Dhe e marr me mend gëzimin tënd.

ANDONI — Si? S'e besoni që zemra e një njeriu, që tërë jetën e tij u ka shërbyer njerëzve të kësaj krahine, të mos gëzohet kur ata dalin në dritë?

ISAKU — Jo, uratë, nuk e besoj.

ANDONI — Më vjen shumë keq!

ISAKU — Duhej t'ju vinte keq po të thosha se ju besoj, atëherë do të kishit të bënit me një gënjeshhtar dhe kjo gjë do të fyente shenjtërinë tuaj.

ANDONI — Oh, tashti po më fyeni, unë s'jam as shenjt, as prift. Ju keni ardhur në këtë shtëpi si elektrikist, kurse unë si kallajxhi. Të dy jemi miq në këtë konak mikpritës.

ISAKU — Ti edhe unë jemi miq të Kostandinit, kurse të dy s'jemi miq.

ANDONI — Si?

ISAKU — Po, uratë.

PRIFTI — Sikur ma thoni me ironi fjalën «uratë».

ISAKU — S'jua di emrin dhe s'i si t'ju thërras.

ANDONI — Andon, më quajnë.

ISAKU — Atëherë, Andon, meqë u përpoqët të humbisnit fjalën, po jua përsëris: miq bashkë s'jemi, ndonëse hamë bukë në një shtëpi mikpritëse.

ANDONI — Po më zemëron, o biri i Demir Lekës.

ISAKU — Çudi!

ANDONI — Çfarë ka këtu për t'u çuditur?

ISAKU — Si u zemëroke kaq shpejt! Ju po kurdisni plane shkatërruese për këtë shtëpi dhe njerëzit e kësaj shtëpie s'po zemërohen.

ANDONI — Derisa ata nuk zemërohen do të thotë se unë s'po bëj asgjë të keqe.

ISAKU — Kjo do të thotë se ata nuk të kuptojnë dhe fatkeqësisht besojnë akoma në fjalën tënde.

ANDONI — Fjala ime s'është plumb që t'i vrasë ata.

ISAKU — Është më keq, është helm. Një helm të tillë ti u ke derdhur me vite njerëzve të këtyre shkrepave dhe ua ke futur në gjak.

ANDONI — Shkuat shumë larg. Ne ishim ngushëllim. Te ne vinin qanin hallet, tregonin mëkatet dhe gjenin qetësi dhe prehje. Shpirti ka nevojë për prehje dhe ngushëllim dhe njerëzve, këtë ilaç që nuk e gjenin kund, ua jepnim ne.

ISAKU — (*Qesh.*) Më bëre të qesh. Për besë më bëre të qesh.

ANDONI — Pse?...

ISAKU — Sepse është për të qeshur kur dikush bën kryq dhe i beson një fuqie që nuk ekziston, kur ai ka dy shpatulla e dy duar të fuqishme që mund të shemb male.

ANDONI — (*Me ironi*) Dhe të bëjë tarraca.

ISAKU — Po, edhe tarraca. Tarraca të jep bereqet, kurse po të bëjë kryq ç'do të fitojë?



ANDONI — Qetësi për shpirtin, o bir i Demirit! Njeriu s'ka nevojë vetëm për bukë. Do edhe prehje. Dhe dikur ai e gjente këtë prehje dhe këtë paqe kur e ndillnin kambanat, e gjente kur thithte erën e temjanit dhe para zotit të madh dhe fuqplotë gjente paqe, urtësi dhe shpresë për të nesërmen e pasigurt dhe bënte kryq.

ISAKU — Ja, pra, sa mirë e pohove pasigurinë për të nesërmen, nënshtrimin para të plotfuqishmit, qetësinë dhe errësirën.

ANDONI — Dhe çfarë i duhej tjetër një trupi të lodhur dhe të rraskapitur veç qetësisë dhe prehjes?

ISAKU — I duhej besimi dhe kundërshtimi, i duhej e kundërta e asaj që i keni dhënë ju.

ANDONI — E ç'do të fitonin nga kjo?

ISAKU — Do të fitonin atë që kishin humbur, do të fitonin, ja, këto datë që kanë fituar, do të fitonin lirinë, bukën, dritën. Ti i di fort mirë këto që po të them, i di aq mirë sa s'po të zënë këmbët dhe duke bredhur poshtë e përpjetë duke u përpjekur që të mos bëhen këto që po bëhen.

ANDONI — E tepërrove.

ISAKU — Jo, nuk e kam tepëruar! Tani po filloj, kjo që biseduam deri tani qe vetëm fillimi.

ANDONI — (I habitur) Ashtu?

ISAKU — Po, «i nderuari» uratë Andoni. Ti do të na prishësh gëzimin tonë të madh.

ANDONI — Si?!

ISAKU — Po, ty s'të ka mbetur më asgjë në këtë krahinë, ti vjen e shkon në këto shkrepë si një hije dhe përpiqesh të trembësh ndonjë me zemër të dobët. Aty ku s'hyn si prift, hyn si kallajxhi. Ke gjetur një petk të ri që shkëlqen, po shpejt ka për të të rënë edhe kallaji. Nesër do të ketë aq dritë, sa njerëzit do të shohin rrobat e tua të zeza dhe përposhtë cipës së hollë me të cilën je kallajisur.

ANDONI — Ti kërkon të më trembësh kështu?

ISAKU — Jo, unë nuk tremb njeri. Profesionimi është

i thjeshtë. Unë lëshoj dhe shpërndaj dritë që njerëzit të shohin qartë dhe të mos u duken trun-gjet, ose trarët si gogola por të shohin mirë for-mat ashtu siç janë, cili është mik dhe cili hiqet-sikur është mik. (*Largohet dhe hyn në dhomën e tij.*)

ANDONI — Qenka i lig! Gjene mirë që s'paska rënë në erë të asaj që do të ndodhë nesër. Më duket se po vijnë. (*Dëgjohen hapa dhe zëra.*) Duhet ikur sa më parë edhe nga kjo shtëpi, bile që sonte. (*Hyn në dhomën e tij.*)

## SKENA VI

(*Hyjnë Kostandini, plaka dhe Zafira. Kostandini ka zënë për dore vajzën dhe gati sa s'e tërheq zvarrë.*)

ZAFIRA — Ç'është, baba! Ç'faj të kam bërë?

KOSTANDINI — Të pata thënë të mos dalësh. Këtu të rrish!

ZAFIRA — U mërzita dhe dola, po të dua, do të dal prapë.

KOSTANDINI — Nesër do të dalësh, nesër në mëngjes do të vijnë dhe do të të marrin nuse.

ZAFIRA — (*Thërret.*) Jo, jo! Mos, tatë! Atje s'dua, s'dua. Atje nuk shkoj e gjallë.

KOSTANDINI — Si? Si the?!

ZAFIRA — Mos, tatë! Mos!

KOSTANDINI — (*E qëllon. Zafira rrëzohet.*) Do të shkosh!

ZAFIRA — (*E rrëzuar për tokë thërret.*) Jo, jo, nuk shkoj!

KOSTANDINI — Do të shkosh!

## AKTI IV

### SKENA I

*(Bishtuku në vatër ndriçon dobët, sepse ka filluar të agojë. Pranë vatrës, në gjunjë është Kostandini. Duket që s'ka fjetur. Pranë tij janë rrobat e gjumit, dysheku, jorgani. Dëgjohen shpërthime minash.)*

KOSTANDINI — Që pa gdhirë mirë filluan të shembin shkëmbinjtë. Gjithçka ka për t'u bërë ashtu siç tha cuni i Palit. *(Gogësin.)* Gjithë natën ka fryrë era e detat, do të kemi shi. *(Shikon bishtukun dhe qesh nëpër dhëmbë.)* Eh, mor i shkretë! *(E merr në dorë.)* Sonte ndriçove tërë natën sikur e paske ditur që ishte nata e fundit. Ja, *(e tund)* dhe vajguri të paska mbaruar. E mbarove dhe ti jetën tënde. Mbase dhe unë. Pse s'flet, ë? *(I fryn lehtë, flaka luhatet dhe përpëlitet.)* Po jep shpirt? *(Hyn plaka me kafënë.)*

SOSIA — Si u gdhive?

KOSTANDINI — Keq. S'më zuri gjumi gjithë natën.

SOSIA — As unë s'fjeta. Sa më mbylleshin sytë, më shpifeshin ëndrra të këqija.

KOSTANDINI — Po ajo fjeti?

SOSIA — Jo, s'mbylli sy fare. Qante e psherëtinte.

KOSTANDINI — Gjene mirë.

SOSIA — Si the?

KOSTANDINI — Gjene mirë! Punë e madhe që s'fjeti një natë. Do të flejë te burri. Kisha frikë se mos na turpëronte.

SOSIA — Çfarë?

KOSTANDINI — Se mos ua mbathte këmbëve dhe ikte.

SOSIA — Mos e thuaj atë fjalë, o burrë! Ne s'kemi të atillë gocë.

KOSTANDINI — Sa vajza kanë ikur, ë? Sot sikur është dita e tyre. Të ikën dhe të turpëron. Kudo që të shkojë i gjen dyert e hapura dhe me turp mbe-tesh ti. Po Isaku ku është? S'e kam ndier gjithë natën e natës, as është kollitur fare.

SOSIA — Ai s'fjeti këtu mbrëmë. Se ç'bëri në qur dhe në ballkon dhe iku. Tha se do të vijë kur të lëshojnë dritat. Tha se do të bëhet festë e madhe.

KOSTANDINI — Tha, tha; na mërzite me këtë «tha» Sikur ka folur perëndia.

## SKENA II

*(Hyn Zafira e heshtur. Merr rrobat e të atit dhe del. I ati dhe e ëma e ndjekin me sy. Hyn përsëri, merr plaçkat e fundit dhe del.)*

SOSIA — E shkreta! *(Kostandini kthen kokën nga plaka.)* Po dasmë s'do të bëjmë? Hiç?!

KOSTANDINI — Hiç! Do të vijnë krushqit, do t'u nxjerrim një gotë rakë në këmbë dhe hop në kalë, pa e marrë vesh kush.

SOSIA — Pa një çikë dasmë?

KOSTANDINI — Hiç, asgjë!...

SOSIA — Si hiç?

KOSTANDINI — Hiç, pra!

SOSIA — Ky është rrëmbim, o burrë!

KOSTANDINI — Ashtu është.

SOSIA — O zot!

KOSTANDINI — S'ka më zot.

SOSIA — Si?

KOSTANDINI — S'ka, s'ka asgjë, as zot, as nder.

(*Hyn Zafira dhe rri e dëgjon babanë që është i nevrikosur.*) Ka vetëm turp. Të kishte lindur djalë do të kishim qenë të lumtur, do ta gëzonim këtë ditë me dasmë edhe me dritë.

ZAFIRA — (*E qetë.*) Po të isha djalë njeri nga ne të dy do të qe vrarë, sepse hasmëria mbeti pa marrë një gjak nga kjo shtëpi.

KOSTANDINI — Mjaft, mos më kundërshto!

ZAFIRA — Babë, kuptomë, babë!

KOSTANDINI — Çfarë të kuptoj? Që s'e do burrin, i cili të takon. Që s'do burrin tënd me të cilin ke tetëmbëdhjetë vjet që je fejuar!

ZAFIRA — Unë atë...

KOSTANDINI — Mos!...

ZAFIRA — Sikur i rënë nga qielli të jetë s'e dua. Sikur trimi i trimave të jetë s'e dua. Dua të jem e lirë, të jem edhe unë e zonja e vetes në shtëpinë time, të marr frymë lirisht, si në shtëpi dhe jo si në burg.

KOSTANDINI — (*I zemëruar*) Kush ta ka bërë burg shtëpinë, ty, moj ë?

ZAFIRA — Ti, në emër të zakoneve. Unë mund të ikë, mund të largohem që këtej, po s'do ta ndiej veten të lirë, sepse do të jem e lirë vetëm atje ku do të shkoj; por s'do të jem e lirë të vij këtu... Kuptomë, baba, kuptomë!

KOSTANDINI — Po ti je femër, kjo shtëpi s'është për ty. Një ditë do të ikësh, do të martohesh.

ZAFIRA — Po, po ajo ditë s'ka ardhur akoma.

KOSTANDINI — Ajo ditë erdhi, ajo agoi. Ja, kjo ishte dita jote.

ZAFIRA — Jo!

KOSTANDINI — Si?

ZAFIRA — Jo, nuk ka ardhur!

KOSTANDINI — Krushqit janë nisur për të të marrë.

ZAFIRA — Jo, një mijë herë jo! (*Kostandini e qëllon.*)

Qëlllo! Unë kam duruar shumë gjëra në këtë shtëpi. Një ditë do të iki, do të iki kur të më thotë zemra, kur të më lindë dhe mua në shpirt dashuria, atëherë do të iki edhe sikur ti të mos duash.

KOSTANDINI — Sot do të nisesh dhe do të shkosh atje ku e ke fatin tënd.

ZAFIRA — Fati im!... Fati im i zi! Jo, nuk ka fat, o tatë! Nuk ka fat!

SOSIA — Të tillë fat ka pasur kjo shtëpi, moj bijë: fat të zi.

ZAFIRA — Jo, nënë, shtëpia s'ka faj, fajin e kemi ne, njerëzit. Ne që jemi robër dhe që bëjmë siç thonë zakonet dhe jo siç të thotë zemra dhe mendja.

SOSIA — Ashtu kanë qenë kohërat, moj bijë.

ZAFIRA — Kanë qenë, por s'janë më.

KOSTANDINI — Janë edhe sot. Nesër le të fillojë koha e re. Ja, po vijnë, po shtien me pushkë, po vijnë, po bien daullet. *(I duket sikur dëgjon zhurma të largëta, të mbytura, krisma pushkësh. Dëgjohe minat, pastaj zëra, pastaj daulle. Jashtë njerëzit kanë filluar të grumbullohen për të festuar ditën e lëshimit të tensionit. Kostandini flet përçart.)* Po vijnë krushqit, tamam si qëmoti. Po vijnë krushqit!

ZAFIRA — *(E nervozuar nga i ati, qesh dhe ajo si ai dhe, duke përfytyruar dasmën, flet.)* Krushqit po vijnë, mirë se të vijnë, të shtruar e kanë shtëpinë dhe unë e mjera nuse jam nisur, kalit të bardhë do t'i hip dhe te burri do të shkoj. *(I ati e dëgjon Zafirën dhe përmendet. Dëgjohe vërtet zhurma e daulles e të shtëna pushke. Zhurmat dëgjohe të qarta dhe të forta aq sa Zafira qetësohet dhe shikon t'anë.)* Si është ai, baba?

KOSTANDINI — Kush?

ZAFIRA — Dhëndri, si është? I gjatë, i shkurtër, i zi, i bardhë, si është?

- KOSTANDINI — (*Mbledh supet.*) Si...
- ZAFIRA — (*E nevrikosur*) Si është burri që më ke zgjedhur, baba?
- KOSTANDINI — (*Mbledh supet.*) S'e di s'e kam parë. Atëherë, kur u lidh kjo kushqi, ai ishte në djep. Që atëherë s'e kam parë. S'di si është bërë.
- ZAFIRA — E shikon, pra, se ti s'di se ç'po më jep, se ti vepron kështu, mbasi të janë veshur sytë nga fjalët e priftit.
- KOSTANDINI — Si, si the?
- ZAFIRA — Sa keq, babë, sa keq që s'do të më kuptosh, që s'je në gjendje të kuptosh se çfarë po bën më mua, me jetën time!
- KOSTANDINI — Se ç'bëj unë, atë e di unë.
- ZAFIRA — Jo, ti bën atë që thotë prifti, ti je një lodër që bie sipas dëshirës së priftit dhe të atyre njerëzve me të cilët u lidhe se të zuri nata jashtë.
- KOSTANDINI — Dhashë besën, lidha fejesën.
- ZAFIRA — Cila është më e shtrenjtë për ty, unë apo fjala që ke dhënë?
- KOSTANDINI — Shumë po të duroj, o bijë!
- ZAFIRA — Atje nuk shkoj, nuk shkoj! Jo, jo! Nuk shkoj. (*Plaka shikon në sy plakun.*)
- SOSIA — E shkreta ti! (*Përqaqon vajzën.*) Së paku kjo të mos vuaj siç vuajta unë. Në djall le të vejë gjithçka! (*E shtrëngon fort të bijën dhe largohen të dyja disa hapa nga plaku. Zëra në oborrin e shtëpisë.*)
- O i zoti i shtëpisë!
- O Kostandin!
- (*Zëra, zhurmë, daulle, muzikë.*)
- O i zoti i shtëpisë!
- (*Zëra të gëzuar, të qeshura.*)
- KOSTANDINI — Kush do të jetë vallë?
- SOSIA — (*Shikon nga dritarja.*) Është katundi i gjithë, është sekretari i Partisë dhe disa të këshillit.
- KOSTANDINI — (*Hap derën.*) Bujrum!

SKENA III

*(Hyn sekretari i Partisë, Maria, anëtarët e këshillit, elektrikistët, burra, gra, të rinj dhe të reja. Mbu-  
shet skena dhe shkallët.)*

SPIROJA — Po ju, ç'jeni mbyllur këtu? Sot dy fshat-  
rat tanë kanë festë. Pas pak do të ndizen dritat.  
Organizata e Partisë dhe këshilli i fshatit vendos-  
sën që festën ta nisim në këtë shtëpi, e cila dikur  
ka qenë shtëpia e veçuar e dy fshatrave. Pas pak  
nga kjo shtëpi do të përhapet drita në të dyja  
anët. Sot kemi festë të madhe. Me këtë rast dy  
fshatrat tona do të bashkohen në një koopera-  
tivë të vetme. Do të jemi të gjithë një familje  
e madhe, me rrugë automobilistike dhe me dritë.  
— Urra! *(Thërrasin të gjithë. Bien daullet dhe  
pipëzat)* — Po vijnë dhe ata! *(Thotë njeri që  
është pranë portës. Dëgjohen daullet e fshatit  
tjetër që është afruar. Daulle dhe të shtëna  
pushkësh.)*

SOSIA — *(E habitur.)* Sot dasmë!

SPIROJA — Po, dasmë, sot është ditë gëzimi. Ti ke  
vuajtur më shumë se kushdo në këtë shtëpi, gë-  
zohu, pra!

*(Ndizen dritat. Britma gëzimi: Urra! Urra! Dritë  
në malësi!)*

*(U hedh dorën në sup plakës dhe Zafirës.)* Ejani!  
*(Fton dhe Kostandinin.)* Ejani të gjithë, të gë-  
zojmë ditën e dritës elektrike! *(Të gjithë me  
zhurmë dhe të gëzuar zenë e dalin. Plaku ka mbe-  
tur i veçuar.)*

KOSTANDINI — *(I hutuar.)* Ç'po ndodh kështu?... E  
morën, e morën Zafirën me gjithë t'ëmën. Kurse  
tashti duhet të vijnë ata, krushqit... Ç'të bëj?...  
Nusen e mori katundi. *(Dy të rinj e fusin Kostan-  
dinin në mes.)*



I RIU — Eja, xhaxho me ne, eja!

KOSTANDINI — *(Vazhdon të jetë i hutuar.)* Ku? Ku  
po më çoni?

I RIU — Në dasmën e madhe të dritave! *(Muzikë.)*

*(Bie perdja.)*

7070

Mbas dy  
vjetësh

## VETAT:

ADEM ZENGA — traktorist, mekanik

MARTA ZENGA — e shoqja, traktoriste

POLOJA — përgjegjësi i oficinës, sekretar i Partisë

SHPRESA — kushëriri e Ademit, tornitore

ZENELI — ndihmëstraktorist i Ademit

XHA KASEMI — i ati i Shpresës

RAMIZI — punëtor

SYTKIU — «

HALIMI — «

DULLA — «

HAXHIU — «

MALOJA — magazinier

PETRI — traktorist

SKËNDERI — «

HALITI — «

PAGATORI

Punëtorë të oficinës, punëtorë të fermës, komshinj etj., në  
role episodike e figurantë.

## TABLOJA E PARË

*(Pamja e një ofiçine bujqësore. Një kapanon i madh. Në fund të skenës një derë me xhama që të lë përshtypjen e një zyre. Paraskena — shesh i ofiçinës. Në skenë diku është vendosur një traktor butaforik. Hapet perdja.*

*Mëngjes herët. Qetësi. Pas derës me xhama shohim përgjegjësin e repartit që bën ndarjen e punës; mbi një libër të madh shkruan dhe mendohet.*

*Dalëngadalë në skenë hyjnë punëtorët dhe punëtorët, përshëndesin njëri-tjetrin, dikush var diku trastën e bukës, dikush vesh rrobat e punës, traktori butaforik u bie në sy pothuajse të gjithëve.)*

RAMIZI — Po ky (I bie me pëllëmbë traktorit si të jetë kalë.) kur paska ardhur?

SYTKIU — (Duke u veshur.) Erdhi mbrëmë.

RAMIZI — Çfarë ka?

SYTKIU — (Mbledh supet.)

HALIMI — Rrangallë, e ka ngrënë çairin e vet ky. Me këtë traktor ka filluar punën ferma jonë.

RAMIZI — Qenka moshatar me fermën. Ky e ditka përmendësh historikun e ndërmarrjes sonë. (Bie çanga për fillimin e punës, njerëzit zënë e grumbullohen, dikush vjen me vonësë dhe vrapon.)

RAMIZI — Më është mërzitur ky surrat, gjithnjë vonë vjen.

SYTKIU — Ka tre kallo, i shkretë, dy në këmbën e majtë dhe një në të djathtë.

DULLA — Epo njerëz jemi dhe do vonohemi nganjëherë.

(*Afrohet përgjegjësi i oficinës, i cili e dëgjon. Në dorë ka librin e punës.*)

POLOJA — Sepse jemi njerëz nuk duhet t'i shkelim rregullat që kemi vënë; orari është orar.

DULLA — E kam larg shtëpinë.

POLOJA — Na e mbushe mendjen. Ja, Ademi (*Tregon me dorë Ademin.*) vjen nga fshati që është një orë e gjysmë larg. Unë s'mbaj mend që ai të ketë ardhur ndonjëherë vonë.

DULLA — Mos më trego Ademin ti, atij ia ka koka fajet. Apartamentin dhe gruan e ka pas murit të oficinës. Apo i pëlqen të mbajë një dorë në revani e tjetrën në bakllava.

ADEMI — Lëre atë muhabet!

DULLA — Ta lë? Po ky (*Tregon me dorë përgjegjësien e oficinës.*) të merr ty për shembull të lartë. Jo, unë s'jam si ti dhe as dua që të jem.

HAXHIU — (*Me ironi.*) Shtëpia e fshatit është e të atit, në sektor është e së shoqes.

DULLA — Ky duhet të bëjë lutje për shtëpi atëherë. (*Të gjithë qeshin.*)

ZYDIU — Lërin shakatë, puna e Ademit nuk është për të qeshur!

DULLA — Epo, u mërzitëm me të, ahu, një e dy po punën e Ademit, daç të vërë mend, daç të mos vërë!

ZYDIU — Jo, jo, nuk është ashtu si thua ti! Ne jemi një kolektiv këtu dhe nëse njëri nga ne bën ndonjë gabim, ose sillet keq, duhet të na bëjë merak, njolla e çdo njeriu na takon edhe neve.

DULLA — (*Si me përtesë.*) Mirë, mirë.

HAXHIU — Zydiu ka të drejtë. Ç'kemi bërë ne për Ademin?

DULLA — Asgjë, ç'të bëjmë ne?

ZYDIU — Jo, asgjë! Ne kemi bërë diçka, ja hoqëm traktorin dhe e morëm në gjirin tonë. Kaq bëmë dhe pandehëm se kjo qe mjaft.

RAMIZI — Për besë, se po flas dhe unë, mua më duket se kemi çfarë të bëjmë. Sa herë e kemi shtruar çështjen e tij. U mërzitëm me punën e Ademit. Fundja vezë të arta s'po na bën ky njeri.  
(Përgjegjësi i ofiçinës matet të flasë po ia pret fjalën Zydiu.)

ZYDIU — Një minutë, shoku përgjegjës!

POLOJA — Një minutë sot, një minutë nesër, si shumë minuta po humbim... (Tregon orën.)

ZYDIU — Nëse këto minuta të «humbura» Ademi dhe ndokush tjetër do të dijë t'i vlerësojë, mua më duket se kemi fitim e jo humbje, bile fitim të madh. Asnjëri prej nesh më vete nuk bën vezë të arta, po ama, të gjithë së bashku bëjmë gjithçka, bëjmë që kjo tokë të pjellë ç'të duam ne.

RAMIZI — Ç'lidhje ka kjo që thua me Ademin?

ZYDIU — Ka shumë lidhje. Ademi i ka të gjithë mundësitë që të jetë një punëtor i mirë e i vërtetë.  
(Ademi zbrapset dhe ul kokën. Zydiu e vë re. E vënë re dhe të tjerët. Të gjithë shohin Ademin, i cili bëhet gati që të flasë.)

ADEMI — Te ju s'kam shumë që punoj. (Tregon duart.) Dhe unë duart me kalloj i kam... e, megjithatë s'qenkam...

POLOJA — Adem, unë të njoh më mirë nga të gjithë këta. Bashkë kemi kohë që njihemi, qëkur ti zbritte nga fshati, mos u prek. Zydiu e ka fjalën gjetkë. Ai do të thotë se jo çdo njeri që ka duart me kallo është punëtor në kuptim të vërtetë të kësaj fjale: punëtor me ndërgjegje të lartë, të pastër.

ADEMI — (Buzëqesh hidhur.) Çudi!

HAXHIU — Mës u çudit, o bir! Ti je i ri, sa të rrosh

do mësosh. Dikur ne punoim për një copë bukë.  
Sot bukën e kemi dhe po u sëmure përgjegjësi ta  
paguan ditën.

SYTKIU — Jo përgjegjësi, xhaxho, po bashkimet pro-  
fesionale.

RAMIZI — Lëreni tjetrin të flasë, Hë, mo xha Haxhi,  
fol!

HAXHIU — Do të flas që ç'ke me të se, ky birçja  
(*Tregon Ademin.*) i bie të mirës me shqelm, pu-  
non këtu me ne, po mendjen kush e di se ku e ka.

ADEMI — Këtu e kam, po ju kërkon!

POLOJA — Të bëhesh si gjithë shokët, asgjë tjetër  
s'kërkojmë. (*Shikon orën dhe thërret me habi.*) O,  
e shkelëm sot, fillojmë, shokë! Sadiku ka ardhur?

SADIKU — Këtu!

POLOJA — Punën që kisha dje. Gëzim Leka!

GËZIMI — Këtu!

POLOJA — Vazhdo punën me zëtorin 32 09. Pajtim  
Hasa!

PAJTIMI — Këtu!

POLOJA — Do të bësh tri kavaleta dhe shpjerja axhus-  
tatorit. Ka ardhur Qerimi?

QERIMI — Këtu jam!

POLOJA — Do t'i bësh shpejt se do të vijnë nga sek-  
tori t'i marrin.

QERIMI — Mirë.

POLOJA — Zyhdi Rusta!

ZYHDIU — Ç'të bëj sot? Motorin e mbarova që mbrëmë.

POLOJA — E di. Shko në NSHRAK të marrësh dy pom-  
paçina! Njëren e duam për këtë (*Tregon me dorë  
traktorin butaforik.*), kurse tjetrin për «STALI-  
NECIN».

RAMIZI — (*I pëshpërit Sytkiut.*) Ehu, qenka për të  
hapur fare ky babaxhan!

DULLA — Kushedi se kujt do t'ia ngopin.

HALIMI — Mbylle atë të shkretë gojë se na qelbe!

POLOJA — Mbani qetësi, shokë! Haxhiu!

HAXHIU — Këtu!

POLOJA — Do të saldosh parakolpin e KD-së dhe...

HAXHIU — S'kam më elektroda ZH-40.

POLOJA — Ama edhe ti, na mërzite me këto ZH-40, E-20; saldo me elektrodën e uzinës «Partizani», edhe ato s'janë të këqija!

HAXHIU — S'thashë se janë të këqija.

POLOJA — Mirë, mirë. Ti, Xhafer!

XHAFERI — Urdhëro!

POLOJA — Merru me plugun pesëveshësh! Adem Zenga!

ADEMI — Këtu jam!

POLOJA — Do të merresh me traktorin që erdhi mbrëmë. (Tregon me dorë.) Shiko çfarë ka dhe bëje nuse. Sabaudin!...

ADEMI — (Ia pret fjalën.) Atë traktor nuk e zë me dorë.

POLOJA — Si?!

ADEMI — — Nuk e zë me dorë.

POLOJA — Ç'do me thënë kjo?

ADEMI — Nuk e zë.

POLOJA — Lëri shakatë!

ADEMI — S'po bëj shaka. Këtu ka edhe mekanikë të tjerë, jepia ndonjë tjetri. (I nevrikosur nxjerr paketën.)

RAMIZI — (Zgjat dorën dhe i rrëmben një cigare.) S'ke ç'i bën!

POLOJA — Ti e njeh këtë traktor, dikur ke punuar me të. Ti do ta ndreqësh, traktoristja do të të ndihmojë.

ADEMI — Traktorin e saj nuk e zë me dorë.

POLOJA — Traktori nuk është pronë personale, as i saj, as imi, është i shtetit, i fermës, ti e njeh se ke punuar me të dhe ti do ta ndreqësh.

ADEMI — Jo!

POLOJA — Po!

ADEMI — Jo, traktorin e saj s'e zë me dorë.  
(Pëshpëritje dhe lëvizje.)

POLOJA — Qetësi, shokë! (Shikon orën.) Filloni nga puna! Edhe ti, nisu!



(Të gjithë zënë e largohen, veç Ademit.)

ADEMI — Të thashë, jo!

POLOJA — Akoma me ato mend ti, kur do të heqësh dorë?

ADEMI — Të thashë, pra, traktorin e saj s'e zë me dorë.

POLOJA — Edhe unë të thashë se traktori s'është i saj, as imi; është i shtetit.

ADEMI — E di.

POLOJA — Pandeh se i di, të duket se i di. I di mbase, por vetëm me fjalë. Me mend, me zemër, jo.

ADEMI — Mos më fyej! Ti e di fare mirë se ajo dikur ka qenë gruaja ime, ti di gjithçka që ka ndodhur midis nesh, e di punën e këtij. (I bie me pëllëmbë traktorit sa buçet kabina.) Ky qe sherri!

POLOJA — Ashtu? Vetëm ky qe shkaku?

ADEMI — (I zënë ngushtë.) Kish edhe shkaqe të tjera, po gjersa ma hoqën këtë (I bie përsëri kabinës së traktorit.) dhe ia dhanë asaj...

POLOJA — Lëri këto, lëri, fillo punën! Më mirë se ti asnjë s'e njih këtë traktor. (Largohet.)

(Të gjithë janë larguar, ka filluar puna, dëgjo-hen zhurma pune në repartet e tjera. Ademi i afrohet traktorit i përmalluar.)

ADEMI — Si qenke katandisur, o i shkretë! Më keq se unë! S'patëm fat, që të dy u bëmë për t'u riparuar. Ja, përsëri jemi bashkë, pas dy vjetësh! E sa kemi punuar! Të kujtohet pylli i pashkelur? Fushë e bëmë? Sa moçalishte kemi tharë! E ç'nuk kemi punuar edhe ja fundi, ti i katandisur mos më keq, kurse unë s'qenkam as punëtor. E, ç'jam unë? Ti më njih, fol, ç'jam? Fshatar i prapambetur qenkam? Jo, jo, mbase nuk gjykojmë mirë apo kam të drejtë, ë? Më thuaj, ti je më i vjetër se unë në këtë zanat, ti ke 25 vjet që po punon kurse unë i kam a s'i kam çerekun tënd. Ti je traktor i lavdishëm, për ty e për traktoristat që të kanë ngarë kanë shkruar gazetat. Mos vallë unë qenkam traktoristi më i keq

që të kam ngarë ty? Ah, sa ma ka ënda të jem dhe unë si gjithë këta, i lirë si gjithë këta, i parvarur si gjithë shokët!

*(Hyn traktoristja, magazinieri, të ngarkuar me disa detale dhe dy punëtorë që mbajnë një aks.)*

MALOJA — Ja edhe kjo punë mbaroi, besoj se ke mbetur e kënaqur, shoqja traktoriste!

DULLA — Sa mirë që e ka kuptuar emancipimin xha Maloja!

HALIMI — Nuk e ka nga emancipimi, jo! E ka nga ashikllëku. Gjithë jetën xha Maloja qejfli grash ka genë.

MALOJA — Tyt lanet, edepsëz, të të vijë turp nga thijnjat e mia dhe nga këto! *(Tregon me dorë mustaqet. Të dy punëtorët qeshin duke u larguar I drejtohet Ademit.)* Ke parë ti, të të bëjnë nevrrik që në mëngjes, të thonë njëqind fjalë se i ndihmova kësaj! Për besë, nuk e njoh, m'u duk si e lodhur dhe thashë t'i ndihmoj. *(Magazinieri flet, kurse ata të dy, Ademi dhe Marta, s'dëgjojnë fare, të heshtur vështrojnë njëri-tjetrin. Magazinieri e kupton më në fund se po flet kot, habitet nga vështrimet e tyre të ngulitura dhe të heshtura dhe largohet. Në këtë çast hyn Shpresa, qëndron pranë tyre, ata nuk e vënë re që ajo është afruar.)*

SHPRESA — *(Buzëqesh.)* Për besë, tamam si dikur, çudi, tamam si dikur! Asnjëherë s'e kam ndier veten të tepërt pranë jush. Për besë, jam gati të vë bast me cilindo, edhe me djallin po deshët, që ju të dy duheni akoma.

ADEMI — Ç'flet budallallëqe!

SHPRESA — Jo, të betohem! Ju të dy u vështruat tamam si dikur, siç vështroheshit atëherë, vite të shkuara, kur nisët të dashuroheshit. Ja, po të mbyll sytë, e po t'ju kujtoj ju të dy para dy vjetësh, të dy fytyrat tuaja më dalin parasysh tamam ashtu siç ishit një minutë më parë.

MARTA — Një minutë më parë?... Jo, jo, Shpresa, ti gabon, dashuri midis nesh?!

SHPRESA — Ka, unë e pashë në sytë e tu, në sytë e Ademit, në vështrimet tuaja.

ADEMI — Dashuria jonë është si puna e asaj bukës që është thyer në mes.

SHPRESA — Ti asnjëherë s'ke folur me arsye, ti gjithnjë je rrëmbyer.

ADEMI — Mbase, mund të jetë ashtu siç thua ti, po këtë radhë më duket se fola me vend.

SHPRESA — I di përmendësh fjalët e tua, me vend e pa vend. Ti, që ishe një nga traktoristët më të dalluar të fermës sonë, po të kishe folur me vënd s'do të...

MARTA — Lëri këto fjalë, Shpresa, qe ç'qe!...

SHPRESA — *(Shikon si e hutuar Martën dhe Ademin/ Marta dhe Ademi përsëri vështrohen.)* Për besë, në sytë tuaj ka akoma dashuri dhe mos më kundërshtoni për këtë.

ADEMI — O, na lodhe, të paska ardhur oreksi për të folur!

MARTA — Mjaft më, Shpresa!

SHPRESA — Të mërzitkam?

ADEMI — Po.

SHPRESA — Edhe ty?

MARTA — Po.

ADEMI — S'ka asgjë për t'u çuditur. *(Fillon të shikoj traktorin.)*

SHPRESA — Si s'paska! Më duket se s'jeni në vete që të dy, ose ky takim i papritur pas kaq kohe ju ka shushatur që të dyve se...

MARTA — Të lutem, Shpresa!

SHPRESA — Çfarë?

MARTA — Harroje edhe ti, përderisa ne vetë kemi harruar gjithçka!

SHPRESA — Si ka mundësi të harrohet gjithçka? Jo,

ti gënjen, dhe ti gënjen, të dy gënjeni veten tuaj, njëri-tjetrin dhe mua. Për besë, s'dua t'ju besoj. Gjithë ajo dashuri, sa e madhe ish, sa bukur nisi! Po ju që të dy nuk jeni në vete, ju që të dy jeni si... Si t'jua shpjegoj të shkretën. Ah, s'di si ta them.

ADEMI — S'di si ta thuash, sepse s'ka ç'të thuash.

MARTA — Ashtu është!

SHPRESA — Ashtu qenka! Tashti po më vjen keq edhe për ty. Dhe po ju them që të dyve se s'është ashtu siç thoni ju. Sepse që të dy gaboheni, që të dy përpiqeni të harroni me zor ndjenjat tuaja. Jo, njeriu nuk jeton që t'i fshehë ato e të trembet kur ndien se i rreh zemra. Frikacakët jetojnë kështu. Dhe ju të dy, qëkur u ndatë, u bëtë frikacakë. Patët guxim vetëm një herë, kur u zutë dhe që prej asaj dite s'guxuat të shiheni me njëri tjetrin. Sepse s'kishit më guxim të ballafaqoheshit edhe një herë. Dhe tashti, tashti thoni...

ADEMI — (Bërtet.) Mjaft! (Në skenë kalon përgjegjësi i oficinës.) Shoku përgjegjës, të thashë se këtë nuk e zë me dorë. Kam një mijë arsye.

POLOJA — Pikërisht se ke shumë arsye do ta zësh.

SHPRESA — (Qesh me inat.) Mjaft, ë?

ADEMI — Më mërzite të them, dëgjon apo jo?!

SHPRESA — Të mërzita, ë? Tashti t'u mërzitkam, ë? Kurse atëherë dridheshe kur takoheshe me mua dhe dora të dridhej kur më jepje letrën që t'ia çoja kësaj. Atëherë...

ADEMI — Të lutem, lëre atë kohë!

SHPRESA — Jo, në asnjë mënyrë! Ty të janë veshur sytë nga egoizmi.

ADEMI — Pusho, më lër të qetë!

SHPRESA — Asnjë çast s'do të të lë të qetë, do të të kujtoj gjithçka. Të kujtohet?

ADEMI — (I hutuar.) Çfarë?

SHPRESA — Atë ditë që erdhe tek unë, që dridheshe si fletë plepi.

MARTA — Mos, Shpresa, të lutem mos, lëre atë kohë! Ajo ish kohë tjetër.

SHPRESA — Po ish ama koha më e bukur, ju kujtohet?

Eh, shikon si t'u çelën sytë? Apo po qan?

ADEMI — *(Me të butë.)* Shpresa, lëre tashti, të lutem!

SHPRESA — Çudi, si u zbutët kështu! *(Ademi dhe Marta heshtin.)* Po, ishte pasdite, jo, ishte mbrëmje: Ti erdhe me traktor, ja me këtë, erdhe me traktor gjer buzë shtëpisë sime, atë ditë ti i kishe thënë për herë të parë «të dua», po, mbrëmje ish.

ADEMI — Jo!

SHPRESA — Çfarë, edhe këtë fakt do ta mohosh?

ADEMI — Jo, jo, desha të të them se s'ish mbrëmje, ish natën, bile shumë vonë.

MARTA — Pasdite ish.

SHPRESA — Të shkretët ju, aq shumë i paski ndrydhur ndjenjat tuaja, kujtimet tuaja, sa të harroni!...

ADEMI — Nuk duroj dot më, për besë, po s'pushove!...

SHPRESA — Jo, nuk do të pushoj, të thashë një herë se do të të kujtoj gjithçka, gjithë historinë tuaj që nga ajo natë... Po mirë e the ti, ishte natë. *(Ademi ndez traktorin që të bëjë zhurmë e të mos dëgjojë. Shpresa ngre zërin.)*

SHPRESA — Ti erdhe, ja, me këtë dhe... *(Errësirë, dëgjohet fuqishëm vetëm zëri i traktorit që gjëmon, errësira dalëngadalë tretet e ne shohim një radhë apartamentesh, një rrugë si shesh, në njërin krah një radhë zyrash dhe klubin me disa stola e tavolina që u janë hequr mbulesat. Natë. Dritat e apartamentit janë shuar. Zhurma e traktorit sa vjen e shtohet dhe dy dritat e tij të fuqishme ndriçojnë skenën, faqet e murit dhe dritaret e përgjumura të apartamenteve.)*

## TABLOJA E DYTË

*(Traktori të lë përshtypjen se qëndroi afër skenës. Zhurma e tij mbush skenën. Ademi hyn e drejtohet për të trokitur. Ndizet një dritë në një dritare, pastaj një tjetër. Dikush del s'andejmi dhe bërtet.)*

NJË BURRË — More, ty të them, je çmendur ti? Shua-  
je motorin se na shurdhove.

NJË GRUA — Ik tutje, more lugat, se na trembe ka-  
lamajtë!

NJË TJETËR — Janë çmendur traktoristët, s'dijnë  
ç'është ditë e ç'është natë!

ADEMI — *(I hutuar.)* Ç'doni, more vëllezër?

NJË BURRË — Shuaje atë djall, se na prishe gjumin!

GRUAJA — Shuaji edhe dritat se na qorrove sytë!

ADEMI — *(Matet të trokasë, troket.)* Ja, ja, një minutë!

BURRI — Ç'minutë, ore, të paskan rrjedhur trutë!

*(Ndizen edhe drita të tjera. Ademi i vë re dhe largohet me të shpejtë, shuan motorin, dritat dhe hyn përsëri. Në skenë qetësi e plotë. Të gjitha dritat në dritare janë shuar. Nata e thellë. Gjysmë errësirë. Dëgjohet një bulk nate.)*

ADEMI — S'më pëlqen kjo qetësi, më duket sikur të gjithë flenë edhe ata që u çorën pak më parë  
*(Troket përsëri me të madhe. Del një burrë, Kasemi.)*

XHA KASEMI — Ç'është kështu, ç'do në mes të natës?!  
Zgjove gjithë sektorin.

ADEMI — — Mirë, mirë, dua Shpresën. Le të dalë pak,

XHA KASEMI — Ç'e do Shpresën tashti në këtë kohë?

ADEMI — Aman e dua, kam një fjalë, një punë të vogël, pesë minuta!

XHA KASEMI — Ik, ore tutje! Atë e ke kushërërë e jo kodoshe...

ADEMI — Aman, xha Kasem, të lutem!

XHA KASEMI — Qenke çmendur, mos ke pirë?!

ADEMI — Jo, të betohem kam që në mëngjes në punë, ja tashti e lashë!

XHA KASEMI — Hajde nesër në mëngjes!

ADEMI — S'kam kohë, sonte do të fle në pyll, se nesër do të filloj përsëri punën që pa gdhirë. Pesë minuta e dua, dy minuta punë kam.

XHA KASEMI — Ik tutje! (*Mbyll derën. Ademi i nevrkosur, shkon jashtë skenës dhe ndez përsëri traktorin dhe dritat. Përsëri ndizen edhe dritat e dritareve të apartamenteve dhe njerëzit zënë e thërrasin.*)

— More, po ky qenka i luajtur fare!

— Ore, do ta shuash atë djall, apo si e ke hallin?!

— E merr vesh nesër ti, te drejtori!

ADEMI — O, xha Kasem!

— Pse punë i thonë kësaj, vjen tjetri pa të keq e të tremb çiliminjtë në gjumë?!

— O ujk pylli!

XHA KASEMI — (*Del në skenë.*) Shuaje atë malukat! Shuaje shpejt!

ADEMI — Thuaj Shpresës të dalë!

XHA KASEMI — (*Duke u larguar.*) Mirë, mirë, po shuaje! (*Ademi vetë e shuan motorin dhe dritat. Hyn përsëri në skenë. Qetësi, natë. Del Shpresa.*)

SHPRESA — Ç'është?

ADEMI — I thashë.

SHPRESA — S'të marr vesh.

ADEMI — I thashë më në fund.

SHPRESA — Çfarë i the, kujt i the? (*Ngre jakën e xhakëtës sepse ka ftohtë.*)

ADEMI — Asaj pra, Martës, i thashë të dua, të dashuroj.

SHPRESA — Ashtu, i the më në fund?

ADEMI — (Me mburrje.) I thashë.

SHPRESA — Shumë mirë bëre!

ADEMI — (Ul kokën dhe gërvisht diçka me këmbë, pastaj  
pastron gërmazin.) Gehë, gehë!

SHPRESA — Po ajo ç'tha?

ADEMI — Hiç.

SHPRESA — Si hiç!

ADEMI — Hiç, u zverdh, iu mbushën sytë me lot dhe  
iku.

SHPRESA — Si, iku?

ADEMI — Ia dha vrapit.

SHPRESA — Kur ia the?

ADEMI — Me të perënduar dielli. Ajo doli nga kursi  
i rrobaqepësisë, unë i thirra dhe i thashë: «Marta,  
të dua!» Sa nisa t'i them të dashuroj, ajo u zverdh  
e krisi e iku.

SHPRESA — Çudi!

ADEMI — Punova, punova, ja, gjer tashti dhe s'munda  
të duroj më. Shemba gjithë ata dru në pyll. Si  
t'ia bëj?

SHPRESA — Ku di unë.

ADEMI — Shko i thuaj, shko pyete më do apo s'më  
do!

SHPRESA — Tashti?

ADEMI — Po.

SHPRESA — Ajo me siguri fle.

ADEMI — (I shqetësuar.) Po ta ketë zënë gjumi do të  
thotë se s'më do.

SHPRESA — S'ka të bëjë gjumi me dashurinë.

ADEMI — Ka, ka të bëjë. E di unë. Po ti shko! Mos  
ma prish! S'mund të punoj më, më beson. Shko,  
të lutem! Kur të dashurosh vetë do të më be-  
sosh.

SHPRESA — E di, e di, kam lexuar Romeon dhe Xhul-  
jetën. E ke lexuar ti?

ADEMI — Unë të lexoj libra? Je në vete! Nisu tani e  
mos më bëj nevrík!

SHPRESA — Do të ta jap ta lexosh, ka për të të pëlqyer.



- ADEMI — *(I mërzhitur.)* Në djall të vesh me gjithë romancën tënde! Do të shkosh apo jo?
- SHPRESA — Mirë, mirë! *(Largohet.)*
- ADEMI — *(Mënjanohet, shikon përreth.)* Ç'natë e bukur! Sikur të vijë, ë? *(Dy hije afrohen.)*
- SHPRESA — S'e kish zënë gjumi. Natën e mirë! *(Largohet.) (Ademi dhe Marta mbeten vetëm pranë karrigeve e tavolinave pa mbulesë të klubit.)*
- ADEMI — Më thua, më do?
- MARTA — Po! *(Ul kokën.)*
- ADEMI — Mos e ul kokën! Ngreje, dua të të shoh! Sa kohë kam që të dua!
- MARTA — Edhe unë.
- ADEMI — Tashti ti je imja. Sa e sa herë kam dashur ta shemb me traktor atë rrobaqepësinë tënde, të të rrëmbeja ty e të çoja në pyll.
- MARTA — Dhe unë kam dashur të hip në traktorin tënd. Sa herë që kaloje ti pranë rrobaqepësisë, unë të shikoja nga dritarja. Një herë shpova edhe gishtin. Që atëherë shoqet më qeshin.
- ADEMI — Çfarë të thonë?
- MARTA — *(Bën sikur imiton shoqet.)* Marta, po kalon Ademi me traktor. Marta, ki kujdes të mos shposh gishtin!
- ADEMI — Po ti ç'u thua?
- MARTA — Hiç. Ato e dinin që unë...
- ADEMI — Çfarë, thuaje!
- MARTA — Ta thashë një herë.
- ADEMI — Dua ta dëgjoj prapë. Thuaje edhe një herë. Më do?
- MARTA — *(Ul kokën.)* Po!
- ADEMI — *(E përqafton dhe ajo i hedh dorën në sup.)* Tashti ti... je imja, imja. Rrobaqepësja ime e vogël. *(Fiken ngadalë dritat deri në errësi të plotë. Dëgjohet zhurma e traktorit, dritat zënë e ndizen ngadalë. Zhurmën e traktorit e zë melodia e një pllake gramafoni.)*

## TABLOJA E TRETË

(Një dhomë e madhe. Apartamenti i Shpresës. Një tavolinë e shtruar me pije dhe meze. Në dhomë janë: Xha Kasemi, Shpresa, Ademi, Marta, e ëma e Martës, shokë e shoqe të Shpresës, Martës dhe Ademit, si dhe komshinjtë, një burrë e një grua. Ka gjallëri skena. Bisedojnë kokë më kokë. Muzika e pllakës së gramafonit mbush skenën me gëzim. Xha Kasemi mundohet të vejë qetësi. Ka gotën në dorë e do që të flasë. Ademi i bie me pirun pjatës dhe ndihmon xha Kasemin që të vendoset qetësia.)

XHA KASEMI — Para tre muajsh (Me solemnitët dhe me gotën në dorë.) një natë, të dashur komshinjtë e komshillarë, ky kushëriri im na prishi gjumin, të gjithë e shanë dhe e mallkuam. (Qeshin.) Në dasëm na mblodhi, tashti na ka mbledhur prapë.

SHPRESA — Sonte na ka mbledhur Marta, baba, jo Ademi.

XHA KASEMI — Mirë, Marta.

ADEMI — Pa lëreni të flasë xha Kasemin!

XHA KASEMI — Më rrofsh, more bir, se këto s'dinë se ç'flasin! (Matet të flasë me solemnitët.) Eh, ma prishët fjalën, doja të fthosha. (Matet të flasë përsëri me solemnitët.) Tashti na ka mbledhur Marta për të festuar kategorinë e rë, për të pirë rrogën e saj të parë si punëtore...

- SHPRESA — Lëre, baba, se e prishe fare tashti!
- XHA KASEMI — (*Që ka ardhur pak në qejf.*) Pse, moj bijë, ç'po bëjmë ne, nuk po pimë?
- ZYDIU — Po, mo xha Kasem, po pimë, po s'jemi mbledhur që të pimë, jemi mbledhur që të festojmë ditën e shënuar që Marta mori kategorinë, se deri dje ishte nxënëse dhe me këtë rast pimë.
- XHA KASEMI — (*I hutuar.*) S'jemi mbledhur që të pimë, por prapë pimë; s'të mora vesh, more bir, s'të mora vesh fare. (*Qeshin.*)
- MARTA — Xha Kasem!
- XHA KASEMI — Urdhëro, moj bijë!
- MARTA — Ti pi, bëj qejf, pi!
- XHA KASEMI — Hë, të lumtë, tashti të mora vesh.
- NJË SHOQE — Shpresa, na gjej një muzikë për të kërcyer!
- XHA KASEMI — Nuk do bëni keq. (*Të rinjtë dhe komshinjtë ngrihen e kërcëjnë. Kasemi mbush gofën dhe i afrohet nënës së Martës.*) E ke çupën flori! Për ta pirë në kupë! Ajo më bën më tepër hyzmet se ime bijë që kam në shtëpi. Ajo më qep, më arnon.
- E ËMA E MARTËS — Epo i vjen ndoresh, rrobaqepëse na u bë dhe juve faleminderit se i jeni ndodhur afër! Ç'të bësh kur e ke çupën në kurs!
- MARTA — (*Duke kërcyer me Shpresën.*) Sa e lumtur jam, kështu vallë janë të gjithë njerëzit, kështu do të jem gjithë jetën?
- SHPRESA — Pse të mos jesh?
- MARTA — Sa frikë që kam.
- SHPRESA — Frikë, pse?
- MARTA — Nuk e di, nuk e di se si më duket.
- SHPRESA — Si të duket?
- MARTA — (*Qëndron.*) Gjithë kjo dhomë, gjithë apartamentet e fermës sonë, gjithë ferma dhe rrobaqepësia më duket sikur kanë hyrë ja, këtu! (*Tregon me dorë gjoksin.*) Ecja rrugës sot, kur u ktheva nga puna dhe gjithçka më dukej e

zbukuruar si për festë. Më dukej sikur nuk shkelja përdhë. Kur hipa shkallët e apartamentit, m'u drodh zemra dhe tashti që po të flas.

SHPRESA — Budallaçkë!

MARTA — Se si më vjen, sikur s'ka për të vazhduar gjatë gjithë ky gëzim, sikur do të prishet diçka.

SHPRESA — Si të prishet, pse të prishet?

MARTA — Sepse gjithçka më duket si e pabesueshme, gjithë kjo lumturia ime.

SHPRESA — Po pse?

MARTA — Sepse gjithçka u bë kaq shpejt, si në ëndërr, si në përrallë.

SHPRESA — S'të kuptoj.

MARTA — Po ja, kaq papritur e gjithë këto gjëra mua më kanë ndodhur. U martova me atë që desha, u bëra punëtoore me kategori, gjithë këta njerëz, gjithë...

SHPRESA — Kjo është jeta jonë. Si t'u dukërka ty e pabesueshme?

MARTA — Ku di unë, e shkreta, kaq papritur, gjithë këto gjëra. (*Ademi afrohet dhe dëgjon.*)

ADEMI — Ç'ka zoqka ime që belbëzon? (*Të dy vajzat sikur tremben.*) Pa shih, pa shih dhe syçkat m'i paska të përlotura. Pa lemë një çikë vetëm me nuskën time se akoma s'ka mbaruar tremujori i mjaltit.

NJË KOMSHI — Shiko, shiko! Demi ynë e paska tre muaj muajin e mjaltit.

ADEMI — Tërë jetën muaj mjalti do ta kemi, gjersa kam një thëllëzë të tillë në shtëpi. (*Marta shikon e trembur nga Shpresa.*)

SHPRESA — Ti mos ke pirë që flet kështu?

ADEMI — Kam pirë, po jo aq sa të humbas mendjen.

SHPRESA — Asnjë i dehur s'pranon se është i dehur.

ADEMI — Mos na i prish muhabetin sonte, ti gjithnjë ke qenë e mrekullueshme, por jo më e mirë se zoqka ime!

SHPRESA — Ti po na prish muhabetin, jo unë.

- ADEMI — (*Martës.*) Pse po fliste Marta ime? (*Përplas duart.*) Qetësi, Marta kërkon të flasë! (*Grumbullohen pothuajse të gjithë përveç dy pleqve.*)
- MARTA — Jo, s'kisha për të thënë gjë.
- ADEMI — Fol, fol, sot është dita jote, sot ti more rrogën e parë! Dy mijë lek, të cilat më duket se për dy orë u tretën. (*Shikon nga tavolinat, të cilat kanë mbetur përgjysmë.*)
- MARTA — Ç'është kështu me ty, Adem?!
- ADEMI — (*Qesh.*) Bëra shaka, desha t'ju bëja për të qeshur. (*Të gjithë rrinë seriozë.*) Hajde të lozim gjë e gjëza!
- MARTA — Çfarë?!
- ADEMI — Gjë e gjëza. Ja p.sh. (*Largohet dy tre hapa, u kthen kurrizin, nxjerr diçka nga jaka e palltos dhe e mban me kujdes mes dy gishtërinjve.*) Më thuaj çfarë kam këtu?
- MARTA — (*Mbledh supet.*)
- ADEMI — Si, nuk e sheh?
- MARTA — Jo!
- ADEMI — (*Bën sikur nxjerr vetëm pak majën e gjilpërës.*) Ja, shikoje mirë!
- MARTA — (*E trembur.*) Nuk të marr vesh ç'do të thuash?
- ADEMI — Asgjë, asgjë! Ti duhet ta gjesh se çfarë kam këtu. (*Lëviz gishtërinjtë.*)
- MARTA — Asgjë s'ke. Ti kërkon të tallesh.
- ADEMI — Jo, nuk tallem, gjeje!
- MARTA — Nuk e gjej dot.
- ADEMI — E gjen, e gjen, pa mendohu mirë! Hë, kam veglën tënde kryesore të punës.
- MARTA — Gjilpërë.
- ADEMI — Bravo, e gjetë! (*Qesh, qeshin edhe dy tre vetë*)
- XHA KASEMI — (*Që ka dëgjuar bisedën, ngrihet më këmbë.*) Të pimë një gotë për gjilpërën.
- SHPRESA — Përse e bëre këtë lojë? (*Ia merr gjilpërën dhe e hedh.*)
- ADEMI — Mirë bëre që e hodhe (*I hedh dorën në sup*

*Martës.*) dhe më mirë bëmë që u mblodhëm sonte dhe pimë për shëndetin e gjilpërës, po ti, zoçka e Ademit, mos u mërzit! Ka plane Ademi për ty.

MARTA — Plane!

SHPRESA — Ç'farë planesh?

ADEMI — Plane të thella, qilizma!

MARTA — Nuk të kuptoj.

ADEMI — (*Qesh.*) Kur të hipësh në traktor do të më kuptosh. Traktori po, ai është mjet, pune, jo gjilpëra. (*Bën sikur kërkon.*) Ku është? Ku e hødhe, moj? S'duket. (*Qesh.*) A mund të punojë njeriu me një vegël pune që s'duket. Gjilpëra jote po të bëhet agresive në kulm mund të nxjerrë vetëm një pikë gjak, kurse traktori im, moj e shkretë, bën çudira. Pyllit të madh i erdhi fundi, moçalishtes po i vjen fundi; hë, si thua? A vjen nesër me mua? Lëre punën tënde vetëm për një ditë, dhe do të çuditesh. Zëri një herë me dorë marshet e traktorit, shemb një lis, një vetëm, dhe do ta ndiesh veten më të madhe dhe më të fuqishme se zoti.

XHA KASEMI — Po ju, more bir, thoni se s'ka zot.

ADEMI — Zëre se ka, gjersa të mësosh traktorin, gjersa të bëhesh traktorist, pastaj do ta ndiesh veten zot dhe kur ta takosh në ndonjë pyll ose kënetë, do t'i bërtasësh: hej, ti që e ndien veten se je zot i gjithësisë, pa prit një çikë të të guldulis brinjët.

XHA KASEMI — Tobestak furuallah, ç'flet i mallkuari!

ADEMI — (*Martës.*) Eh, si thua?

SHPRESA — Të bëhet Marta traktoriste?

ADEMI — Ndhimsësja ime.

NJË KOMSHI — (*Shikon me vëmendje supet delikate të Martës dhe tund kokën.*) Matu mirë, Adem!

ADEMI — Unë dua që gruaja ime të ecë përpara, të jetë në ballë (*Të gjithë bërtasin. Zhurma të fuqishme traktorësh. Të gjitha këto zhurma shoqërohen me shuarjen e dritave.*)

## TABLOJA E KATËRT

*(Në fushë, pranë dyqanit-klub. Përtej, diku afër punohet për tharjen e një moçalishteje. Së anejmi vjen e shurdhër zhurma e traktorëve që punojnë. Në derën e dyqanit një dyqanxhi bisedon me një traktorist. Të dy janë në moshë të afërt, rreth 40-45 vjeçëve. Traktoristi ka në dorë një vegël të traktorit. Marta po mundohet të ndezë traktorin.)*

DYQANXHIU — Për besë, tashti më është mbushur mendja top që kjo vajzë u bë traktoriste. Po të isha në vendin tënd, do të bëja çmos që ajo të merrte traktor të ri.

PETRI — Ajo dhe me këtë rrangallë na vuri përpara, jo më t'i japësh traktor të ri. E theu normën, ka një muaj që bën një normë e gjysmë. E provoi dhe u ngrit në mbledhje e tha që norma të ngrihet.

DYQANXHIU — Po më çudit.

PETRI — Hiç, mos u çudit. Gjaku i ri, norma të reja, nuk flitet më as për mua as për Ademin, as për Sokratin, ne që ishim lavdia e fermës, që na quanin djall i tokës. Ja, e shikon? S'ta mbush syrin, po hajde matu me të?

DYQANXHIU — Ç'i ka traktori që s'i ndizet?

PETRI — Po i bën shërbim teknik.

DYQANXHIU — Tashti, pasdite?

PETRI — Tashti vjen dhe e merr i shoqi, ia dorëzon

si nuse, pa një pikë baltë, të grasatuar, të pas-truar. Kam një sihariq për të.

DYQANXHIU — Çfarë? Pse s'ia thua?

PETRI — Të mbarojë punë një herë, se e di që me t'ia thënë do t'ia marrë vrapit.

DYQANXHIU — (*Thërret.*) Marta, moj Marta!

MARTA — (*Kthen kokën.*) Ç'është?

DYQANXHIU — Hajde, hajde një çikë!

MARTA — Ja, erdha! (*Merr një leckë dhe fshin du-art e afrohet.*)

DYQANXHIU — Petri vjen nga sektori, ka një lajm të mirë për ty.

MARTA — Ashtu! E pse rri si buf e s'ma thua, ke gjysmë ore që lllomotit aty si gratë në burim?

PETRI — Epo, ç'të bësh, edhe ne burrat kemi të më-tat tona, ju keni burimin për muhabet, ne ke-mi klubin, dhe ky burim është...

MARTA — E, u miratua norma e re?

PETRI — Shiko ku e ka mendjen shejtania! Në qoftë se s'është miratuar, do të miratohet, mjafton që ti e bërë fakt të kryer dhe kur e ke bërë ti, s'ka nevojë për sqarim.

MARTA — Po fol ahëre, ç'është?

PETRI — Vallahi u mata disa herë të ta thosha, po që të mos më shkojë dëm gjithë ai lajm, thashë të pres Ademin e t'ia them.

MARTA — (*Dyqanxhiut.*) Mbushi Petrit një dopio ko-njak! Ju burrat s'flisni dot po s'e lagët fytn. Hë, fol!

PETRI — Për besë ti, Marta, s'e ke shoqen në fermën tonë.

MARTA — (*I thërret dyqanxhiut që po hyn brenda.*) Mbushe dhe një për vete! E, ç'është?

PETRI — Hiç moj, asgjë! U talla.

MARTA — (*E kërcënon.*) Fol se!...

PETRI — Apartament!

MARTA — Urra! (*I thërret dyqanxhiut.*) Mbushe dhe



- një teke për mua! (*Vjen dyqanxhiu me gotat në duar. I çukasin dhe i pinë me fund.*)
- PETRI — E gëzofsh apartamentin! Tashti ika.
- DYQANXHIU — Prit, se do të vi dhe unë! (*Mbyll dyqanin dhe të dy largohen. Marta mbetet vetëm.*)
- MARTA — Ja dhe me shtëpi u bëmë, sa do të gëzohet Ademi. Po tashti? Ç'të bëj? (*Shikon rreth e qark.*) Sa shpejt bëhet i lumtur njeriu! (*Hyn Ademi, në dorë ka një shami ku mban bukën e gjellën.*) Adem! (*I hidhet në qafë.*)
- ADEMI — Ç'është? Desh më rrëzove. Ç'është, pra?
- MARTA — S'e merr dot me mend. Pa më, mendohu një çikë. (*Ademi rri idhët.*)
- ADEMI — Për besë, s'më vete mendja gjëkundi.
- MARTA — Po ti kaq të lumtur më ke parë ndonjëherë?
- ADEMI — Shumë herë.
- MARTA — (*Si e zemëruar.*) Kaq, kaq sa sot?
- ADEMI — Po, ti gjithnjë e gëzuar je.
- MARTA — Kaq?
- ADEMI — Kaq.
- MARTA — Çudi!
- ADEMI — Thuamë ç'është!
- MARTA — Apartamentin na e dhanë.
- ADEMI — Ashtu? Kush ta tha?
- MARTA — Petri. Qe në sektor për të marrë s'di se ç'vegël. Ai desh të të priste ty po nuk i doli keq që ma tha mua.
- ADEMI — Ashtu? Sa mirë!
- MARTA — Më duket se ti nuk po gëzohesh.
- ADEMI — (*Mundohet të fshehtë ç'mendon.*) Jo, jo, u gëzova! Si të mos gëzohem.
- MARTA — Po ç'ke atëherë, pse s'më përqafon?
- ADEMI — Në shtëpi, jo këtu.
- MARTA — Më thuaj ç'ke? Ti dhe kur erdhe se si ishte.
- ADEMI — Si isha?

MARTA — Nejse, i lemë këto ishe si ishe, tani u bë-  
më me shtëpi. S'do të shkojmë poshtë e lart  
deri në fshat, një orë e gjysmë rrugë. Do të  
hamë në shtëpi si njerëz e jo kështu. (*I bie me  
dorë bukës që mban varur në shami i shoqi.  
Ademi i vendosur e ndalon lëvizjen e shamisë.*)

ADEMI — Mos i bjer ashtu! Është bukë, është gjynah.

MARTA — (*Qesh dhe ç përqafton. Ademi sprapset.*) Më  
thuaj ç'ke? Ç'të mundon?

ADEMI — Asgjë s'më mundon, asgjë!

MARTA — Mos gënje veten tënde! Thuama të paktën  
mua!

ADEMI — Që ta thuash në mbledhje.

MARTA — Si? Si the? (*Qesh hidhur.*) Dhe për punën e  
normës ti kështu u ngryse, ja si tani. Mezi t'u  
mbush mendja. Në fillim u tërbove kur të tha-  
shë propozimin tim. Ç'është me ty? Unë shpesh  
herë nuk të kuptoj, çfarë traktoristi je ti?

ADEMI — Mos do që të vë brirë?

MARTA — Brirë jo! Dua që të jesh si gjithë shokët  
e tu. I çiltër.

ADEMI — Hë, fillove prapë ti?

MARTA — Sepse më vjen keq për ty, sepse të dua,  
sepse...

ADEMI — Çfarë?

MARTA — Sepse s'më pëlqejnë ca gjëra te ti.

ADEMI — Ashtu? Pa hë, të dëgjojmë njëherë!

MARTA — Lëri, Adem, kot që i kujtojmë! Tashti u  
bëmë me shtëpi, ti e di se sa nevojë kishim për  
të. Tashti ne do të krijojmë familjen tonë. Do  
të bëjmë fëmijë.

ADEMI — Tjetër ç'do të bëjmë?

MARTA — Ti s'qenke në vete sot Adem!

ADEMI — Tjetër, tjetër, ç'do të bësh tjetër?

MARTA — Do të gatuaj për ty dhe ti s'do të ecësh  
poshtë e lart tri orë udhë në ditë, sa në fshat  
në sektor. Do të lësh punën si gjithë shokët, do  
të vish në shtëpi, do të rrish në klub.

ADEMI — Si gjithë shokët. Këtu e ke hallin ti?

MARTA — Po, këtu e kam. Sepse ti se si je. Ti se ku e ke mendjen.

ADEMI — Pse s'thua edhe ti atë që thonë poshtë e përpjetë për mua?

MARTA — Sepse ti më në fund re dakord që të ngremë normën.

ADEMI — Po të mos kisha rënë dakord?

MARTA — Do të thosha dhe unë atë që thonë të gjithë. Se ti punon me hile, që nuk i jep shoqërisë aq sa ke mundësi t'i japësh, kurse prej saj kërkon të marrësh sa më shumë.

ADEMI — Shyqyr që paskam rënë dakord!

MARTA — Gëzohu, pra, gëzohu dhe ti! (*I afrohet.*)  
Çfarë ke, xhanëm?

ADEMI — Kisha qejf ta ndërtoja vetë shtëpinë time. Kaq vjet kam punuar për këtë gjë. Dhe paret avash-avash po i grumbulloj. Të kisha dhe unë shtëpinë time me oborr, me pemë.

MARTA — Kurse tashti do ta kemi shtëpinë tonë, tënden dhe timen.

ADEMI — Marta, s'e kisha fjalën për ty.

(*Marta qesh.*)

ADEMI — Pse qesh?

MARTA — Sepse je i çuditshëm. Ti ke punuar si ka, ke grumbulluar lekun lek-lek, ke lënë mënjanë gjithçka për të bërë një shtëpi të vogël...

ADEMI — Po.

MARTA — Dhe ja vjen një ditë e ty të falin një shtëpi.

ADEMI — Po.

MARTA — Dhe ti nuk gëzohesh që tjetërkush ta realizon ëndrrën tënde pa paguar një dhjetëleksh?

ADEMI — Jo, gëzohem, tashti po e ndiej gëzimin, po, si të them, kisha kohë që ëndërroja për të bërë shtëpinë time vetë, atje pranë shtëpisë së vjetër, pranë oborrit, larg sektorit. Ah, Marta!

MARTA — Ti je i çuditshëm, Adem!

ADEMI — Jo, Marta! Unë jam si shumë bashkëfshatarët e mi. Dhe kam ëndrrat e planet e mia.

MARTA — Çfarë planesh? S'po të kuptoj, Adem.

ADEMI — Do më kuptosh.

MARTA — Po kur kështu?

ADEMI — Kur të vijë data.

MARTA — Cila ditë, Adem? Çfarë dite pret ti?

ADEMI — (*Qesh dhe e ngacmon Martën me përkëdheli.*) Atë që do të të bëjë ty të lumtur.

MARTA — Unë jam e lumtur.

ADEMI — Po nuk je e qetë. Lodhesh, vritesh gjithë ditën në punë, majë traktorit.

MARTA — O, Adem, po ti ma fute në gjak këtë zanat dhe unë u dashurova pas traktorit. Mos më mundo, Adem! Fol! Ç'janë këto plane?

ADEMI — Mos u mërzit. S'ka ardhur dita.

## TABLOJA E PESTË

(Skena e tablosë së parë. Gjithë skena është e mbushur me punëtorë të fermës, të ofiçinës, shoferë, traktoristë e ndihmës të tyre; janë ndarë grupe-grupe. Atmosferë e gjallë. Është dita e pagave. Në mes të skenës arkëtari dhe pagatori ndajnë pagat. Pranë tavolinës një qese e madhe me lekë.)

PAGATORI — Rustë Mezini!

RUSTA — Erdha, erdha, vëllajo! (Afrohet pranë tavolinës.)

PAGATORI — Qeva Luzi!

QEVA — Mbërrita!

PAGATORI — Nuk Zela! (Vazhdon t'i thërrasë një nga një.)

SHPRESA — Sa është rritur ferma jonë, s'ta merрте kurrë mendja se do të bëheshim ndërmarrja më e madhe në rreth!

MARTA — Dhe sa shpejt!

SHPRESA — Ti gjithnjë çuditesh, Marta.

MARTA — (E veshur me kominoshe gjithë vajëra.) Si të mos çuditem, para disa vitesh u bëra rroba-qepëse, kurse tashti traktoriste. Ti sekretare e rinisë e ofiçinës, ja dhe gjithë këta. Para dy tre vjetësh këtu mblidheshin apo s'mblidheshin për të marrë lekët gjysma e këtyre.

SHPRESA — Një mijë e dyqind punëtorë vetëm sektori ynë. Po gjithë ferma jonë sa ka? (Duke bi-

*seduar futet një grup vajzash që qeshin njëra me tjetrën.)*

NJË VAJZË — Ç'do të blesh me rrogën?

NJË TJETËR — Një orë dore.

E PARA — Domosdo, se u bëre brigadiere dhe do t'u kërkosh njerëzve llogari.

PAGATORI — *(Thërret fort.)* Zenun Tafa!

SHOFERI — Ehu, Zenuni! Ky ka tjetër avaz. *(Zenuni mezi ngrihet. Është ulur këmbëkryq. Ngrihet ngadalë, afrohet. Në dorë ka një rrjetë me rroba të palara.)*

PAGATORI — *(I nevrikosur.)* Luaj këmbët se s'do të të presin ty gjithë këta burra!

ZENUNI — Të më presin, posi! Po unë pse i prita. Tashti më erdhi radha, tashti do ta marr.

PAGATORI — Mirë, mirë, po luaj këmbët!

ZENUNI — *(Afrohet.)* Ja, erdha! *(Merr paret, nxjerr nga qafa një qese të lidhur me gjalm dhe e zgjidh avash-avash. Pagatori thërret një emër tjetër dhe i bën me dorë Zenunit që të largohet.)*

RUSTA — Tashti Zenunin s'e ke më në punë për tre ditë. Të katërtën ditë vjen avash-avash.

ZENUNI — *(Niset të dalë nga skena.)* E kam shtëpinë larg.

RUSTA — Epo tre ditë larg nuk e ke, të shkretën!

ZENUNI — Epo dhe do të çlodhem.

RUSTA — Udhë e mbarë, Zenun, e mirë ardhç!

ZENUNI — Ejvallah!

*(Pranë fasadës së klubit është grupi i traktoristëve, janë mbledhur kokë më kokë e diçka bisedojnë. Pranë tyre është Ademi. Vjen me vonesë Petri, përshëndet shokët, i shtrëngon dorën vetëm Martës.)*

PETRI — Të lumtë, Marta, propozimi yt për ngri-tjen e normës u miratua dhe nga drejtoria!

SKËNDERI — Thoni si të doni, po kjo na e hodhi. *(I bie me pëllëmbë në sup.)*

PETRI — Ai qe një propozim kolektiv, Marta qe iniciatore.

SKËNDERI — Po pse s'e more ti iniciativën?

PETRI — Këtu ke të drejtë.

SKËNDERI — Gjaku i ri, normë e re, hajde Marta, të lumtë për besë! (*Matet t'i bjerë në sup, po ndesh me vështrimin e Ademit dhe sprapset.*)

HALITI — Mirë që u miratua, po tashti si do t'ia bëjmë?

PETRI — Do të punojmë me normën e re, bile që nesër.

SKËNDERI — Unë propozoj që të pimë sonte për Martën e për normën e re.

PAGATORI — (*Me zë të lartë i nevrikosur.*) Skëndo Lamçe! Ore Skëndo, Skëndo ore!

SKËNDERI — Ç'është?

ADEMI — (*Bën një hap drejt pagatorit, kthen kokën nga Skënderi.*) Na erdhi radha, brigada e traktoristëve e ka radhën për të marrë lekët, ejani!

PETRI — Le t'i marrë tjetër brigadë, pastaj marrim ne.

PAGATORI — Ore, do të vini, apo jo?

ADEMI — Erdhëm, erdhëm! (*Niset drejt pagatorit.*)

SKËNDERI — Si do të vendosim? Do të pimë, apo jo?

DISA PREJ TYRE — Po, po, do të pimë, po ti, Adem? (*Ademi bën sikur nuk dëgjon.*)

PETRI — Kryesorja është të bëjmë një rindarje të zonave të punës sipas gjendjes së traktorëve, me që nesër do të fillojmë me normën e re. Për shebull, traktori yt (*i drejtohet traktoristit të tretë*) s'e bën dot normën e re në moçale, ti do të kalosh me plugim, kurse...

PAGATORI — More, ju do të vini, apo jo?

ADEMI — Erdhëm, erdhëm!

PETRI — Fillo një brigadë tjetër, pastaj marrim ne.

PAGATORI — (*Ademit.*) Ik, pastaj, kur ta marrin shokët!

ADEMI — More, ma jep mua një herë, po ata daç ta

marrin, daç jo! Kam punë, dua t'i marr se do të shkoj gjer në fshat.

PAGATORI — Ta ka mbledhur plaku, na!... (Ia jep e thërret emër tjetër.) Qerim Shegu!

QERIMI — Këtu!

PETRI — Ti (i drejtohet traktoristit II) do të kalosh me tarracat. Kurse Ademi. Ç'u bë Ademi?

SKËNDERI — Iku, mori lekët e iku.

MARTA — Do të shkante gjer në fshat, do të kthehet. Flas unë dhe në emër të Ademit. Do ta bëjmë normën e re në moçalishte.

PETRI — Jo, Marta, atje do të dal unë, ju punoni në plugim, traktori juaj është më i vjetri në brigadë.

MARTA — Në asnjë mënyrë nuk e ndërroj punën.

TË GJITHË — Dakord, he më të lumtë, moj Martë, na vure në lëvizje të gjithëve.

PAGATORI — (Vazhdon të thërrasë.)

Demir Hasa!

Gëzim Dulla!

Ali Hyka! etj...



## TABLOJA E GJASHTË

(Në shtëpinë e re. Apartamenti i Ademit e i Martës. Një tavolinë e mbushur plot me meze dhe pije. Ademi, i kapardisur, këmbë përmbi këmbë, ka filluar të pijë, është ulur përballë derës që të bjerë në sy përnjëherë kur të hyjë e shoqja. Marta hyn po aq e drojtur dhe e hutuar, siç doli nga skena e tablosë së pestë. Në duar mban akoma lekët. Habitet kur sheh të shoqin kapardisur dhe tavolinën plot me gjithë ato gjëra; mundohet të flasë po s'flet dot.)

ADEMI — Hajde, hajde zoçka e Ademit! (Ia bën me dorë që të afrohet.) Hajde, hajde!

(Marta afrohet pranë tavolinës.) 'Ç'është? Pse je si e hutuar?

MARTA — Hiç, kot! Ç'është kështu?

ADEMI — (Përmbledh buzët për të mos i dhënë rëndësi.) Asgjë, një kurth i vogël për thëllëzën e hutuar. Kush të ka trembur kështu?

MARTA — (Zgjat duart plot me lekë dhe i vë përmbi tavolinë.) Ja!

ADEMI — E kuptova. (Qesh.) Thashë se mos të ka qëlluar ndonjë gjahtar me saçme. Ha, ha, ha, kurse ti qenke trembur nga çiftja e arkëtarit! Paraja e tepërt ta prish mendjen. E shkreta ti, ishe mësuar me një mijë e tetëqind, dy mijë lekë në pesëmbëdhjetëditësh dhe ato i merrje pesëdhjetëshe-pesëdhjetëshe, si pare vakëfi! Ja,

këto janë para! (*I merr dhe i peshon në dorë.*) Të rënda si vetë traktori. (*Marta e tronditur shikon me habi burrin e saj.*) Habitesh (*Tund lekët e saj*) me kaq? Po këto! (*Nxjerr lekët e veta dhe ia tund në fytyrë.*) Eee! Cike, cike, pry, pry! Be, be! (*Bën sikur tremb një tufë dhensh*) Ha-ha, ha-ha! (*Qetësohet dhe i hedh krahun.*) Mos u tremb, me djersë i ke, me hak, gjumin e ke bërë mangut! Do të mësohesh edhe ti me pare, siç u mësove me traktorin. Derisa je gruaja ime, mos u tremb, mendoj unë për ty!

MARTA — S'kam pse të trembem, po më vjen çudi me ty.

ADEMI — (*Ia pret fjalën.*) Mos u çudit, zoçka ime! Tashti e tutje nuk do të lodhesh më dhe gjumin do ta bësh si zonjë dhe këto (*tregon lekët*) do të vijnë vetë këtu. Vetëm një gjë do të bësh...

MARTA — (*Vazhdon të jetë e trembur.*) Çfarë?

ADEMI — E shikon këtë tavolinë?

MARTA — Po.

ADEMI — Kështu dua të ma shtrosh me të skuqura e të tiganisura.

MARTA — Mirë... Po s'do të kem kohë. Ne gjithë ditën jemi në punë, në arë, në pyll.

ADEMI — (*Qesh.*) Në arë, në pyll jo, thëllëza ime, ti do të rrish këtu tashti. Ja, në këto mure. Ti s'je për traktor, ta marrsha! (*E zë për beli dhe e ngrë si pupël. Marta përpëlitet që të largohet. Ademi e godulis, më në fund Marta i shpëton nga dora.*)

MARTA — Ç'është me ty? Pse bëhesh i keq?

ADEMI — I keq pse të dua ty?

MARTA — Se si më dukesh, s'të kam parë kurrë ndonjëherë të tillë! Ti sikur ke ndryshuar shumë, s'je më ai i pari.

ADEMI — Si, si the?

MARTA — Ke ndryshuar, se si je bërë!

ADEMI — Unë?!

MARTA — Po, ti!

ADEMI — (Qesh.)

MARTA — Më parë nuk qeshje kështu. Ti se çfarë më fsheh, s'të kuptoj. Ta them me gjithë shpirt se si je bërë.

ADEMI — Jo unë, jo unë, moj, po ti! Ti ke filluar të ndryshosh. Ja, vetëm sot, tashti, pak më parë, kur hyre me paret në duar, oh, sa ma bëre qejfin kur hyre ashtu! Tamam, tamam Marta ime e vogël, Marta ime e parë, rrobaqepësja ime e drojtur. Më kujtohet si tashti kur hiqe sefte në traktor, kur kishe frikë të lëvizje marshet që që të dridheshin këmbët kur shkelje friksionin, ah sa bukur dukesh atëherë ti mbi traktor!

MARTA — (Qesh.) Po pse, tashti si të dukem mbi traktor?

ADEMI — Si dukesh? Si mashkull! S'të bën më bef syri, as dora s'të dridhet, futesh si qorre në mes të kënetës e del matanë si djall.

MARTA — Adem, ç'ke kështu, o burrë?

ADEMI — S'kam gjë, kam frikë, ti shkove shumë larg, Marta!

MARTA — S'po të marr vesh.

ADEMI — Shyqyr! (E përqafton) Thëllëza ime, e vogla ime! Rrobaqepësja ime!

MARTA — Ç'është kjo «rrobaqepësja ime»?

ADEMI — Ptu, harrova, traktoristja ime! (Qesh dhe matet të flasë.)

MARTA — Fol, ti se ç'ke sonte!

ADEMI — Ulu, ulu, hajt të pijmë! (Mbush dy gota.)  
Gëzuar!

MARTA — Gëzuar!

ADEMI — Pije me fund!

MARTA — S'mund ta pi.

ADEMI — Pije, pije!

MARTA — S'e pi dot, është e fortë.

ADEMI — Merr birrë, pra! (I hap një shishe birrë dhe

*mbush një gotë. E pinë dhe e mbush prapë.)*  
Gëzuar!

MARTA — Gëzuar! *(E pi përsëri me fund.)* Qenka e mirë!

ADEMI — Si the?

MARTA — Qenka e mirë!

ADEMI — *(Me ironi.)* U mësove dhe të pish. Sa ke ndryshuar!

MARTA — Po ti ç'ke sonte kështu, sikur më shikon për të parën herë?

ADEMI — *(Si i hutuar.)* Vërtet, ç'kam?

MARTA — *(Mbush gotat.)* Hajt, gëzuar! Këtë gotë do ta pimë për traktorin!

ADEMI — Për traktorin?!

MARTA — Për traktorin tonë, për plakushin e fermës sonë!

ADEMI — Ha, ha, ha! Kam gjashtë vjet me të dhe s'kam pirë ndonjëherë për shëndetin e tij.

MARTA — Ja, pimë sonte! Është gjynah të mos pish për të. *(E kthen me fund.)*

ADEMI — *(Shikon i habitur.)* Marta! *(Fshin buzët me mëngën e kominosheve.)*

MARTA — Ç'është? Ç'ke?

ADEMI — S'po të kuptoj.

MARTA — Çudi!

ADEMI — Përse?

MARTA — Çudi, vërtet sonte s'po merremi vesh fare me njëri-tjetrin!

ADEMI — Do të merremi, do të bisedojmë, unë kështu kam vendosur.

MARTA — Pa hë?

ADEMI — *(Gëzohet.)* Shiko këtu, zoçka ime!

MARTA — Majft më me këto zoçkat!

ADEMI — *(I gëzuar.)* Zoçkë të kam, thëllëzë. *(Duke folur kështu duart i kapin lekët, të dy turrat me lekët e tij dhe të Martës. Marta e vë re me interes.)* Ti sot hyre si heroinë në radhët e traktoristëve. Gjithë ferma tani e di që ti s'je më një

ndihmëse po traktoriste që ngrë normat. Kjo më në fund u vulos. Tashti gjithë fitimi i punës që i takon traktorit tonë na përket ne.

MARTA — Si, si?

ADEMI — Ja, (*Ngre lart tufën e lekëve të tij.*) këto janë haku i punës që kam bërë unë, kurse këto (*Tregon lekët e saj*) janë shtatëdhjetëpërqindëshi i punës që ke bërë ti!

MARTA — (*E hutuar.*) E pastaj?

ADEMI — Si pastaj, si s'e kupton që të gjitha këto janë tashti tonat? (*I bashkon të dy turrat e lekëve.*) Tashti qind për qind fitimi i punës është imi, është yni, imi dhe yti. Kësaj dite ia arritëm. S'e duroja dot kur ma merrte ai tjetri shtatëdhjetëpërqindëshin.

MARTA — Adem, çfarë flet kështu? Ti s'je në vete, o burrë! Ai merrte hakun e punës së tij, si ndihmëstraktorist.

ADEMI — (*Qesh.*) Dëgjo këtu, thëllëza ime, tashti s'është nevoja që ti të mundohesh të ngrihesh që pa gdhirë e të kthehesh në të ngrysur!

MARTA — E ç'do të bëj unë atëherë?

ADEMI — Mos u rrëmbe! Gjithë fitimi që del nga traktori tani është yni. Ti do të dukesh ngandonjëherë, sa për sy e faqe të botës, që të mos thonë se...

(*Marta ngrihet në këmbë me rrëmbim, një gotë bie përdhë nga tavolina po asnjëri s'e vë re.*) Të gjitha punët do t'i bëj unë, gjithë normën e re dhe të gjitha t'ardhurat tashti janë tonat.

MARTA — (*Zë veshët me duar që të mos dëgjojë.*) Sa poshtërsi! Sa turp!

ADEMI — (*I trembur.*) Si the?

MARTA — (*E tronditur.*) Dhe unë, unë budallaçka panda se ti gjithçka e bëje për mua. O, sa qenkam gabuar! Unë nga dita në ditë shpresoja se ti më në fund do të lësh mënjanë huqet e tua, se do

të bëhesh dhe ti një ditë si gjithë shokët. Ky paska qenë ai plani yt?

ADEMI — Për ty, gjithçka për ty dhe tashti për të mirën tënde e kam, thëllëza ime!

MARTA — Për të mirën time? O, Adem, po si s'e kupton që e mira ime është atje ku janë të gjithë e jo këtu ku kërkon të më mbyllësh ti!

ADEMI — Pse s'do të më kuptosh, Marta, pse s'më dëgjon më? Ti ke kohë që ke filluar të grindesh me mua.

MARTA — Shiko, Adem, ti je burri im, ti je më shumë se sa burrë për mua, sepse e para unë të dua, dhe e dyta, sepse ti më ndihmove të bëhem traktoriste, më bëre traktoriste. Ti ke shpirt të mirë, unë këtë e ndiej, po ti kohët e fundit ke filluar të ndryshosh ose mua së paku kështu më duket. Mbase ti s'ke filluar të ndryshosh po të shfaqesh para meje ashtu siç je dhe unë tashti po vë re te ti gjëra jo të pëlqyeshme. Mblidhe mendjen, Adem, të dua, pa të flas! Ti kur do, ose kur të intereson bëhesh hero, pse s'je i tillë gjithnjë. Ç'janë këto hesape që bën me kokën tënde?

ADEMI — Për ty, moj! Si nuk e merr vesh, xhanëm, ë?

MARTA — Jo, jo, Adem, jo për mua, ja pse, ja, për këto! (*Rrëmben lekët dhe i lëviz nga vendi.*) Këto ta kanë prishur mendjen. Këto kanë qenë për ty gjithçka. Këto të kanë nxitur ty të bësh çudira, të çash kënetë. O, sa turp, sa keq kur njeriu bie kaq poshtë! Ç'do të bësh tashti me këto? (*Tregon lekët, pastaj hap komonë dhe nxjerr lekët e kursyera të Ademit.*) Ja dhe lekët e shtëpisë që i mblodhe kaq vjet. Ja ku e ke shtëpinë, ta falën. Këto (*Tregon lekët*) s'janë gjë tjetër, veç kafshata të hequra nga goja! O ç'djersë e mund është derdhur kot! Ti as jetën s'e ke gëzuar, or i shkretë! Kurse tani, që sigurove

qind për qind fitimin e traktorit kërkon të më mbyllësh mua në shtëpinë që ta fali shteti. Mos vallë ky paska qenë gjithë qëllimi yt?

ADEMI — Marta, eja në vete, Marta! Ti po flet përçart, si s'paskam ditur unë pse punoj. Ti po më shan si shumë. Pse s'kam qenë unë ai që kam punuar pa fjetur net të tëra, kur ka qenë nevoja dhe vullnetarisht. Kurdo i pari i jam përgjigjur çdo thirrjeje. Marta, kuptove?

MARTA — Kuptova, kuptova gjithçka. Veç tepër vonë.

ADEMI — Çfarë? Shiko se po e tepëron! Po për të mirën tënde e kam, pse të mundohesh, pse të punosh, rri, moj, në shtëpi rehat! Atë që do ta fitoje ti ne s'kemi për ta humbur, kurse ti ke për të qenë e qetë në shtëpi. Po s'të ndenjën duart, po qe se mërzhitesh, të blej edhe një makinë qepëse, ë?

MARTA — O, Adem, si s'të vjen zor nga vetja jote që flet kështu?

ADEMI — Pse, moj, si po flas, keq?

MARTA — Si një njeri i ulët.

ADEMI — Si the?

MARTA — Si një njeri...

ADEMI — Mbylle gojën! Do të bësh kështu si them unë, se kështu është më mirë për ty e për mua!

MARTA — As për ty, as për mua nuk është mirë. Ti kërkon që të më largosh mua nga...

ADEMI — Pusho! Ti fole shumë për mua. Tashti dëgjomë, se kam radhën! Mos e hiq veten tënde si heroinë! Unë e di pse s'pranon të rrish në shtëpi. Ty të pëlqen fusha, të pëlqejnë rrugët, të pëlqen klubi buzë pyllit, të pëlqen të dukesh, të mburresh.

MARTA — Mos e tepëro! Gjysmat e atyre që the më pëlqejnë, më pëlqen fusha, më pëlqen kur lëroj, më pëlqen kur shemb pyllin, kur zhytem në ledh të kënetës.

ADEMI — *(Vjen vërdallë tavolinës, ajo zbrapset.)* Pu-

sho! (*Bën me dorë sikur pi.*) Të pëlqen edhe të pish.

MARTA — Me ty.

ADEMI — Me mua dhe me të tjerë, bile ke pirë!

MARTA — I poshtër!

ADEMI — Na! (*E qëllon.*)

MARTA — (*E përmban veten, i afrohet dollapit që është në anë të skenës, merr valixhen mbi dollap dhe e mbush me rrobat e saj: bluzat, fustanet, këpuçët. I rras me zor dhe mundohet të mbyllë valixhen. Gjatë kësaj kohe Ademi vjen vërdallë si i tërbuar.*)

*Hapet dera dhe hyn Shpresa me dy bileta kinemaje në dorë)*

SHPRESA — (*E çuditur.*) Ç'është kjo gosti? Po kjo rrëmuje?

ADEMI — Po ty, kush të thirri?

SHPRESA — Do të shkojmë në kinema, kështu ka vendosur kolektivi i oficinës, do të shohim filmin e Adem Rekës. Ja edhe biletat tuaja, pastaj do të pimë e do kërcejmë në lulishten e turizmit. (*Kupton se midis tyre diçka ka ndodhur.*) Ç'është, ç'ka bërë vaki, Marta?

MARTA — Hiç, asgjë, ti shko, unë s'vij!

SHPRESA — S'do të vish në film? Po ti më plase. Ku do të gjesh bileta nesër? Shkojmë! Hajt se u vonuam!

MARTA — (*Që më në fund arrin të mbyllë valixhen.*) Shko, unë sapo e pashë filmin për Ademin, por që s'i ngjan fare Adem Rekës.

SHPRESA — Si? Qenkeni zënë, e përse?

MARTA — Ja, për këto! (*Rrëmben nga tavolina një dorë me lekë dhe ia hedh Ademit dhe ikën.*)

ADEMI — Iku, në djall të vejë!

SHPRESA — (*Thërret.*) Marta, Marta! (*Ikën dhe ajo.*)

ADEMI — Dhe ti në djall të vesh! (*Rrëmben një gotë në tavolinë dhe e thyen.*)



## TABLOJA E SHTATË

*(Në oficinë, pranë traktorit janë vetëm Ademi dhe Shpresa. Ademi është ulur mbi zinxhirë të traktorit dhe ka zënë kokën me duar.)*

ADEMI — Megjithatë unë e desha, e desha atë dhe këtë *(i bie me pëllëmbë zinxhirave)* po, që atëherë, që nga ajo ditë kanë kaluar dy vjet dhe ne pothuajse s'patëm asnjë rast që të bisedonim. Ti e di, kolektivi dhe shokët e Partisë ia dhanë asaj traktorin dhe ajo aq desh.

SHPRESA — Përsëri gaboresh, ajo të deshi ty, bile të adhuronte. Po ti, ti nuk e deshe atë.

ADEMI — Unë për të i bëra të gjitha, gjithçka për të.

SHPRESA — Që ta mbaje si kukull në shtëpi. Si s'e kuptoje ti atëherë se ajo pas gjithë atij ndryshimi që pësoi, s'mund të kthehej më në shtëpi e të rrinte mbyllur. Ti vetë ia hoqe asaj drojtjen. Ti vetë i dhe krahë. Ti dhe ky. *(Tregon me dorë traktorin.)* Ajo s'mund të bënte më hap prapa.

ADEMI — Për të mirën e saj e kisha.

SHPRESA — E pra, pikërisht këtë të mirë ti nuk e kuptoje atëherë.

ADEMI — Jo, nuk e kuptova! Bile për një kohë të gjatë i mbajta mëri edhe asaj, pandeha... *(Hyn Marta, Shpresa largohet si me qëllim.)*

MARTA — Ç'do të bëjmë, do të fillojmë, apo jo?

ADEMI — Mirë, fillojmë! Ndize!

*(Marta e ndez. Traktori gjëmon, të dy rrinë e dëgjojnë zhurmat se si punon traktori; dëgjojnë, po mendjen e kanë gjetkë, Ademi shikon Martën.)*

ADEMI — Gjithnjë kështu bën kur e ndez?

MARTA — Kështu, rënkon, mezi ndizet.

ADEMI — Sa kohë ka që bën kështu?

MARTA — Tre muaj.

ADEMI — Dhe ti s'ke çarë kokë fare?

MARTA — Kisha punë. S'më linte brigadieri të vija më parë. Tarracat duheshin bërë. Po ti mos më akuzo mua, dhe ti s'je sjellur më mirë. Na, dëgjo!  
(*I jep gaz.*) Po kjo zhurmë ç'është?

ADEMI — (*Dëgjon zhurmën e re.*) Kjo është plagë e vjetër.

MARTA — Hëm, plagë e vjetër, po kush ia bëri?

ADEMI — (*Buzëqesh.*) Paske përparuar në zanat.

MARTA — Do ta hapësh apo jo?

ADEMI — Shko merr kompletin e çelësave. (*Marta largohet.*) E, a mund të të hap unë ty? Çdo dëmtim yti është për mua një akuzë. Dhe me ty s'jam sjellur mirë, të kam përdorur keq, të kam munduar, s'të kam lënë të marrësh frymë. Dhe kur ti ke rënkuar, kam bërë veshin shurdh. Eh, kohëra, kishim shumë punëra për të bërë atëherë. Tash-ti, në fermën tonë s'ka më as pyje, as kënetë dhe njerëzit shesin mend duke mirëmbajtur traktorët. (*Hyn Marta, sjell çelësat dhe ikën përsëri. Ademi e vështron se si ajo largohet.*) Ky traktor ta paska vrarë rininë. Eh, moj gërdalla ime plakë (*përkëdhel traktorin*) edhe ti qenke katandisur keq! (*I jep gaz dhe dëgjon i emocionuar sikur dëgjon muzikë pastaj e përkëdhel prapë. Hyn përsëri Marta dhe e gjen duke përkëdhelur traktorin, Ademi zbrapset përnjëherë.*)

MARTA — Do ta hapim?

ADEMI — Po!

MARTA — (*Gëzohet.*) Shyqyr, kisha frikë se s'do ta zije me dorë. Do ta bëjmë përsëri të ri. Më ka marrë malli që të punojë një herë si dikur.

ADEMI — Si dikur s'ka për të punuar më, plaku s'bëhet më i ri, ky e jetoi jetën e tij. Ky na bashkoi, ky na ndau.

MARTA — Jo, nuk na ndau ky!

ADEMI — Ky, ky, (*I bie me pëllëmbë.*) Po të mos ish ky, çdo gjë do të kish qenë ndryshe, ky ndryshoi gjithçka; dhe fermën tonë ky e ndryshoi, ky e ndërtoi.

MARTA — Fermën e ndërtuan njerëzit.

ADEMI — Mbase, mbase është ashtu si thua ti, po, po të mos ish ky...

MARTA — Ti do të ishe një bari, kurse unë një rrobaqepëse.

ADEMI — Nejsë, fillojmë! (*Fillon të çmontojë pjesë-pjesë. Ademi i duhet një levë.*) Shko merr një levë në kovaçanë! (*Marta largohet, Ademi shikon traktorin e zbërthyer, e shikon gjatë.*) T'i zbërthyer kockat, o plakush! (*E dëgjon përgjegjësi i oficinës që ka hyrë atë çast.*)

POLOJA — Të ardhka keq për plakushin?

ADEMI — Me këtë e kam mësuar zanatin. Do ta bëj përsëri të marrë-fushat, kurse me veten time ç'të bëj?

POLOJA — Mos fol ashtu! Ti je njeri, sapo e pe këtë me sy ti sikur u bëre tjetër.

ADEMI — Ky traktor është biografia ime dhe...

POLOJA — Por ja që s'dite ta mbash. Kishe filluar të bëheshe i padurueshëm dhe përse? Për disa para të qelbura.

ADEMI — Para të qelbura? Jo, parave të mia shumë shumë erë djersë u ka ardhur dhe, nëse era e djersës për ty është e qelbur, po e pranoj. Unë falas s'do të punoja. Më thoshin të punoja dhe punoja. Ditën e bëja natë dhe kam marrë atë që më përkiste, hakun tim.

POLOJA — Haku yt, paret e tua, djersa jote, traktori yt, të gjitha këto të tuat ti i vije në fillim e në fund të çdo fjale që thoshe, për ty kjo ish bërë gjithçka, ish bërë qëllim. Dhe moshën e këtij (*tregon traktorin*) dhe difektet e këtij fillove t'i shfrytëzoje duke kërkuar kompesim dhe pakësim të normës, të kujtohet?

ADEMI — Çfarë?

POLOJA — Sa herë që merrje punë të re. Të kujtohet kur more përsipër tharjen e kënetës? Po kur more përsipër shpyllëzimin? Pa kujtohu pak se ç'grindje bëje për pagesën?

ADEMI — Po, grindesha. Veç kisha të drejtë, se normisti ish bërë i padurueshëm. Ai sillej sikur të ish zot, kurse mua më quante mashtrues.

POLOJA — Dhe të dy u hodhët në sulm kundër njëri-tjetrit, ai që të të hante hakun, ti që t'i merrje atij mbi hakun. Pastaj filluat allishverishet dhe dallaveret dhe harruat parimet. Paraja zuri vend e u bë zot.

ADEMI — Po të kish qenë ai i ndershëm e i drejtë...

POLOJA — Ashtu është, ai u tregua i ulët, maskara po edhe ti nuk u tregove i larë.

ADEMI — Kundër atij s'luftoja dot. Ai të vinte gërshërën. Punoje s'punoje, ai të kish në dorë, dinte t'i sorollaste nenet e rregulloret.

POLOJA — Dhe ti u bërë ortak me të, se në dallaveret e atij të qenë veshur sytë nga paraja, nga egoizmi; ai gjeti në shpirtin tënd shpirtin e vogël të fshatarit mikroborgjez. Ti dhe me ndihmësin që pate, me Zenelin, nuk u solle si duhet. E trajtoje si çirak, kurse me gruan tënde fillove të silleshe si një borgjez. Ti më turpërove edhe përpara Martës, ti erdhe atë mëngjes e më gënjeve, të kujtohet? Atë mëngjes, që ajo të kish ikur nga shtëpia. Për ty e kam një vërejtje në biografi.

ADEMI — Jo, s'të gënjeva. Atëherë isha i bindur për të gjitha ato që erdha e t'i thashë.

POLOJA — I bindur? Jo, Adem, ti ishe i xhindosur. Po të ishe i bindur do të kishe ardhur më parë, ose fill pas ikjes së saj nga shtëpia, e jo të nesërmen.

ADEMI — M'u errën sytë kur e pashë mbi traktor, rrinte kapardisur dhe i vinte era konjak. Oh, në atë minutë m'u mbush mendja top dhe u nisa për te ty... (*Shuhen dritat.*),

## TABLOJA E TETË

*(Ndizen dritat. Një zyrë e thjeshtë. Në tavolinë rri përgjegjësi i oficinës dhe diçka shënon mbi librin e madh. Ademi hyn i zemëruar, gjithë inat dhe përplas dorën. Është mëngjes herët.)*

POLOJA — Ç'është, ç'ke që qenke xhindosur?

ADEMI — O unë, o ajo.

POLOJA — Ç'është? Ç'ka ndodhur?

ADEMI — S'di se ç'duhet më shumë që njeriu të bëhet vrasës.

POLOJA — Dale, dale, jo me kaq yrysh!

ADEMI — S'duroj dot më, ajo e mbushi kupën.

POLOJA — Kush, mor vëlla, se s'po të marr vesh fare?

ADEMI — Ndihmësja ime, ime shoqe.

POLOJA — Si është puna, qetësohu!

ADEMI — *(Mundohet të qetësohet.)* Dje iku nga shtëpia.

U zumë, u ndamë. Ajo s'kish qenë grua e mirë. Traktori e tërboi. Kohët e fundit kish nisur të rrinte gjer vonë në pyll duke punuar, kthehej vonë, më lutej t'ia lija traktorin dhe unë ia bëja qejfin dhe e prisja në klub buzë pyllit, për t'u kthyer bashkë në shtëpi, por ajo asnjëherë nuk erdhi, duhej të shkoja e ta merrja vetë. Dje u zumë dhe ajo pa të keq i mbledhi plaçkat dhe iku, tani e gjej mbi traktor, e kish ndezur dhe rrinte këmbë për mbi këmbë dhe goja i qelbëj nga konjaku. Unë e mora për grua; e bëra traktoriste, po jo që ajo të bredhë pyjeve, të pijë klu-beve e të kapardiset mbi traktorin tim.

POLOJA — Dale, dale!

ADEMI — Ç'dale, more, ç'dale, ç'të pres, kur të bëjë kopilin?

POLOJA — Fakte ke?

ADEMI — Faktet janë në pyll, në kënetë. Pyet traktoristët e tjerë, pyet fshatarët.

POLOJA — Ka traktoristë që flasin, dhe fshatarët flasin. Kësaj nuk i kam dhënë rëndësi, sepse ajo si grua që është, do të shkaktonte thashetheme kur ta shihnin majë traktorit ose në klub, kur ta shihnin vetëm në pyll, po që të arrijë puna gjer këtu, sa të iki nga shtëpia ...

ADEMI — Qafën le të thyejë, prapa diellit le të vejë, por jo majë traktorit tim! Unë s'e dua më për grua, jo ta dua si ndihmëse! Të lutem, ma hiq sysh!

POLOJA — Sa keq, dhe një grua që donim ta bënim traktoriste! Mirë, ma thirr këtu, se ia tregoj unë qejfin! Ti merr traktorin e nisu në punë. (*Ademi del.*) S'na doli siç prisnim, ta hajë dreqi, ta hajë! Do të qe vërtet fitore. Ajo e mësoi aq mirë traktorin. Do të ish traktoristja e parë e fermës sonë, ah Marta! (*Hyn Marta e veshur me kominoshe, tepër e nevrikosur, dhe e zemëruar në kulm. Sa hyn zë e bërtet.*)

MARTA — Më thirre, ë? Më thirre që të mbetet ai vetë me traktorin. I dhe urdhër të marrë traktorin, ë?! I dhe urdhër që unë të vij te ty. Ç'më do, pse më thirre?

POLOJA — Të thirra që të më japësh ti llogari, nuk të thirra që të të jap unë llogari. Mbylle gojën e dëgjo ç'do të të them!

MARTA — Ti s'ke se ç'të më thuash, ti s'di asgjë...

POLOJA — Ti dje ike nga shtëpia e burrit?

MARTA — (*Ia pret fjalën.*) Ajo është puna ime, iki ose jo është punë për mua!

POLOJA — Si, moj, qenka punë për ty! Të bësh të nën-

- tëdhjetenëntat, të ikësh nga shtëpia e burrit qenka punë për ty?!
- MARTA — (*Çuditet nga ç'dëgjon dhe hesht. Edhe përgjegjësi i oficinës hesht.*) Fol, ç'ke për të thënë tjetër?
- POLOJA — (*I bën përshtypje qetësia e Martës.*) Ja, të të gjitha këto mos janë pak?
- MARTA — (*Me ironi.*) Po të ishin të vërteta janë shumë.
- POLOJA — Si?!
- MARTA — (*E imiton.*) Si?! A mund të dyshosh pas gjithë atyre që më the, je edhe komunist?  
(*Përgjegjësi i oficinës hutohet.*) Përgjigju pra, kur paske pasur një fije dyshimi pse më ngarkove me gjithë ato turpe?
- POLOJA — Po ti hyre si rrufe, ti s'më le të flas, të pyes. Të verifikoj janë a s'janë të vërteta.
- MARTA — S'më thirre për të më pyetur, jo! Më thirre që të më akuzosh, më thirre dhe më le pa traktor, ia dhe atij dhe ai krisi e iku në pyll, i besove atij, sepse edhe ti je si ai, si ata që flasin poshtë e përpjetë, dhe ti qenke një burrë që s'të pëlqen, kur shikon një grua me pantallona burri, kur shikon një grua që nget një makinë si burri, që rri vetëm në pyll, kur hyn në klub, ku paskan të drejtë të rrinë vetëm burrat dhe pika një pikë nga ajo që ju pini një shishe.
- POLOJA — Pa dale, dale, moj çupë!
- MARTA — S'jam çupë, po grua!
- POLOJA — Qetësohu, fol më shtruar!
- MARTA — Tashti dashke të flas shtruar, po ti pse s'fole shtruar, pse i besove atij e mua s'më pyete fare? Jo, s'do të qetësohem përderisa të më kërkosh falje ti dhe ai. E di ti pse ika nga shtëpia? Jo, nuk e di dhe as nuk më pyete. Një grua nuk ikën kot nga shtëpia e burrit të saj. Ai më qëlloi, ai më turpëroi, ai filloi të dyshojë tek unë, ai u tremb nga unë, ai u tremb nga jeta e re që nisa të bëj, ai u frikësua, ai më bëri ndihmëse vetëm për tri-

dhjetëpërqindëshin. Ai desh që unë tani të kthehesha në shtëpi, po unë midis katër mureve nuk kthehem më. (*Qetësohet.*) Të kish ndodhur kjo që ndodhi vite më parë, po, mund t'i plotësohej dëshira atij dhe jotja, po sot jo! (*I zgjat duart me kallo e vajra.*) I shikon këto duar? Këto duar ndryshuan, s'janë më duart e mia të dikurshme, s'janë më as të buta, as të bukura. Ai nuk e di sa zor e sa vështirë e kam pasur...

POLOJA — E di...

MARTA — Jo, po ta dije, nuk do të kishe dyshuar për mua. Po ta dije, nuk do të kishe urdhëruar që të zbrisja unë nga traktori, që të hipte ai. Unë e kam njomur me djersë e me lot atë traktor. Kam ngrënë turpin e fjalëve të botës me dhëmbë, që ta mësoja traktorin dhe tashti të zbres nga ai, sepse s'iu binda tim shoqi që të rri në shtëpi? Jo, kurrë! Shqipëria është e madhe dhe unë do të gjej një traktor.

POLOJA — (*I penduar.*) Marta!

MARTA — Ç'do tjetër?

POLOJA — (*U kokën.*) Ti mund ta drejtosh vetëm traktorin, sigurisht me ndihmës.

MARTA — Si? Do të ma japësh mua traktorin? E ke me gjithë mend?

POLOJA — (*Fshin ballin nga djersët.*) Po, Marta, ti e meriton plotësisht dhe të lutem më fal për gjithçka!

MARTA — (*E emocionuar s'di ç'të bëjë.*) Jo, jo, ti më fal mua, të fola rëndë! Fajtor është im shoq, por mbase edhe ai...

POLOJA — Ai ka shumë faj, jo vetëm karshi teje. Dhe unë kam faj. Unë mbaj përgjegjësi si komunist dhe si përgjegjës i oficinës e i makinerive. (*Marta largohet dalëngadalë, përgjegjësi mbetet vetëm.*) Sa herë gabojmë kështu! Na rrëmbejnë makinat, tokë, brazdat, plani, u besojmë fjalëve, thasethemeve dhe ngutemi kur gjykojmë për njerëzit. Ah Adem, Adem!



(Ndizen dritat. Ademi hesht, përgjegjësi i ofiçinës e vështron gjatë.)

POLOJA — Të dy gabuam rëndë.

ADEMI — Ti s'kishe faj. Fajtor për gjithçka jam vetëm unë.

POLOJA — Më vjen keq për Martën! Sa dhimbje i kemi shkaktuar, sa vuajtje!

ADEMI — Mjaft më, të paktën Martën mos e zë me gojë!

POLOJA — Të mos e zë në gojë, për gjëra që s'të pëlqejnë, s'do që ti zëri njëri me gojë, s'pranon që të gërvishtet plaga, ë?

ADEMI — Më dhemb.

POLOJA — Të dhemb?

ADEMI — (Merr frymë thellë.) Po!

POLOJA — Kur të dhemb do të thotë se e ndien.

ADEMI — S'kam vuajtur ndonjëherë më shumë se gjatë këtyre dy vjetëve, jeta pa traktorin, pa të më duket shumë e rëndë.

POLOJA — Po, po më rëndë e ka pasur ajo, e megjithatë ajo doli më e fortë se ti. Çudi, sa e vërtetë është!...

ADEMI — Çfarë?

POLOJA — Mendimi punëtor. Të mendosh si punëtor, të jetosh si punëtor. Marta është brez pas brezi punëtore, me mend e me zemër. Ajo që e vogël hyri në radhët tona, hyri me gjithë pastërtinë e shpirtit të një fëmije të rritur. Tek ajo çdo tipar i klasës sonë ngulitej thellë, gatuhej e çelikosej i pastër. Ajo mori prej teje vetëm cilësitë e tua të mira. Asgjë të keqe nuk mori nga ti. Të adhuroi, të dashuroi dhe u largua prej teje me dhimbje, kur ti shfaqe gjithë mbeturinat e tua prej fshatari mikrobrorgjez. Braktisja e saj të tronditi ty, të shkundi. Ti, siç e kishe nisur, do të përfundoje edhe më keq. Çudi!

ADEMI — Si shumë po çuditesh me mua!

POLOJA — Vërtet, megjithëse s'duhet çuditur fare; si

komunist s'duhet të çuditem. Mua më vjen turp dhe s'më falet që po flas me ty kaq hapur e kaq vonë. Më kujtohet kur erdhe te ne, më kujtohet fare mirë se ti, që ditën e parë kërkoje traktor e u zemërove kur ne të dhamë shatin. Ti the: «S'erdha për të kapur shatin, atë e kam edhe atje në fshat. Erdha të bëhem traktorist, të bëhem punëtor.» Dhe ne u rrëmbyem nga entuziazmi yt. Më vonë, kur ne vinim re se si ti shfaqje tek-tuk mbeturinat e tua thoshim: Epo, janë mbeturina! S'i dhamë rëndësinë e duhur. S'është e lehtë të bëhesh punëtor i vërtetë, Adem. Mund të kesh duar me kallo, mund të kesh edhe rroba punëtori, po kryesorja është shpirti, zemra prej punëtori, mendja. (Ademi humbet në kujtime të largëta. Përgjegjësi i oficinës e vë re.)

POLOJA — Ç'është, ç'po mendon?

ADEMI — S'je ti i pari që po m'i thua këto. Dikur... (Shuhen dritat dalëngadalë, bie perdjja. Errësirë, dalëngadalë errësira zë e tretet, dëgjohet se diku punon një traktor. Ndizen dritat. Fushë, mëngjes herët, një arë e madhe gjysmë e lëruar. Më një anë është traktori. Ademi është vetëm, i shqetësuar, rri e pret. Bufeja buzë pyllit është e mbyllur.)

## TABLOJA E NËNTE

ADEMI — A do t'i mbushet mbendja Zenelit? Oh, do të jetë fitore! Martës i pëlqen traktori dhe qejfi ia ka të bëhet ndihmësja ime, pse të mos ketë? Nga 1800 lekë të marri 6000 në pesëmbëdhjetëditësh, pse pak janë? Dhe në drejtori e pranuan këtë mendim. Sekretarit të partisë i pëlqeu. Ah, ty si të ta bëj, o Zenel! Sikur t'i jepnin Zenelit një traktor tjetër? Ah, sikur të kishte dhe një traktor tjetër kjo fermë! (*Hyn Zeneli.*)

ZENELI — Mirëmëngjes! Ç'të paska gjetur sot? Paske dalë herët! Paske ndezur edhe traktorin! Pa shiko, dhe e paske fshirë, për besë, po më çudit, o usta!

ADEMI — (*Si i prekur.*) Pse çuditësh? Traktori im është.

ZENELI — Për besë, më çudit, bashkë kemi shumë kohë që punojmë dhe s'të kam parë ta fshish një herë.

ADEMI — Epo pastrimi, ndezja, mirëmbajtja janë detyra të ndihmësit, apo jo?

ZENELI — Po, të miat janë. (*Me ironi.*) Të miat janë dhe lërimi...

ADEMI — Lëre, lëre ironinë mënjanë: lërim, plugim m'i ke thënë sa herë. Po të mos të të lija unë të punoje, kur do ta mësoje traktorin? Vërtet, Zenel, të them si vëlla, ti u bëre tamam traktorist. Pse s'kërkon traktor, ke kaq kohë tek unë si ndihmës? Ti ke të drejtë ta kërkosh, do ta ngre këtë çështje në drejtori.

ZENELI — Vërtetë e ke?

ADEMI — Të betohem!

ZENELI — Përse?

ADEMI — Çfarë, ç'është kjo përse, për ty që të të japin traktor?

ZENELI — S'më kuptove, ti the «betohem!»

ADEMI — Po.

ZENELI — Përse do të betohesh: për nder apo për flamur?

ADEMI — Pse tallesh?

ZENELI — Ah, Adem, Adem! Unë kam kohë që punoj me ty, ti je vërtet traktorist i lavdëruar në ndër-marrjen tonë, të gjithë të njohin, të mbajnë në gojë, por ama si unë s'të njeh njeri.

ADEMI — Ç'do të thuash?

ZENELI — Mos u mërzit, sot kam qejf të flas dhe ti mbaji vesh fjalët e mia, nëse e do veten tënde! Ti po shkon shumë larg, o Adem!

ADEMI — S'të kuptoj!

ZENELI — Të kam folur shumë herë, po ti s'më ke dëgjuar. Sot po të flas për të fundit herë, ndaj do më dëgjosh!

ADEMI — Për të fundit herë? Pse?

ZENELI — Do ta dish?

ADEMI — Sigurisht.

ZENELI — Do të ta them në fund, pasi të të dal borxhit edhe një herë.

ADEMI — Më parë thumë pse po më flet për të fundit herë.

ZENELI — (*Qesh.*) S'të durohet?

ADEMI — Jo se s'më durohet, por më vjen keq.

ZENELI — Do të gëzohesh, por prit, mos ma pre fjalën!

ADEMI — Mirë, mirë. Ne shokë jemi, kemi qenë e do të mbetemi. Fol, me ty nuk zemërohem!

ZENELI — Ashtu?

ADEMI — Po.

ZENELI — Mirë, pra, po ta them. Ti s'dole siç e pandeha në fillim.

ADEMI — (*I nevrikosur.*) Si? Si the?

ZENELI — (*I qetë.*) Thashë se s'je siç duhet të jetë njeriu ynë, se ti je akoma larg shokëve të tu. Ti nuk e ke shumë të qartë përse ne punojmë, megjithëse punon sa për shtatë, megjithëse je i papërtueshëm dhe punën e ke nën thua, je tinzar. Gjithçka që bën e llogarit dhe meqë do të fitosh lekë, nuk kursen as veten tënde, as traktorin, as ndihmësin, po për lekë ama. Për ato të shkreta ti je kail të bësh gjithçka. Gjynah që një punëtori si ti i mungon ajo që është e domosdoshme për çdo punëtor.

ADEMI — Mbylle, more gojën, mbylle të them!

ZENELI — Mos u mërzit! Unë po iki, po largohem, për mua ka punë kudo, po iki nga ty, jo për të të bërë qejfin ty, po iki vullnetarisht për hatër të Martës, për hatër të fermës sonë që të nxjerrë edhe ajo gruan e parë traktoriste. U vonova sot se më thirrën në Komitet të Partisë. Atje më thanë se Marta do të bëhet traktoriste dhe se ti, burri i saj, je angazhuar për këtë gjë... Pranova dhe erdha këtu të të them këshillën e fundit: Martën bëje traktoriste dhe kur ta mësojë mirë traktorin, dorëzoja asaj, në se s'do ta bësh këtë gjë do të përfundosh keq. Ky është traktor i kuq, është pronë socialiste, nuk është kalë kulaku.

ADEMI — E di.

ZENELI — Shët, nuk e di, po ta dije do të silleshe ndryshe me mua! Ti i shkretë kërkon të nxjerrësh fitim nga ky! (*I bie traktorit me pëllëmbë.*) Ti je gati të punosh tashti si ka, vetëm e vetëm për atë shtatëdhjetëpërqindësh që do të marrë Marta, jot shoqe. Me mua u solle si u solle, tashti mendohu mirë dhe ki mendjen se mos luan edhe me Martën. Ajo është vërtet gruaja jote, por s'është prona jote.

ADEMI — Atë mos e zër me gojë, po pate qejf fol për veten tënde.

ZENELI — Nuk flas nga qejfi, flas se më vjen keq kur njerëzit humbasin dinjitetin e tyre, më vjen keq kur marrin tatëpjetën.

ADEMI — Pusho tashti, pusho të them! E di pse flet  
kështu, nga inati... Unë...

ZENELI — Lëre unin tënd!

ADEMI — Nga inati i ke të gjitha këto përralla. Pse  
ke duruar atëherë kur qenkam sjell keq me ty?

ZENELI — Ta kam thënë sa herë që me këtë traktor  
ishim caktuar ne të dy që të punonim këto ara,  
të shembnim këto pyje, të thanim ato moçaliste.  
Kjo ishte detyra jonë dhe ne këtë detyrë e kemi  
kryer dhe kjo është kryesorja. Se kush i merrte  
lekët s'ish kryesorja. Pastaj ja ku po të them dhe  
diçka që s'ta kam thënë: Kam shpresuar se ti do  
të më kuptoje, në mos mua shokët e tjerë. Do të  
shikoje vetë, me sytë e tu se s'je në rrugë të  
mbarë e shpresoja se një ditë do të bëheshe dhe  
ti si të gjithë, do të lije mënjanë interesin tënd,  
do të kuptoje më në fund, se interesi i shoqërisë  
sonë ka më shumë rëndësi sesa dëshirat e ëndrrat  
e tua të vogla. Shëndet! *(Ikën.)*

ADEMI — Njeri i çuditshëm! Gjithnjë i çuditshëm ka  
qenë, po gjithë këto fjalë pse i tha? Nga inati, unë  
do t'i kisha thënë më shumë po të më hiqnin nga  
traktori.

*(Shuhen dritat. Errësohet. Përsëri ndizen. Ademi  
dhe përgjegjësi i oficinës rrinë në heshtje.)*

ADEMI — S'e kuptova atëherë Zenelin, ndihmësin tim.  
Të gjitha ç'tha ai dolën.

POLOJA — Se të tha të vërtetën.

*(Bie çanga.)*

## TABLOJA E DHJETË

*(Pamja e tablosë së parë. Mëngjes herët. Kur hapet perdja disa punëtorë bisedojnë me gjallëri. Traktori është i ndrequr dhe është në provë.)*

- RAMIZI — *(I thotë shokut me të cilin bisedon.)* Hiç mos u çudit, unë di një rast, një burrë dhe një grua u bashkuan pas shtatë vjetë ndarjeje.
- SYTKIU — Pas shtatë vjetësh? Përralla!
- RAMIZI — Më plaçin sytë në gënjej! Pas shtatë vjetësh u sqaruan.
- HALIMI — Unë jam pak si i shkuar në moshë dhe...
- DULLA — *(Ia pret fjalën.)* Jo një çikë, por boll.
- HALIMI — *(E shikon me inat.)* Dhe gjëra të këtilla nuk i kuptoj, po u ndave, mbaroi. Gruaja është vëllajo, si puna e shtamës, po u thye, hidhe.
- RAMIZI — Vdiq ajo, kohë, vëllajo.
- HALIMI — Vallahi me ç'po më shohin sytë, vdiq ajo kohë. *(Hyjnë punëtorë të tjerë, përshëndeten dhe futen në muhabet.)*
- SADIKU — Ç'është që keni marrë zjarr?
- SYTKIU — Ja, e nisëm me Ademin tonë e dolëm te shtama e thyer.
- SADIKU — Marta nuk është shtamë e thyer, fajtor për ndarjen është Ademi.
- DULLA — Ahu, ky qenka me baba qemon! Ata po bashkohen kurse ky flet për ndarje.
- SADIKU — Po bashkohen?

DULLA — Pse sytë me lesh i ke pasur ti? Si ke parë?

Ka një muaj dava që ata rrinë bashkë.

SADIKU — Ata punojnë bashkë.

DULLA — Vallahi unë po të ndahem me plakën time s'ja shoh më surratin!

QERIMI — Sepse je surratsëz, prandaj. Ademi bile bëri gabim që kundërshtoi në fillim për të ndrequr traktorin dhe bëri shumë mirë e s'u ndie më, por iu shtrua punës dhe e mbaroi një, javë përpara afatit. Kur do ai është i rrallë, qoftë si traktorist, qoftë si mekanik. Të keqen e ka gjetkë ai.

DULLA — Ku e ka, sipas teje?

QERIMI — Ja, lëre se si është, i mbyllur në vetvete, shikon interesin e tij. Një herë doja ta qerasja...

DULLA — Ë, e qerase?

QERIMI — Po dhe m'u dhimbs. Më foli shumë, nuk e besoja që ai njeri të ishte bërë aq pishman.

DULLA — Paska vënë mend.

QERIMI — Më ftoi në shtëpi. Dua shokë, më tha, jam vetëm fare.

DULLA — Po ti ç'i the?

QERIMI — I thashë se shokë na ke të gjithë.

HAXHIU — Qerimi ka të drejtë. Ademi s'është më ai që ka qenë. Ne duhet t'i rrimë dhe më pranë. (Hyn Ademi. Të gjithë heshtin për një çast. Ademi e ndien.)

ADEMI — Ç'keni që...

ZYDIU — Ja për ty po flasim.

DULLA — Për punën tënde.

ADEMI — Më thoni që të dëgjoj edhe unë.

ZYDIU — T'i kemi thënë dhe ti i ke dëgjuar.

ADEMI — Këto që thatë sot s'e besoj të mi keni thënë.

ZYDIU — Mos u nxe, Adem! Të gjithë shokë na ke, na ka rënë në sy diçka dhe e thamë ashtu siç e kuptojmë.

ADEMI — Mua mos më fshini, flisni ku e kini hallin? Mos pëshpërisni!



SADIKU — Nuk pëshpëritën, i thanë hapur e me zë të lartë, bile unë pandeha se mos zihen.

ADEMI — Po zihen për punët e mia?

HAXHIU — Dhe të asaj.

ADEMI — Ç'doni pra, flisni! Ç'doni të dini më tepër? Më duket se jua kam thënë të gjitha. S'dua të mbaj në shpirt asgjë, gjithçka më rëndon. Si jam bërë kështu!

*(Të gjithë heshtin.)* Juve ju kam shokë, ju më keni qëndruar pranë.

ZYDIU — Mbase të lëndo, por desha të di...

ADEMI — Fol!

ZYDIU — A e do më Martën?

ADEMI — Po! E dua!

*(Hyn Marta. Të gjithë në heshtje lëvizin, i hapin rrugë. Rastësisht grumbullohen në një krah, të gjithë e shikojnë atë. Vetëm Ademi ka ulur kokën. Marta shëtanget.)*

MARTA — Ç'është, pse u mënjanuat kështu?

*(Hujnë një grup vajzash dhe Shpresa.)*

SHPRESA — Ç'është, ç'ka bërë vaki?

MARTA — Flisni, ju lutem!

ZYDIU — *(I zënë ngushtë, lëviz, bën një hap drejt Martës.)* Marta, mos na keqkupto, mbase, një ditë, dikush do të të thotë. Ti për ne, për të gjithë ne je... *(Marta s'duron dot dhe largohet.)*

SHPRESA — Ç'është, shokë? Ç'është kjo skenë si në teatër?, Mos e fyet?

ZYDIU — Ne po bisedonim për punët e tyre. Ademi tha se e do akoma...

*(Ademi nis të largohet. Përgjegjësi i oficinës, i cili ka kohë që ka hyrë dhe që s'është vënë re nga shokët, thërret.)*

POLOJA — Adem! *(Ademi qëndron.)* Desha të të bëj një pyetje. *(Ademi afrohet dhe pret.)* Atëherë, kur u bë mbledhja për ty, kur gjithë këta dhe shokët e fermës folën, thanë gjithashtu se ti mund

të punoje si traktorist, por si ndihmës i saj, kështu  
qe?

ADEMI — Po.

POLOJA — Dhe ti s'pranove atëherë.

ADEMI — Nuk pranova se...

POLOJA — Nejse të shkuara të kaluara, po tani a pra-  
non të punosh qoftë dhe si ndihmës i Martës?

ADEMI — Si, me gjithë mend e ke? Shokë, po ju ç'thoni?

ZYDIU — Ti ç'thua?

ADEMI — Po, do të punoja qoftë dhe si ndihmës, dua të  
filloj gjithçka që nga e para, gjithçka. Po Marta  
ç'thotë?

SHPRESA — Marta gjithnjë të ka pritur ty. (*Ademi  
ikën.*) Hajde të vemi te Marta! Kur i pashë ashtu  
të veçuar thashë se mos ka ngjarë gjë. (*Dalin për  
te Marta.*)

## TABLOJA E NJEMBËDHJETË

*(Ademi vetëm pranë traktorit shtrëngon vidhat e fundit, dikush e furnizon me karburant.)*

DULLA — Ke punë tjetër me mua?

ADEMI — Jo, faleminderit! *(Dulla largohet.)* Ja, gjithçka mbaroi dhe ti, o plakush, u ripërtërive, do të marrësh prapë fushat. Do të lërosh dhe do sheshosh, do të fillosh përsëri jetën. Të kujtohen ditët tona, ëh? S'të kujtohen? Për ty njësoj është kushdo që të të ngasë, mjafton që të të shtyjë përpara, pastaj ti bën kërdrinë. Ah, s'ke faj ti, fajin e kam vetë për gjithçka! Të humba ty, humba atë, gjithshka humba, e pse? Sepse s'qeshë i zoti të përmbaja veten, sepse u shkëputa nga shokët, doja të isha mbi ta dhe... ja ç'bëra. Sikur të ndreqej edhe njeriu si makinat? Eh, ç'po flas bu-dallallëqe! Të kam bërë si nuse, gjithçka të re ta kemi vënë. Do të të vijë edhe ty çudi, kur të marrësh përpara kapicat e dheut, s'do ta ndiesh fare peshën. Si i ri, do të punosh si atëherë. Sa mirë, përsëri në fushë! *(Hyn magazinieri.)*

MAGAZINIERI — E mbarove, më thanë.

ADEMI — Çfarë?

MAGAZINIERI — Qenke hutuar, more djalë, erdha të marrë mbeturinat për në rikuper.

ADEMI — Ta provonim njëherë, pastaj ti mirrje.

MAGAZINIERI — Hajt, hajt, s'del gjë e keqe nga dora jote!

ADEMI — Mirë, merri! (*Magazinieri ulet dhe merr.*) Po të ndihmoj edhe unë. (*Merr dhe ai çka tepëruar dhe të dy dalin. Hyn Marta, afrohet pranë traktorit dhe e prek me dorë.*)

MARTA — Të ndreqi Ademi. Ah, Adem, pse ndodhën gjithë këto gjëra me ne? Thashë se çdo gjë mori fund, por jo, njerëzit paskan kuptuar gjithçka kemi në shpirt dhe s'u pëlqeu poza jonë e jashtme. Thashë se do të isha e qetë kështu si jam, por ja që edhe kështu s'qenka gjë. Njerëzit dashkan që në marrëdhëniet midis tyre të jenë të sinqertë. (*Përkëdhel traktorin.*) Ky e di shpirtin tim, sot e mësuam të gjithë. Po, edhe unë e dua Ademin. Sikur të mos ishte prishur ti, çdo gjë do të ishte e qetë, e fjetur dhe kurrkush s'do të mësonte gjë nga jeta ime, veç pyjet e fushat. Ti u bëre sebeb për të gjitha. (*I bie me grusht kabinës.*) Ti! Ti edhe ai më joshët. Ti që më dukesh përbindësh, më tërhoqe. Doja të të zija prej brirësh e të të mposhtja, doja të ngrihesha mbi ty. Më lodhe gjersa të mposhta, por s'qenka kjo gjithçka. Njeriu s'paska armë vetëm muskujt, njeriu s'qenka i lumtur vetëm duke qenë i lirë të përdorë forcën, të derdhë djersën e të marrë hakun, kjo qenka pak, njeriu s'qenka i lumtur vetëm me kaq.

(*Hyn Ademi, Marta e shqetësuar ndez motorin. Ademi afrohet. Pas tij hyn Zydiu, Poloja, Shpresa, hyjnë edhe disa të tjerë për të dëgjuar zhurmën e re e të pastër të traktorit që ka ndezur Marta. Ademi dhe ajo nuk shohin prapa. Të dy rrinë e dëgjojnë zhurmën e traktorit. Të emocionuar zgjatin duart për t'i dhënë gaz. Të dy duart kapin levën dhe bashkohen. Ademi i flet Martës, por s'dëgjohej gjë nga zhurma e fuqishme e traktorit dhe Marta i flet e qeshur, e gëzuar, por publiku asgjë s'dëgjon.*)

ADEMI — Më fort, më fort! (Zhurma e fuqishme gjëmon dhe mbush skenën, të dy përkulen, diçka shohin mbi traktor dhe vazhdojnë të flasin ngadalë.)

(Bie perdja.)

Në prag  
të jetës

## VETAT:

ELSA KOLANI

— studente në Institutin e Lartë të Arteve

AJDIN KOLANI

— i ati, nëpunës

DONIKA KOLANI

— e ëma

JAKUBIN SEVA

— inxhinier, i fejuari i Elsës

ANDONI

— student i Institutit të Lartë të Arteve, shok i Elsës

MONDA

— studente e Fakultetit të Gjeologjisë, shoqe e Elsës

JOVAN SHELICANI

— pedagog në Institutin e Arteve

SHKËLZEN LAMI

» » »

SANIJA

— studente

ELMAZI

»

SALIU

»

THEOFANI

»

SIMONI

»

*Studentë figurantë që luajnë në dramë*

## TABLOJA I

(Apartamenti i Ajdin Kolanit. Sallon që shërben dhe si dhomë pritjeje. Ka dhe një aneks kuzhine. Duket një derë, një varëse rrobash, një telefon dhe një derë tjetër që të futë në dhomën e Elsës.

Mbi tavolinën e mesit ka një fletore të trashë, një libër, disa fletë të bardha. Në mur është varur portreti i Shote Galicës.

Në skenë janë Ajdin Kolani dhe e shoqja, Donika, e cila mban në duar një punë paje të qëndisur. Të dy, siç duket, bëhen gati të dalin. Nga dera e dhomës së Elsës vijne zhurma të një magnetofoni, herë copa melodish vallëzimi, e herë muzikë që shoqëron një pjesë dramatike.

Burrë e grua u tërheq vëmendjen muzika.)

DONIKA — Po kjo muzikë kështu?

AJDINI — Do të jetë muzika që shoqëron dramën. (Duke iu afruar portretit të Shotës.) E, moj grua, na u rrit çupa, na u bë aktore që të luajë një heroinë si Shote Galica.

DONIKA — E, ore burrë, s'të besohej atëherë, kur ngulja këmbë që ta fusnim çupën në atë shkollë. Unë ta mbusha mendjen... Tani radhën e ke ti.

AJDINI — Unë? E për çfarë?

DONIKA — Erdhi fundi, pra... Emërimet bëhen që tani, prandaj bjeru telefonave. Mora vesh që në teatër ka një vend. Le që po s'pati e rregullojnë ata... Pak shokë e miq ke ti?

AJDINI — Akoma ti me këto ndërhyrje? Lëre tani atë qëndismë dhe ngrehu të dalim. Na presin. S'bën të vemi të fundit.



- DONIKA — Eh, (*psherëtin e shikon qëndismën*) sa ta sjellim dhe dhëndrin në Tiranë! Kush do të jetë si ne pastaj. Dasmë do ta kemi jetën, Ajdin.
- AJDINI — Dasmën e kemi lënë për ta bërë pas shkollës, të marrë diplomën çupa, të fillojë punën, pastaj...
- DONIKA — Pastaj është vonë, Ajdin. Po u emërua jepja pajën me vete, nise për në Elbasan, te burri, se ti s'je nga ata që të ndërhysh për të bërë dy transferrime.
- AJDINI — Ma bërë kokën dhallë.
- DONIKA — Ah, more i shkretë! Je goxha kuadër, u jep dum punëve në një institut të tërë e s'je i zoti të mbarosh një punë për vete.
- AJDINI — E ç'të bëj, se më plase!
- DONIKA — Celebrimin. Le të quhen të martuar. Formalitetet janë formalitete, me firmë e vulë, pastaj ndërhy që ta sjellin sa më parë Jakubin në institutin e projektimit. Aty ku ishte. U bë një vit në metalurgji.
- AJDINI — (*Mundohet ta qetësojë të shoqen.*) Aman, o grua, përse bëhesh merak. Rri, moj, e qetë se po të shtohen thinjat,
- DONIKA — Shiko të tuat ti, je bërë grivë fare, sikur të ka zënë bora.  
(*Hapet dera e dhomës së Elsës. Hyn e fuqishme muzika dhe Elsa me tekstin e dramës në dorë. Është si e përhumbur, sikur thotë përmendsh tekstin. Dhe të ecurit e ka skenik.*)
- DONIKA — Shpirti i nënës, Shote e nënës!
- ELSA — Aman, mama, më lër rehat!
- DONIKA — (*E gëzuar.*) Prit, të keqen nëna! (*I vë së bijës në gjoks copën që ka qëndisur.*) Hë, more burrë, e shikon? Do ta bëj dhe me ca rrudha këtu.
- ELSA — Me ç'të duash bëje, veç më lër të qetë.
- DONIKA — Je në rol, të keqen mami.
- ELSA — Na, babi, të lutem mbaje një çikë tekstin sa të vishet mami. (*Ia jep.*) O, një minutë, sa të kthej shiritin nga e para. (*Hyn në dhomën e saj, kthen*

shiritin e sërish dëgjohet motivi i njohur, si pak më parë. Kur Elsa del nga dhoma e saj, e shohin që është duke veshur një xhamadan të zi të rolit të Shotës. Është e emocionuar. Bën një hap, dy e sa nisjet të deklamojë tekstin, bie zilja e derës.) Uf! Ju kam thënë njëqind herë se në shtëpi s'përgatitem dot. Për dhjetë ditë kemi premierën e unë jam më pas se shokët. (Impulsive shkon dhe hap derën. Hyn Jakubini.) O, Jakubini! (Thërret dhe i hidhet në qafë.) Po ti, nga mbive kështu? Sot është e mërkurë. Pse s'telefonove që do të vish?

JAKUBINI — (Vështrohet sikur do të blejë diçka.) Zëre se s'kam ardhur. Na thirrën në atë mbledhjen. Sapo mbaruam e do të nisemi sërish. (Shikon orën.)

AJDINI — Po, po, e mora vesh. Isha me drejtorin tuaj të ministri. Duhet të kini kujdes, more çuna!

JAKUBINI — Tani do të nisemi prapë. Këtej, me sa po shoh, qenkeni të gjithë mirë.

DONIKA — Pse të mos jemi mirë? Ja, Elsa, me premierën, unë me pajën se po na afron dita...

JAKUBINI — (Përtypet, diçka do të thotë.) Sikur ta shpejtonim ca. (Vë re se Ajdinit nuk i pëlqen.)... Nuk e kam fjalën për dasmën po... si t'jua them... për formalitetet se zyrtarët ato gjëra shohin, sukseset...

AJDINI — Po, pse, mor djalë, çfarë të shqetëson? Se dhe kjo më foli pak më parë. Ç'është kjo ngutje kështu?

JAKUBINI — Hiç! Asgjë! Po, si t'jua shpjegoj, janë ca gjëra vërtet formale, sidomos kjo puna e celebrimit, po që kanë vlera praktike se... Elsa do quhet e celebruar dhe unë do ta kem më të lehtë të kthehem sërish në Tiranë, pastaj.... emërimi i saj... duke qenë unë në Elbasan, mund që ta sjellin dhe atje... Më falni, shoku Ajdin, mua mbase s'më takon që të flas në emër të Elsës, megjithëse me të diçka kemi folur, po kam frikë se nesër do të jetë vonë... jo për gjë, po ato të shkreta dokumenta të emërimit ata të ministrisë i bëjnë që tani.

- DONIKA — Ajdin! Mos i ngrys vetullat! Dhëndri ka të drejtë. Fanja e Sotirit e kishte bërë celebrimin një vit e gjysmë më parë se sa të bënte dasmën dhe e fitoi të bijën se do ta çonin në veri ku vajtën të gjithë shokët e shoqet e kursit.
- JAKUBINI — Nejse, më falni se jua prisha qetësinë, s'erdha që t'ju shqetësoj, si të thuash, më shumë erdha t'ju shoh e sa për të sjellë atllasin! Punët tuaja ju i dini vetë e më mirë se unë. Unë shqetësohem kot...
- ELSA — E gjete?
- DONIKA — Ngjyrë ari?
- JAKUBINI — Bile, më gjethe si të gdhendura. *(E shpesh-tjell copën e atllasit.)*
- DONIKA — Tamam, kjo copë është! E, s'të pëlqen?
- ELSA — Nuk më pëlqen ngutja juaj... Si ti, mama, si ky se ç'keni që nguteni, se ç'më fshihni.
- JAKUBINI — O, Elsa, si e thua këtë fjalë? Si është e mundur që t'i fshehë gjë nëna së bijës e unë ty?
- DONIKA — Të të shohim ty të lumtur, moj. E ç'kemi ne veç teje?
- AJDINI — Nxitohu, grua, se na u bë vonë!
- DONIKA — Ja, erdha!, *(Del nga skena. Flet që larg.)*  
Elsa, gostite Jakun!
- AJDINI — Dhe ti mbaje një çikë këtë. *(I jep tekstin, pastaj i drejtohet së bijës.)* Zëre se ky është Azemi.
- ELSA — E, babi, fillove dhe ti të talleh? Mua më del tym nga koka!  
*(Hyn Donika.)*
- JAKUBINI — Pse, moj, ç'u bëre, ti, oxhaku i furnnaltës që të nxjerrësh tym?  
*(Qeshin. Hyn Monda, Donika nuk e pret mirë ardhjen e saj.)*
- MONDA — Ju po dilni kështu? Atëherë, s'po hyj fare.
- ELSA — Jo, Monda! Vetëm babi me mamin do dalin. Hyr, hyr, pra!
- MONDA — Tungjatjeta, shoku Jakubin! Ç'thotë metalurgjia?

JAKUBINI — E, ç'të thotë! Pret të dalësh ti gjeologe, se jemi në vështirësi për mineralin...

MONDA — Për një muaj marr diplomën. Ti e ke gati furnnaltën?

DONIKA — (*Duke dalë.*) Brisk e ke atë gjuhë, moj e shkretë! S'ta kish me të keq.

AJDINI — Hadje, grua, mos u pleks me të rinjtë! (*Dalin.*)

MONDA — (*Jakubini.*) Jo, ju qenkeni bërë sufler? Më thanë se në Teatrin Popullor vendi i suflerit është bosh.

JAKUBINI — Në Teatrin Popullor do shkojë kush do shkojë!

ELSA — O, sa vështirë e kam me këtë rol!

JAKUBINI — S'ka vështirësi që nuk kapërcen njeriu. (*Ia jep tekstin Mondës.*) Elsa, më duhet të iki. S'bën t'i lë gjatë shokët në mikrobuz, aq më tepër drejtorin. Më dha të fala për tët atë e unë harrova.

ELSA — Çudi! Po ata qenë bashkë te ministri si të dha të fala për të?

JAKUBINI — (*Sikur kujtohet.*) E, pra, vërtet. Ai drejtorin ynë është matufjepsur fare. Ç'tha yt atë?

ELSA — Im atë? S'tha gjë. Çdo të thosh im atë? S'po të marr vesh, Jaku.

JAKUBINI — Kot fola, po, se si m'u duk, sikur drejtori im atje, në bufenë e ministrisë, duke pirë kafe, i foli gjatë tyt eti... Mbase do të ketë folur për çështje pune. Nejse, s'ka rëndësi. Unë po iki.

ELSA — S'të mora vesh fare. Si erdhe, pse erdhe e si po ikën kështu!

JAKUBINI — Të paska hutuar roli. Mirupafshim të shtunën!

(*Matet ta përfafojë, po Monda nuk i lë.*)

MONDA — (*Përplas duart.*) Stop! Para një vajze beqare si unë nuk është e hijshme të putheni. Prisni të mbyll sytë, (*Vë pëllëmbën me gishtrinjtë e hapur para syve.*) Më mirë do të jetë të dal. Elsa, nesër, të pres si zakonisht. Natën e mirë! (*Del.*)

(*Jakubini i afrohet Elsës. Elsa e pret ftohtë afri-min e tij. Njëkohësisht mbyllet dhe perdja.*)

## TABLOJA II

*(Në rrugë para shtëpisë së Elsës. Është mëngjes. Monda me librat nën sqetull rri e pret. Kalon një çift studentësh. Djalë e vajzë. Djali e ngacmon Mondën.)*

STUDENTI — E, Monda, po pret Elsën, ë?

MONDA — Pse, ç'hall ke ti?

STUDENTI — Hiç, më vjen keq për ty, se mbete duke pritur.

MONDA — Epo ç'të bësh, disa presin, disa grisin këpuçë duke shoqëruar.

*(Sa dalin ata, hyn Elsa. Duket që ka kaluar një natë të gjatë e të shqetësuar.)*

MONDA — Bobo, si qënke ti sot! Mushkë xanxare! Shiko se mos i bie me shkelma dhe atij.

ELSA — Na, mbami një çikë librat sa të rregulloj karfiçën *(Duke kapur flokët psherëtin.)*

MONDA — Ah, këto të shtunat sa larg që janë nga njëra-tjera. Gjashtë ditë të tëra në mes e njëra më e gjatë se tjetra.

ELSA — Dëgjo, Monda! Sot nuk kam qejf për shaka të tilla. Me Jakubinin s'ke punë as ti as....

MONDA — *(Ia rrëmben fjalën.)* ...Andoni, ë?

ELSA — Ç'hyn Andoni këtu?

MONDA — Shokë të rinj zër, po të vjetrit mos i lër!

ELSA — Jakubini nuk është shok. Ai është i fejuari im pavarësisht se ty dhe Andonit e ndonjë tjetri nuk ju pëlqen.

MONDA — Unë nuk e njoh fare atë. Nëse kam ndonjë

mendim, këtë e kam nga fjalët e tua të fundit. Ti nuk je më e qetë dhe e lumtur si në fillim. Vërtet, ç'ke sot kështu? Pse je bërë kaq nervoze?

ELSA — S'kam fjetur mirë mbrëmë.

MONDA — Po pse s'ke fjetur mirë? (*Elsa e shikon me qortim.*) Çfarë ke, Elsa? As mua s'do të ma thuash?

ELSA — S'di ç'të të them e si të ta them. Nuk e di. Besomë, Monda. Nuk më pëlqeu ardhja e tij mbrëmë. Se si m'u duk. S'e kisha vënë re më parë tek ai atë buzëqeshje dhe atë kureshtje që ai e fshehu aq shpejt.

MONDA — Ama dhe ti ç'nuk vë re! Për kaq gjë paske ndenjtur pa gjumë mbrëmë?

ELSA — Ai ngul këmbë që ta bëjmë patjetër celebrimin. Ai dhe mamaja. I kanë pjekur pipëzat bashkë dhe...

MONDA — Po ajo punë në mos sot nesër do të bëhet...

ELSA — Më parë, kur binte fjala për formalitetet e celebrimit, ai thoshte t'i shtyjmë që të mos figuroja unë e martuar se kishte rrezik që të më emëronin në Elbasan. Tani ngul këmbë të bëhet celebrimi.

MONDA — Sepse ai mendon që po të bëhet celebrimi, yt atë e jot ëmë do të kërkojnë ta sjellin sa më parë në Tiranë se ndryshe shkon ti në Elbasan. Hesap. Pse më shikon ashtu?

ELSA — Sa thjesht i merr gjërat ti, Monda... U bie shkurt, me një fjalë. «Hesap» thua... Po s'është puna vetëm tek ai hesap. Djë nuk më pëlqeu fare ardhja e tij. Ai diçka priste të dëgjonte ose të kuptonte prej meje, se, kishte biseduar im atë me drejtorin e kantierit.

MONDA — Qetësohu, Elsa!

ELSA — Ç'të qetësohem! As me rolin nuk i kam mirë punët... Sidomos sot jam fare e papërqëndruar.

MONDA — Ti nuk i ke mirë punët me veten tënde, mojt qyqe! Ç'je lëshuar kështu? Mblidh mendjen! Martesa është një eveniment...

ELSA — (*Ironike.*) ... me rëndësi të madhe jetike, këtë do të më thuash?

MONDA — Po. Më duket se ke nevojë t'ia thuash vetes disa herë...

ELSA — Nuk është nevoja t'ia them vetes. Unë atë e dua. Merr vesh ti apo jo? Nuk di se si, po ja që kaq gjë e di, e ndiej.

MONDA — Atëherë lëri mënjanë dyshimet. Na lodhe, Elsa! Kur mbaron sot? Sa orë ke?

ELSA — Si zakonisht.

MONDA — Atëherë po vij të të marr. Ose më mirë, hajde ti. Mirupafshim!

(*Ndahen në fund të skenës.*)

### TABLOJA III

(Në studio Dekori, i paplotësuar ende, paraqet një pamje të rrethit të Drenicës në Kosovë. Pyll. Diku larg bie në sy një majë minareje. Vjeshtë. Bën pak ftohtë. Ngjyrat e dekorit janë shqetësuese. Studentët aktorë merren me rregullimin e tij.)

Elmaz Alia në rolin e Azemit, është duke u rregulluar përfundimisht sipas fotografisë së njohur. Andon Gurashi, që luan rolin e Ukës, Sania, që luan rolin e nënë Lezes, dhe figurantët e tjerë nuk janë veshur plotësisht si luftëtarë të çetës. Përnjëherësh të bie në sy se jemi akoma në prova. Pedagogu-regjisor, Jovan Shelcani, ka përveshur mëngët e një bluze të zakonshme dhe mundohet t'u caktojë vendet.)

JOVANI — Gati? Fillojmë?

SANIA — Gati, profesor!

JOVANI — Fillo, Elsa!

(Elsa mezi hyn në rol.)

ELSA — Si mund të bisedosh ti me njerëzit e Krol Pjetrit? Ata duan të të shkëpusin ty nga ne që ta kenë më të lehtë. Nuk të lë të shkosh e të bisedosh me ta, Azem! Plumbi të pret në këtë takim. Jo, Azem Galica! Po gabon rëndë. Mbreti që nuk kursen floririn e gradat, e ka hilen të madhe. Nuk të lë të shkosh, Azem!

ELMAZI — Ne duam të fitojmë kohë, Shotë, Jemi të rre-



thuar. Do të di të zgjas kuvendin që ju të çani rrethimin. E di që shkoj drejt vdekjes, po vdekja ime do t'ju japë kohë juve...

ELSA — *Po gabon rëndë, Azem! S'po të lutem si gruaja jote, por si bashkëluftëtare. Vetëm emri yt i tmeron ata...*

JOVANI — *(Ndërhyn i nervozuar.)* Jo, jo! S'je Shotë... As me fjalë as me veprim. Çka ndodhur me ty, ë? Ti ke qenë mirë, dhe në procesin e tavolinës dhe në fillim të mizanskenës, tani s'je gjëkundi. E ke humbur figurën, logjikën e saj. E kemi zbërthyer një herë e mirë se kush është Shota, e cila për Shqipërinë e për Azemin ka lënë shtëpinë, ka lënë jetën e saj si grua dhe i është bërë shok armësh burrit. Ka dhe ajo po ato ideale që ka edhe ai, i dhëmb në shpirt Shqipëria që po e copëtojnë kafshata, kafshata.

ELSA — *(Reagon.)* Po, profesor, i dhëmb... dhe mua më dhëmb!

JOVANI — Jepja, pra, këtë dhimbje spektatorit, mos e mbaj për vete. Ç'ke në sy, në shpirtin tënd, duhet ta shohë publiku. Çfarë ndien ti, si e ndien, duhet ta ndiejë dhe ai që rri atje në karrige në sallë. Dhe me shpinë nga njerëzit po të jesh, ata duhet të ndiejnë atë që ndien ti. Po ju pse u shturët? Zini vendet që patët! *(U drejtohet studentëve)* Dhe një herë! *(Elsa mezi lëviz.)*

SALIU — *(Duke zënë vendin.)* Bobo, dhe një herë nga e para.

THEOFANI — Epo, ç'ti bësh! Kusuret e Elsës që t'i heqim.

SALIU — Ama dhe ti me këto krahasimet e tua prej fshatari!

THEOFANI — Fshatar, fshatar, po jam klasë më vete unë, jo si ti që s'di kujt klase i përket.

SALIU — Klasës së shakaxhinjve, ka më mirë. Ja, të bëra të qeshësh?

THEOFANI — Mua po, po Simonin, ëhë!

SALIU — Ai është minator. Do martinelin që të gudu-  
liset.

SIMONI — Futi brenda dhëmbët, o karagjoz, se t'u  
thanë!!

JOVANI — I lini fjalët! Shkak doni që të prishni provat.

SANIA — (*Shikon orën.*) Ou! Na hëngri gjithë pasditen.

SALIU — Mos keni lënë ndonjë takim?

SANIA — Epo e diel është, pasdite, vonë vajti!

JOVANI — (*Përplas duart.*) Mjaft më! Përqendrohuni!  
(*Theofani lëviz një letër nëpër gishtërinj*). Theo-  
fan, fute atë letër në xhep! (*Theofani i mërztitur*  
*fut letrën në xhep dhe shikon me inat nga Saliu.*)

SALIU — Tuhaf! T'i kishe thënë se ke lajmthirrje, kishe  
shpëtuar nga provat e do bëje xhiro në bu-  
levard me Mondën.

THEOFANI — U mata po s'ia thashë dot.

JOVANI — Çfarë ke, Sali?

SALIU — Unë! Asgjë, profesor! Ky ka lajmthirrje, por  
i vjen zor t'ju thotë si fshatar që është.

JOVANI — (*I nxehur.*) More! Jeni këtu ju apo jo?  
Për dhjetë ditë kemi premierën! A vendosëm që  
të punojmë dhe pasdite?

SIMONI — Po, profesor, edhe si kurs edhe si orga-  
nizatë, gati jemi.

SANIA — Gati, gati, po kështu nuk punohet. Elsa du-  
het të kishte ardhur e përgatitur. Të gjithë po sa-  
krifikojmë për të. Për të erdhëm edhe sot që është  
e diel...

ANDONI — Fillove prapë, ti?

SANIA — Fillova se më dhimbset shfaqja, është punë  
diplome kjo, me këtë shfaqje ne hyjmë në jetë.  
Nderohemi ose turpërohemi të gjithë. Përse të vle-  
rësohemi keq? Për hatër të Elsës? Ta kishim dub-  
luar.

SALIU — Mos e deshe ti atë rol?

SANIA — Jo! Mua nuk më shkojnë rolet e heroinave,  
se jam pak e trashë nga trupi.

- (Saliu e imiton atë duke lëvizur si patë. Ata që e shohin mezi e mbajnë të qeshurit.)
- JOVANI — Boll më! Fillojmë tani? Hadje, Elsa, fillo!  
(Elsa zbrat nga podiumi e mërzhitur.)
- THEOFANI — Bobo! Filloi kjo nga avazi i saj. Prite kur të qajë tani.
- SIMONI — (Që mezi e përmban veten.) Elsa! Ne sot po punojmë për ty. E kupton ti kaq gjë, apo jo?
- JOVANI — Qetësohu, Elsa! Qetësohu!
- SALIU — Mos ke lënë dhe ti takim me inxhinier Jakubin?! E pashë që kishte ardhur nga kantieri. Dje e pashë. Kishte valixhe të bukur. Dhe xhupin e kishte me jakë lëkure si skile, si ujk...
- ELSA — Mos më nga, Sali! Si t'ju them, profesor... (Ul kokën.) nuk mundem... s'e nxjerr dot. E kuptoj gjëndjen e Shotës, e ndiej dhe dramën e saj. Mbrëmë s'kam qenë mirë. Kam menduar gjithë natën dhe... (Ul sërish kokën.)
- JOVANI — (Ia merr fjalën nga goja.) Je trembur nga premiera. Pse moj, kështu do të hysh në jetë ti? Me frikë? E di ti se ç'tregon kjo? Pavendosmëri, dobësi karakteri. Njerëzit pa kurajo, pa vetëpërim tremben para evenimenteve. Ky rol është prova e fundit që ti duhet të tregosh gjithë zotësinë tënde, gjithë formimin tënd, gjithë ç'ke mësuar në shkollë. Nesër do të dalësh në skenë, do t'ju japësh spektatorëve figura të ndryshme grash. Si do t'i luash ti ato?  
(Elsa e mërzhitur fillon e ngjitet prapë në podium për të zënë vendin e saj nga ku duhet të rifillojë provat. Pedagogu e vë re që ecën fare e papërqendruar.) Pushim, dhjetë minuta pushim! (Të gjithë zënë e dalin. Dikush hap tranzistorin dhe dëgjon transmetimin e një ndeshjeje futbollë.).
- JOVANI — Prisni, prisni! Ju të dy! (U drejtohet Saliut e Theofanit.) Pas pushimit do të kalojmë në skenën e burgut. Vini dritaren me hekura.
- SALIU — (Që ka cigaren në dorë.) Profesor po...

JOVANI — Mirë, hajde ti, Gazmend, se këtij iu ça hun-  
da për duhan.

THEOFANI — Po unë thashë t'ju kërkoj leje. Unë s'kam  
rol në skenën e burgut. Kam lajmthirrje. Pas  
lajmthirrjes vij prapë. I kam thirrur vetë, profesor  
dhe po të mos dal do të bëhen merak.

SALIU — I janë mbaruar paratë, profesor, Lëre të shko-  
jë! Më ka 50 lekë borxh e tri lata.

JOVANI — Hë, shejtanër! Në jetë jeni aktorë të vërtetë,  
kurse në skenë... (*Saliu e Theofani janë larguar.  
Elsa nis e zbërthen jelekun, Liron dhe rrypin e  
brezit. Duket sikur i rëndon koburja.*)

ELSA — Po unë ç'të bëj profesor?

JOVANI — Si gjithë të tjerët. Dil e qetësohu! Dhe këtë  
(*i kap rrypin e brezit*) mos e liro! Koburja që mban  
në brez s'duhet të të rëndojë. Duhet ta ndiesh si  
pjesë të trupit tënd. Dhe jelekun...  
(*Elsa nis dhe mbërthen kopsat e jelekut dhe del.*)

JOVANI — (*Me vete.*) Ç'ka kjo vajzë?

#### TABLOJA IV

*(Oborri i pasëm i Institutit që lidhet me një derë me skenën. Pemët këtu janë të gjelbra. Andoni dhe Sania duket që janë zënë.)*

**SANIA** — Mos pandeh se duke e mbrojtur atë i bën mirë? Pedagogu ka gabuar që i dha rolin e Shotës. Ahuuu... si është mësuar ajo!...

**ANDONI** — E ç'ka të bëjë se si është mësuar? Aktori është aktor. Ai ka të vetëndierit e tij artistik, ka talentin dhe...

**SANIA** — *(E ndërpret.)* Çdo aktor ka planin e tij. Ka, në fund të fundit, diçka të tijën që e bën më të afërt ndaj një kategorie tipash.

**ANDONI** — Derisa jemi studentë duhet të provojmë shumë role, tipa, karaktere; gjersa të gjejmë veten. Si do ta krijojmë ne individualitetin tonë?

**SANIA** — Atë gjë duhet të zbulojë pedagogu te ne. Unë them prapë se me Elsën ai ka gabuar. Për mua Elsa është akoma fëmijë. Akoma e mbyllur në flantikth, ajo s'ka akoma personalitetin e saj në jetë, jo më ta ketë në art.

**ANDONI** — Ti flet kot! Ti nuk e njeh fare Elsën.

**SANIA** — A, po! Më fal, gabova! Elsën vetëm ti e njeh. Po ajo çfarë njeh? Të paktën ty, të njeh?

**ANDONI** — Shiko! Mos fut hundët atje ku s'të përket!

**SANIA** — A, more buf! Ti je i verbuar ndaj saj, kurse ajo as që do ta dijë se çfarë ndien ti, ç'mendon ti për të. Dhe a e di ti pse të ndodhi kështu?

**ANDONI** — *(Bëhet kureshtar, po i vjen zor.)* E di. Ajo

gjithnjë më ka dashur si shok, si vëlla, pavarësisht nga ndjenjat e qëllimi im i mirë. Pse çuditësh, nuk ndodh kështu në jetë? Ajo... pëlqeu Jakubinin.

SANIA — Jo ajo, po e ëma! Elsa shikon me sytë e të tjerëve. Kjo është Elsa Kolani. Një Elsë e tillë e ka të vështirë të jetë Elsë në radhë të parë, jo më Shotë.

ANDONI — Nuk ke të drejtë! Elsa ka personalitetin e saj.

SANIA — Elsa? Ç'më bëre të qesh!

*(Hyn Elsa duke mbërthyer kopsën e fundit të jelekut.)*

ELSA — Po ju, për mua po flisni?

ANDONI — Jo! Ç'ne! E kishim fjalën për...

SANIA — ...figurën artistike. Për rolin e madh që luan vetë jeta, përvoja vetjake, kujtesa emocionale...

ANDONI — E dimë që more dhjetë në teori.

SANIA — Unë do vete deri në klub, do vini? Dje më erdhën ca lekë nga shtëpia. Hajdeni dhe bisedojmë rrugës! *(Andoni nuk pranon.)*

ANDONI — Kavalier i mirë është ai që kur s'ka lekë, nuk pranon të qeraset nga damat.

SANIA — Ashtu është se ka dhe ca kavalierë që më shumë kënaqen kur thithin në vetmi të njëjtin ajër që thith dhe dama e tij. Mirupafshim! *(Del.)*

ANDONI — Ti se ç'ke, Elsa? Se si je bërë këto ditë! Dhe e heshtur je bërë!...

ELSA — Lermë, Andon, se më vjen të pëlças! As unë nuk e di se ç'kam. Nuk e duroj këtë gjendje. Pedagogu më bërtet, ju të gjithë jeni gati të më hani. Nuk mund ta nxjerr rolin. Pse qesh?

ANDONI — Se flet budallallëqe. Ti je ndër studentet e mira.

ELSA — Fillove dhe ti si mamaja? Mirë ajo se nuk di gjë po ti që e pe sa keq luajta!

ANDONI — Po ç'ke atëherë? Fol! Ty të mundon një gjë. Të paktën mua s'më gënjen dot.

- ELSA — Nuk e di! Të betohem që nuk e di! Ndaj më vjen inat, dhe me veten time që jam bllokuar kështu, që po bëhem shkak...
- ANDONI — Ti, Elsa, nuk je e sigurtë, më fal që po ta them, po!...
- ELSA — Si? S'qenkam e sigurtë?
- ANDONI — Ti mban një të fshehtë që të rëndon në shpirt. Mos nuk i ke mirë punët me Jakubin? Më fal që po të flas kështu, po dhe Mondës i ka rënë në sy! Ti mos je penduar që je lidhur me atë aq shumë, që...
- ELSA — *(I vë dorën në gojë Andonit.)* Mos fol për të! E dua. Ta kam thënë dhe një herë tjetër. *(Andoni qesh.)* Pse qesh, xhanëm?
- ANDONI — Nga mënyra se si e thua.
- ELSA — Pse, si e thashë?
- ANDONI — Sikur nuk je e sigurt. Mos është pak e nxituar kjo dashuria jote? Apo, më mirë të them, e imponuar?
- ELSA — Nga kush?
- ANDONI — Nga ai, nga kush tjetër! Mbase dhe nga jot ëmë.
- ELSA — O, Andon! Ti je i çuditshëm. Flet ca gjëra... si të them.
- ANDONI — Zembrën tënde unë e kam në pëllëmbë të dorës dhe shoh aty gjithçka. Dhe ato që ti nuk i shikon dot.
- ELSA — E çfarë shikon aty?
- ANDONI — Që ti je e pavendosur, e trembur, e tronditur...
- ELSA — Jo! Nuk jam e trembur, as e tronditur, po, se si më vjen që pas një jave do të bëjmë celebrimin. Pse e kërkon ai, një gjë të tillë me aq këmbëngulje? Atë seç e shtyn, diçka jo e mirë. A mund të flasë njeriu për martesë pa e parë në sy atë që do? Ka një javë e ca që ngul këmbë dhe sytë i mban përdhë: Pastaj se si më shikon,

aq sa më duket sikur është tjetër njeri, jo ai që kam njohur.

ANDONI — Atëherë del që ju nuk jeni njohur akoma, ndryshe s'ka se si që njeriu yt më i afërt, me të cilin do të lidhesh përjetë, të të duket herë flori e herë kallp. Përderisa ty të shqetëson kjo gjë do të thotë se nuk e njeh deri në fund. Më fal, Elsa! Ne jemi rritur bashkë, si të të them, ne e njohim mirë njëri-tjetrin dhe nuk besoj se do të m'i marrësh ters fjalët e mia.

ELSA — O, Andon, ç'janë këto fjalë!

ANDONI — Atëherë mendohu mirë, Elsa, sa nuk është vonë! Martesa është një gjë më shumë rëndësi në moshën tonë, them për ty se je vajzë, pa unë, ah, kam kohë.

ELSA — Nuk e besoja kurrë se kjo gjë do të ishte kaq e zorshme.

ANDONI — Atëherë... (Ngurron.)

ELSA — Fol, Andon! Pse ngurron?

ANDONI — A të pëlqen ai? Të pyes si njeri, jo si inxhinier?

ELSA — (Mbledh supet.) Mamaja e pëlqen, mamaja thotë që... Andon, ç'është kjo pyetje? Unë e dua atë, veç më vjen inat që nuk jam e qetë, që nuk e kuptoj pse të kem këto ndjenja tani që dashuria jonë do të kurorëzohet. Pse të kem këtë brengë, ë?

ANDONI — Atëherë ti nuk je e lumtur.

ELSA — E lumtur? Pse të mos jem?!

ANDONI — Kur njeriu pyet vetveten do të thotë se atij ç'ç' nuk i pëlqen. Çfarë s'të pëlqen ty te inxhinier Jakubini?

ELSA — Mua ai më duket i përkryer. I mirë, i sjellshëm, i zoti, Dhe ja ku po ta përsëris, e dua!

ANDONI — A i ndien ti shpirtërisht të gjitha këto që thua apo vetëm i thua kështu me zë si për t'i mbushur mendjen vetes?

ELSA — Ehu, Andon! Me ty nuk u folka sot!

ANDONI — Sytë gënjehen, shpirti jo.



ELSA — Andon, ti s'duhet të më flasësh kështu! Nuk e prisja nga ti që të më merrje kështu si në hetuesi. (*Elsa matet të ikë. Andoni e kap për dore dhe nuk e lëshon.*)

ANDONI — Mos u nixeh me mua, Elsa! Mbase bëra gabim, që fola kaq shumë, që fola kaq vonë. Mua më takon vetëm të hesht, ashtu siç kam heshtur kaq e kaq vite. Po... si të të them... Më vjen keq për ty që nuk je e qetë, që nuk je e vendosur, që nuk je e lumtur.

ELSA — S'është e vërtetë. E qetë jam dhe e vendosur që atë e dua. Veç nuk di pse jam kështu!

ANDONI — O, Elsa, njeriu bën gabimin më të madh kur i fshihet vetvetes! Gjithnjë më ka shqetësuar kjo gjë. Shpesh ecim në jetë jo me këmbët tona. Na shtyjnë dhe ne ecim. O erdhi! (*Ka parë Jakubin dhe largohet.*)

ELSA — (*Kthehet andej nga ikën Andoni.*) Dhe unë si jam bërë! Përse më shqetëson këmbëngulja e tij për t'u celebruar? Mos vallë jam bërë xheloze për atë inxhinieren, Liri Rekën, që ai nuk e heq nga goja? Po vetë këmbëngulja e tij për fejesë çfarë tregon? Pse s'ia thashë Andonit dhe këtë dyshim? Ah, Andon!... Pse iku ai kështu?... (*Sa kthen kokën shikon Jakubin që siç duket ka dëgjuar monologun e Elës.*) O, Jakubin, sa mirë që erdhe! (I hidhet në qafë dhe ngjeshet e tëra tek ai sikur kërkon mbrojtje nga i fejuari.)

JAKUBINI — (*I shqetësuar.*) Ç'ke, Elsa? Ti sikur nuk je mirë! Ç'të ka ndodhur? Mos të fyu ai djali? Kush ishte ai fshatar?

ELSA — Andoni ishte. Shoku im i kursit. I vetmi shok që tërë jetën më ka ndihmuar, më ka mbrojtur. Ai sikur është hija ime. Kemi qenë bashkë dhe në gjimnaz. S'të kam folur për të?

JAKUBINI — Jo. Tani po më flet.

ELSA — Çudi! Si s'të kam folur për Andonin? Kur unë isha në vitin e tretë ai qe në maturë. Atë vit

shkolla jonë mori pjesë në olimpiadën teatrale të shkollave të mesme të qytetit të Tiranës. Shkolla jonë kish dramën «Rruga Budi».

JAKUBINI — E di, e kam parë në televizor një natë.

ELSA — Andoni më futi në grupin teatral të shkollës. Punuam nja dhjetë ditë, po nëna, kur e mori vesh, më hoqi. Nuk e di pse, pi ajo s'donte që unë të rrija me Andonin. Të them të drejtën, nuk e kuptoj dot atë njeri. Dhe këtu në Institut, tre vjet të tëra, ai më del krah. Ai dhe sot më mbrojt.

JAKUBINI — Nga kush?

ELSA — Si nga kush? Po, ja, nga profesori... Sania, neje-se... Sania ashtu e ka. Ta thotë copë... kurse ai, profesori... Nuk i kam punët mirë me rolin.

(Tregon me dorë për rrobat.)

JAKUBINI — (I shqetësuar.) Si është e mundur? Ti as në shtëpi s'ke thënë gjë, as mua s'më ke thënë gjë... Yt atë kë nuk njeh. Ai është personalitet. Ai mund të ndërhyjë...

ELSA — (Qesh lehtë e hidhur.) Oh! Këtu s'ka të bëjë fare babai, as mamaja, as ti, askush. Nuk e kisha menduar kurrë kaq të vështirë rrugën e artit. Në këtë shkollë s'të ndihmon dot as babai, as mamaja.

JAKUBINI — Asgjë s'po marr vesh. Nuk mund të flasësh më qartë? Ç'hall ke, ë?

ELSA — (Shfryn.) S'kam forcë shpirtërore, S'kam vetë-veprim, pavarësi, individualitet. S'kam mbresa jetësore sikur të jem akoma në djep që më lëkundin të tjerët. (Zbërthen jelekun. Në çast sikur kujton këshillën e pedagogut dhe nervoze nis të mbërthejë kopsat që ka zbërthyer.) Unë... më duket se kam hyrë më parë në art pa hyrë në jetë. Unë duhet të luaj rolin e një heroine si Shota, unë që s'kam guxuar në jetën time të them një herë jo.

JAKUBINI — (I shqetësuar.) Sepse s'ke pasur arsye ta thuash, sepse s'të ka munguar asgjë. Unë po çudi-

tem e s'po kuptoj se çfarë kërkon prej teje ai pedagogu yt. Mos do të të ndërrojë karakterin tënd?

ELSA — Ai ka shumë të drejtë. Unë e ndiej çdo fjalë të tij se si më hyn në gjak, se si më bën që ta ndiej jetën e madhe. Ai përpiqet të më ngjallë krenarinë, pavarësinë dhe dinjitetin tim si njeri dhe si aktore. Jeta, thotë ai...

IAKUBINI — (*E ndërpret.*) Jeta... eh, jeta... jeta është si ta marrësh, si ta kuptosh, si të intereson! Jeta është tjetër gjë, sepse në të pleksen shumë gjëra të vogla, të përditshme që duhet t'i shfrytëzosh për qëllimet e tua; jeta, moj gocë, është tjetër gjë, kurse arti... ndoshta unë s'marr vesh nga ai, po besoj që duhet të jetë tjetër gjë...

ELSA — Jo, jo! Edhe unë ashtu pandehja se arti është diçka e rrallë si i shenjtë, si diçka e bukur, diçka që njeriu nuk e shpjegon dot veç kënaqet kur e ndien, kur e lexon ose kur e shikon, por tani që po mundohem të bëj vetë art, po bindem çdo ditë e më shumë se arti dhe jeta janë dy anë të një medaljeje. Në qoftë se njëra anë e medaljes, jeta, është e madhe, e fortë, e bukur apo e ashpër, e hidhur apo e ëmbël, me baltë, me hekura, me lëndina apo lule, ashtu siç është, me të mirat e të këqijat e saj, me gëzimet, dëshpërimet, hidhërimet e sukseset e saj, arti, që buron nga kjo jetë, pra, që është ana tjetër e medaljes, duhet të jetë pasqyra e jetës, ashtu siç është dhe se si duhet të jetë, që t'u shërbejë njerëzve jo vetëm për t'u dhënë kënaqësi, por dhe mësim. Pa jetë s'ka art. Dhe mua kjo jetë më mungon... më mungon dhe diçka tjetër... s'di si ta them. Pedagogu më thotë gjithnjë: tënden, çfarë ke ti tënden që t'ia japësh Shotës, çfarë përfaqëson ti veç vetes sate, ku e ke kohën që ti jeton. Ç'i jep kjo kohë njeriut tonë. Çfarë mesazhi sjell unë. Kush jam unë. Çfarë individualiteti e çfarë personaliteti kam unë! E? (*Elsa pret. Jakubini hutohet.*)

JAKUBINI — Ashtu është... ty... vërtetë diçka sikur të mungon. (*Elsa reagon. Jakubini trembet.*) Por ja, ku po ta them... Unë jam i kënaqur me ty, me atë që të mungon ty. Në do ta dish me hollësi e sinqeritet, mua kjo lloj... pavendosmërie që ke ti... ishte ajo që më joshi drejt teje. Ti je e brishtë, je..., ti je ajo që më duhesh mua, ajo që unë kam kërkuar në jetë. O, Elsa, ti kot bëhesh merak për ca gjëra kaq të vogla, për ca grimca jete a karakteri që, në fund të fundit, pedagogu s'ka të drejtë të të bëjë ty remont. »

ELSA — (*E hutuar, dyshon.*) Si është e mundur që ty të mos të pëlqejnë mendimet e pedagogut? Ai për të mirën time e ka, për personalitetin tim...

JAKUBINI — Mos më keqkupto, Elsë! Veç... si të të them.... ti tani je vajzë e rritur, je në prag të jetës, ti je ajo që je... Dhe unë jam i lumtur që ti je e tillë. Ja, për një javë ne fejohe mi. Do jemi një familje, do të bëjmë bashkë një jetë. Yt atë, apo dikush tjetër do të ndërhyjë që edhe unë të kthehem sërish në Tiranë. Ne do të kemi shtëpinë tonë, do të bëjmë jetën tonë, si duam ne. Përse duhet të ndryshosh? E çfarë duhet të ndryshosh ti në karakterin tënd?

ELSA — Po ja, pra! S'kam pavarësi, s'kam personalitetin tim. Këtë gjë e ndiejnë edhe shokët e shoqet e mia. Disa ma thonë tërthorazi, disa ma thonë se këto veti të karakterit tim pengojnë bile dhe punën tonë, premierën...

JAKUBINI — (*Humb durimin.*) Mirë, xhanëm, se s'po marr vesh asgjë, ti ke ardhur në këtë shkollë për t'u bërë aktore apo për t'u bërë tjetër njeri nga ç'ishe kur u fute? Ç'dreq shkolle është kjo e arteve? Ç'ka ajo me karakterin tënd, ë?

ELSA — (*E hutuar.*) Ato role që kam luajtur gjatë viteve të shkollës kanë zbuluar disa dobësi të miat si njeri, si karakter dhe...

- JAKUBINI — ...dhe tani po të përpunojnë përfundimisht, ë?
- ELSA — (*Nxehet.*) Pse flet kështu, Jaku? Ç'janë këto mendime?
- JAKUBINI — Çfarë mendimesh? Unë s'të thashë asgjë të keqe.
- ELSA — (*Hutohet.*) Mbase s'the, po ama shfaqe pakënaqësi ndaj asaj që kërkon pedagogu për formimin dhe përsosmërinë e njeriut. I quajte grimca pa rëndësi.
- JAKUBINI — O, Elsa, me ty e paskam të vështirë të flas.
- ELSA — Pse? Mos vallë bëj gabim që ngul këmbë të shpjegohem?
- JAKUBINI — Jo, jo! Pse? Përkundrazi, meqë një gjë të tillë e kërkon edhe shkolla.... (*Ironik.*)
- ELSA — (*E fyer.*) Ti gjithnjë qesh e luan me mua sikur unë të jem lodër për ty. Ç'jam, në për ty, ë?
- JAKUBINI — Elsa ime e vogël, me kobure! (*Zgjat dorën t'ia prekë armën që i varet në brez. Elsa fyhet e nuk e lejon.*)
- ELSA — Po ti pse erdhe? Ne e lamë që ti të më prisje në shtëpi. Mos të dërgoi mamaja?
- JAKUBINI — Aty isha duke të pritur, me prindërit e tu aq të mirë. Ra zilja e derës. Unë mendova se do të ishte ti. Jot ëmë tha: «Jo, nuk i bie kështu ziles ime bijë!»
- ELSA — Pse? Si i bikam ziles unë? (*E hutuar.*)
- JAKUBINI — Ku di unë. Jot ëmë tha se duhet të jetë dorë burri ajo që ka shtypur butonin e ziles.
- ELSA — Dhe kush qe?
- JAKUBINI — Një punëtor imi. Një teknik i mesëm. Jot ëmë kishte të drejtë. Xhezoja e ka dorën si putër ariu.
- ELSA — (*E gëzuar.*) Pastaj?
- JAKUBINI — Më mori me vete. Nuk e sheh që jam i veshur me rrobat e punës. (*Dalëngadalë shuhet ajo e folur si me të qeshur.*) Tani duhet të nisem

për në kantier. Erdha sa për t'u ndarë. Në vend që të ikja nesër, po iki që sonte, që tani.

ELSA — (*E habitur.*) Po... si ka mundësi që të vish tek unë për t'u ndarë, me një lajm të tillë dhe të bisedosh gjëra të tjera? Po më habit, Jakubin!

JAKUBINI — (*Mundohet të qeshë.*) E po... jeta kështu është, ka të papriturat e saj, s'është si në skenën tuaj që dihet çdo gjë.

ELSA — Lëre skenën. Më thuaj ç'ka ndodhur?

JAKUBINI — Nuk e di ç'të të them. Sot në mëngjes është bërë një mbledhje e hapur e organizatës. Më kishin ftuar dhe mua po unë isha këtu. Mbase s'ka dalë mirë derdhja e shtangës që kam marrë përsipër ta bëj bashkë me atë, Liri Rekën... mbase... nesje... kur të vi të shtunën do të të them me hollësi gjithçka.

ELSA — E shtuna është larg. Më telefono nesër. Mirë?

JAKUBINI — Mos ngul këmbë për nesër. Kam frikë se s'do të kem kohë. Pastaj pse të të shqetësoj? Të zgjidhet ai problem njëherë, pastaj të njoftoj.

ELSA — Ti ke dy javë që s'më flet më për Lirinë. (*Jakubini mezi e përmban veten.*) Po ti ç'ke? Pse u prishe në fytyrë sa të kujtova Lirinë?

JAKUBINI — Asgjë s'kam. (*Mezi e mbledh veten. Me ironi.*) Do të ishim më të qetë po të mos qe ajo vajzë, inxhinierja Liri Reka.

ELSA — E shikon, pra, që ti më fsheh shumë gjëra. Fol, Jakubin! Mos vallë ajo ka bërë ndonjë gabim të pandreqshëm? Pse s'flet? Është e pamundur që Xhezoja të mos të ketë thënë gjë. Fol, Jakubin, si është puna?

JAKUBINI — Nuk di ç'të them e si ta them. Prit! Kur të vij të shtunën do të t'i them të gjitha dhe unë jam i bindur që ti do të më kuptosh... do të më...

ELSA — Jo! Kështu nuk të lë të nisesh. Prit, dua të të shoh në sy! Pse m'i fsheh sytë?

JAKUBINI — Nuk të fsheh asgjë. (*Ndonëse mundohet arrin ta shikojë i qetë.*) Ja... ku i ke sytë e mi! (*Buzëqesh me ngrohtësi.*)

ELSA — (*Që hutohet*) Oh! Ti, Jakubin, mund të ishe bërë një aktor i shkëlqyer! Si ndryshove kaq bukuri? Megjithatë ti diçka më fsheh. Mos vallë ngatërresa atje s'ka të bëjë me çështje pune, ë?

JAKUBINI — Mos u shqetëso, Elsa! Ti je para premierës. Unë të dua ty. Ti je për mua gjithçka, ti je...

ELSA — (*Pak e hutuar*) Përse m'i thua këto. Ke disa javë që ngul këmbë të më bindësh se më do, që ngul këmbë të bëjmë celebrim. Përse? Mos vallë e kërcënon ndonjë rrezik dashurinë tonë? Jakubin, ti duhet të më thuash të vërtetën. Mos më fshih asgjë! Fol, pastaj ik!

JAKUBINI — Dëgjo, Elsa, këtu... (*Shikon përreth.*) Nuk është vendi... Kur të kthehem do të të them gjithçka. Dhe ty, dhe prindërve të tu. Mos krijoni asnjë dyshim për mua, për çdo gjë që mund të dëgjoni. Tani më duhet të nisem. Në rrugë më pret makina.

ELSA — (*E nervozuar*). Le të presë! Unë s'jam e qetë. More vesh ti, apo jo? Çfarë mund të dëgjoj më? Nga kush do të dëgjoj fjalë të cilat s'duhet t'i besoj? E shikon, pra, se ti më fsheh diçka se ti ke një arsye që ngutësh të quhesh i fejuar zyrtarisht? Mos vallë është e shpejtuar kjo fejesë? Mos vallë ne nuk jemi njohur aq sa...

JAKUBINI — Ç'flet, Elsa? Ti po dyshon edhe në dashurinë tënde?

ELSA — Jo! Në dashurinë time, jo, në tënden!

JAKUBINI — Si është e mundur, Elsa!

ELSA — Po pse atëherë u dashka të dëgjoj diçka nga dikush, e jo prej teje? Dhe të mos u besoj atyre? Nëse ne duhemi vërtet, s'duhet të trembemi për t'i thënë njëri-tjetrit edhe fjalë të hidhura.

JAKUBINI — (Ngurron, por e kalon lehtë pozitën e vështirë.) Kurrë!

ELSA — Si kurrë? Ç'do të thuash me këtë fjalë?

JAKUBINI — Kurrë s'do të dëgjosh fjalë të hidhura as nga unë, as nga të tjerët! S'do të kesh kurrë asnjë shqetësim nga unë. Ti do të jesh gjithmonë e lumtur me mua. A më do?

ELSA — (E hutuar) Po...

JAKUBINI — Edhe unë të dua. A nuk është dashuria garancia më e madhe për një jetë të lumtur? Ç'na mungon ne, Elsa? Ndaj të them, ndaj të lutem, mos u shqetëso për asgjë. Ki besim tek unë, Elsa! Unë mund ta them dhe tani atë që më shqetëson, por do të jetë më mirë kur të kthehem, kur të sheshojmë çdo gjë që është ngatërruar atje. (Shfrytëzon rastin që Elsa është e hutuar. E puth në faqe dhe ikën. Elsa vë dorën në faqe si për të mbuluar të puthurën e Jakubinit.)

ELSA — Jakubin! Prit! (E ndjek dhe del nga skena.)



## TABLOJA V

*(Pamje e tablosë së parë. Elsa është nervoze dhe e papërqendruar në studimin e saj. Donika, e ëma, që është duke rrahur ca vezë në një enë, vë re të bijën.)*

DONIKA — Mbaje veten, bijë! Mblidhe mendjen se i ke hipur së prapthi mushkës!

ELSA — Në atë mushkë më hipët ju!

DONIKA — Shiko, shiko! Pa dale një çikë! Pse moj, nuk ishe ti që e pëlqeve Jakubinin kur ta prezentuam? Ishte ime motër, ti, unë dhe ajo halla e tij. Si tani më kujtohet. Ai tha se të njihite dhe ti u skuqe. Aty na doli se ju njiheshit njëri me tjetrin.

ELSA — Ai më ishte qepur pas. Unë s'kisha asnjë mendim për të. Se si hyri ai në jetën time...

DONIKA — Hyri si hyri tani s'ka më llafë, more vesh? Ai është i fejuari yt. Të kujtohet, moj, se ç'the atë ditë kur u kthyem në shtëpi, pasi pimë kafet në pasticerinë «Flora». Mama, kjo është dita më e lumtur e jetës sime, s'do ta harroj gjersa të vdes. E, moj, s'të kujtohet?

ELSA — *(E hutuar)* Asgjë s'më kujtohet! Atë ditë mua më priste Monda. Atë ditë Andoni kishte marrë bileta për në teatër. E unë budallaçka s'vajta atje ku duhej të veja, po ku më çuat ju.

DONIKA — E po azat s'do të të linim, de. Ahu, sa shokë e shoqe ka në rrugë, në shkollë!

ELSA — Andoni nuk është shok rruge, mama.

DONIKA — E mirë, mirë, lëre atë Andon ziun! Ai djalë i mirë është, po jo për ty. Dhe bëre mirë që nise ta duash Jakubin. Mos thuaj se nuk u njohët? Po mbushen shtatë muaj, apo jo? U patë, shëtitet, hytë e dolët në shtëpitë e njëri-tjetrit. E gjithë Tirana ju di të fejuar. Tani të kujtosh Andonin? Jo, bijë, jo! Ne vërtet e zgjodhëm, u interesuam për biografinë e tij, për origjinën, po jo, të keqen nëna, të thuash se ta dhamë ne, se të paskemi hipur ne në atë mushkë.

ELSA — O, mama! Ti flet aq shumë sa të huton. Dhe unë s'di ç'të bëj. S'di si ta kuptoj atë dhe ty.

DONIKA — E ç'të kuptosh, moj! Nuk e paske kuptuar deri tani? Pse, moj, si u bë i keq ai, për një javë?

ELSA — Njeriu s'mund të fshehë vetveten tërë jetës. Ja, ardhka një çast dhe ai e shfaq fytyrën e tij të vërtetë.

DONIKA — Mblidh mendtë, vajzë, e mos na bëj më turp me botën. Yt atë është njeri i nderuar, jemi familje....

ELSA — E ç'rëndësi kanë këto gjëra kur unë.... unë s'jam e qetë.

DONIKA — E pse s'je e qetë ti, ë? Pse s'të tha arsyen që iku të dielën ashtu, aq papritur? Që s'të mori në telefon të hënën? Aman, sa teka-njoze je bërë, moj e shkretë! Mirë s'të mori as të martën, as të mërkurën, po të mori të enjten ama dhe të premtën. Edhe sot në mëngjes të mori prapë dhe biseduat një orë të tërë: çu, çu! Ç'të tha sot? Ç'të tha, moj? Ty, po të flas!

ELSA — Deklarata dashurie më tha, sikur të jem akoma gjimnaziste. Asnjë fjalë për mbledhjen e kolektivit që u bë të nesërmen e mbledhjes së organizatës së Partisë, e cila nuk na qenka bërë për shtangën, po për të. Nuk është çështje pune, mama, po çështje morale. Murmurit nëpër dhëmbë emrin e asaj inxhinieres, Lirisë, e pastaj nis nga avazi i tij që më dashka shumë, që tek

unë e paska mendjen ditë e natë, që babai duhet të ndërhyjë t'u telefonojë atyre e t'u thotë se qenka dhëndri i tij. E shikon se ku i doli koka muhabetit për të bërë celebrimin sa më parë?

DONIKA — (*E hutuar*) Çudi! Një gjë të tillë ma pat kërkuar dhe mua para një muaji.

ELSA — E shikon, pra!

DONIKA — (*E mbledh veten.*) Dale, moj, se më hutove. Ç'të keqe ka këtu? Edhe celebrimi, edhe transferimi i tij duhet të bëhen. Drejt ka menduar. U bënë shtatë muaj që bridhni bashkë, që hyni e dilni. Au, dhe unë s'di si t'u përgjigjem njerëzve në punë e në udhë! E fejove çupën, moj Donikë? Të trashëgohet! Po dhëndrin, moj, atje do ta lini, në Elbasan?...

Dhe me tët atë e pata biseduar këtë punë.

ELSA — E, ç'tha babi?

DONIKA — Babi? Si babi! Meazallah se i bie telefonit për punët e shtëpisë. Rri, aman, sikur s'e njeh tët atë! Sikur vetëm ai është parimor. E, të ishte yt atë ndryshe, s'do të kishim mbetur në këtë apartament. Ndërton burri i botës për tërë Shqipërinë, kurse për vete i pikon çatia.

ELSA — Mua më ndien zemra diçka të ligë, mama! Atë ditë që erdhi e u nda nga unë, në Institut, mua se si m'u duk ai... Sikur pashë tek ai një njeri të dytë. Edhe në telefon zëri i tij se si më duket, si zë tjetër. Dhe dashurinë e tij që ma shfaq me aq këmbëngulje se si më duket tani. Sikur kërkon të më mbushë mendjen se më do.

DONIKA — Që të do, të do! Dhe ti e do, apo jo?

ELSA — (*E pavendosur*) Po...

DONIKA — (*Nervoze*) Mbushe, moj, gojën, ç'është ajo «po» e ngordhur! Bijë, mos na bëj me turp se na janë thinjur flokët e qemë me nder një jetë të tërë.

ELSA — O, mama! Pse më flet kështu? Mos vallë për hir të thinjave tuaja unë...

DONIKA — Pu, pu! Ç'bën, moj? Mblidhe kallaballëkun se ke marrë kot! T'u thuash fjalë dashurie thonë pse m'i thoni. Të mos u thuash, thonë pse s'm'i thatë. Ç'bëni, moj, ë? Apo ka filluar të të pëlqejë mendja e Mondës.

ELSA — Ç'ke me Mondën ti! Ajo ka të drejtë. Ta dëgjosh atë do t'i japësh hak.

DONIKA — E ç'hak, moj, ditëzezë! Të ishte e zonja Mondë e kishte gjetur me vaht burrin. Jo ky s'më pëlqen se është egoist, ky tjetri menefregist, ky tjetri sportist. Ç'doni, moj? Vini gishtin kokës se po mbaruat fakultetin pa u martuar, pa burrë keni për të mbetur ose keni për të marrë arratinë! Kush do t'ju shikojë andej nga do shkoni, maleve, fushave, fshatrave, ë?

ELSA — (E hutuar) Ti, mama, je e çuditshme! S'më lë të mendoj vetë. Do patjetër të them ashtu si thua ti.

DONIKA — E po një më shumë se ti, di. Atë një më dëgjo! Dhe lëri këto cicërime! Hajt, meqë s'të mësohet, vishu dhe dil e prite te treni!

ELSA — (Shikon orën.) Tani është vonë. Treni duhet të ketë ardhur dhe kam frikë se s'piqem me të rrugës.

DONIKA — (E kënaqur) Kështu po! Tani fole si vajzë që e do atë me të cilin do të fejojesh. Hiç mos u sëkëlldis! Ke gjithë javën që përpëlitesh. Asgjë s'ka qenë ajo mbledhje. Punë kantieresh. I njoh unë kantieret, ehu! Ngatërrohen njerëzit për një fjalë goje. Ja, sa të vijë ke për t'u qetësuar.

ELSA — Jo, mama, jo! Ai është i tronditur. Ai më fsheh mua diçka të tmerrshme. E ndiej kur belbëzon në telefon.

DONIKA — E po ç'të bëj unë e shkreta se më plase! S'të shikoj dot në këtë gjendje.

(Dëgjohet fishkëllima e largët e trenit.)

DONIKA — Po ky tren tani?

ELSA — (Shikon orën.) Ky është treni i Shkodrës. Treni i Elbasanit ka dhjetë minuta që ka ardhur.

- (*Bie zilja e derës. Elsa trembet e nuk lëviz.*)  
 DONIKA — Ai do të jetë. Hapia derën. (*Elsa e drojtur mezi arrin te dera, zilja e së cilës bie nervoze.*)  
 Hape moj, derën! (*Hyn Monda e cila habitet kur shikon Elsen të qëndrojë ashtu.*)  
 MONDA — Po ti s'paskë dalë ta presësh te treni, Jakubinin?  
 DONIKA — Po ti për këtë pyetje paske ardhur?  
 MONDA — Jo, kot, më ra rruga këtej dhe u ktheva.  
 DONIKA — Si shpesh po të sjell rruga këtej këto ditë.  
 MONDA — Dikur më qortoje se vija rrallë e tani...  
 DONIKA — Po ç'jeni bërë kështu, moj, si ti, si kjo?  
 Shëndet t'ju thuash, plaç thoni! Moj, Monda!  
 Ç'i ke çuçuritur sime bije, ë?  
 MONDA — Përse e ke fjalën, teto Donika?  
 ELSA — Mama! Monda s'di gjë!  
 DONIKA — Ç'mama, moj! Mortje thuaj!  
 ELSA — Për kokën e babit që nuk i kam thënë asgjë.  
 DONIKA — (*Mezi e përmbledh veten.*) Ashtu? Epo me të vërtetë s'ke se ç't'i thuash! (*Mondës.*) Na fal, moj bijë! Po, ulu!  
 MONDA — Jo, s'po ulem se bëhen merak në shtëpi. Unë u ktheva se... Po, nejtse...  
 DONIKA — Ua, Monda, ç'është ky turp kështu, s'të shkon fare! Fol, moj, ç'do? Ti je si vajzë e shtëpisë.  
 MONDA — Po, atë trikon e re të Elses. E doja për model.  
 DONIKA — (*Me dyshim.*) Posi! Shko, Elsa, dhe sille! (*Elsa del e hyn me triko në dorë. Atë çast bie zilja e derës. Donika dhe Elsa sikur shtangin. Elsa e merr veten dhe lëviz drejt derës për ta hapur.*)  
 ELSA — Rri, se e hap unë! (*Sërisht bie zilja. Donika shikon të bijën.*)  
 MONDA — Po ju ç'keni kështu? Pse keni frikë nga dera? Ta hap unë? (*Elsa i jep trikon Mondës dhe hap derën. Hyn i ati, është, i shqetësuar. Sa*

- hyn heq kapelën republike dhe liron kravatën.)
- ELSA — O babi! Ç'ke, babi? Mos nuk je mirë?  
(I afrohet si zakonisht po ai nuk e puth.)
- AJDINI — (Sikur kujtohet. Ia puth faqen së bijës.)  
Mirë jam, mirë.
- DONIKA — Si është puna, o burrë? Ti je bërë si meit.  
Fol! Ç'ka ndodhur?
- AJDINI — (Vë re Mondën.) O, Monda! Si je, moj bijë?  
Grua, shtro tavolinën! Ç'më rri kështu?
- DONIKA — Po... sikur të presim dhe një çikë. Mbase  
vjen dhe ai...
- AJDINI — Pse, s'ka ardhur akoma ai nga Elbasani?
- DONIKA — Po... tani duhet të jetë duke ardhur. Kur  
ra zilja thashë se do të qe ai.
- MONDA — E po, më falni mua!
- AJDINI — Rri, Monda! Hamë drekë bashkë!
- MONDA — Jo, shoku Ajdin! Nuk i kam lajmëruar në  
shtëpi dhe bëhen merak. Ktheva sa për të marrë  
trikon. Bile ndenja shumë. Mirupafshim! (Ajdini  
përcjell Mondën dhe mbyll derën.)
- AJDINI — (Së shoqes.) Ç'më rri si e ngrirë? Shtro bukën!
- DONIKA — Dhe ti ç'e ke këtë uri sot? Ja, zëre se ka  
ardhur Jakubini. Çdo të shtunë e kemi pritur.
- AJDINI — S'kemi për ta pritur më. As derën s'kam për  
t'ia hapur më. S'na duhet neve një njeri si ai.
- DONIKA — Çfarë flet, o burrë! E kemi të fejuarin e  
çupës. Të gjithë e dinë për dhëndër të kësaj shtë-  
pie... Po më luani mendsh sot, si ti, si kjo, si ajo  
Monda. Shyqyr që iku. Na erdhi për trikon! Thoni  
të paktën ç'ka ndodhur!  
Ta vëmë në kandar e ta peshojmë, kush rëndon  
më shumë: faji i tij, apo turpi ynë.
- AJDINI — S'jam farmacist...
- DONIKA — Dale, dale, mos merr yrysh! Na fol me  
qetësi! Ç'ka bërë?
- AJDINI — (I shqetësuar) E ç'të të them, oj grua! Mos  
pandeh se unë e pata të lehtë kur mësova se  
ai nuk na qenka njeri i mirë.

- DONIKA — E si na u bë i keq ky djalë për një javë? Ata që iu vunë kësaj punë e njihnin për njeri të mirë, ne po pyetëm poshtë e lart, e pamë, shtatë muaj e njohëm në dhe kjo.
- AJDINI — Po ja që s'e paskemi njohur. Atje në kantier i doli boja. Karrierist, interesaxhi që ecën në jetë me kalem në dorë, egoist... Ç'të them tjetër?
- DONIKA — Të gjitha, ç'di e ç'ke dëgjuar.
- AJDINI — Dhe imoral...
- DONIKA — I paskan bërë gjyq kështu? E kush paska genë ky gjyqtar?
- AJDINI — Kolektivi.
- DONIKA — Mos na lodh e mos na mundo më, na thuaj shkoqur, ç'ka ndodhur?
- AJDINI — Ka mashtruar një vajzë, atë inxhinieren, Liri Rekën, me të cilën punonin bashkë për shtangën. Ka shfrytëzuar naivitetin e saj, çiltërsinë e saj, besimin e saj. Kur janë trashur marrëdhëniet e kur ajo ka kërkuar që të fejohen, atëherë është shfaqur si dhëndri ynë, na ka dalë si i fejuar me çupën tonë. A e kupton tani përse ai ka dy tri javë që ngutet të bëjë celebrimin? A e di ti se ai, kur ishte në rrezik të qarkullonte, doli gjoja vullnetar për në bazë e se tani ka bërë lutje që të kthehet se ne gjoja s'rrokemi dot pa çupën tonë. Flet në emrin tonë, moj! Kjo është për të vënë duart në kokë. Përse ia ka fshehur asaj e të tjerëve çupën tonë e tani më del me të si mburojë?
- DONIKA — Si është e mundur?... Mos ka ndonjë hile këtu, ndonjë kurth? Ehu, ç'nuk bën vaki! Mund të mos jetë kështu si thua ti, mund të mos jetë fajtor, mund të jetë diçka e rastit. Si të them dhe unë e shkreta! Ç'është kjo hata kështu? Mbase....
- AJDINI — Ç'mbase, moj! Hajt, shtro drekën!
- DONIKA — Ç'drekë, mor ditëzi! Prit njëherë se nuk i thonë shaka! Të presim, mbase është duke ardhur.
- AJDINI — Unë s'dua ta shoh me sy, ti thua prit të

hash bukë me të. S'janë shakara ato që të thashë. Janë të vërteta. Erdhën nga kantieri e m'i thanë një për një. Bile ka gënjer, ka thënë se është i celebruar. Shyqyr që nuk u ngutëm e si bëmë formalitetet se pastaj do të kishim të bënim dhe me gjyqe.

DONIKA — Njëlloj është. Njerëzit do të na marrin në pyetje më shumë se në gjyq. E ku ka gjyq më të madh se t'u përgjigjesh njerëzve se si e qysh ndodhi, se si e qysh është faji, se si e qysh na u nda çupa. A mendon ti një çikë për nderin e çupës. E di ti që kjo e do, që ka një javë që vuan, që nuk i ka punët mirë as në shkollë më atë rolin që luan? E ke pyetur ti si i ka punët? A e ke pyetur se si do ta zgjidhë këtë hall që i ra në kokë? E do apo s'e do Jakubinin? Je interesuar xhanëm për fëmijën tënde?

AJDINI — Oj, grua! Mos kërce degë më degë! Kjo që thua ti është punë tjetër. E pranoj që kam faj ndaj sime bije, që s'jam interesuar për të aq sa je interesuar ti... Megjithëse dhe ai interesimi yt...

DONIKA — Do të ma lësh mua fajin tani?

AJDINI — S'ka rëndësi se kush është fajtor, ti, apo unë! E gjejmë më vonë se kujt i takon faji. Tani kemi hall tjetër, grua. Ai na doli maskara. E unë me një njeri të tillë nuk e lidh çupën.

DONIKA — Çupa është e lidhur.

AJDINI — Çupën e lidhëm ne, jot motër, ti e unë qorri që nuk shikoja, që isha verbuar pas stur-dimeve të tij shkencore, që e futa në shtëpi, që e ndihmova. Dhe ti kaq deshe, sa pe që unë e çmova si inxhinier s'le gur pa lëvizur derisa e ndave këtë nga ai, Andoni.

DONIKA — Pse më flet kështu, Ajdin! Në qoftë se unë kam ndërhyrë në jetën e saj, këtë e kam bërë për atë, për të mirën e saj që është dhe e mira jonë.

AJDINI — Varet se si e kupton ti të mirën. S'mund



të ndërhysh në jetën e tjetrit, qoftë dhe të pjellës sate, aq sa t'i imponohesh pa të drejtë. Ti ke ndërhyrë në çdo hap të jetës së saj, bile ke ngulur këmbë që të shkonte e jotja. Kjo s'është e mirë, nuk është e drejtë.

DONIKA — Ndërsa tani ngul këmbë ti që të shkojë e jotja. Ja ku e ke, merru vesh me të.

AJDINI — E si mund të merrem unë me të kur ti ke tërë jetën që i je imponuar asaj? Nuk e shikon që edhe tani, që ajo e mori vesh të vërtetën, po hesht si gur varri? A e kupton, moj grua, se ç'do të thotë kjo? Se çfarë fëmije kemi përgatitur për jetën, ë? Po kjo është e tmerrshme. (Heshtje.) Fol, moj bijë! Fol vetë atë që mendon, ato që ndien! (Heshtje.) Tani po e kuptoj që të kam ndenjtur larg, që je rritur në sytë e mi po që nuk kam ditur se si po rritesh, si po formohesh. Ja, si ardhka çasti e prindi e ndieka veten ligisht! Fol, bijë, ashtu si e mendon ti! Dhe, në gabofsh një herë, koha do të të mësojë që të mos gabosh për së dyti, sepse vetëm atëherë do të ndiesh përgjegjësinë tënde. Fol, bijë, fol me gojën tënde, me fjalët e tua!

ELSA — O, baba! (Qan e mbështetet në gjoksin e tij)

DONIKA — Mos e torturo vajzën! Nuk e kupton që ajo e do?

AJDINI — Lëre, moj vajzën, të vendosë vetë!

DONIKA — E si mund të vendosë kjo kundër vetvetes. kundër dëshirës së saj, kundër dashurisë së saj?

AJDINI — Njeriu i fortë është ai që gjykon vetveten.

ELSA — E ç'faj kam bërë që të gjykoj vetveten, baba? Se e dashurova? Se m'u duk i mirë, i zoti, i ndershëm, i pashëm? Ato cilësi vutë re ju, ato cilësi vura re dhe unë!

AJDINI — Edhe pa bërë faj njeriu mund të gabojë. Gabon ngaqë është formuar keq, ose e kanë formuar keq, ose ngaqë s'ka qenë aq i pjekur që të vendosë drejt. Janë këto gabime të vogla në jetë që formojnë një karakter të dobët, të lëkundur.

Njeriu duhet t'i bëjë ballë çdo të keqeje, të vogël apo të madhe.

DONIKA — Aman si flet dhe ti!

AJDINI — E si të flas? Mos po flas keq?

DONIKA — Në këtë histori jemi dhe ne të dy fajtorë!

Ne e nxitëm këtë njohje, ne na pëlqente ai djalë.

Ti na the gjithë ato fjalë të mira: i zoti, i talentuar! A nuk kemi faj që e lamë aq gjatë në

Elbasan? Ta kishe transferuar, të kishe ndërhyrë që atëherë kur të thashë s'do të kishte ndodhur

asgjë nga këto që ndodhën. Dhe ne do të ishim të qetë e të lumtur. Ç'i mbetet tani kësaj, nami

që u nda nga i fejuari?

AJDINI — Po pse, moj grua, të bën përshtypje pasoja e jo shkak? Si, moj, s'të bën përshtypje karakteri i tij, horllëku i tij.

DONIKA — Sepse më dhimbset ime bijë.

AJDINI — Atëherë për hir të opinionit kjo duhet të vuajë tërë jetën, të mbajë plagën të mbyllur e të helmatisë gjakun.

DONIKA — Ti i zmadhon gjërat.

AJDINI — Kurse ti i fsheh fare, bile je gati t'i vesh dhe lustër plagës, t'ia mbulosh turpin atij. E si është e mundur ta falësh atë që një javë dashurion çupën tonë, një javë çupën e atij tjetrit? Këtu uth këtë, atje lë me barrë një tjetër.

DONIKA — A, a, a! Punë barre qenka! Tani e mora vesh. Do t'i jetë vardisur ajo kuçka! E ka gatuar ajo këtë çorbë. E, huu, sa dinë dynjaja! Ta varin kopilin në qafë e të thonë mbaje se më ra. (Heshtje) Kjo punë do shkoqitur mirë.

AJDINI — (I lodhur) Dakord! Nëse ti dhe kjo pranoni, po bie dhe unë dakord me ty e me këtë që hesht si gur varri. Veç ama të dyja ta dini mirë, se ajo vajzë nuk është ashtu si the ti e as nuk nakatos çorbë. Ajo është një vajzë e rrallë për të cilën kanë respekt të gjithë ata që e njohin. Po të qe ashtu si thua ti, kuçkë, s'kishte për të ardhur

drejtori i kantierit deri tek unë për këtë çështje, i ngarkuar nga organizata bazë.

DONIKA — Domethënë ata po përpiqen që t'i bashkojnë ata të dy ë? Ju lumtë! E shikon se ç'bëre ti më indiferentizmin tënd, që të vinte zor t'i thoshe një fjalë ministrit për ta kthyer në Tiranë? Pra, ata të metalurgjisë kanë të drejtë të interesohen për fatin e Liri Rekës, kurse ne s'kemi të drejtë të interesohemi për fatin e çupës sonë. Ne, le t'u themi atyre: merreni dhëndrin tonë!

AJDINI — Nuk është ashtu. Ata nuk na e marrin ne Jakubin që t'ia japin asaj. Ajo nuk pranoi që Jakubini të bëhet burri i saj. Ata e përzunë, e transferuan në një objekt të largët, si punëtor të thjeshtë, të thyejë gurë në guroren e Lëtanit. Dhe erdhën më njoftuan mua, më treguan se kush është ai njeri me dy fytyra, që kjo, ti dhe unë, ta peshojmë mirë punën, ta gjykojmë me gjakftohtësi karakterin e tij, cilësitë e tij negative që s'janë të denja për shoqërinë tonë. *(Elsa që ka shtangur si e ngrirë, lëviz e dërrmuar. Del.)*

DONIKA — Si është, e mundur! Si është, e mundur që të ketë njerëz të tillë! Si do t'ia bëjmë, burrë? Si do të vejë halli i çupës sonë?

AJDINI — Unë nuk kam vajzë të tepert që t'ia jap një njeriu si ai. As të tepër, as të lënë.

DONIKA — *(E dëshpëruar.)* Për e lënë, e lënë na u bë vajza. Mjerë ajo e mjerë e ne bashkë me të! Ishim me të gjitha të mirat. Ah, o burrë, ç'na gjeti!

AJDINI — Shpëtuam nga një maskara, grua! Ja, kjo na gjeti! Dhe më mirë sot se nesër, kur të ishin të martuar, apo më fëmijë.... *(Bie zilja. Ajdini dhe Donika kthejnë kryet. Nuk kuptojnë në është zilja e derës apo e telefonit. Bie përsëri zilja e derës.)*

AJDINI — Hë, qenka dera! Ai do të jetë. Si është e mundur që të ketë kaq guxim?! *(Matet të dalë po e shoqja e pengon.)*

DONIKA — Derisa ka kaq kurajo, diçka ka për të thënë. Le ta dëgjojmë. (*Ajdini nervozohet. Ulet. ndonëse nuk e pi duhanin, mer nga kutia e cigareve për miqtë dhe mezi e ndez, me duart që i dridhen. Në këtë kohë Donika hap derën. Hyn Jakubini, i cili me një vështrim e nuhat gjendjen. Ngurron. Gjen forca dhe hyn e qëndron përballë Ajdinit, i cili e ka të vështirë ta shohë.*)

JAKUBINI — Tungjatjeta! (*Nuk merr asnjë përgjigje.*)

DONIKA — (*E shqetësuar s'di ç'të bëjë. Merr kutinë e cigareve dhe ia zgjat Jakubinit. Dora e Jakubinit dridhet lehtë.*) Im shoq na i tha të gjitha. Unë, si nënë, dua të di se sa të vërteta janë, jo për të lehtësuar gabimin tënd, sesa për të qetësuar veten time dhe time bijë.

(*Jakubini hutohet. Mezi e mbledh veten.*)

AJDINI — Ime shoqe ju pyet. Po presim përgjigjen tuaj, megjithëse mendjen e kemi ndarë.

JAKUBINI — Atëherë s'më mbetet gjë tjetër veç t'u kërkoj ndjesë për shqetësimet që ju kam sjellë. E shoh që guximi im ju habit, por besomëni se më ka shtyrë vetëm dashuria që kam për Elsën dhe pendimi. Atje, në kantier, më dhanë një dënim të rëndë, një mësim të hidhur por të nevojshëm për mua. Dhe tani jam gati të marr dënimin e dytë. Dënimin tuaj. (*Hyn Elsa. Asnjë nuk e vë re. Ajdini mbledh buzët me neveri.*)

Mos më përbuzni, shoku Ajdin! Nëse do të më falni, këtë mos e bëni për mua, por për hir të vajzës suaj. Ju betohem që e dua. E dua siç më do dhe ajo. Jam gati të them gjithçka, si ndodhi, si rashë në atë gabim.... Si?... Mos folët gjë?... Më falni, m'u bë sikur folët!... (*Pastron zërin dhe fshin ballin.*) Unë erdha të rrëfhem. Erdha t'ju them të vërtetën. Unë... jam penduar. Ju betohem se gjithçka ndodhi pa vetëdije, ndodhi.... S'dua të justifikohem. Unë...

AJDINI — E ç'do ti atëherë?

JAKUBINI (*S'di ç'të bëjë. Shikon Ajdinin, pastaj Elsën, në fund Donikën.*) Ti je nënë. Ti je më afër vajzës. Ti duhet të më falësh e para. Elsën e dua. Gjithnjë e kam dashur.

DONIKA — Si është e mundur?!

JAKUBINI — Pyeteni. Fol, Elsa! Fjalëve të mia tani u ka humbur besimi. Ti, Elsa, më njeh. Më njeh më mirë se kushdo. Ti ke qenë e lumtur me mua. Ti ke ndier dashurinë time. Elsa, përmendu dhe fol!

ELSA — Përse të flas, për çfarë të flas?

JAKUBINI — Si për çfarë? Për dashurinë tonë, për dashurinë tënde!

ELSA — Për cilën dashuri... për atë të cilën ti e shkele?

JAKUBINI — Jo, Elsa!

ELSA — Baba! (*Thërret sikur kërkon ndihmë.*)

AJDINI — Derisa jot ëmë e pranoi në shtëpi e po flet me të fol dhe ti! Fol! Edhe unë dua të të dëgjoj. Të gjithë duam të të dëgjojmë.

ELSA — Mama!

DONIKA — Mamazeza! Ishim të lumtur. Kush ish si ne?...

JAKUBINI — Atë kohë do ta kthejmë prapë, dhe prapë kjo familje do të jetë e lumtur.

AJDINI — Po jo me ty. Lumturinë nuk e mbron dot një tip si ti, as e ndërton dot, ti veç mund ta shkatërrosh atë. Familja e vërtetë, familja e shëndoshë është baza e shoqërisë sonë e ajo duhet të dijë të operojë plagët e saj, nëse do që të jetë e palëkundshme.

JAKUBINI — Elsa! As ti s'ke besim tek unë? Pse s'flet, Elsa?

DONIKA — Po fol, të keqen! Fol një fjalë!

ELSA — Ik! Ik!... Nuk mundem të të shoh më!...

AJDINI — (*Ngrihet dhe hap derën.*) E po...

JAKUBINI — (*Shikon derën, Ajdinin, Donikën dhe Elsën, pastaj prapë Ajdinin.*) Si, po më përzeni?! S'po pranoni as të shfaqësohem, as të shpjego-hem... as të...

AJDINI — Jashtë! Jashtë! Dhe kaq sa bëmë, bëmë shumë. (Ngre dorën ta qëllojë.)

DONIKA — Mos, Ajdin! (Ajdin! mezi e përmban veten.)

JAKUBINI — (Duke dalë së prapthi) Elsa, megjithatë unë kam besim se ti do të më falësh. Ti duhet të më falësh, Elsa! Dhe ju mos harroni se kjo është e fejuar me mua. Shtatë muaj!

AJDINI — Jashtë! (I mbyll derën. Vë shpinën pas saj dhe merr frymë lirisht.)

DONIKA — Ç'na ndodhi kështu, burrë!

AJDINI — Shpëtuam nga një maskara!

## TABLOJA VI

(*Është po ajo pamje e skenës së parë. Të gjithë janë veshur si kosovarë. Ka midis tyre të veshur si oficerë të krajlit të Serbisë e si ushtarë. Në skenë ka pengesa të ndryshme që shërbejnë për orën e mësimit të plastikës skenike. Pedagogu, Shkëlzen Lami, i veshur me tuta, jep e merr me gjithë studentët e kursit. Disa i ka vënë të stër-viten me shpatë, dy bëjnë mundje të lirë, e disa ushtrime të tjera. Në këtë orë të lirë e gazmore pedagogu është i përqëndruar te Elmazi dhe Andoni me të cilët është duke zhvilluar mënyrën e ecjes së një komiti.)*

SHKËLZENI — Dëgjo, Andon! Mbase vetë emri «komit» të bën që të ecësh pak me frikë se mos të përgjojnë, se mos thyen ndonjë shkarpë në pyll... Ja, kështu, Andon! Komitet e çetës së Azem Galicës janë në truallin e tyre, janë zot e tmerr për push-tuesit. Hë, pra, jepe këtë hollësi psikologjike në ecjen e tyre. Fjalën «komit» kuptoje si luftëtar, si trim në vendin e vet. E qartë?

ANDONI — Po, profesor! E qartë!

SHKËLZENI — Vazhdoni pra e korrigjoni njëri-tjetrin. (*Pedagogu i afrohet majës së shkëmbit ku ka hi-pur Saliu dhe nis ta këshillojë atë duke bërë disa lëvizje me duar si të rrëzohet që andej që të mos dëmtohet.*)

ELMAZI — Po ti ç'ke sot?

ANDONI — Hiç! S'jam në formë.

ELMAZI — Lëri ato! Ku e ke mendjen? Ke një orë të tërë mësimi që nuk përqëndrohesh.

- ANDONI — *(I zënë ngushtë)* Elmaz, do të të them diçka, por mos e bëj fjalë, mirë?
- ELMAZI — Ahu, dhe ti, pse të ka dalë ndonjë fjalë nga unë? Si është puna?
- ANDONI — Më duket se Elsa po ndahet nga Jakubini.
- ELMAZI — Kështu e kanë fejesat me shkuesi.
- ANDONI — S'qe punë shkuesie ajo. Elsa u rrëmbye pas tij ose më mirë të them e shtynë drejt tij.
- ELMAZI — Shkuesi e kamufluar me dashuri.
- ANDONI — Mos fol kot!
- ELMAZI — E u, dhe ti, të mos të vijë keq, po u tregove qull, s'ia the që s'ia the se e dashuroje.
- ANDONI — E si t'ia thosha kur shikoja se si i shkëlqenin sytë kur na dilte ai përpara?
- ELMAZI — Po tani ç'pret, pse s'ia thua të vërtetën?
- ANDONI — Tani? Kurrë! Do më duket se kam pritur këtë ditë. Jam gati të bëj gjithçka për të, po kurrë s'kam për t'ia thënë atë që ndiej.
- ELMAZI — Ters të qëlloi dhe ty.
- ANDONI — Më vjen keq për të.
- SHKËLZENI — *(Që ka mbaruar së instruktuari Saliun, kthen kokën dhe qorton Andonin.)* S'ju lashë vetëm që t'ia nisni muhabetit! *(Kthehet nga Saliu.)* E, Sali, gati?
- SALIU — Që kaq lart s'jam hedhur ndonjëherë, profesor.
- SHKËLZENI — Mos do dhe një dyshek tjetër?
- THEOFANI — Mbase do dhe çarçaf.
- SALIU — Pusho ti, myzeqar! Më mirë shko e na sill një krah kashtë.
- SHKËLZENI — Lëri shakatë, Sali! Gati? Hë ti, Sanie, gati?
- SANIA — *(Me revole në dorë.)* Në lule të ballit e kam shënuar që të shpëtojme nga thumbat e tij.
- SALIU — Aman, Sanie! Do të të jap një petull po më le të gjallë.
- SHKËLZENI — Qëllo, Sanie, ç'pret? *(Kërcet revolveri e Saliu nuk lëviz.)*



- SHKËLZENI — Hë, mo Sali, pse s'u rrëzove?
- SALIU — Sikur kam frikë, profesor.
- SHKËLZENI — Mirë, zbrit! Për sot katër.
- SALIU — Jo, jo! Një vërejtje e kam ngrënë nga profesor Jovani, një katër nga ju dhe hajt të mërrësh në pyetje nga katedra.
- SHKËLZENI — Lëri shakatë! Do vritesh apo të vë katër?
- SALIU — Më mirë po vritem. Hajde, Sanie, qëllo ku të duash!
- SHKËLZENI — Gati? *(Bie zilja e orës së mësimimit.)*
- SALIU — Shpëtova më duket.
- SHKËLZENI — *(E qorton.)* Sali! *(Të gjithë, meqë ra zilja e pushimit, afrohen për të parë. Saliu mbushet me frymë dhe pret «plumbin» duke pozuar në mënyrë pompozë e qesharake.)*
- SALIU — Meqë kështu është shkruar në tekst të dramaturgut, le të vdes. Meqë kështu dëshiron dhe regjisori, le të vdes. Meqë kështu do dhe Dylqinja ime, le të... *(Sania qëllon. Saliu shembet që nga maja e shkëmbit dhe bie në dyshek si i vdekur.)*
- SHKËLZENI — Shpëtova nga katra!
- SALIU — Shpëtova nga katra, po më duket se theva këmbën. *(Mezi ngrihet dhe ecën duke çaluar në mënyrë qesharake.)*
- SHKËLZENI — Shejtan!  
*(Shkëlzeni merr regjistrin e del. Këtë kohë bie sërish zilja dhe hyn Jovan Shelcani, i cili mezi e duron rrëmujën e orës së mësimimit plastik.)*
- JOVANI — Shpejt! Vini rregull! Hiqni këto dysheke e jorganë! Improvizoni skenën e pyllit! *(Studentët lëvizin dhe e bëjnë gati.)* Hajde, Elmaz, zër vëndin tënd! Andon, Sanie, përqendrohuni! *(Sania dhe Andoni çoh pëshpërisin.)* Po ju, ç'keni? Do fillojmë sot nga puna apo jo? Figurantët gati!
- NJË FIGURANT — S'ka ardhur akoma Elsa, profesor!  
*(Hyn Elsa. Duket që është e shqetësuar.)*
- ELSA — Më falni për vonesën, profesor, unë... si t'ju them.... dje.... *(Ul kokën gati me lot në sy.)*

JOVANI — *(Psherëtin.)* Shko, vajzë, shko vishu dhe tjetër herë mos u vono! *(Me inat)*  
*(Elsa del nga skena.)*

SANIA — *(Ngurron.)* Profesor... ajo...

JOVANI — Çfarë ka? Çfarë ka ndodhur? Dhe mua s'm'u duk mirë.

SHPRESA — Hë, pra, fol! *(Andoni shikon nga Elmazi, i cili ul kokën.)*

JOVANI — S'duhet të jeni mospërfillës ndaj njëri-tjetrit. Halli nuk mbahet vetëm. Dhe ti, Andon, nuk je i qetë. Aktori ka nevojë për qetësi shpirtërore.

ANDONI — *(Ngurron.)* S'mund ta them, profesor. S'më takon mua ta them. Di që ajo nuk i ka punët mirë...

*(Heshtje. Hyn Elsa e veshur si Shotë duke ecur e kontraktuar. Jovani e shikon me vëmendje.)*

JOVANI — A je në gjendje të kalojmë në provë?

ELSA — Po, profesor!

JOVANI — Shumë mirë! Atëherë përqendrohu! Do kalojmë skenën e pyllit. Do të theksojmë një diçka të rëndësishme, që na bëri vërejtje katedra. Do të nxjerrësh në pah vlerat e Azemit si luftëtar. Pra, ai të dhimbset ty, jo vetëm se është yt shoq, po se është udhëheqës. *(Elsa s'është e përqëndruar.)* Çfarë ke? Ti s'më dukesh e qetë. Në qoftë se ke gjë, na e thuaj!

ELSA — Jo, profesor, mirë jam.

JOVANI — Atëherë përmbli dhe veten! Këtu jemi në skenë, ja ku e ke publikun! Ai do të shikojë Shotën, dramën e saj, shqetësimet e saj, jo...

ELSA — Po, profesor, e kuptoj. *(Elsa ka ndryshuar gjendjen e saj. Pedagogu e kap këtë moment dhe ngutet.)*

JOVANI — *(Përplas duart.)* Gati! Zini vendet! Hë, të shkretën, një e diel ka kaluar. Për një ditë u shturët kështu? Muzika gati? Fillo!

*(Dëgjohet muzikë e rëndë, e dhimbshme por optimiste. Skena sikur elektrizohet nga përqendrimi i studentëve që hyjnë në rolet e tyre.)*

Fillo, Elsa! Ec drejt tët shoqi! Ashtu! Më e shqetësuar, më e gjallë, më e vendosur. Mendo se po iku ai në takimin që e kanë thirrur, kanë për ta vrarë. Është kurth. Imagjino një gardh, një pùshkë e fshehur, një sinjal, një shami, osë një degë peme që do lëvizë dhe krisma. Një plumb hasmi që do të ta rrëmbejë udhëheqësin e çetës së komitëve. Ec e vendosur dhe vlerësoje Azemin si udhëheqës! Ashtu... Fillo!

ELSA — Azem! Mos shko! Si po u zë besë atyre?! Është kurth, Azem!

ELMAZI — Ne duhet të fitojmë kohë, Shotë! Jemi të rrethuar. Një minutë kushton shtrenjtë për ju që keni mbetur. Pse të mos u them dy tri fjalë dhe me këtë (tregon pushkën) e me gojë? Do të di ta zgjas kuvendin dhe ju që keni mbetur do të çani rrethimin, do të lidheni me shokë të rinj e do të ngrini çeta të reja. Sikur një pushkë e vetmë të mbetet prej nesh e të krisë e lirë në male, do të zgjojë me dhjetëra e qindra të tjera e unë do të ngjalle më sërish. S'të gënjej dot, Shotë. E di që po shkoj drejt vdekjes, por s'kam ç'të bëj, vdekja ime do t'ju japë kohë që juve...

ELSA — Po gabon rëndë, Azem. Vetëm emri yt i tmerron ata. S'po të lutem si gruaja jote, të lutem për Drenicën tonë, për Kosovën që është mësuar me pushkën tënde, Azem!

JOVANI — (I pakënaqur.) Jo, jo kështu! Mos e thjeshtëzo! Mos i hidh ujë të ftohtë skenës! Vlerëso Drenicën, Kosovën martire që është mësuar me pushkën e Azemit. Ta thashë që duhet të vlerësosh më shumë Azemin si luftëtar. Ç'ke sot, ë? Përse erdhe vonë?

ELSA — (Hutohet.) Si?

SANIA — (I pëshpërit Andonit.) Po ky ç'pati? Tani u kujtua ta pyesë për vonesën?

SIMONI — Profesori ka të drejtë.

JOVANI — (U ndërpret pëshpëritjet me një të përplasur serioze të duarve duke i parë shtrembër.) Pardje

e arrite disi figurën e Shotës që i dhimbset burri! Pate një ditë të tërë pushim për ta fiksuar në shtëpi atë që arrite këtu, kurse tani, që duhet të punojmë më tej për ta ngritur Shotën si heroinë, ti na i sjell më dobët. Ç'bëre dje gjithë ditën? Punove apo shëtite? (Elsa ul kokën. *Është gati të qajë.*)

SALIU — Filloi prapë nga avazi, prite kur të qajë tani.

JOVANI — Pusho ti, karagjoz! Në vend që të shqetësohesh, zbardh dhëmbët. Hë, more flisni, ç'më rrini ashtu?

ANDONI — Fol, Elsa! Ti duhet të flasësh. Ne jemi shokët e tu. Ne na vjen keq për ty.

ELSA — (*E shikon me inat.*) Ç'doni të dini prej meje, ë? Si i kam punët me të? Ç'punë keni ju me jetën time?

ELMAZI — Mos u rrëmbe, Elsa! Sigurisht që ne s'kemi punë me jetën tënde intime, por ama, kur jeta jote bëhet shkak apo pengesë për punën tënde, për punën tonë të përbashkët, si të të them, s'duhet të shqetësohemi ne për ty?

ELSA — (*E hutuar*) Mos doni të më bëni gjyq?!

SANIA — Si the, moj, gjyq?! Pse gjyq e quan ti interesimin e shokëve? Ç'janë këto mendime, Elsa!

ELSA — Nuk i jap llogari kurrkujt për jetën time, për ndjenjat e mia.

JOVANI — Sigurisht, por kur këto ndjenja intime bëhen pengesë për punën, shokët e shoqet e tua dhe unë, mësuesi yt, kemi të drejtë të pyesim, apo jo? Ne na ka ngecur puna në një pikë kulminante. Nuk po na e jep me forcën e duhur figurën e Shotës. Ti në vetvete ke mundësi dhe talent ta japësh atë... Çfarë ke?... Na e hap zemrën, ndoshta të ndihmojmë, të ndihmojmë ty dhe punën tonë.

SANIA — Dhe unë, nëse kam folur ndonjëherë për rolin tënd, këtë nuk e kam bërë nga zilia, por ngaqë më dhimbset shfaqja, puna jonë.

ELSA — Pse të ndodhë kështu me mua, pse të bëhem unë shkak?

ANDONI — Sepse nuk je e qetë, Elsa, sepse u rrëmbeve, sepse, si të them....

ELSA — Mos, Andon! Të paktën ti mos fol!

ANDONI — Jo, Elsa, unë duhet të flas, bile kam bërë gabim që kam heshtur. Ti duhet ta mposhtësh dhimbjen që të shkaktoi ai. Ti duhet të bëhesh e fortë për të ecur në jetë, se jeta është më e madhe e më e vështirë se një spektakël.

ELSA — Nuk mundem, nuk mund ta luaj Shotën.

JOVANI — Përkundrazi! Unë them, se mund ta luash, bile shumë mirë, sepse ti më shumë nga shoqet e tua ke nevojë për cilësitë e saj heroike. Aktori i jep vërtet shpirtin e tij personazhit që luan, por ama merr nga ai atë që është thelbësore, moralin, për vete dhe për publikun.

ELMAZI — Elsa, mos e humb besimin në veten tënde.

ELSA — Të lutem, nuk dua moral! (*Kthehet me rrëmbim nga pedagogu*). Të lutem fillojmë, profesor?

JOVANI — (*Që kap vendosmërinë e saj*) Posi, fillojmë! Hajde, zini secili vendet! (*Studentët nguten derisa zënë vendet. Elsa zien përbrenda.*) Ashtu, Elsa! Ec drejt Azemit dhe vepro e pavarur prej urdhrit të tij. Jo, i thuaj burrit tënd! Ngul këmbë e trego personalitetin tënd. Vepro e pavarur, sepse ke bindjet e tuaj, ke personalitetin tënd!

ELSA — (*Psherëtin.*) ....Ndjenjat e mia... bindjet e mia, personaliteti im... (*Të gjitha shihen sy më sy. Pritet ngadalë mizanskena sikur të gjithë dalin nga rolet, veç Azemit, drejt të cilit ecën ngadalë Elsa. Duke ecur ajo e merr veten, gjen siguri. Fillon muzika. Është si e hutuar. Jovani tërhiqet i habitur. Asnjë s'ka hyrë në rol, veç Elsës*). (*Që i është afruar Elmazit.*) Azem! Mos shko! Si po u zë besë atyre? Është kurth, Azem!

ELMAZI — (*Që ka marrë veten.*) Na duhet të fitojmë kohë, Shotë. Jemi të rrethuar. Një minutë kushton shtrenjtë për ju që keni mbetur. Pse të mos u

them dy tri fjalë dhe me këtë (tregon pushkën) e me gojë. Do të di ta zgjas kuvendin dhe ju që keni mbetur do të çani rrethimin, do të lidheni me shokë të rinj e do të ngrini çeta të reja. Sikur një pushkë e vetme të mbetet prej nesh e të krisi e lirë në male do të zgjojë me dhjetëra e qindra pushkë të tjera e unë do të ngjalle më sërisht.

S'të gënjej dot, Shotë! E di që po shkoj drejt vdekjes, por s'kam ç'të bëj: Vdekja ime do t'ju japë kohë juve...

ELSA — Po gabon rëndë, Azem. Vetëm emri yt i tmeron ata. S'po të lutem si gruaja jote, por si luftëtare. Të lutem për Drenicën tonë, për Kosovën, që është mësuar me pushkën tënde, Azem! Sa herë e kanë shpallur gazetat e Beogradit vdekjen tënde? Sa herë të kanë bërë të vdekur ty? Nuk kupton ti pse e duan ata vdekjen tënde? Ata, duke të vrarë ty, duan të vrasin legjendat, këngët, që thur populli për ty, duan të vrasin dëshirën për liri e pavarësi të kësaj toke, të njerëzve që vijnë pas. Nuk të lë, Azem!

ELMAZI — Mos e korit veten tënde, oj Shotë! Për burrin vdekja nga plumbi është si të lind për së dyti.

ELSA — Ani, le të koritem. Unë s'të lë. Ti i duhesh gjallë Drenicës, i duhesh Kosovës. S'po të lutem si grua, po të flas si shoqe lufte.

ANDONI — Shota ka të drejtë... Ti s'mund të vritesh për ne, Azem?

ELMAZI — Po ju pse vriteni për mua?

ELSA — Ne vritemi për liri, Azem! Ne s'vritemi për vete, po për Kosovën. Jeta jote...

ELMAZI — Pusho dhe largohu!

ELSA — Jo!

ELMAZI — Grua!... (Me kërcënim e me habi.)

ELSA — S'jam grua. Nuk e sheh?! Një ndryshim kemi: që ti ke jelekun të kuq e unë të zi. Ti e ke ble këtë copë në pazar të Mitrovicës e unë e kam qëndisë me këto dy duar kur isha grua. Isha ulur

pranë frëngjisë së kullës. Dielli u fik e ti më erdhe me kandil në dorë e mbushe me dritë dhomën. Më kishte mbetur dhe kjo kopsë pa qëndisur. (I zbrërthen dhe mundohet t'ia heqë Azemit që i vjen turp nga fjalët e veprimet e gruas.)

ELMAZI — Ç'të ka shkrepur në kokë?

ELSA — Asgjë e keqe. Më jep jelekun tënd, Azem! E dua!

SANIA — Moj, Shotë, mos, moj trime, mos ia ndill të keqen burrit!

ELSA — Nuk e kam për të keqen e burrit. E dua për të mirën e tij, për të mirën e Kosovës.

ELMAZI — Si? Si the?

ELSA — E dua për vete. Jelekun po të kërkoj. A të dhimbset, a? Me këto duar e kam qëndisur për ty e tani e dua për vete. Dua ta vesh e të shoh si më rri. Meqë dikush prej nesh duhet të niset për të shpëtuar shokët po nisem unë, veshur me jelekun tënd. Ata ta njohin mirë jelekun e kuq. Le ta mbajnë pushkën tinzare në të. Le të shtien mbi të, le të kujtojnë se të kanë vra ty. Do të qeshë tërë Kosova me ta kur ta marrë vesh se kanë vra në vend të Azemit një grua. Dhe unë e vdekur do të qesh me ta.

ELMAZI — Shotë, ti ke luajtur mendsh! Hiq duart! (I shpëton nga duart. Sa matet të largohet, ajo ia kap pushkën. Të dy tërheqin secili në krahun e tij pushkën.)

ELSA — As unë nuk të lë të ikësh!

JOVANI — (I kënaqur ndërhyr.) Kjo është! Qe në funksion dhe fjala dhe veprimi. Pushim! Dhjetë minuta pushim! (Të gjithë çlirohen, e përqafojnë Elsën e nisën të dalin nga skena. Elsa ka mbetur si e hutuar.)

SANIA — (E puth në faqe.) Më fal, Elsë, për ato që të thashë! Na dhë një Shotë trime. Hajde se do të të qeras!

SALIU — Me siguri me ndonjë petull.

ELSA — Nuk më hahet asgjë.

SANIA — Një arançatë atëherë. Nga ato me shgegë.

ELSA — Jo, nuk dua! Mos m'u zemëro, Sanie!

THEOFANI — Ma jep mua arançatën e Elsës. Ti e di që unë nuk i refuzoj kurrë qerasjet, sidomos të vajzave. Se ç'kanë një shije të veçantë.

SANIA — Ik, ore, koprac! Hajde, Elsa! Po të pres te klubi. *(Të gjithë dalin. Mbeten Elsa dhe Andoni.)*

ELSA — *(E shikon gjatë Andonin, si për herë të parë. Andoni heq plisin. Ai, bashkë me shqetësimin për të, sikur ka dhe njëfarë kënaqësie që po shikohet ashtu nga Elsa.)* Andon!

ANDONI — S'ka lehtësi më të madhe sesa kur peshën që të rëndon e ndan me një tjetër.

ELSA — Pas premierës do të të them shumë gjëra.

ANDONI — Jo, Elsa! Ti duhet të flasësh tani. S'mund të luash në skenë pa qenë plotësisht e qetë. Unë s'dua të përfitoj nga miqësia jonë, as nga rasti, apo nga fatkeqësia që të ndodhi me të. Unë gjithmonë kam besuar se ti ke talent, ke forcë. Sa mirë e dhe Shotën! Unë e prisja nga ty këtë shpërthim. *(Elsa nuk e përmban dot veten. Qan.)* Mbaje veten, Elsa!

ELSA — E pabesueshme! O çfarë zhgënjimi! Ai, që do të bëhej i fejuari im, burri im i ardhshëm, me të cilin kisha nisur të lidhesha shpirtërisht, që më kishte joshur vërtet.... më ka fyer rëndë, më ka shkelur në shpirt. O, nuk e di si qëndroj në këmbë! Nuk di se si arrita ta luaj Shotën!

ANDONI — Sepse more nga ajo forcën e saj dhe i dhe asaj shpirtin tënd, revoltën tënde. Ti gjete forca e u ngrite mbi veten tënde. Kjo do të të japë më shumë forca dhe ti nesër, ke për ta çuar më tej figurën e Shotës.

ELSA — Mos fol, Andon! Sa frikë kam! S'dua gjë tjetër veç të dalë mirë premiera.

ANDONI — Ti ke dy premiera, Elsa! Për të parën ti dhe sot një provë të mirë dhe për të dytën unë kam besim se ti do të dish t'i bësh ballë. Hajde, dalim, se na presin shokët! Dhe mua më pihet një cigare.



## TABLOJA VII

(Një rrugë e gjerë, para korpusit të universitetit. Një vend biçikletash. Rruga është e ndriçuar nga neonet. Është mbrëmje e bukur. Ka pak kalimtarë. Kalon një çift. Në skenë hyn Saliu, dhe Theofani. Saliu mban një biçikletë të ngarkuar me disa reklama të premierës. Theofani shtyn nga pas biçikletën dhe njëkohësisht mban reklamën që të mos bien.)

**SALIU** — E, o Theofan vëlla, bir i fushave të Myzeqesë, si ikën kështu vitet e shkollës! Më kujtohet dita e parë kur u fute ti në klasë me ato rrobat e tua prej doku, ngjyrë kafe dhe i pjekur nga dielli si një kalli gruri.

**THEOFANI** — Aman dhe ti ç'mban mend! Le që ju estradaxhinjtë kështu e keni.

**SALIU** — Për shpirt të nënës, nuk tallem! Të betohet vëllai! Jam shumë i emocionuar, aq sa këtë punë hamallëku po e bëj me kënaqësinë që bëjnë poetët vargje. Pse s'është poezi sonte gjithë kjo natë e mbushur me dritë dhe ëndrra për të ardhmen tonë? Shiko, more, se si je bërë, shik! Kam frikë se s'do të të njohin kur të kthehesh në Gradishtë, aktor i diplomuar në Institutin Dramatik për drama të vendit dhe klasike...

**THEOFANI** — Lëri shakatë, o Sali! Mbage timonin drejt e jepu këmbëve se do të bredhim gjithë Tiranën sonte për të varur reklamën!

SALIU — Mos, mos shtyj ashtu si buall se s'jemi në kënetë këtu!

THEOFANI — Ama ç'më the tani!

SALIU — Domethënë, ç'të thashë pak më parë, të paska pëlqyer, ë?

THEOFANI — Po! Në ato fjalë kishte vërtet poezi. (Ngre një reklamë, ku duket portreti i Shotës të interpretuar prej Elsës.) Ja dhe Elsa jonë e brishtë, që lëkundej si ato degët e kallamish-tes buzë kënetës! E shikon Elsën. Shotë? Si na rriti kështu kjo shkollë! ë (Shikon rreth e qark, i hutuar.) Këtu është qendra e ëndrrave që hap hapësirat e shkencës e të artit. (Për reklamën) Ku ta vemë? (Theofani ka humbur pas telajos. Saliu e lidh me të shpejtë litarin dhe fshihet me gjithë biçikletë. Theofani del nga telajoja e shikon i hutuar.) Ku iku ky drej, ore palaço! S'janë shakara këto. Ç'më le si hu gardhi këtu! Dil se do të ti përshesh turinjtë! (Saliu del i trembur.)

SALIU — Nuk u fsheha gjëkund. Kërkova një gur për të mbërthyer reklamën. Na, merre dhe mbërtheje. Këtu nesër në mëngjes do të mbushet me studentë.

THEOFANI — (Duke punuar) Ja dhe kjo punë mbaroi! (Zbret dhe të dy shohin reklamën. Theofani e lexon me zë.) «Premierë. Elsa dhe Shota. Interpretojnë studentët e kursit të fundit të Institutit të Lartë të Arteve. (Theofani është i emocionuar. Rregullon jakën e kostumit, kravatën dhe matet të lexojë prapë.)

SALIU — (E tërheq.) Mjaft, Theofan!

THEOFANI — E di si më duket? Si e pabesueshme. Si erdhi kjo ditë! (Saliu e tërheq prapë.)

SALI — Kemi gjithë ato reklama për të ngjitur nëpër Tiranë. Nisemi, Theofan, se tani dalin dhe shokët! Le të kënaqen dhe ata.

(Dalin. Në skenë hyn Jakubini që, si duket, ka dëgjuar fjalët e tyre. Shikon reklamën, Shikon se mos vjen ndokush, pastaj tërhiqet pak mënjanë,

— Në hije. Në skenë hyn Elsa, Andoni, Sania dhe Monda.)

ANDONI — E paskan vënë reklamën. Shiko, Elsa! Veç mos të të rritet mendja!

ELSA — Mua po më dridhen këmbët, ti thua të më rritet mendja. Aman, Andon, ç'flet!

MONDA — Pse akoma s'ke besim në rolin që ke nxjerrë? Gjithë shokët e katedrës fjalë të mira thanë.

ANDONI — E kanë zënë ethet e premierës.

ELSA — Pse, ti je fare i qetë?

ANDONI — Për besë, s'di ç'të them! Sa pashë reklamën, se si më bëri zemra...

ELSA — Edhe mua. Më duket sikur do më kërcejë zemra jashtë gjoksit. *(Ia merr dorën dhe matet t'ia verë në kraharorin e saj. Andoni mezi ia jep. Sapo ajo ia afron te gjoksi, ai e tërheq dhe ia rrëmben asaj dorën dhe e vë në gjoksin e tij.)*

ANDONI — Më mirë vëre ti dorën në gjoksin tim! Dhe mua ashtu si ty më rreh.

SANIA — Aman dhe ju me këto zemrat tuaja si ata kalamajtë që lëpijnë akulloret e njëri-tjetrit!

MONDA — *(Qesh me të madhe.)* Aman, Sanie, ç'ia gje-te! *(Sania rregullon me gishtërinj flokët e bëhet serioze. Dikë ka parë që po afrohet.)* Po ti ç'pate kështu? *(Sania i bën shenjë atij që e pret.)* Shiko, shiko, nënë Lezia, paske filluar dhe ti nga dashuria, ë?

SANIA — Epo, sëmundje ngjitëse është, na i ngjiti Elsa.

MONDA — Jo, moj, jo! Po të qe sëmundje ngjitëse dashuria do të isha sëmurrur unë e para se unë rri ditë e natë me këtë.

SANIA — Ëhë! Ty s'të zë...

ANDONI — Vërtet, Monda, ti se si je...

MONDA — Si jam, e mo fol, si jam? Mos të dukem si mashkull?

SANIA — Ika unë. Mirupafshim! *(Ikën.)*

MONDA — Çudi është dashuria. Sikur të jep krah! *(Hyn Jakubini.)*

JAKUBINI — Me leje? Më falni!...

ELSA — (*Trembet.*) O, nga dole ti?

JAKUBINI — Unë kam tre ditë që të ndjek.

ELSA — E di! Të kam vënë re. Më je bërë si hije.

JAKUBINI — Dhe ke bërë sikur s'më ke parë? Elsa, ti s'mund të më harrosh mua. Ti s'mund të harrosh dashurinë tonë. (*Elsa hutohet. Jakubini i drejtohet Andonit dhe Mondës.*) E di që bashkë jeni shokë të ngushtë. Ju e kuptoni. Unë kam aq të drejtë sa të qëndroj me të vetëm për vetëm. Kam shumë gjëra për të thënë dhe jam i bindur që do të më falë. Elsa, besomë! Çdo gjë ngjau si në një ëndërr e keqe, Ju lutem, më lini vetëm! Në fund të fundit kjo është e fejuara ime. Të gjithë e dinë këtë gjë. (*Andoni ngurron. Është gati të largohet, po Monda e zë për dore.*)

ELSA — Mos më lini vetëm me këtë njeri!

JAKUBINI — (*Andonit dhe Mondës.*) Dy minuta! Besoj që për aq kohë unë do t'i them të gjitha, pastaj le të më gjykojë.

ELSA — Unë s'kam se ç'të gjykoj. Në shtëpi....

JAKUBINI — Në shtëpi më gjykoi vetëm yt atë.

MONDA — More shok, ti qenke i çuditshëm! Nuk e kupton se kjo s'do të të shohë me sy e jo më të bisedojë?

JAKUBINI — Sepse s'më ka dëgjuar, sepse s'më ka dhënë mundësi që të rrëfehëm, që t'i shpjegoj gjithçka. (*I drejtohet Elsës.*) Elsa, pse s'më beson më? Pse flasin të tjerët për ty? Në shtëpi yt atë, këtu kjo.... E shikon, pra, se unë kam të drejtë, se po të më dëgjosh dhe një herë, ti do të më falësh, do të më kuptosh, unë pranoj gjithçka, veç...

MONDA — Po he, moj, se na plase, fol të shkretën!  
(*Elsa mezi e përmbledh veten.*)

ELSA — Në shtëpi munda të të them që nuk të fal dot. Tani, meqë kërkon me këmbëngulje të dëgjosh patjetër fjalën time, po të them se të urrej!  
(*Jakubini është larguar dalëngadalë. Elsa tani e vë re dhe çuditet.*) Si? Paska ikur! O, më duket

se pashë një ëndërr të ligë! Si, shpëtova vërtet nga ajo hije!..

ANDONI — Hijet janë të çudifshme, Elsa. Kam vënë re se po të trembesh, të ikësh, hija të ndjek nga pas, kurse po të ecësh me guxim, përpara, hija ikën, largohet. Nuk e ke vënë re?! Qyteti do të jetë mbushur me reklamat e premierës sonë. Kam qejf të shoh si mblidhen njerëzit rreth tyre!  
(Të tre ecin drejt rrugës së gjerë me drita.)  
(Bie perdja.)

VESTAT:

BRAT & AUSTRIAT

LIRI BERKA  
 LİMİ BERKA  
 NIGAR BERKA  
 LİVİE BERKA  
 İAKUBİ ZANA  
 FERİDİN İMAMİ  
 ŞİUAN İMİ  
 ANA HİSA  
 İBİLA  
 İPİOLA  
 İTİO SORİKA  
 Dr. Mustafa İsmail

# Në jetë

**VETAT:**

- LIRI REKA
- AGIM REKA
- MAGAN REKA
- YLVIE REKA
- JAKUBIN SARA
- SELAUDIN IMAMI
- SINAN VILANI
- XHA. HYSA
- SELA
- SPIROJA
- TETO SOFIKA
- Dy punëtorë figurantë
- inxhiniere, përgjegjëse montimi në furrnaltë
  - brigadier, montator, vëllai i Lirisë
  - i ati, pensionist
  - e shoqja e Maganit, shtëpiake
  - inxhinier, përgjegjës reparti në uzinën mekanike të kombinatit.
  - drejtor kantieri në furrnaltë
  - sekretar i Komitetit të Partisë i kombinatit
  - montator, sekretar Partie i organizatës bazë të furrnaltës.
  - saldator
  - drejtor i uzinës mekanike
  - pastruese e mensës

## TABLOJA E PARË

(Mjedisi i shtëpisë së Magan Rekës. Një derë të çon në dhomën e gjumit, një hapësirë që lidhet me korridorin ku duket dera e banjës dhe dera e shkallëve. Dhoma, si tip kuzhine e sallon, është e mobiluar thjesht po bukur.)

Është natë vonë. Ylvia është e shqetësuar. Magani ka ndërprerë leximin e revistës «Ylli». Ora e murit bie ting-tang, ting-tang.)

YLVIA — Ngrehu, o burrë! Si të lexohet, xhanëm! Ngrehu kërko fëmijët se po vete mesi i natës.

MAGANI — S'janë më fëmijë që t'i kërkoj rrugëve, mblidh mendjen e rri e qetë, o grua! (Bie zilja e derës.)

YLVIA — (Ndryshon përnjëherësh. Qesh.) Erdhën! (Sulet të hapë derën. Hyn Agimi i veshur me rroba doku.) Po tët motër ku e ke, o bir?

AGIMI — Nuk e di. E kërkova gjithandej, në punë, në zyrat e drejtorisë, në klub, në turizëm... Mbase do të jetë me atë, Jakubin.

YLVIA — E ç'është ky Jakubin? Se ku ma ka zënë veshi emrin e tij.

MAGANI — Ai inxhinieri i uzinës mekanike, moj grua, ai që punoi shtangën me tët bijë, që e mori dhe gazeta.

YLVIA — Ç'gazetë, more ditëzi, unë jam në merak për çupën, ti thua gazeta. Mjaft lexove se do të të pri-



- shen sytë. Hajt, ngrehu dhe dil njëherë për tët bijë.
- MAGANI — Ja, moj, ku e ke bandillin. E paska kërkuar dhe lokaleve. Duket që është merakosur për të motrën se i ardhka erë mejhane.
- AGIMI — Pse flet ashtu, baba? Të betohem që e kër-kova gjithandej. Sa për mejhane, ato mos i zër në gojë se qëkur i mbylle ti, atëherë kur ishe anëtar i komisionit të tatimeve, nuk janë hapur më.
- MAGANI — E more, se pa gjë s'mbetët. Taverna, luli-shte, restorante plot keni, bile moderne!
- YLVIA — Ama dhe ju majë më majë, si dy gjela, mea-zallah se i hapni udhë njëri-tjetrit. Dil, të keqen nëna! E shoh që je edhe ti i lodhur, po bëj si të bësh... dil, pastaj lahu!
- AGIMI — Po s'di se ku ta kërkoj, moj nënë. Mbase janë duke festuar të dy suksesin e shtangës, mbase... Ou, mama! Më jep ndërresat se dua të lahem!
- YLVIA — Ç'është kështu me ju!... Mbi komo i ke. Nuk i shikon? (*Agimi merr ndërresat e futet në derën që të çon në banjë, kurse Magani nis të lexojë.*)
- AGIMI — (*Që brenda*) Po sapuni ku qenka?
- YLVIA — Hapi sytë se aty e ke... Të gjitha gjërat nga dora ime i doni, për asgjë s'e çani kokën. Plas, po deshë. Njëri lahet, tjetri lexon, kurse ajo s'dihet se nga brendh. Epo ky fat kështu me ne! Si s'po troket kush në derë e të na e kërkojë. Ç'kanë këta djemtë e sotëm që nuk i duan gratë me përgjegjësira, ë? Mos bëre gabim që e le të bëhej përgjegjëse e mon-timit të furnaltës? Ja, dhjetë sahati i natës dhe ajo kushedi se ku është! Në mbledhje, a në kontroll, a...
- MAGANI — Epo kanë ndryshuar kohërat, moj Ylvie. S'është më si atëherë, kur të vinte zor të shikoje një burrë në sy. Si delet venit në fabrikën e rime-sos, tufë, gjithë turp.
- YLVIA — Mirë, o burrë, mirë, po gruaja është grua, ania! Dhe burri kur kthehet nga puna, do që ta gjejë gruan pranë vatrës. Jo burri në shtëpi ta shohë sahatin që vajti dhjetë e gruaja në punë, majë furn-naltës, të shamatohet me burrat e botës, me vëllanë

- dhe me atë Selën. E di ti se ishte zënë prapë me të?
- MAGANI — Prapë?!
- YLVIA — *(Pohon me kokë.)* Prapë, posi!
- MAGANI — Nuk e ka mirë që zihet me shokët.
- YLVIA — As me shokët, as me njeri. Është femër, që m'os qoftë! *(Ylvia afrohet dhe më pas të shoqit e matet të flasë, po ai ia pret.)*
- MAGANI — Ç'do moj, pse u ngjeshe kështu?
- YLVIA — *(E kënaqur)* Hiç, o burrë, muhabet po bëjmë!
- MAGANI — Shtyu, moj tutje, sikur s'ka vend ku të rrih!
- YLVIA — Eh pleqëri, pleqëri, as frymën s'ta duron më burri!
- MAGANI — Oh, grua, a do më lësh të lexoj rehat?
- (Bie zilja. Ylvia kërcen si pupël. Duke dalë flet.)*
- YLVIA — Erdhi që ju bëftë nëna, erdhi! *(Hyn Liria e veshur edhe ajo me rroba pune, një palë pantallona bluxhins, një golf dhe një xhaketë të trashë. Është e gëzuar. Në dorë ka dy libra të mëdhenj e ca letra në formë ruli. Puth të ëmën.)*
- MAGANI — Nga humbe kështu sonte, moj bijë? Jot ëmë u bë merak.
- LIRIA — Në bibliotekën e institutit isha. Shiko! *(Tregon librat.)* Sot erdhën nga Suedia. Janë ato që pata porositur nëpërmjet Bibliotekës Kombëtare. I pamë bashkarisht për çështjen e detaleve.
- AGIMI — Me Jakubinjin?
- (Hyn Agimi duke fshirë kokën me peshqir.)*
- LIRIA — Ai iku herët. Unë ndenja që të përgatitesha. Nesër do të punoj gjithë ditën me të. Për drekë s'do të vi dot, as pasnesër. Dhe për darkë, po u vonova, mos u bëni merak.
- YLVIA — Pasnesër mos u vono, të keqen nëna, se është e diel! Hajde të mblidhemi e të hamë një darkë bashkë! Ç'është kjo kështu?
- AGIMI — Mirë, moj nënë, dakord.
- YLVIA — Po ti, moj, ç'ke? Pse m'i fsheh sytë? E paske ndarë mendjen të vish vonë, ë? Pse s'i thua nënës, ç'hall ke?
- LIRIA — S'kam më asnjë hall. Shtanga u bë.

- MAGANI — Epo për shtangën të mblidhemi atëherë.
- LIRIA — Unë...
- AGIMI — Mbase i ka dhënë fjalën atij që të hanë bashkë, në turizmin e ri.
- YLVIA — Ç'flet, mor bir? Me kë do haka ajo kështu?
- AGIMI — (Me ironi) Ehu, sa dreka e darka kanë ngrënë bashkë ata.
- YLVIA — Daleni more, ç'është kështu?
- LIRIA — U bënë kaq kohë që punoj me të, mama dhe nuk e kam ftuar një herë në shtëpi, se si më vjen.
- MAGANI — Epo ftoje për pasnesër mbrëma.
- YLVIA — Dale, more burrë, kë të ftojë? Përse ta ftojë, ç'është ai?!
- LIRIA — Jakubini, moj nënë, inxhinieri i uzinës mekaniqe që punoi me mua për shtangën. Ai na ka ndihmuar në furnaltë. Për disa ditë i japim fund montimeve. Ai...
- YLVIA — Dale, moj bijë! Ç'do të thotë bota kur t'ju shohin që të vini këtu? Mos pandehin se... Jo, të keqen nëna! Mos na bëj me fjalë kot së koti.
- LIRIA — Po s'ka ndonjë gjë të keqe, moj mama!
- YLVIA — Si the, moj? S'paska asgjë të keqe të vijë burri i botës për darkë?
- MAGANI — Epo një shok pune po fton. Shtanga u doli me sukses. E dëgjove radion ti? Gjithë Shqipëria e mori vesh, se bija jonë dhe ai arritën të bëjnë me forcat e tyre një detal aq të rëndësishëm e të vështirë si shtanga.
- YLVIA — E dëgjova, si s'e dëgjove! Aq ngritur e mban radion ti, e ka dëgjuar gjithë mëhalla.
- MAGANI — Ej, kokë! Mblidhe veten e krenohu! Bijtë tanë, moj, po çajnë bllokadën, i mori radioja, prit tani t'i marrë dhe televizori. Kur e mbaroni furnaltën, ë?
- LIRIA — (Si e zënë ngushtë) Po... si të them... Nëse do të na ndihmojë Jakubini, siç më ndihmoi për shtangën, besoj se për tre-katër javë i japim fund montimit.
- MAGANI — (Si i ekzaltuar) Dhe Shqipëria do të ketë

furnnaltën e saj, kombinatin e saj metalurgjik. E, moj grua, a të kujtohet punishtja e sapunit, kur punonim si argatë të Dumrelasit, ë?

YLVIA — *(Si e hutuar)* Ç'punishte, mor ditëzi!...

MAGANI — Punishtja e sapunit, moj! Ajo ka qenë industria e Elbasanit, ajo dhe fabrika e vajit. E, more bir, ti i stampoje, vije vulën e vëllezërve Dumrela. Ja, aty në fund të kuzhinës ishte furra. Këtu ishin kallëpet e sapunit që mbushje ti. *(Së shoqes)* E moj, s'të kujtohet?

LIRIA — Aman dhe ti, baba, çfarë kujton!

MAGANI — Po, është historia ime. Është jeta ime. Dhe ju që po bëni metalurgjikun jeni fëmijët e mi.

YLVIA — Ii! Iku ky! Degë më degë, doli majë ullishtes. *(Ylvia, e cila qysh më parë, kur fliste i shoqi, pati marrë teshat e së bijës, ia jep asaj.)* Na, të keqen! Shko lahu se t'u ftoh uji fare! *(Të dyja dalin. Në skenë mbeten atë e bir. Agimi duket si i pakënaqur.)*

MAGANI — Ç'ke, o bir! Mos vallë s'bëra mirë që pranova atë për darkë?

AGIMI — *(Zihet ngushtë e mezi e përmban veten.)* Si të them? Ata të dy... I gjithë kombinati flet... Asaj i ka marrë koka erë!...

MAGANI — Dhe ti ke heshtur në shtëpi për një çështje kaq të rëndësishme! Ç'njeri është ai?

AGIMI — Ç'njeri është? I zoti është, qen i punës!

MAGANI — Përse flet me inat për të?

AGIMI — Sepse... Të them të vërtetën, nuk e di se ç'njeri është. Ai... s'duhej të kishte pritur ftesë për të ardhur këtu te ne, në shtëpi, qoftë për drekë, për darkë, a për të pirë, fjala vjen, një kafe. *(Hyn Ylvija, e cila shikon se atë e bir janë mbërthyer me sy.)*

YLVIA — Po ju ç'keni?

AGIMI — Hiç, kot.

YLVIA — Epo kot s'rri njeriu i mbërthyer sy më sy. Flisni, mua s'më gënjeni dot, as ju, as e ajo. Go-

- cën nuk e kemi mirë, o burrë. Ajo se ç'do të ketë me atë inxhinierin që s'ia them dot emrin.
- MAGANI — Epo, ta shohim, oj grua, megjithëse ky mbledh supet. Ku di dhe unë i shkreti ç'të të them?
- YLVIA — O, more qyq! Veç s'di gjë, thua ti!... Shikoni këtu. Kini kujdes vajzën, se ta dini, na bëri ndonjë turp, mua do të më pushojë zemra. (*Heshtje*) Pse pranove të vijë ai për darkë, ë? Apo je liberal? Kështu të thoshin edhe në punë. Nuk i shikoje dashuricat që bëheshin?...
- MAGANI — Unë isha drejtor i kombinatit të drurit e jo xhandar... Pastaj... Ç'të keqe kishte?... Njihe-shin, duheshin dhe martoheshin.
- YLVIA — Po kishte dhe prej atyre që s'u martuan..
- MAGANI — E po.. (*Magani mbledh supet.*)
- YLVIA — E po, e po!... (*Përqesh të shoqin.*) Po unë s'dua t'i ndodhë asgjë e keqe çupës. Se ç'kam këtu si viani. Është çupë, që mos qoftë!
- MAGANI — Ta hajë dreqi, ta hajë! Dhe mua ç'm'u desh që thashë të vijë për darkë! Kurrë, moj, mos ardhhtë!
- AGIMI — O bobobo! Filluat ju avazin tani! (*Hyn Liria e veshur me rrobe nate, me kokën të lidhur. Agimi bën shenjë që të shohë sherrin që plasi.*)
- LIRIA — Qetësohu, mama! Qetësohu, të lutem, se s'të bën mirë për zemrën dhe mos u bëj merak për mua! Unë di se ç'bëj. (*I drejtohet të vëllait.*) Dhe për rojë nuk kam nevojë, as për hafijet që më vë pas, more vesh? I thuaj, atij Selës se...
- AGIMI — (*Justifikohet.*) S'kam ç'ti them! Sela e ka zakon që i ruan vajzat e furnnaltës.
- LIRIA — Unë nuk jam vajza e furnnaltës, jam inxhinierë e furnnaltës, unë përgjigjem për montimin e saj, dhe për ty, dhe për atë, Selën. Dhe, dëgjo këtu, e pashë edhe një herë që të më vijë si hije pas...
- AGIMI — Au! Me ty nuk flitet! (*Del. Pas tij del dhe Magani. Ylvia i afrohet së bijës.*)
- YLVIA — Mos u nxeh me tët vëlla, të pastë nëna! Për

të mirën tënde e ka që të ruan: Ne për të mirën tënde shqetësohemi. Vajza do gjithnjë kujdes. (E përkëdhel, Liria qetësohet dhe ulet para pasqyrës, lëshon flokët e nis të bëjë tualet. Fërkon fytyrën me një krem, pastaj nis e krihet. Ylvia duke u marrë me punë, shikon vjedhurazi të bijën që përkëdhelet e zbukurohet në pasqyrë.)

YLVIA — (Me vete) Pse kështu, moj xhan, ë? Pse s'i bërë dhe ti këto punë ashtu siç bëjnë tërë dynjaja? Mirë, ta zemë se e do, e po themi «shyqyr» se dhe mosha po të ikën, po ku janë prindërit e tij, apo kushërinjtë? Pse s'vijjnë, pse s'trokasin në derë? Pastaj të vemi dhe ne, unë, yt atë, yt vëlla, pastaj të pimë kafet e vogla, të presim fjalën, pastaj le të vijë për darkë e për drekë sa herë të dojë. Jo, të keqen nëna jo kështu, se kështu mbetesh me turp! Ja s'ia vumë dot unazën kësaj njohjeje, ç'të mbetet ty, ë? Nami që u lidhe me të e ai të la! E kush të merr ty pastaj? Se, si i thonë, vajza është si qelqi. A po s'je shushkë ti për këto punë. Të ishe si shoqet, do të ishe bërë me fëmijë tani e s'do të hipje e të zbrisje majë furrnaltës. Si ta pres atë kur s'di se ç'është ai... «E kam shok...» Jo, jo! S'bëhen këto punë kështu! Le të ndryshojnë kohërat si të duan, ne jemi njerëz, kemi namuz. (Liria lëviz. Ylvia trembet.)

LIRIA — Mama, si dukem me këta flokë kështu?

YLVIA — (S'di ç'të thotë se mendjen e ka gjetkë.) Aman të keqen, ç'janë këto që bën? Thuam, të keqen, si është puna, vetëm shok e ke?

LIRIA — Po të kam thënë, moj mama, e kam më shumë se shok.

YLVIA — E do?

LIRIA — Po, e dua!

YLVIA — Si the, moj, e do?

LIRIA — (Mbledh supet.) E...

YLVIA — Si moj, e? Po pse, moj, tani i thuhet nënës? Ç'jemi ne për ty, ë? Njerëz të huaj? Ndaj ishin mbërthyer sy më sy yt vëlla e yt atë? Jo, të keqen

- nëna! Vajza s'bën dot pa këshillën e nënës, të babait, të vëllait. Ke shyqyr plot njerëz. Tët vëlla e ke krah, e ke shok, Vetëm dhe mund të gabosh. Po ai ç'thotë, ë?
- LIRIA — Kush?
- YLVIA — Si kush, moj? Ai pra, që ti e dashke. Ai të do apo... E, moj, fol!
- LIRIA — (*Mbledh supet.*) Besoj se edhe ai më do.
- YLVIA — Si beson? Ç'është kjo fjalë, besoj. S'kanë besë e fe këto punë, bijë. Nëse duheni, hajt t'i vëmë kapak kësaj pune, që edhe unë të flë e qetë.
- LIRIA — Po ti fli e qetë, moj mama! Sa herë të kam thënë se unë jam zonjë e vetvetes.
- YLVIA — Jo, të keqen, jo! (*Heshtje*) Zonjë e vetvetes! As e lidhur as e zgjidhur. E si mund të jesh zonja e vetvetes kështu. Jo të keqen, jo.
- LIRIA — E po mirë, zëre se jam lidhur, po shpirtërisht ama.
- YLVIA — Lëre shpirtin, moj bijë! Shpirti as duket as kapet, as lidhet e as del dot.
- LIRIA — E po çdo gjë ka kohën e vet, mama. Si thua ti, të fejothem nesër?
- YLVIA — Që në mëngjes, bile, oj kjo!
- LIRIA — Dale, moj nënë, se nuk bëhen kështu këto punë! Në fillim duhet të lindë miqësia, mirëkuptimi, pastaj dashuria.
- YLVIA — Prandaj ke mbetur prapa shoqeve ti, se pret të lindë dashuria? Kur s'të qenka mbushur mendja pse na e sjell në derë.
- LIRIA — Po dashuria, moj mama, nuk është e thënë që të lindë...
- YLVIA — Mos më fol mua për dashurinë, ehu! Dashuria...
- LIRIA — (*E gëzuar*) Pse e njihke dashurinë ti, mama? Pa hë, më fol një çikë! (*E rrëmben hopa dhe e ul në divan.*) Hë, pra, fol, kur ke dashuruar, kë ke dashuruar?
- YLVIA — Qyqja, moj bijë, ty të ka plasur cipa! Po a pyetet nëna kështu?!
- LIRIA — Pse ç'të keqe ka? Apo ke frikë se të ndan babai.

YLVIA — Ptu, lanet! Ç'muhabet që na hape. Mbylle, moj, gojën se turp kush na dëgjon.

LIRIA — Nuk e mbyll, kollaj kur m'u vardise mua.

YLVIA — U... kjo! Po unë jam nënë, moj, pastaj sot është ndryshe, s'është si kur isha unë vajzë. Sot edhe gazeta flet për dashurinë, edhe librat, edhe teatrot flasin...

LIRIA — Pse, atëherë s'flitej fare për dashurinë? Nuk kishte fare dashuri atëherë?

YLVIA — Ku kishte turp më të madh se dashuria atëherë, moj e zezë! Jo të dashuroje, po mjafton të shikohesh e zbuluar nga ndonjë mashkull, duhej t'i bëje vend vetes, o në pus, o në Shkumbin.

LIRIA — Domethënë ti, mama, s'paske dashuruar fare.

YLVIA — Iii, kjo! Si, moj, s'kam dashuruar? Po tët atë, moj Maganin?

LIRIA — Kur kështu? Ti ke qenë e mbuluar.

YLVIA — Si kur, moj qyqe! Po atë vit, moj, pasi lindi yt vëlla, Agimi.

LIRIA — Aha! Pas lindjes, ë!

YLVIA — Domethënë ty t'u desh një vit e ca që të njihje babanë e pastaj ta dashuroje, ë?

YLVIA — Nuk e di. Pas lindjes së Agimit ë dashurova. S'dija kë desha më shumë beben e vogël, apo të atin. Nuk ngopesha së shikuari të dy. Le kur vinte yt atë nga pazari e trokiste në derë. Tak-tak ma bënte zemra. Dhe ai më donte. Ia shikoja në sy dashurinë, ia ndieja në pëllëmbët e duarve të enjtura se punonte për tre veta. Eh, dashuria jonë, dashurizeza!...

LIRIA — (Me lot në sy psherëtin.) O, mama!

YLVIA — Po ti pse qan, moj shpirt.

LIRIA — Për ty. Po sikur babai të kishte dalë i keq?

YLVIA — (Mbledh supet) E po fati... Pse i thonë «fat». Pse urojnë njerëzit, paç fat të mirë! I daltë fat i bardhë!...

LIRIA — Ose i zi, i lig, i keq dhe tërë jeta sterrë, pa dashuri, me një burrë që njihesh pas fejesës ose martesës, që s'di se ç'i pëlqen e ç'nuk i pëlqen,



që s'të ka rrahur kurrë zemra, që gëzohesh kur ai s'është në shtëpi. Tërë jetën me njeri të tillë, o nënë! Çfarë tmerri ka qenë! Ti ke shpëtuar rastësisht. Rastësisht ty të qëlloi i mirë dhe ti nise ta duash pas një viti e ca, pas lindjes. (*E përqaqon. Hyn Magani.*)

MAGANI — Po ju ç'keni? Pse jeni shtrënguar kështu?

YLVIA — (*Shkëputet nga përqaqimi i së bijës.*) Hiç, kot! Ja kjo flama m'u qep! (*Liria duke dalë si e përhumbur*)

LIRIA — Natën e mirë!

YLVIA — (*Psherëtin sa del e bija.*) Ia kam frikën kësaj dashurie, o burrë! Duhet biseduar njëherë. Duhet pyetur për të. S'lihet kjo punë kështu. As varur, as këputur.

MAGANI — Ç'të bëj, moj grua, se më plase?

YLVIA — Të fejohen nëse duhen. Të bëjnë celebrimin.

MAGANI — A, moj grua, nuk i lidh celebrimi njerëzit, moj, jo! Nuk i lidh zyra, aktet, firma, se ato siç lidhen edhe zgjidhen; lidhje quhet ajo kur njerëzit bashkohen shpirtërisht, mendërisht. Ajo është lidhje e sigurt, e përjetshme.

YLVIA — As me ty nuk u folka sonte. Po më luani mendsh si ti, si ajo!

MAGANI — (*Që i vjen keq për të shoqen.*) Ngrehu, grua, ngrehu të vemi të flemë! (*Del.*)

YLVIA — (*Fiken dritat. Mbetet vetëm ajo e ndriçimit.*) E ku më flihet sonte mua!

## TABLOJA E DYTË

*(Natë e bukur. Rrugës kalojnë Liria dhe Jakubini. Të dy janë të lumtur.)*

LIRIA — Mos duhet ta përsërit pyetjen?

JAKUBINI — O, jo, Liri! Ti duhet të më kuptosh. Nuk mundem. Jo se nuk dua të njihem me prindërit e tu... Por... siç të thashë, më vjen zor... pastaj të dielën unë duhet të jem patjetër në Tiranë.

LIRIA — Mirë, po të besoj, po pse ndryshove ashtu në fytyrë sa ta thashë që nesër mbrëma do vish për darkë në shtëpinë time? Ti sikur u trembe!

JAKUBINI — Unë u trëmba? E pse?

LIRIA — Ti dhe tashti nuk je i qetë.

JAKUBINI — I qetë jam, bile...

LIRIA — Mos fol kot! Të shoh në sy. Ç'ke, Jakubin, çfarë më fsheh? Pse s'ma thua?

JAKUBINI — E çuditshme je! Hiç, moj, s'kam gjë... Vetëm ca mendime.

LIRIA — Të zymta? Për mua?

JAKUBINI — O, jo Liri, jo për ty, ndonëse kanë të bëjnë me dashurinë tonë, ose më mirë të them me dashurinë time! Mos mendo keq për mua, Liri! Unë kam nevojë të qartësoj veten time njëherë pastaj...

LIRIA — Ju meshkujt jeni të çuditshëm. Ndryshoni shumë më nga ne, femrat. Ju hidheni të parët në dashuri,

hidheni si në det, si notarë të mirë që s'tremben as nga dallgët, as nga rrymat, pastaj, sepse nisni dhe matni shumë gjëra, sikur mendoheni, sikur trembeni, kurse ne druhemi në fillim...

JAKUBINI — ... e pastaj bëheni zot të detit, të furtunës dhe luftoni për jetë a vdekje, sikur kushedi ç'do të ndodhë, se u njohët, u lidhët dhe u dashuruan me një djalë...

LIRIA — *(E ndërpret se nuk i pëlqen.)* Jaku! Ç'janë këto mendime?!

JAKUBINI — E shikon pra, si bëheni ju vajzat? S'të lini të thuash...

LIRIA — *(Ia rrëmben fjalën.)* Ah, si jeni ju çunat, ju mund të thoni ç'të doni, ju mund të silleni si t'ju pëlqejë dhe të veproni...

JAKUBINI — O Liri, ti qenke e çuditshme sonte!

LIRIA — Sa kishim hallet e shtangës, e cila na njohu aq shumë, ne flisnim vetëm për të, harroheshim pas saj, harronim dhe vetveten. Nëse të ka lindur ndonjë dyshim, ose ke ndër mend të më bësh ndonjë pyetje, ma bëj!

JAKUBINI — Unë do të fyeja singëritetin tënd po të bëja ndonjë pyetje. Për mua ti je një vajzë ideale. Je ajo që kam ëndërruar të gjej. E ç'rëndësi ka për mua e kaluara jote! Përse duhet të bëj pyetje?

LIRIA — O, Jaku, në atë drejtim që aludon ti, unë... unë s'kam asgjë. Mbase kjo më ka bërë mua të tillë, pak naive, që nuk u drojta ndaj teje. Megjithatë, sikur s'më pëlqen që ti s'do të dish asgjë nga e kaluara ime si vajzë. E di se si më duket? Sikur s'të intereson, sikur s'do, sikur aq të bën, sikur.. ku di unë, jo se e ndiej veten të fyer që nuk përfill të kaluarën time, jetën time, por duke e lidhur dhe me atë drojtje apo frikë që vura re te ty, kur të ftova për t'u njohur me prindërit e mi, s'di si ta shpjegoj.

JAKUBINI — Mos u shqetëso, Liri! S'ka rëndësi se sa di njeriu për njeriun, se sa di vajza për djalin ose djali për vajzën. Rëndësi ka se sa të ndiej ynë ty

dhe ti mua, sa kuptohemi të dy. Për shembull, një nga gjërat që mua më bëri shumë përshtypje dhe që më lidhi me ty, që ajo ndjenja jote e pastër, ajo çiltërsia jote që ti nuk u bëre kureshtarë të dish për jetën time para njohjes sonë. Ti nuk pyete kërkënd për mua. E di, Liri, seç ndieja unë gjatë gjithë njohjes sonë? Sikur unë po bëhesha një njeri tjetër, ashtu siç më shikoje ti, ashtu siç dëshiroje ti.

LIRIA — Pse, ti nuk je i tillë? Nuk ke qenë i tillë tërë jetën? O, Jaku, po më çudit! Njeriu s'ka se si të jetë, dikur tjetër e tani tjetër. E shikon se paske mi bërë gabim që nuk kemi folur për të kaluarën, unë për veten time e ti për tënden?

JAKUBINI — Aspak! Ne kemi qenë të lumtur me mirë-kuptimin tonë të përbashkët, përderisa jemi bashkë, këtu, në metalurgji, në Elbasan, në këtë copë jetë të jetës sonë që na njohu kaq...

LIRIA — Jakubin! S'po të marr vesh fare! Thua ca fjalë të errëta si kjo natë, të dyshimta si këto hije.

JAKUBINI — As unë s'po të kuptoj sonte. Nuk po di nëse kam të bëj me inxhinieren e furrnaltës, apo me një poeteshë që flet me figura, që ka frikë nga hijet.

LIRIA — Parmbrëmë, kur ra fjala për ty...

JAKUBINI — (*Ironik*) E di, ma ke thënë dy herë sonte.

LIRIA — Jo! Këtë që do të them s'ta kam zënë në gojë dhe më vjen çudi, që nëna, të cilën e njoh më shumë se çdo njeri në botë, m'u duk tjetër njeri, siç po më dukesh ti sonte. Ajo sikur s'ishte nëna ime e vogël, po një grua tjetër, një nga ato gratë e shumta, të mbyllura të Elbasanit të vjetër që burrin e shikonin për të parën herë natën e martesës.

JAKUBINI — Pse, nuk i paske ditur ti këto historira? Mbrëmë i dëgjove për herë të parë?

LIRIA — Tjetër është t'i dish e tjetër gjë është t'i

- ndiesh. Unë mbrëmë sikur s'isha unë, kjo që jam, po një...
- JAKUBINI — ... një vajzë tjetër, siç ka qenë dikur nëna jote? Dhe donin të të martonin me zor me një burrë tjetër që të kishte gjetur halla, ë?
- LIRIA — (*Qesh hidhur.*) Jo, Jakubin! Ajo kohë perëndoi, veç hija e saj sikur ekziston. Besomë. Atë hije unë e pashë mbrëmë në sytë e nënës sime. Se si u zgjuan mbrëmë gjithë ato brenga, dyshime të frikshme tek ajo. Dhe unë e humba për një çast.
- JAKUBINI — I interesant. Dhe unë po zbuloj sonte diçka të re të ti. Mos vallë e ke mbajtur të fshehtë për të ma zbuluar tani? Mos vallë ardhja ime në shtëpinë tuaj është një formalitet, si një garanci për fejesë?
- LIRIA — Nëna, vetëm nëna! Ajo e shkreta ngulte këmbë e donte të dinte se ç'të kam unë ty, shok apo diçka më shumë...
- JAKUBINI — Mos kërkoj se më parë do të qe më mirë të celebroheshim, të vinin njerëzit e mi, të pinin kafet e pastaj të vija unë te ju, ë?
- LIRIA — Përse flet me ironi? Nëna atë mentalitet ka. Nënata s'kanë faj. Ato e kanë zor të kuptojnë zhvillimin tonë, emancipimin tonë, dashurinë tonë, mirëkuptimin tonë shoqëror.
- JAKUBINI — Ta paska ngjitur keq hijen e botës së vdekur.
- LIRIA — Për atë brez nënash hija e botës së vdekur vjen vërdallë hatullave të shtëpisë, endët rrugëve. Ti nuk mund ta marrësh me mend se sa e sa drama të heshtura, shurdhe kanë ndodhur pas këtyre mureve të gurta, sa dashurira janë vyshkur sapo kanë çelur. (*Jakubini qesh*). Ti ke të drejtë të qeshësh, ti je mashkull. Për ju jeta rrjedh ndryshe, kurse për ne...
- JAKUBINI — O, jo, Liri, ç'janë këto filozofime? Ç'ke, moj vajzë, ë? Pse nuk e thua troç, ç'të tremb ty, ë?
- LIRIA — Dyshimi dhe frika e nënës. E di se si m'u dukën ato ndjenja? Sikur i dolën nga thellësi të

shpirtit e i ngeçën në sy. (*Heshtje*) O, erdhëm para shtëpisë! Meqë s'do të vish dot nesër, kthejmë e pimë një kafe sonte. Nuk është dhe aq vonë.

JAKUBINI — (*Pak i trembur nga festa e Lirisë.*) Jo, jo! Nuk mundem. Aq më tepër tani, pas gjithë atyre që kanë ndodhur në shtëpinë tuaj. Më vjen zor. Natën e mirë!

LIRIA — Si natën e mirë? Pse, kështu do të ndahemi sonte? Jo, Jaku! Unë dua të bisedoj, t'i themi njëri-tjetrit shumë gjëra, Sidomos unë... Unë dua të të them se...

JAKUBINI — (*Si i trembur*) Një natë tjetër, kur të kthehem nga Tirana. Kështu e kishim fjalën për sonte apo jo? Do të të përcillja deri afër shtëpisë. Natën e mirë! (*Largohet.*)

LIRIA — (*Sikur i flet natës*) Jaku! Jaku! O, sa i çuditshëm! Si iku kështu! Si hije! Jaku, ku je? Dil! Mos luaj me mua, Jaku!  
(*Duke kërkuar del nga skena, errësinë.*)

## TABLOJA E TRETË

(Mensë, bufe e objektit të furrnaltës. Pas dritareve të mëdha duket furrnalta. Nga dera e hapur ajo duket dhe më mirë. Tek-tuk në sfond kalojnë punëtorë. Ka mbaruar koha e drekës dhe në mensë ka rrëmujë karrigesh e tavolinash. Liria është ulur, më tej janë ulur Sela dhe një punëtor tjetër. Liria ka përpara dy pjata dhe një copë bukë. Nuk i ha het. Në mensë një pjatolarëse mbledh pjatat e lugët. Dëgjohet zhurma e pjatave e tek-tuk ndonjë zhurmë e jashtme hekurash. Liria duket sikur nuk dëgjon.)

SELA — Teta Sofika, si shumë je shëndoshur, sikur s'të shkon.

SOFIKA — Po ç'të bëj unë e shkreta, vetëm kos ha.

SELA — Teta Sofika.... (Kërkon ta ngacmojë përsëri).

SOFIKA — Ç'ke, o kërthi i tetës, ë? Pa ngrahu se çanga s'bie për së dyti, mbaroi pushimi i drekës. Mos shiko inxhinieren.

PUNËTORI II — Ngrahu, Selë!

SELA — (Duke dalë) Shoqja inxhiniere, do të vini ju?...

LIRIA — Erdha, erdha! Filloni ju! (Të gjithë dalin.)  
(Hyn Agimi dhe i drejtohet së motrës.)

AGIMI — I the gjë Jakubinit?

LIRIA — Jo! Nuk e gjeta. Më erdhi zor të hyja përsëri në zyrën e tij.

AGIMI — O, në ç'telashe na fute, moj motër! Ja ku të çoi ai mirëbesimi yt i tepëruar, ai sinqeriteti yt,

ajo pastërtia jote. (S'inton të motrën.) — E kam  
shok, unë e njoh, i bësoj si vetes, simë! Të vinate  
rëndë të më thoshe një fjalë. U zemërove se të  
duartë. Sela, Pse, moj, çishte Sela për ty, ë? Nuk  
është dhënë ajo shokasi Jakubini?

LIRIA — Lëri këto, Gimi! E desha dhe se dua. E desha  
siç më deshi. E ç'do një vajzë veç dashurisë së  
pastër, të vërtetë?

AGIMI — Do kujdes se je vajzë! Do më dend në kokë se  
bëshesh me turp që nuk e lan dot. Përsikur ai të  
mos pranojë.

LIRIA — Çfarë të mos pranojë?

AGIMI — Që të bëni celebrimin, pra. Se vetëm ajo  
punë i vë kapak turpiti që na zuri.

LIRIA — Ehu dhe ti, më keq se mamaja po bëkësh?

AGIMI — Tani mbidhur radaken e jje e vendosur në  
fjalën tënde, more vesh?

LIRIA — Asgjë s'marr vesh. Asgjë s'di se ç'duhet të  
bëj. Prit një çerë të bisedojmë të. Nerduhemi.

AGIMI — A s'është kjo më e rrëndësishmja?

LIRIA — Si s'qenka!

AGIMI — Nëse të dashka aq shumë, atëherë pse s'pranoi  
të vinate atë natë për darkë në? Nga kush pati turp,  
nga ty apo nga unë, apo nga prindërit?

LIRIA — Ahu, sa rrëndësi qëri jep asaj natë!

AGIMI — (Atë natë ai diçka zbuloi. Atë që të ka mbaj-  
tur të fshhtë ty dhe mua!

LIRIA — Çfarë zbuloi, more, aman?!

AGIMI — A, moj motër! Ti je verbuar fare pas tij. Nuk  
peshikon asgjë. Ase di ti, moj, se atje, në Tiranë,  
një vajzë e një vajzë të cilën e di?

LIRIA — Paskë dërguar dhe atje informatorë?

AGIMI — Jo! deri atje nuk kam arritur! Po kaq gjë e  
mësova nga Sela, se edhe ai ç'do të shtunë shkon  
në Tiranë. Jakubini ka lidhje me.

LIRIA — Ç'tidhje, more, se njeh një vajzë?

AGIMI — Po! Dhe se teki ajo vajzë nuk i vjen zor të  
shkojë në shtëpi.



- LIRIA — Mbase e ka shoqe,
- AGIMI — Jo, po, motër! A më dëgjon se ç'po të them?  
Ai në Tiranë ka një...
- LIRIA — Asgjë s'dua të dëgjoj! Asgjë s'më besohet!  
Unë e dua atë. Merr vesh apo jo? Dhe ai më do.
- AGIMI — Sa të do? Kë do më shumë, ty apo atë tjetrën?
- LIRIA — Nuk është e vërtetë! S'ka se si të jetë e vërtetë. Çdo gjë do të shkojë ashtu siç dëshironi ju.  
Ai do të gëzohet kur ta marrë vesh se... (*Hyn Jakubini.*)
- JAKUBINI — Po hani familjarisht?
- AGIMI — Unë hëngrá me shokët. (*Del.*)
- JAKUBINI — Po ky, ç'pati?
- LIRIA — (*Mbledh supet.*) Ashtu e ka ai, mos ia vër re.  
Është ca i rrëmbyer.
- JAKUBINI — Të qenka ftohur gjella.
- LIRIA — Sikur s'më hahet.
- JAKUBINI — Më thanë se kishe alarmuar uzinën që s'më kishe gjetur. Nuk është mirë kështu. Jemi kuadro, nuk jemi çiliminj.
- LIRIA — Nuk bëra alarm. Unë erdha, të kërkova dhe s'të gjeta...
- JAKUBINI — Dhe futët nën derë këtë copë letër, ë?  
Ç'do të thuash me këtë? (*I tregon copën e letrës.*)
- LIRIA — Si? Nuk ke kuptuar asgjë? (*Mundohet të qeshë.*)
- JAKUBINI — E nga ta kuptoj. Është shumë enigmatike.  
«Në shtëpi ka plasur shërri». (*Hështje*) Ç'ka ndodhur, Liri? Fol! Po pres të flasësh. Çfarë fshihet pas këtij telegrami kërcënues?
- LIRIA — Unë s'po të fsheh asgjë. Më duket se je ti që më fsheh mua diçka... nejtë... mbase s'ka aq rëndësi. Si më the atë natë, ë? Të kujtohet? Për ne s'ka rëndësi e kaluara e njëri-tjetrit, për ne ka rëndësi ajo që ndiejmë për njëri-tjetrin sot, tani, përderisa jemi bashkarisht, këtu, në Elbasan.  
Kështu më duket se më the, apo jo?
- JAKUBINI — Liri, lëre se ç'kemi thënë! Fol, ç'do t'më thuash me këtë copë letër?
- LIRIA — E si mund ta them atë që më gëzon e më

shqetëson, kur ti je kaq i vrenjtur, kur ti s'je i predispozuar shpirtërisht.

JAKUBINI — Nuk e dija se ma qenke dhe psikologel Hajde, fol! Tani jam i qetë. (Mundohet të duket i qetë.)

LIRIA — Nuk mundem. Të prisja ndryshe. Ti se si je kthyer këtë radhë nga Tirana. (Heshtje) Ta them më vonë, mirë? (Shikon përreth.)

JAKUBINI — Dëgjo, Liri! Kohët e fundit të dy kemi filluar të bëhemi nervozë. Si është puna?

LIRIA — Unë prisja që ti të vije me vrap, sapo të merrje letrën. Ne kemi biseduar vetëm për dashurinë e asnjëherë për të ardhmen tonë. E kemi ndier atë të dy dhe kjo na ka mjaftuar për të qenë të lumtur.

JAKUBINI — Po... po nuk po marr vesh se ç'do të dish më prej meje, ë?

LIRIA — Dua të dëgjoj edhe një herë nga goja jote, a je i gatshëm t'i bësh ballë çdo vështirësie, çdo të papriture, a më do?

JAKUBINI — Sigurisht që të dua. Më duket se një gjë të tillë ta kam thënë.

LIRIA — (E gëzuar) Atëherë ajo që do të të them nuk ka aq rëndësi. Mamaja, babai, bile dhe Agimi ngulin këmbë që të të them.

JAKUBINI — Dhe...

LIRIA — Po... si të them? Doja të ta thosha ndryshe, jo këtu, jo kështu... Doja që ti të ishe i gëzuar si gjithnjë, si çdo të hënë, kur kthehesh tek unë i qeshur, i lumtur.

JAKUBINI — Fol, Liri! Të lutem, mos më mundo kështu. Ç'ka ndodhur mëntypë?

LIRIA — (Matet po s'flet dot.) Si të them...

JAKUBINI — Fol, pra! Nga unë drruhesh? Ti diçka ke shkruar këtu. (I tregon letrën.) Vazhdoje tani, fol!

LIRIA — Jaku! (Mbështetet tek ai.) Ne së shpejti do të kemi një fëmijë.

JAKUBINI — (E largon.) Si? Si the?...

LIRIA — (Pohon me kokë, lëkundet, afrohet për t'u

mbështetur sërish, po Jakubini zgjat dorën dhe e mban larg.)

JAKUBINI — E ma thua tani?

LIRIA — (E hutuar). Si?... Po kur?

JAKUBINI — Po të pyes pse s'ma ke thënë më parë?

LIRIA — Më vinte zorr, pastaj si të ta thosha kur dhe më vetë nuk isha e sigurt? Dje...

JAKUBINI — (I hutuar, nervoz) Sidoqoftë duhej të më ma kishe thënë mua të parit. Ke bërë gabim që u ke thënë prindërve, sidomos tët vëllai.

LIRIA — Nëse dikur ua fsheha prindërve dashurinë, s'është tani s'mund t'ua fsheh pasojën. (E trembër, vërtetë duart në bark.)

JAKUBINI — Po është shumë shpejt për ne ai fëmijë, për ty, sidomos për ty e për mua. Po ne kemi jetën përpara. Ne akoma s'kemi zgjidhur disa gjëra jetike... Si të them, disa formalitete, celebritimin. As jemi fejuar, as jemi martuar, as shtëpi s'kemi, as... ç'të të them, Liri! Gjyko një cikë me gjakftohtësi! Ç'jemi ne përpara opinionit, ë? Dy të njohur, dy shokë që duhen, vetëm kaq, pa asnjë formalitet.

LIRIA — Formalitete... E pse u jep aq rëndësi atyre sidomos tani? Përse s'të kanë shqetësuar formalitetet deri dje, pardje... Ato s'na kanë penguar ne që të jemi të lumtur. Lumturia s'varet nga celebrimi. O, Jaku! S'të dija kaq të ngurtë, kaq zyrtar, kaq...

JAKUBINI — Nejse, mbase ke të drejtë, po si të them, nuk dua të implikohem me gjëra të tilla. Jo, Liri! Të them copë dhe të lutem besomë! Është shpejt të lidhemi pas një fëmije kur akoma nuk kemi zgjidhur probleme më të rëndësishme jetike. Të krijojmë familje, të sigurojmë më parë të ardhmen, tonë, timen. Unë kam plane të tjera në jetë.

LIRIA — Plane?! Të tjera?! Jakubin, ti s'je në vetel! Përse po flas unë e përse po më flet ti. Ç'ke që trembesh? Nga kush trembesh, xhanëm? Nga jeta? Po ne kemi gjithçka, Jaku. Ne kemi dashurinë

tonë, ne kemi lumturinë tonë. Nëse të shqetësojnë formalitetet e celebrimit i bëjmë që nesër, zor i madh. Dy dëshmitarë duhen. Dhe dhomën ti e ke, sa herë kemi thënë se kjo është dhoma jonë, shtëpia jonë. O, Jaku, si qenke ti sot! Të them të drejtën s'po të njoh. Ti sikur je kthyer në tjetër njeri.

JAKUBINI — E shikon, pra, sa mirë që fole! E shikon, pra, se ne kemi nevojë të njihemi akoma. E përse duhet të nxitohemi? Për një gabim. Jo, Liri! Fëmija s'mund të jetë gjithçka që të na lidhë përjetësisht.

LIRIA — Si the, ore, si the?!... Pse, dashuria jonë s'që një lidhje e përjetshme? Ç'ka të bëjë fëmija? Po sikur të mos kishte ndodhur kjo, a do të ishe zverdhur kështu? A do të të dridheshin duart, ë?

JAKUBINI — Unë dhe tani pohoj se ti më pëlqen, se ti je një vajzë e cila përmbush disa ideale të mia për femrën e emancipuar, por jeta është jetë dhe njeriu s'duhet të verbohet se gjeti një grua, se gjeti mbase dhe atë që ka kërkuar se veç gruas njeriu ka dhe kërkesa të tjera jetike.

LIRIA — E cilat na qenkan këto kërkesa jetike? Mos vallë puna jonë që na njohu, dashuria e vërtetë, e singertë, mirëkuptimi ynë e sa e sa gjëra të përbashkëta, nuk qenkan të mjaftueshme, nuk qenkan jetike?

JAKUBINI — *(Si i zënë ngushtë.)* E... ne jse, mos m'i merr për kapital ato fjalë që mbase i thashë pak i rrëmbyer po... kuptomë drejt, Liri. Në jetë njeriu duhet të ecë me kujdes, të matet mirë para se të krijojë familjen të cilën, si të të them, unë e vlerësoj si një eveniment, si një hallkë jetike, si një siguri për të ardhmen që...

LIRIA — Përpara se të vije ti këtu, tani, im vëlla diçka më pëshpëriti në vesh. Them më pëshpëriti, sepse s'dua t'i besoj ato fjalë. Ne kemi qenë të lumtur nga puna që bënim bashkë dhe nga dashuria që kishim në shpirt. Ose më mirë të them nga da-

shuria që paskam pasur unë, se ti, siç po na del, na paske pasur kërkesa të tjera jetike, sigurira, plane...

JAKUBINI — Liri, mos u rrëmbe, mos beso asgjë! E rëndësishme është të heqësh fëmijën. Dhe unë kam po aq të drejtë ndaj fëmijës sa ke dhe ti. Pastaj bisedojmë më shtruar për jetën tonë, për dashurinë tonë.

LIRIA — Për cilën dashuri, për atë që pëshpëritet apo për këtë që ti kërkon ta mohosh? Jakubin, mendohu mirë! Ti s'mund të luash as me mua, as me atë tjetrën në Tiranë, cilado qoftë ajo!

JAKUBINI — Qetësohu, Liri, qetësohu! (*E kap prej supeve. Ajo i shkëputet dhe vjen rrotull tavolinës.*)

LIRIA — (*Si e përhumbur*) Si është e mundur! Si është e mundur!

JAKUBINI — (*I afrohet.*) Liri, mos u tremb, Liri! Aborti është një gjë e thjeshtë sot. Unë do të gjej një njeri të besuar që të mos e bëjë fjalë...

LIRIA — Kurrë!

JAKUBINI — Do të pendohesh! Mendohu mirë se pastaj do të jetë vonë dhe keq për ty! Sidomos për ty.

LIRIA — Pse? Ç'do të ndodhë? Ç'do të bësh?

JAKUBINI — Asgjë s'kam se ç'të bëj. Unë po të lutem dhe, ta dish mirë, nëse ti s'pranon unë do të jem i detyruar ta mohoj fëmijën.

LIRIA — Si?! Si the?

JAKUBINI — S'kam se ç'të bëj tjetër. Të dola borxhit. (*Matet të ikë, po Liria nuk e lë.*)

LIRIA — Prit! Nuk e lan kaq lehtë borxhin. Nuk mund të ndahesh kaq kollaj nga ky gabim, nga ai mirëbesimi im i singertë që paskam qenë verbuar pas teje. Im vëlla paska pasur të drejtë. Midis nesh qenka një e tretë, e cila, me sa duket, përmbushka ato interesat e tua jetike, kurse unë paskam përmbushur vetëm interesat e tua shpirtërore, intelektuale. (*Ulet si e dërrmuar në karriqe. Në mensë s'ka njeri. Jakubini kontrollon mensën dhe i afrohet.*)

JAKUBINI — Në të vërtetë ne duhemi, Liri, por të them sinqerisht unë s'jam dakord që të bëhem baba këtu në metalurgji, sepse nuk e kam ndarë përfundimisht mendjen që të martohem. Mos ma merr për të keq. Jo se nuk të dua, përkundrazi. Por që do të arrinim deri këtu sa ti dhe unë, ose unë më mirë, më fal që po ta kujtoj fëmijën nuk e prisja dhe nuk e dëshiroja, sepse... si të të them. Unë kam shumë gjëra për të të thënë ty. Unë nuk kam qenë i sinqertë me ty, nuk kam qenë i gjithi i yti. Jeta qenka e çuditshme dhe me mua ka ndodhur një fenomen i rrallë. Unë, duke të njohur ty gjeta femrën që kisha ëndërruar, që do të më bënte të lumtur, por fatkeqësia ime, ose më mirë të them dramë ime, qëndron se unë, para se të vija këtu në Elbasan dhe para se të të njihja ty isha implikuar, ose më mirë të them, kisha nisur të dashuroj dikë tjetër. Për mua qe një provë e madhe, një e vërtetë e hidhur që njeriu qenka qenie e dobët, sepse unë rashë njëkohësisht në dy dashuri, por nëse do të dish dashurinë e vërtetë, është dashuria që kam për ty, por fatkeqësia është se unë s'mund të heq dorë nga dashuria e parë ngaqë me të më lidhin gjithashtu jo vetëm disa kujtime, por dhe disa ndjenja.

LIRIA — (*Me ironi.*) Ndjenja? Si është e mundur që një njeri të ketë njëkohësisht të njëjtat ndjenja të sinqerta dashurie për dy femra? O Jakubin, po më luan mendsh! A i mendon fjalët që thua? Apo i ke të inçizuara në kokë, ë?

JAKUBINI — E di që jam duke të lënduar, që jam duke bërë një veprim të ulët që ti nuk e meriton, por s'mund të mos jem i sinqertë me ty deri në fund. Ja, t'i thashë të gjitha! Ky jam unë! Dhe të lutem të më falësh? A dëgjon, Liri? Unë po të kërkoj ndjesë!

LIRIA — Përsë më kërkon ndjesë? Për mashtrimin, të cilin po përpiqesh ta justifikosh me gojëtarinë të-

nde? Fol, Jakubin Sara, përse më kërkon ndjesë, ë?

JAKUBINI — Si përse? Po ja, pra, për gjithçka që ndodhi midis nesh, për dashurinë që më dhe, për singëritetin tënd, për gjithçka. Unë s'mund të jem i qetë, nëse ti nuk më fal. Mos pandeh se unë e kam të lehtë që po të lutem, jo për dinjitetin tim, jo, aspak, se unë s'kam më dinjitet, s'kam sy e faqe të dal para teje, para njerëzve të tu, para shoqëve dhe shokëve tanë. Unë me këtë që po kërkoj nga ty, jam duke vrarë veten, personalitetin tim. A më kupton, Liri? Ti, nëse më ke dashur vërtet, duhet të bësh kaq gjë për mua. Duhet të më shpëtosh.

LIRIA — *(Me përbuzje)* Nga kush?

JAKUBINI — Liri! Mos më përbuz! Unë u tregova i singërtë. Unë të thashë ty atë që s'kam guxuar t'ia them asaj tjetrës, e kjo tregon se për ty unë kam shumë respekt e konsideratë, se ti je për mua më shumë se ajo, por siç të thashë pak më parë, ti duhet të më shpëtosh, sepse unë gabova me ty. Po, Liri, gabova rëndë e të thashë të besojë që të dua po aq sa më do ti, por s'paska qenë kështu. Dashuria jote paska qenë më e madhe se e imja. Dashuria ime që e vërtetë, por jo e singërtë, jo aq e fortë sa të mohonte dashurinë e parë.

LIRIA — *(Ka humbur durimin.)* Ore djalë, je në vete ti apo jo? A i dëgjon fjalët që thua? *(Heshtje)* Ti, veç në qofsh një përjashtim, një xhongler i pa-turpshëm që vazhdon me këmbëngulje të luash dhe tani më mua. Hiqmu sysh se s'të shoh dot!

JAKUBINI — Edhe unë po habitem. Nuk të gënjej dot më, Liri. Kisha nevojë për dashurinë tënde, por jo deri në atë shkallë sa të bashkoheshim përjetë bashkë, sepse të thashë që jam i implikuar me një dashuri tjetër. Kur isha në Tiranë, tani u binda. Kam vuajtur dhe unë me veten time që rëshë, si ta them, në një gjendje të tillë. Gabimin që bëra me ty, unë s'do t'ia fal kurrë vetes, po që të jem

i qetë, të lutem të më falësh! Një gjë të tillë, sigurisht. unë s'do të kisha sy e faqe t'ia kërkoja një njeriu tjetër, se njeriut i vjen zor e turp t'i zbulojë shpirtin tjetrit, por para teje unë s'mund të hesht, s'mund të fshihem, s'mund të shfaqem tjetërsoj. Ti po e shikon vetë se sa...

LIRIA — (*Me ironi*) E shoh dhe... (*Një punëtor hyn me një copë letër në dorë dhe i drejtohet Jakubinit.*)

PUNËTORI — Shoku inxhinier, një firmë ju lutem!

JAKUBINI — (*Gjithë inat*) Në zyrë! Nuk e sheh se jam i zënë? (*Punëtori largohet. Jakubini ul zërin.*) Dashuria jonë, megjithëse u njollos, sigurisht nga ana ime, prapëseprapë nuk është e humbur, nuk është pa shpresa për t'u ringjallur sërish e pastër, e fuqishme...

LIRIA — Sigurisht, në qoftë se ajo tjetra, atje në Tiranën tënde kaq të dashur, mund të marrë vesh marrëdhëniet tona dhe mund të tërhiqet e fyer që ti ke arritur me mua deri aty sa të kesh edhe një fëmijë, apo jo? Ajo mund të jetë më trimë se unë, mund të jetë më me dinjitet se unë dhe të jep një dackë turinjve e të thotë shko në djall, ë?

JAKUBINI — (*I penduar*) Unë t'u rrëfeva. Unë të thashë gjithçka që njeriut i vjen, zor t'ia thotë dhe vetvetes. Tani ti ke në dorë jetën time, të ardhmen time, karrierën time. Bëj ç'të duash me mua. Ja ku më ke, veç unë kërkoj me këmbëngulje të heqësh fëmijën, sepse ai, sa ç'është yti, është dhe imi.

LIRIA — Ti kërkon këtë gjë kaq paturpësisht sa më vjen pështirë që kam në bark diçka nga gjaku yt.

JAKUBINI — (*Mezi e fsheh qezimin që ia shkuli këto fjalë Lirisë*). E shikon, pra, se unë kam të drejtë! Ti fillove të më urresh. Dhe ke të drejtë. Sa herë që do të përkëdhelësh fëmijën ti do të më kujtosh mua, poshtërsinë time, prandaj ta heqësh...

LIRIA — (*E inatosur në kulm*) Kurrë! Oh, ja pra dhe ti fillove të shfaqësh fytyrën tënde!

JAKUBINI — Mendohu mirë dhe jo me inat. Këmbëngul



për dy arsye: e para, sepse, siç të thashë, ai fëmijë është i parakohshëm për ne, sidomos për ty, dhe, e dyta, sepse ajo fëmijë do të të diskreditojë ty tërë jetën.

LIRIA — Mjaft! Nuk dua të të dëgjoj më!

JAKUBINI — Mos u bëj naive, Liri! Një femër, një vajzë pa burrë, me një fëmijë për dore nuk e ka të lehtë, s'e kam fjalën për anën ekonomike, po për opinionin. Ajo fëmijë do të të rëndojë shumë.

LIRIA — Atë peshë do ta mbajmë bashkë. Ti në Tiranë e kudo qofsh e unë këtu në Elbasan. Opinioni e di se i kujt është ajo fëmijë.

JAKUBINI — Se i kujt është ajo fëmijë është çështje tjetër.

LIRIA — Ç'do të thuash me këtë? Mos vallë deri këtu do të arrish?

JAKUBINI — Oh, jo! Po opinionin është opinion, moj gocë.

LIRIA — E përse u dashka të ngrihet ky opinion kundër meje e jo kundër teje? Pse jam femër? E ç'rëndësi ka se unë jam femër e ti mashkull, kur fëmija është e përbashkët?

JAKUBINI — Po si të them... Kështu është. Nuk e ditke ti një gjë të tillë.

LIRIA — Po përse të jetë kështu, ë? Përse të ngrihet opinionin kundër meje e jo kundër teje, përse ti na qenke i privilegjuar, pse je mashkull? Përse ti paske të drejtë të më këshillosh mua, të ndahesh nga faji apo nga gabimi ynë i përbashkët e të më kujtosh mua opinionin, të më trembësh me të, se je mashkull! Po kjo është e padrejtë. Ky është një abuzim i ulët, është një poshtërsi. (Si e hutuar) Sa e çuditshme! Përse të jetë kështu, ë? Përse të mos rëndojë ky turp dhe mbi ty, njësoj si mbi mua, në mos më shumë mbi ty se ti më mashtrove me dashurinë tënde të shtirur që po përpiqesh ta justifikosh?

JAKUBINI — Mos e lodh veten, Liri! Ti ke të drejtë... si të them... tani ne, ti dhe unë, duhet të shpëtojmë

nga kjo që na ra mbi kokë. Rrugë tjetër s'ka.  
Opinionit nuk i bëjmë dot ballë. Nuk i bihet mu-  
rit me kokë. Duhet ta heqësh!

LIRIA — *(Me inat)* Jo, kurrë!

JAKUBINI — *(Qesh me ironi.)* Jam kurioz të di se ç'do  
të bësh po ta mohoj fëmijën, ë? E ke shkuar në  
mend një gjë të tillë

LIRIA — Deri para këtij çasti jo! Tani po! Tani e besoj  
se ti je gati të bësh çdo gjë.

JAKUBINI — Dhe... *(E nxit që të flasë.)*

LIRIA — Dhe do t'i them kujt do se ti je një maskara, i  
pari dhe i fundit që kam njohur në jetë, që ga-  
bimisht i besova si vetes sime dhe se kjo që më  
ndodhi mua do t'u shërbejë si mësim i hidhur  
shoqeve të mia. *(Niset të dalë.)* Ti më dhe disa  
këshilla, unë po të jap vetëm një, që ta kujtosh sa  
herë që të shihesh në pasqyrë. Na! *(Ia kërcet me  
sa fuqi që ka, aq sa Jakubini lëkundet dhe mba-  
het pas tavolinës. Liria, pa e parë, niset dhe del.)*

## TABLOJA E KATËRT

*(Zyra e drejtorit të kantierit të furnnaltës. Bëhet ballafaqimi i shokëve të uzinës mekanike me shokë e furnnaltës, afati i dorëzimit të së cilës nuk u bë në kohën e caktuar. Ndodhen drejtori i furnnaltës, Selaudin Imami, drejtori i uzinës mekanike, Spiroja, sekretari i Partisë Sinan Vilani, xha Hysa, Jakubini dhe Liria. E gjithë faqja e murit është xhamllëk, ku duken konturet e furnnaltës. Në një qoshe një kasafortë, një lule, një mbajtëse me libra, një krevat, një palë çizme që ndodhen poshtë krevatit dhe një mushama ushtarake. Ballafaqimi ka filluar prej kohësh)*

**XHA HYSA** — E thashë dhe pak më parë, shokë. Mos dorëzimi në kohë i montimeve të furnnaltës më bën të skuqem jo para vetes, po para tërë Shqipërisë, që e pret si ujët e pakët, si pikën e floririt. Nuk di ç'të them... fajtorë janë Liria dhe Jakubini. Le të mos na sjellin vërdallë, le ta thonë troç: u vonuan tre ditë detalet. Kjo s'vaji t'i marrë, ky nuk i solli.

**JAKUBINI** — Nuk e kam për detyrë që çdo detal që prodhojmë të vete e ta çoj kantier më kantier dhe objekt më objekt.

**SINANI** — Pse, ti nuk pranon asnjë faj për mosrealizimin në kohën e duhur të furnnaltës? Nëse është kështu, atëherë qoftë drejtori yt, qoftë drejtori i kantierit të furnnaltës paskan folur kot. Ata provuan negli-

zhencën e uzinës mekanike dhe mosinteresimin e shokëve të furnaltës që nuk paskan ngulur këmbë në kërkimin e detaleve, të cilat ju duhet t'i kishit bërë me kohë, me përparësi dhe kur i bëtë të paktën të telefononit e jo të qëndronit indiferehtë.

JAKUBINI — Po... si t'ju them, shoku Sinan, kështu, në përgjithësi dhe unë e ndiej fajin.

SINANI — Në përgjithësi? Ama ç'na the! Ne s'jemi mbledhur të flasim në përgjithësi, po konkretisht dhe secili për punën e tij, ndryshe nuk i gjejmë dot shkaqet dhe arsytet.

JAKUBINI — Atëherë më lejoni t'i referohem pasqyrës së kërkesave dhe afateve të caktuara nga dy drejtoritë tona dhe të miratuara nga drejtoria qendrore. Ja ku janë porositë e furnaltës, ja datat, ja dhe kur janë mbaruar. I kenë të nënvizuara me laps të kuq. Urdhëroni! (*U tregon grafikun.*) Porosinë urgjente njeriute ndjek, nuk e harron. Sigurisht atë që e ha merakun i punës. Në situatën e tanishme, të them të drejtën, s'di kujt t'i jap përparësi: furnaltës, koksit, gazgoltave, uzinës... Të gjitha uzinat, dhe çeliku dhe petëzimi, i kërkojnë me ngut detalet. (*Selaudini kërvesh buzët e lëviz në ajër dorën sikur tremb një mizë. Jakobini e vë re.*) Nuk e kuptoj përse jeni të pakënaqur nga unë.

SINANI — Më lejoni ta pyes për diçka?

SELAUDINI — Urdhëroni, shoku sekretar!

SINANI — Si e shpjegoni ju, shoku Jakubin, pse ra ai vrull i madh pune dhe ai mobilizim që pate ti dhe shoqja Liri kur morët përsipër shtangën? Dhe pasi e mbaruat atë, ju i ndoqët shumë mirë detalet e furnaltës, pa i penguar detalet e objekteve të tjera.

JAKUBINI — Atëherë unë akuzohem se dikur paskam punuar mirë, ë? Dhe për këtë gjë duhet të jap llogari sot? (*Buzëqesh me ironi.*) Më falni, shokë, por mua nuk më pëlqen tendenca juaj!

SELAUDINI — Sinani e ka fjalën pse ju ra juve ai vrull,

ai mobilizim. Mos vallë marrëdhëniet e reja, tuajat, midis teje dhe Lirisë, pra, marrëdhëniet thjesht personale, ju i ngatërruat me marrëdhëniet shtetërore? Se... tamam, sipas këtij grafiku na del se neglizhencja juaj apo indiferentizmi yt përkojnë me grindjet tuaja dhe të Lirisë në mensën e furnnaltës. (*Hesh-tje*) Domethënë nëse unë dhe ti shkojmë mirë si shokë, kemi simpati personale ose familjare, punët ecin, nëse unë dhe ti kemi mosmarrëveshje personale, punët ngecin, kështu?

**JAKUBINI** — Mua s'mund të më akuzoni për një gjë të tillë. Grindjet tona, marrëdhëniet tona personale Liria i vuri mbi të gjitha, dhe mbi detyrën e saj si përgjegjëse e montimit të furnnaltës. Ja ku është xha Hysa, le të flasë ai më mirë, si sekretar i organizatës bazë të furnnaltës. Çfarë vendimi mori organizata për Lirinë? Pse e ka kritikuar? Më falni, shokë, po këmbëngulja juaj që të më bëni bashkëfajtor me Lirinë nuk më duket e drejtë dhe, ju lutem, çështjet tona intime nuk keni pse i zini në gojë kaq publikisht!

**SINANI** — Si the, ore, çështjet intime? Po kur këto çështje intime bëhen shkak për mosrealizimin e planit, s'paskemi të drejtë t'i zemë në gojë? Jo, Jakubin Sara, jo! E ke gabim! Për çështjet e punës do të përgjigjesh një për një, kurse për çështjet intime dhe personale ke përgjegjësi edhe më të madhe, sepse ke abuzuar në postin që ke, duke shfrytëzuar marrëdhëniet e tua me Lirinë. Ke pritur që ajo të vijë në zyrën tënde, që të vazhdosh presionin tënd, që të marrësh hak për atë dackë që të dha ajo në mensën e furnnaltës dhe për të realizuar qëllimet e tua.

**JAKUBINI** — Ato janë çështje personale, shoku sekretar, ju lutem shumë!

**SINANI** — (*Nxehet.*) Nuk janë personale. Mos u mundo të mbulosh pasojat që janë pasqyruar në punë gjoja me marrëdhënie personale. Ti shkele punën, Lirinë. dashurinë dhe nënvizove me vijë të kuqe jo vetëm

afatet e dorëzimit. Kush të lejon ty, more, të sillesh kështu me njerëzit? Qenka sekretar partie unë dhe m'u lejoka të sjell njerëzit vërdallë derisa të plotësoj ndonjë dëshirën time, apo ndonjë interes të vogël ose të madh, të mbuloj ndonjë gabim e t'ia vesh një tjetri që të dal i larë, kështu, ë? Pandeha se do të kishe reflektuar pas bisedës që bëmë dje.

LIRIA — Për çështjet tona personale nuk lejoj të flitet. Është puna ime se si do t'i zgjidh unë hallet e mia. Më vjen keq që ato u pasqyruan në punë. Grafiku, siç na doli këtu, qenka në rregull. Unë pranoj që nuk kam ngulur këmbë, që jam vonuar në kërkesën time për detalet. Unë dhashë llogari në organizatë dhe tani jam gati të përgjigjem për pasojat. Duhet të kisha shkelur mbi ndjenjat e mia e të mos pyesja sedrën, por ja që s'munda. Jam fajtores për vonesën e afatit të furnaltës dhe pres dënimin që meritoj.

SELAUDINI — Prit, Liri! Mos merr përsipër më tepër nga ç'të takojnë. Nëse ti je druajtur dhe ke neglizhuar, ke qenë deri në njëfarë mase e justifikuar. Gjendja jote shpirtërore...

JAKUBINI — Ju lutem dhe njëherë lërimi çështjet tona! Ja dhe Liria s'do. Ajo është një çështje që na përket vetëm neve të dyve, përsa i takon gabimeve në punë, edhe unë po pranoj diçka dhe jam gati të përgjigjem.

SELAUDINI — Do të përgjigjesh për punën dhe për këtë! (*Tregon me dorë Lirinë.*) Mbi të gjitha njeriu. Nuk do të lejojmë kurrë që dinjiteti i njeriut të shkelet me këmbë siç po kërkon ta shkelësh ti. (*Liria lëviz e shqetësuar në karrige. Selaudini i vë dorën mbi sup dhe nuk e lë të ngrihet.*)

SPIROJA — Më duket se po kalojmë në një temë tjetër. Nuk them se është pa vlerë, po, së pari, jemi mbledhur për të gjetur fajtorin. Shoqja Liri e pranoi. Nëse ju, shoku Sinan, si sekretar i Partisë, doni ta mbronin Lirinë si femër...

SINAN — Si femër?! (*Qesh.*) Asnjëherë nuk e kam parë

shoqen Liri si femër, shoku Spiro. Majë furnaltës, mes shqotës, e lidhur me litar ka montuar ajo. As ti, as unë, as Jakubini s'kemi punuar në ato kushte. Ç'është ky koncept? Më falni, shokë, po dua të ngre një problem, i cili tek-tuk ka filluar të ngrejë krye edhe midis nesh. Dakord jam me të gjithë ju, që jeni mbledhur këtu për vonesën e afatit të dorëzimit të furnaltës. E analizuar një për një e na doli fajtoresh Liria. Tani s'na mbetet gjë tjetër veç ta dënojmë atë, kështu? Pra, kemi fajtorin, pasojat e fajit, po shkaktari ku është? Kush është ai?

**SPIROJA** — (Si i prekur.) Nuk jemi në gjyq këtu, shoku sekretar.

**SINANI** — Jemi në jetë, shoku Spiro. Dhe në jetë, kudo që të jemi duhet t'i ndiejmë përgjegjësitë kushtetuese, se nga ajo kanë dalë nenet, ndërsa gjyqi është pjesë e jetës. Sa shkaktarë kemi në jetë, të cilët fshihen bukur duke mbuluar viktimat e tyre, që mbase janë fajtorë po dhe s'janë, se janë shtyrë, janë imponuar. Ata kapen dhe, sigurisht, përgjigjen. Mos vallë ne duhet të mbetemi të kënaqur që i gjetëm, i kapëm dhe i dënuam? Mos vallë më kaq mbaron detyra jonë si qytetarë, si komunistë?

**SPIROJA** — Sigurisht që jo.

**SINANI** — Hë pra, këtu të dua! Këtu duhet të tregohemi të ndërgjegjshëm, të drejtë, largpamës, që me analizën e një faji apo fajtori të gjejmë shkaktar, shkaktarin, konceptet. Ç'të bënte Liria kur ai e fyejti, e mashtroi, e poshtëroi? Si mund të trokiste ajo në zyrën e tij e t'i kërkonte zbatimin e kontratës së detaleve?

**SPIROJA** — E po, zyra është e shtetit, është shtetërore...

**SINANI** — E thua ti, me gjakftohtësi, po i fyeri, të cilit i janë errur sytë, i është vrarë zemra, e ka zor të ndajë zyrën shtetërore nga nëpunësi. Ai shikon njësh dhe zyrën dhe zyrtarin.

**SPIROJA** — Atëherë ti e justifikon Lirinë, justifikon shkeljen e afatit.

SINANI — Jo! Lirinë si fajtoje unë e kritikoj rëndë, e kritikoj që s'pati fuqi e guxim të ngrihej mbi vetveten, për të kryer detyrën shtetërore, kurse shkaktarin e dënoj, cilido qoftë ky, edhe veten që nuk jam treguar vigjilent, që nuk jam shqetësuar për marrëdhëniet e acaruar midis Lirisë dhe Jakubinit. Edhe ty, shoku Spiro, që po përpiqesh ta justifikosh Jakubinin se duke mbrojtur atë, nëpunësin tënd, ti mbron ndërmarrjen tënde!

SPIROJA — (*Murmurit si i pakënaqur.*) Ehu! Përse u mblodhëm e përse po flasim.

SINANI — Mos fol me vete, shoku Spiro!

SPIROJA — Derisa më dëgjuat, do të thotë që s'folam me vete. Nuk më pëlqen kjo koklavitje gjërash.

SINANI — E po ja që gjërat shpeshherë nuk janë aq të thjeshta sa ç'duken, shoku Spiro, ose siç mundohet t'i paraqesë inxhinier Jakubini, se, fatkeqësisht, ka njerëz që abuzojnë me postin që kanë. E shohin atë si një privilegj të tyre dhe për të kryer detyrën shtetërore presin t'u vesh, t'i kujtosh, t'i nxitësh, bile dhe t'u lutesh. E si mund t'i lutej Liria Jakubinit kur ai i bën asaj presion dhe e fyen aq rëndë sa...

JAKUBINI — Daleni, ju po shkoni shumë larg me mua.

SINANI — Hiç fare, ja ku jemi ballë për ballë dhe le t'i themi mendimet troç. Ti je shkaktari i vonës së montimit të furnnaltës. Kjo është e para. E dyta, ti ke fyer rëndë dinjitetin e Lirisë. Dhe e treta, ke manovruar aq bukur jo vetëm që të dalësh në rregull me grafikun por dhe në marrëdhëniet e tua me Lirinë.

JAKUBINI — Fundja unë nuk i kam premtuar asgjë Lirisë në marrëdhëniet tona. Ka qenë thjesht një... dashuri, një mirëkuptim i përbashkët. Unë nuk e kam gënjer, nuk e kam mashtruar, mbase me vonesë, por i kam thënë gjithçka. I kam shpjeguar se si kam qenë i lidhur me një vajzë tjetër. Ju lutem, mos e dramatizoni kaq gjendjen! Do të ki-



shit të drejtë nëse unë do t'i kisha premtuar asaj martesë.

SELAUDINI — Martesë?! Domethënë sipas teje djali qenka fajtor vetëm atëherë kur i ka premtuar vajzës martesë, në rast se nuk i ka premtuar asgjë, qenka në rregull, ç'koncept!

JAKUBINI — Shoku Selaudin, shoku drejtor, më falni, më keqkuptuat!

SELAUDINI — Hë pra, shpjegohu!

LIRIA — (*Ngrihet e nervozuar.*) Më falni! Unë s'mund të qëndroj dot më këtu! Ç'kisha për të thënë i thashë. E përsëris edhe një herë që të mos pandehni se dua t'i shmangem përgjegjësisë. Për shkeljen e afatit jam fajtorë. E ndiej. S'kam gabuar vetëm si inxhinierë, si drejtuese e punimeve, por dhe si vajzë që i besova si e verbuar këtij... (*Del. Asnjë nuk ka fuqi që ta ndalojë. Heshtje.*)

JAKUBINI — (*Sikur flet me vete*) Më vjen zor të flas. Liria pati të drejtë që iku. Unë e respektoj, e dashuroj atë. Dhe fëmijën ia pranoj. Është imi sa dhe i saj. Jua them sinqerisht, nuk jam në gjendje të vendos për martesë. Njohja jonë që e shkurtër, e pastër, e sinqertë, siç që dhe gabimi ynë. Se bëra një gabim, të bëj tani dhe një tjetër? Të bashkohem me të?

XHA HUSA — Po ky, gabimi yt, apo i të dyve, rëndon mbi të, more djalë. Mirë se të metat e punës do t'i rregullojmë, po e bëjmë natën ditë siç e kemi bërë dhe... po këtë gabim si do ta ndreqim, ë?

SPIROJA — Gabimi është i pandreqshëm. Liria e ka të vështirë ta pranojë tani. Unë ia njoh karakterin asaj. Ajo nuk erdhi të merrete detalet, siç e dëgjuat, pranoi fajin, pranoi përgjegjësinë e mosrealizimit të furnaltës, kur kishte mundësi të manovronte, të justifikohet. Pastaj, vetë fakti që iku...

SELAUDINI — Dale, more shokë, të mos rrëmbehemi! Bashkimi apo ndarja e tyre vërtet nuk është në dorën tonë dhe ne mbase nuk kemi të drejtë t'u imponohemi të krijojmë me zor një familje të re,

por ama dhe kështu t'i presim drutë shkurt, siç thotë shoku Spiro jo, jo. Mua më shqetëson vërtet fati i Lirisë, po më shumë më shqetësojnë konceptet e Jakubinit që e shikon punën, postin që ka, si një privilegj dhe abuzon me të. Ai e shikon dashurinë jo si një ndjenjë të pastër, të bukur, por si një kënaqësi të çastit, e shikon si një egoist. Çdo njeri ka të drejtë të ketë pretendimet për jetën e tij, për punën, për gruan që do të marrë, por nuk ka të drejtë të abuzojë, prandaj Jakubini është fajtor.

SPIROJA — Dhe je dakord me mua, apo jo?

SELAUDINI — Përse?

SPIROJA — Që ky gabim është i pandreqshëm, që është një fatkeqësi.

SELAUDINI — Jo, s'jam dakord fare me ty, se fatkeqësia në këto raste rëndon mbi femrën e jo mbi mashkullin. Liria do mbetet me turp se ka pasë lidhje me një djalë, se paska qenë fejuar e ku di unë, kurse për Jakubinin as që do të pyesin shumë se ka pasë dhe ai ndonjë femër, ka qenë mbase i fejuar, ahu! (*Xha Hysa ngre dorën si në shkollë.*) Hë, mo, xha Hysë!

XHA HYSA — Po le të kujtojmë, more shokë, se me çfarë dashurie punuan ata të dy. Se ç'vështirësi zgjidhën duke bërë shtangën. Më gëzohej shpirti kur i shikoja të dy. Sa dashurira kanë lindur këtu para syve tanë, të pastra, të shëndetshme. Të gjithë e shikonin dashurinë e tyre se si lulëzonte, se si forcohej çdo ditë, se si ngrihej bashkë me kombinatin. Le t'i lemë të mendohen. Mbase është ashtu siç thotë ajo fjala e urtë që grindjet, zëniet në dashuri janë si fryma për zjarrin. E? S'jeni dakord as me mua?

SPIROJA — Mirë e ka xha Hysa. Le të presim të mendohen...

SINANI — Po s'pret puna që t'i lemë të mendohen, shoku Spiro.

JAKUBINI — Nuk mundem ta marr. Pranoj çdo pasojë, çdo dënim. Jua thashë se unë jam gati për t'u

fejuar me Elsën, të bijën e shokut Ajdin Kolani.

SINANI — Mos vallë, ti pandeh se do të na trembësh me emrin e shokut Ajdin?

JAKUBINI — Jo, ç'ne! Aspak! Më falni që përmenda emrin e vjehrrit tim të ardhshëm po... e thashë vetëm për t'ju vënë në dijeni, për të treguar një të vërtetë.

SINANI — Një të vërtetë?! Një mashtrim thuaj! Ti shite Lirinë, dashurinë e sinqertë të saj për Elsën, sepse Elsa, e bija e shokut Ajdin, ty të siguron Tiranën!

JAKUBINI — Lirisë ia shpjegova të gjitha. I kërkova që të më falë. Ajo nuk iku kot. Ajo...

SINANI — Ajo iku se s'mundi të durojë këtë pazar që po bën ti. Ajo iku sepse ka sedër, ka dinjitet e personalitet më shumë se ti. Zgjidhe këtë lëmsh, Jakubin Sara! Mendohu mirë para se të bësh qoftë edhe një hap drejt Elsës, apo drejt Lirisë, dhe mos pandeh se është në dorën tënde fati i Liri Rekës. Ajo është aq e fortë sa ta mbajë këtë peshë të rëndë. Por dije mirë se ajo peshë do të rëndojë më shumë mbi ty. Sepse ti je shkaktari. Ballafaqimi mori fund.

SELAUDINI — Na rrëmben plani, norma, raportet, ballafaqimet për punën, kurse në hallet e njerëzve hyjmë me vonesë. Partia na ka hequr veshin kush e di sa herë, por ne, me sa duket, dashkemi të na shkundi mirë. (Heshtje) Përgjegjësi mbajmë të gjithë për fatin e Liri Rekës dhe për konceptet e tua, Jakubin Sara, sepse ti abuzove në gjënë më delikate që ka femra, në nderin e saj, të cilën e merr nëpër këmbë, e shkel, e përdhunon. Kush ta jep ty këtë të drejtë?!

## TABLOJA E PESTË

*(Dekori i tablosë së parë. Në këmbë janë Magani, Ylvia dhe i biri, Agimi, i veshur me rrobat e punës. Duket që posa ka ardhur dhe heq me mërzi e nervozizëm xhupin. Ulet. Është i lodhur.)*

MAGANI — Po tët motër ku e ke, ku ngeci? Ju prisnim të vini bashkë. Ajo sot ta ka nevojën si vëlla më shumë se kurrë.

AGIMI — Në mbledhje e lashë, ose më mirë e çova, e porositë se si të fliste, si t'ia mblidhte dy këmbët në një këpucë atij maskarai. Dhe i thashë se po të pres, po ajo më përzuri edhe mua, edhe Selën.

MAGANI — Dë jetë trembur se mos bën ti ndonjë bu-dallallëk, nga ato të tuat.

YLVIA — Ta kishë pritur, mor ditëzi! Ah, femra e shkretë që mos goftë! Të bën me turp e të nxin jetën.

MAGANI — Mjaft ndolle zi, hej dreq! *(Agimët.)* Dhe ti ngrehu e lahu!

YLVIA — Të mbytet thuaj, go të lahet!

AGIMI — *(Ngrihet, merr tashat e peshqirin, pendohet dhe vete në dritare.)* U bënë tri orë mbledhje. *(Duke parë orën)* Akoma... *(Bie zilia e derës.)* Ja, erdhi! Ajo duhet të jetë. *(Hyn Liria.)*

YLVIA — Hajër ishalla! Ç'haber po na sjell? *(Liria ngec te dera.)*

MAGANI — Po hajde, moj bijë, hajde ulu!

AGIMI — Ç'u vendos në mbledhje?

LIRIA — Nuk e di. Unë ika. Nuk munda të qëndroj.

Nuk munda të duroj atë zallamahi. (*Ulet në karriqe.*)

YLVIA — (*E trembur.*) Si?! Ike? Po si të bëjnë këmbët, moj qyqe? Po aty, moj, të ngordhje! Ngrehu, burrë, ngrehu e shko ti atje tek ai shoku yt, te Selaudini. E ke shok luftë apo jo?

MAGANI — E ç'të bëj unë atje, oj grua? Atje ka pushtet, ka parti.

YLVIA — Po ti je pushtet, o ditëzi! Je kryetar i këshillit të lagjes, je anëtar i gjykatës. Ligjet i di. Hë, pra, ç'pret? Detyroje atë ta marrë e të shpëtojme. S'ka rrugë tjetër, o burrë. Këtë turp vetëm ligji e lan. Ka ligje apo s'ka xhanëm? Më zu goja lesh duke thënë të bëjnë celebrimin, t'i vemë kapak këtij turpi. Hë tani, ç'do të bëjë kjo me fëmijën pa baba, pa burrë?! Dhe na ikërka nga mbledhja, pale! Ata mblidhen për të, e kjo s'duroka, ngreka bishtin e ikërka. Si ike, moj e lënë? Aty, moj, të ngordhje, në mbledhje dhe të mos i lije ata të iknin pa të zgjidhur hallin, turpin, moj qyqe!

LIRIA — Nuk jam qyqe, jo!

YLVIA — Po ç'je, moj? A e di ti se si del ajo ikja jote?

LIRIA — E di. Atë nuk e dua më dhe pikë.

YLVIA — Shiko, shiko, nuk e dashka më. E dëgjon, more se ç'flet? Pse, moj, kështu the dhe atje në mbledhje? (*Asnjë lëvizje.*) Ore!... (*E alarmuar.*) Jeni në vete ju apo jo? E dini ju se ç'na pret? Unë bëhesha merak nëse do ta detyrojnë dot atë që ta marrë, kurse kjo nxjerr tani avaz tjetër, Nuk e dashka!

LIRIA — Mama! Ti alarmohesh kot!

YLVIA — Si, moj, kot, po puna jote mori dhenë, moj! Një qytet i tërë dhe një kombinat i tërë e mori vesh. Vëri kapak kësaj pune, vër unazën në gisht e prapa diellit vafsh, pastaj!

LIRIA — Jo, mama, jo! Ai më ka fyer rëndë mua, më ka shkelur dinjitetin tim, më ka mohuar personalitetin tim. Ai më ka mashtruar, ai...

YLVIA — Dale, dale! Mos merr revan, dinjiteti, personë-

liteti!... A pranon ai se fëmija është e tij? A të merr për grua?

LIRIA — Po pse, ç'jam unë? Një copë qilim që ai të më marrë për të fshirë këmbët. Jo, mama, mos më ul kaq poshtë!

YLVIA — Po kush të merr ty, moj korbë, po s'të mori ai? E ke menduar këtë gjë? Kush të merr ty, moj, me fëmijën e tjetërkujt përdore, ë?

LIRIA — O, mama! Ti je e çuditshme!

YLVIA — Jo, unë, të keqen nëna! Unë jam si gjithë gratë, ti po bëhesh veç të tjerave. Ti që kishe marrë revan. (*Imiton të bijën.*) Jemi lidhur shpirtërisht. Ku i keni ato shpirtërat tani, ë? T'i thoshe nënës që në fillim si e qysh, t'i kishe thënë tët et, tët vëlla, moj korbë, që e ke dritë syri!

LIRIA — Ç'të thosha, moj, çfarë të të thosha?

YLVIA — Dashurikat e tua të thoshe, jo të kërcëje përpjetë se të ruante Sela. A e di ti, moj se si quhesh tani? Kështu siç u katandise?

LIRIA — Fëmija që kam në bark është e tija dhe e imja, ose më mirë e imja dhe e tija. Të gjithë e dinë.

YLVIA — I tij bëhet po të celebrhesh, po të firmoset atje në këshill, te ky matufi që hesht.

MAGANI — Nuk po hesht, moj grua, jo! (*Psherëtin.*) Po mendohem!

YLVIA — E ku ka kohë për t'u menduar, ore burrë! O fute në dhë të gjallë këtë, o jepi burrin, babanë e fëmijës, a kushdo goftë!

AGIMI — Burrë me zor? Burrë sa për t'u quajtur e martuar? Po pse të tepërt e kemi këtë? Më dhemb shpirti që ndodhi kështu, po derisa kjo është e fyer nga ai, e poshtëruar ashtu jemi dhe ne, të fyer e të poshtëruar.

YLVIA — U bë dhe ky me të. Po a di ti, more çun, se kush e shpëton tët motër tani? Ë? Vetëm burri, cilido goftë ai.

AGIMI — Dhe kjo të vuajë tërë jetën. Të jetë e larë

dhe e lyer me buzë të kuqe para opinionit, me unazë në gisht, por me një burrë që e urren? Po pse, moj nënë, kalohet jeta ashtu?

YLVIA — Ore, ejani në vete se po flisni përçart! (*I drejtohet të shoqit.*) Hë, ore burrë, mjaft u mendove! Kë namuz ti, ke dorë apo të është tharë?

LIRIA — Qëllomë, baba! Nëna të ka thënë dy herë. (*Magani ngrihet, afrohet drejt së bijës. Dhe Liria pret që ai të qëllojë po ja, që të dy përqafohen me dhimbje.*)

YLVIA — Shiko ky!

MAGANI — Oj, grua, nuk ndreqet gjë duke qëlluar me shuplakë fëmijët kur gabojnë! S'duhet ti kishim lënë të gabojnë, moj, e more vesh ti apo jo?

YLVIA — Po pse, ore, na pyeti ne kjo e ne i thamë: gabo, gabo, bijë, se...

MAGANI — Nuk na pyeti, por ama edhe ne nuk e pyetëm. Pritëm vetëm kur çdo gjë kish marrë fund midis tyre, e njohëm atë kur ai që bërë i dashuri i kësaj e jo që kur ishin shokë.

YLVIA — Atëherë, si thua ti, del që çdo djalë që njuh çupa duhet ta fusë në shtëpi, ë? Ta njohë ajo, ti, unë, halla, e çaja, tezja e xhaja. Ja ku e ke të vëllanë, e njohu ky!... Apo nuk e njohë ti, more bir, Jakubinin, ë?

AGIMI — Jo, nënë! Asnjëherë s'kemi ngrënë bukë të tre, as kafe s'kemi pirë, as në metalurgji, as në qytet. As kjo s'më pyeti kurrë se ç'mendje kisha unë për të, veç kur më tha Sela se...

YLVIA — (*Përqesh të birin.*) Paske pritur të ta thoshte Sela? Pse të mbyllur i kishe sytë ti? Po ti, moj shushkë ti, moj, ku i kishe mendtë.

MAGANI — Mos ju hakërre ashtu fëmijëve, oj grua! Kësaj iu veshën sytë, u rrëmbye pas tij, iu dha dhe e besoi. siç duhet të besojë njeriu te njeriu, moj grua. I lidhi puna, halli, djersa që derdhën bashkë, dashuria që i lindi në shpirt. Oj Ylvia, erdhi kohë tjetër!...

YLVIA — Jo, or burrë, jo! Mos marr mendtë e të rinjve se nuk u shkojnë thinjave të tua! S'ka të bëjë koha fare me këtë punë. Edhe dje, edhe sot, edhe nesër, njëlloj është ky turp. Ç'na llafos edhe ti sikur jemi në mbledhje. Të është bërë zakon ty me dynjanë dhe hamron se je në shtëpi, se po të bje mbi kokën tënde hataja, se jot bje, është në rrezik. Gruaja rron nën hijen e burrit. Burri është çadra e gruas! Dhe kjo s'ka shpëtim tjetër veg të martohet me të një orë e më parë. Këtë të bëni ju të dy, jo të përdridhni buzët e të mbani konferenca brenda në shtëpi.

*(Liria s'duron dot, dhe qëllon me grusht tavolinën.)*

LIRIA — Amani, se më çmendët! Si në punë, si në shtëpi, gjyq!

YLVIA — Shiko, shiko! Po ti, moj e shkrete, më mirë qëllo veten tënde! Mbledhe, moj, radaken, e nënshtroju fatit! E deshe, vajte me të deri atje... Merrre, tani, hajt dhe vëri kapak të gjithave!

LIRIA — Atë nuk e marr. Ai doli tjetër për tjetër. Ai gjatë kohës që rrinte me mua, që u njoh e u dashuria me mua, ka dashur dhe një tjetër atje në Tiranë.

YLVIA — Atëherë leria asaj të Tiranës e ti mbaj kopilin!

MAGANI — Pusho, moj, ç'flet dhe ti!

YLVIA — Nënë jam dhe do të flas si të më vijë, se më dhemb shpirti. *(Bie zilja e derës. Të gjithë ngrijnë, Më shumë Ylvia.)*

LIRIA — Kush të jetë?

AGIMI — *(Mbledh supet.)* Tani, kaç vonë?

YLVIA — Luaj dhe hap derën, se mua s'më bëkan këmbët! Do të këtë mbaruar mbledhja. Ai do të jetë. Do ta kenë zgjidhur hallin tonë.

MAGANI — Nuk zgjidhen në mbledhje këto punë, oj grua!

YLVIA — Ngrehu, hap derën ti, atë bëj! *(Magani hap derën, hyn Sela.)*

SELA — Mirëmbrema!



YLVIA — O, Sela! (*Ngrihet dhe e përqafton.*) A, more bir, ti i dole borxhit kësaj dhe neve! Dhe tani na kujtove. Ulu të keqen, ulu se të sheh Ylvia, s'je pa habere ti! Hë të keqen, fol, a mbaroi mbledhja?

SELA — Ahu, ka gjysmë ore!

YLVIA — Hë, po si? Fol, të shkretën!

SELA — (*Mbledh supet.*) S'di gjë. Të betohem që s'di gjë! Po ju ç'keni kështu? (*Tani ai sikur e blen situatën.*)

AGIMI — Po ja, nëna është pak e shqetësuar. (*I bën me shenjë për Lirinë.*)

SELA — Aa!

MAGANI — Nëse di ndonjë gjë na e thuaj!

SELA — Po.. si t'ju them... Megjithëse hakçe unë erdha për çështje pune.

YLVIA — Ç'punë, mor Selë, se të kam si vëllanë e djalit, s'kemi mend për punë sonte, o Selë!

LIRIA — Mos vallë erdhën detalet?

YLVIA — Çfarë detalesh, more të keqen!...

SELA — Ato tri copë për të cilat u bë ballafaqimi, nënë. I kishte pasur Jakubini në zyrë. Tha se i kishte ngatërruar me porosinë e uzinës së çelikut. Na kërkoi njëqind të falura dhe iku.

YLVIA — Si iku? Ku iku?

SELA — Nuk e di. Me drejtorin iku. Të dy u nisën për në Tiranë me gazin e drejtorit. Aty brenda, në se diljen prapa ishte dhe Sinani. Do të shkonin tek ai... ai pra, shoku Ajdin. Sinani i kishte thënë daj Hysës se do f'ia numëronte të gjitha, një për një, (*Liria vesh xhupin e saj. Merr xhupin e të vëllait dhe ia hedh, po në vend të tij e pret Sela.*) Si, do të vish dhe ti? Të them të drejtën, unë erdha vetëm sa për të marrë Agimin se e di që ato mezi montohen.

YLVIA — Daleni, more! Ç'bëni? Ku do të shkoni kështu? Shiko si i qeshi nuri këtij!

SELA — Unë jam punëtor i thjeshtë, nënë, këta kam përgjegjësa, ç'të bëj unë! S'mund të rrija dot pa

ardhur. E di që është vonë, natë, që ju këni halle...  
po dhe puna...

YLVIA — Mirë bëre, se... nejse, po rri dhe ca, të lla-  
fosemi! Të të bëj një kafe?

LIRIA — Mos na vono, nënë! Kemi tri ditë që i presim  
ato detale, për ato u vonua tri ditë furnalta.

MAGANI — Atëherë nga një gotë të vogël raki. Hë, moj  
grua, luaj!

YLVIA — (Ngrihet.) Jua sjell nënëzeza! U gëzoka çupa  
për detalet... eh!...

SELA — (E ndalon.) Jo, nënë Ylvie! Lëre rakinë! Kjo s'të  
lë ta pish fshehurazi, jo më në sy të saj. Ikëm ne.  
Do ta pimë rakinë nënë, veç mos u mërzit! (Dalin  
që të tre.)

YLVIA — (Si e hutuar.) E mo burrë, po kësaj ç'i thonë?  
Vajza me një barrë halle iku! (Magani në dritarë  
ua bën me dorë.) Shiko, ky ua bën dhe me dorë,  
sikur po shkojnë në dasmë. O zot, unë s'jam në  
vetel! Si do t'i vejë halli vajzës, o burrë?

## TABLOJA E GJASHTË

(Në shtëpi. Po ai dekor. Magani lexon një libër. Ylvia është duke mbaruar me shtizë një triko të vogël fëmijësh.)

YLVIA — Nuk mundem. Nuk e bëj dot. Nuk më bëjnë duart. Ajo ka luajtur mendsh që ka vendosur ta mbajë fëmijën. Fëmijë pa baba! Po Selaudini ç'tha djë? Po Sinani, sekretari i Partisë, ç'tha?

MAGANI — Thanë se kemi një gocë trime e të rrallë.

YLVIA — Po, jo! E rrallë na u bë! Me gisht do e tregojnë të gjithë. Atë dhe fëmijën e saj. (Merr trikon dhe vazhdon të punojë. Magani nis të lexojë. Ylvia e shikon me inat.) Aman, o burrë, si të lexohet? Ato librat ta kanë prishur mendjen ty dhe asaj. (Magani nuk reagon.) Me kë flas dhe unë. Thyej gishtat, moj korbë, e ngryse pleqërinë me turp, bëj triko për fëmijën e botës!

MAGANI — Nuk është i botës, jo! Është yni, i bijës sonë.

YLVIA — I bijës sonë? Ku e ke tët bijë, ë? U bë një javë që vjen natën si hajdute e ikën pa gdhirë si kaçake.

MAGANI — Atje e ke, në furrnaltë, me vëllanë, me shoqët.

YLVIA — Ç'bëhet atje, o burrë? Harroi goca shtëpinë, harroi hallin e saj fatzeza!

MAGANI — Nuk thua shyqyr, se ti desh na i vure zjarrin shtëpisë.

YLVIA — Zjarrin e kam këtu. (Vë dorën në stomak.)  
Shuk, më djeg, më përvëlton e më lë pa gjumë.  
S'do më tresë dheu!...

MAGANI — Kukudh bëhu, veç asaj mos i bjer në sy!  
Ç'pandeh ti, moj, se unë e kam të lehtë këtë turp,  
ë? Ç'e zë njeriun e s'e duron. Më dridhen duart  
kur e përkëdhet. Pak ka hallet e saj të punës, të  
fëmijës, po dhe tonat, mërzitjen e dëshpërimit  
tënd e tmin. Jo, grua, ne duhet t'ia lehtësojmë  
dhimbjen, more vesh?

YLVIA — (Mezi e përmban veten.) Mora vesh si jo, mora.  
Ashtu si thua ti, duhet të kemi zemër prej guri.  
(Nis e qan.)

MAGANI — Oj grua, mblidh mendtë se po e tepëron!  
Ja, kjo kohë erdhi dhe çupa birinxhi po rron, po  
punon. Po të kish bërë vaki kjo gjë më kohën tonë?  
Ty, moj, hë?

YLVIA — Mos ma zër më në gojë, kohën se më plase!  
S'ka faj kolia hiç! Mendtë, mendtë e saj dhe to-  
nat që e lamë gocën azat... Lexo aty, lexo! Dhe  
unë me kë flas.

MAGANI — S'ke me kë të flasësh tjetër, më mua do të  
flasësh.

(Hyn Agimi i veshur me rrobat e punës dhe qëndron  
i gëzuar para së ëmës. Ylvia e shikon me dyshim.  
Lë trikon dhe ngrihet e shqetësuar.)

YLVIA — Fol, të keqen nëna, ç'e ke atë gëzim në sy,  
hë?

(Agimi kërkon në aneks, te dera e dhomës tjetër.)

MAGANI — Kë kërkon kështu; more bir?

AGIMI — S'paska ardhur Liria? Atëherë duhet të jetë  
akoma në komitetin e partisë. Nesër u dorëzojmë  
furnaltën shokëve të shfrytëzimit. Kam frikë se  
mos vomohet. Si nuk u ktheva atje, ta hajë dreqi,  
ta hajë!

MAGANI — Po fol, more bir, ti seç ke?

AGIMI — (I shqetësuar.) Ku di dhe unë, more baba, lajm  
të mirë, a lajm të keq. Ehu, u bë gurguleja sot!

Pesë orë mbledhje. Ia vunë dy këmbët në një këpucë.

MAGANI — Kujt, more bir, s'po të marr vesh?

AGIMI — Atij, pra. U kthye mbrëmë nga Tirana. Sot pasdite u bë mbledhja e kolektivit.

YLVIA — Për kë?

AGIMI — Për atë, pra, për Jakubin!

MAGANI — Dhe...

AGIMI — Ai kërkoi ndjesë, kërkoi që çdo gjë të jetë si më parë, ishte penduar dhe kërkoi që të vijë këtu. Tani, të pijë kafe me ne, me Lirinë, sigurisht, nëse e pranon ajo.

MAGANI — Po Liria s'ditka gjë kështu? S'paska qenë në mbledhje ajo?

AGIMI — Jo, s'erdhi! S'deshi të vinte ndaj dhe unë s'di ç'të them.

YLVIA — E po, domosdo! I ka ardhur turp. Shpëtuam, po burrë. Dhe ty të pastë nëna, o bir, se ma hoqë të keqen, ma zbardhe faqen! Si do të rrija unë me gjithë atë turp? Ku është ai? Ë?

AGIMI — Kush?

YLVIA — Po ai, Jakubini?

AGIMI — Aa, aty përjashta, përtej trotuarit. Është futur nën strehën e mapos se filloi shiu.

YLVIA — *(E shikon si më frikë të shoqin.)* Po s'bën ta lemë atje. Sikur s'bën, ë? Po kjo goca dhe sonte e gjeti të vonohet? Ah, moj bijë, mbete mbledhjeve! Shko thirre, hë të keqen nëna! Shko e thuaj se përjashta, është ai, se po e pret.

AGIMI — *(Afrohet te dritarja, e shikon. Nervozohet dhe vjen vërdallë. Ylvies dhe Maganit nuk i pëlqen veprimi i djalit.)* Si t'ia bëj?

YLVIA — Ja ku është komiteti i partisë, një çap e ke. Shko e thirre tët motër ose shko e merre atë, mos e lër përjashta!

AGIMI — Po prit, moj mama! Prit të shkretën të vijë ajo, të bisedojmë!

YLVIA — Ç'të bisedojmë, more! *(Shikon me vëmendje*

të shoqin dhe të birin.) Po ç'keni xhanëm, nuk gëzoheni që ai po pret përjashta? Shkoni e thirreni, shkoni e merreni!

MAGANI — Prit, moj grua, të vijë Liria njëherë!... Të bisedojmë.

YLVIA — Ç'të bisedosh? Me kë të bisedosh? Me tët bijë? S'ka si të mos e dojë një grua babanë e fëmijës së vet.

MAGANI — Oj grua, si morën udhë punët s'mund të ndërhyjmë më midis tyre.

YLVIA — Si ore, s'hykam unë në punët e sime bije? Ngrehuni dhe futeni brenda! Ngrehu, burrë, e mos e lërë përjashta, në shi. Pse, nuk gëzohesh që shpëtuam, xhanëm?

MAGANI — Prit, moj grua, mos më nxit! Nuk ma merrte mendja kurrë që do të vinte një çast si ky e të mos di se si do të veprojë ime bijë me një räst të tillë dhe unë të jem kaq i pafuqishëm për të ndikuar tek ajo, t'i them mirë, merrë, apo t'i them mos e merr.

YLVIA — Ahu, ti s'je në vete, po ti, more bir, ç'thua? Ti erdhe i gëzuar. Të pashë në sy gëzimin. Fol, foli nënës! (*Agimi e shikon me dyshim të atin dhe mbledh supet. Ylvia nxehet.*)

YLVIA — Mblidhni, ore, veten! Mblidhjani dhe asaj!

MAGANI — T'ia japim me zor, nga halli apo nga turpi?

YLVIA — Hajt, hajt se çdo gjë rregullohet! Ehu sa kemi parë që janë ndarë dhe janë bashkuar.

MAGANI — Pikërisht se nuk më pëlqen kjo modë, nuk mund t'i flas asaj. Ajo e di vetë, ajo...

YLVIA — Ajo le t'i verë gishtin kokës, atë të bëjë ajo!

AGIMI — E ç'faj pati ajo, moj mama, se ai qëlloi maskara, abuzoi në çiltërsinë e saj? Veç ta dëgjonte se si fliste në mbledhje, të thoshit ju se ai...  
(*Hapet dera dhe hyn Liria e gëzuar.*)

LIRIA — Mirëmbërëma! Si u ngrysët?

YLVIA — Hë, moj bijë, erdhe?

LIRIA — (*Puth të ëmën.*) Deri tani në mbledhje, mama.

Nesër fillojmë provat me ngarkesë. Është caktuar një shtab i tërë si shtab lufte, baba. Vajtëm të gjithë, hipëm e zbritëm disa herë deri në majë të furrnaltës. S'ke ide, mama, se sa bukur, duken dritat e gjithë kombinatit si të jetë një botë e tërë me yje, tamam sikur ka zbritur një copë qiell.. Uzina 12 duket si Arusha e Madhe, kurse ylli mbi oxhakun e saj, duket si Ylli i Mëngjesit. O, një botë e tërë, një botë e tërë dritash! (*Të vëllait.*) Dhe pompat i kishe rregulluar, ë?

AGIMI — Kishte pasur një defekt që mezi e gjetëm. Duhej të ishte montuar keq që në fabrikë, që kur ka qenë prodhuar.

YLVIA — Shiko ky!... Thuaj ç'ke për të thënë, thuaji se ai...

LIRIA — (*Tani vë re shqetësimin e s'ëmës.*) Ç'ka ndodhur, mama?

AGIMI — Ai, pra, Jakubini, pas mbledhjes së kolektivit erdhi në furrnaltë. Sa kishe ikur ti.

LIRIA — Më thanë që po më kërkonte.

AGIMI — Bisedoi gjerë e gjatë me mua. Ai është përdur për gjithçka dhe do që çdo gjë të jetë si më parë. Zëre se s'ka ndodhur asgjë. Do të bisedojë patjetër me ty, me ne të gjithë. E presim të vijë. Kishte qejf të pinte një kafe këtu, në shtëpinë tonë. (*Lirisë i ka mbetur një mëngë e xhakëtës pa hequr, E tronditur, duke dëgjuar të vëllanë, përpiqet të veshë mëngën.*)

YLVIA — Është jashtë në rrugë? Ky thotë se është në strehën e mapos. Shko, bir, e thirre! (*Shikon të bijën.*) Sa për një kafe.

LIRIA — Me ju po, mund të pijë ç'të dojë, kurse me mua jo! Jo, po ju them dhe mos më shikoni ashtu! S'kam mbetur rrugëve që të marr atë njeri me dy fytyra, apo me tri. Jam e zonja e vetes sime dhe fëmija im, kur të rritet, do të jetë më zot se unë. Më vjen keq për ju, sidomos për ty, nënë, që s'do të më kuptosh. (*Ylvia e shikon e habitur.*)

O nënë, po ti duhet të gëzohesh që unë dhe fëmija im shpëtuam nga një njeri si ai!...

YLVIA — Sido që të jetë është babai i fëmijës...

LIRIA — O, nënë, unë e urrej atë, nuk e pranoj si njeri, ti thua të shkoj më tej. Jo! Nëse gabova një herë e nëse shoqëria më fali lehtësinë me të cilën e dashurova pa e njohur thellë, s'do të më falë kurrë që të mbyll sytë para poshtërsive të tij, të bëhem skllave e tij. (*Duke veshur chakoventon.*) Ku the se është futur?

YLVIA — Nën strehën e mapos. (*Liria mbledh buzët me neveri.*)

LIRIA — E po sigurisht po bie shi. Ka frikë se laget.

MAGANI — (*E ndalon.*) Prit, bijë!

AGIMI — S'ka ç'të presë më, baba! E pat kjo punë! S'do, s'do! Dhe ka hak.

YLVIA — Si, more, paska hak? Bijë, mblihd mendtë!

LIRIA — Top i kam mendtë.

YLVIA — S'të lë. (*I del përpara.*) Më thuaj ç'do të bësh me gjithë këtë mëri?

LIRIA — Atë që meriton do të bëj, do ta qëlloj në fytyrën tjetër, se ai ka dy fytyra. A e di ti, moj nënë, pse u kthye ai sërish tek unë, pse pret atje në shi që të vijë këtu? Sepse ia prenë shpresën atje në Tiranë, sepse e flakën në rrugë, sepse në kombinat shokët e tij, punëtorët e dënuan rëndë. Ja, pse pret ai nën strehën e mapos, që të mos laget, që të shpëtojë. Ai është gati ta bëjë të zezën të bardhë. Jo, nënë, mos na e ndyj shtëpinë me një njeri si ai. (*Niset por e ndalon i vëllai.*)

AGIMI — Lermë mua, motër! Kam kohë që më hanë duart për atë surrat! Vete dhe ia jap unë atë dackë, që të thyejë qafën nëpër shi, deri në guroren e Letanit, atje ku e kanë detyruar të thyejë gurë. (*Niset, po e ndalon i ati.*)

MAGANI — Jo, bir! Edhe nën strehë njeriu laget. Do të mërdhijë, duke pritur e do të iki atje ku i kanë thënë. Rrini, bijtë e mi. (*I merr nën krahë.*)



YLVIA — Edhe ti po merr anën e tyre, po merr mendtë e fëmijëve?

MAGANI — Po, të tyre. Do të kishim bërë më mirë t'i kishim nderjur më pranë e të kishim hyrë më shpejt në hallin e tyre. Kësaj iu gjendën më shumë shoqet e shokët sesa ti me atë frikën tënde dhe unë me atë besimin tim. Ai njeri që pret jashtë, është një turp, është një i pacipë. (Mbledh supet.) Si të them? Ai s'më hyri në shpirt, jo më ta fus në shtëpi, ai...

YLVIA — (Ia pret fjalën, Po...

MAGANI — (Le fëmijët e kap për supesh të shoqen.)

Qetësohu, grua! Në hallin tonë hyri i gjithë kombinati, i gjithë qyteti. Ata i dolën krah vajzës sonë. Ata e duan vajzën tonë si vajzën e tyre. Ata e dënuan më rëndë se ç'do ta dënonim ne. Përse duhet ta fusim në shtëpinë tonë? Le të jetë një hije, një hije që nesër do të tretet. Na shtro darkën, grua, se ja, jemi tok të gjithë ashtu siç do ti!

LIRIA — (E ngashëryer.) O, baba! E dija që do të më kuptoje!

(Futet në gji të të atit)

(Bie perdja)

## PËRMBAJTJA

<b>KUR NDERROHEN KOHERAT</b> .....	3
<b>MBAS DY VJETËSH</b> .....	59
<b>NË PRAG TË JETËS</b> .....	119
<b>NË JETË</b> .....	175

Xhuvani, Dp.  
 Drama [Red: S. Dajç] T.  
 -Naim Frashëri, 1988  
 - 228 f.  
 (lib.) : 891.983-21  
 (B.e.) : 891.983-2  
 Xp 97

Recensentë:  
 Djalvet Djalvet,  
 Naim Pili

Tirazhi 1000 kopje      Formati 12x18cm/32      Shteti 2504-82  
 KOMBINATI POLIGRAFIK — Shkupskovalja e Re      Titovë 1992